

# NENTORI

---

ORGAN I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE  
ARTISTËVE TË SHQIPËRISË

*Revistë e përmuajshme  
letrare artistike  
shoqërore politike*

Nr. 5, VITI XXIV I BOTIMIT,  
MAJ, 1977

## PËRMBAJTJA:

	Faqe
<b>PLENUMI I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE</b> (mbajtur më 11, 12 e 14 mars 1977)	
Mësimet e Partisë — burim i madh frymëzimi për pasqyrimin revolucionar të realitetit tonë socialist — Fjala e shokut <b>Ramiz Alia</b> mbajtur në plenum .....	5
Letërsia dhe artet të ndjekin ritmet e zhvillimit të shoqërisë sonë — Raport i shokut <b>Dritëro Agolli</b> .....	37
<b>NGA NËNREFERATET E DISKUTIMET PËR LETËRSINË</b>	
<b>LLAZAR SILIQI</b> Forcimi i vazhdueshëm i partishmërisë proletare — detyrë bazë për zhvillimin e arteve tona .....	65
<b>JAKOV XOKA</b> Të forcojmë karakterin kombëtar popullor të letërsisë sonë .....	96
<b>ISMAIL KADARE</b> Zhvillimi i letërsisë sonë në luftë me presionin borgjez e revizionist .....	106
<b>DHIMITËR S. SHUTERIQI</b> Folklori letrar dhe letërsia e kultivuar .....	116
<b>KOÇO BIHIKU</b> Temat e mëdha dhe mishërimi i karakterit të heroit pozitiv .....	126
<b>DHIMITËR XHUVANI</b> Të njohim më thellë klasën punëtore .....	136
<b>TEODOR LAÇO</b> Konflikti dhe karakteri në dramë .....	140

	Faqe
<b>DALAN SHAPLLO</b> Pasqyrimi i drejtë i kontradiktave në letërsi .....	146
<b>FATOS ARAPI</b> Frymëzimi militant e i partishëm i poezisë sonë .....	151
<b>LAVDIE LEKA</b> Për një pasqyrim më të drejtë të figurës së gruas në letërsi .....	156
<b>FOTO MALO</b> Aspekte të mbështetjes në folklor .....	161
<b>KOÇO KOSTA</b> Shkrimtari dhe njohja direkte e jetës .....	166
<b>BASHKIM ÇUÇI</b> Punëtori — hero i kohës sonë .....	171
<b>NDOC PAPLEKA</b> Jeta të pasqyrohet me vërtetësi, në zhvillimin e saj revolucionar .....	173
<b>NDUE ZEF TOMA</b> Proza e shkurtër dhe aktualiteti .....	177
<b>XHEZAIR ABAZI</b> Pasqyrimi i figurës së komunistit në letërsi .....	182
<b>NEKI LEZHA</b> Jeta e sotme — burim temash të reja .....	185
<b>NGA NËNREFERATET E DISKUTIMET PËR ARTET FIGURATIVE</b>	
<b>FOTO STAMO</b> Probleme të partishmërisë proletare në artet figurative .....	191
<b>KUJTIM BUZA</b> Forcimi i karakterit kombëtar e popullor. 200	
<b>MUMTAZ DHRAMI</b> Zhvillimi i arit tonë në luftë me artin dekadent borgjezo-revizionist .....	209
<b>FUAT DUSHKU</b> Artet figurative dhe krijimtaria popullore .....	219
<b>KRISTAQ RAMA</b> Tablotë e gje- ra të jetës dhe heroit pozitiv .....	227
<b>ZEF SHOSHI</b> Ngjarjet e mëdha të jetës në pikturën tonë .....	235
<b>ANDON KUQALI</b> Zhvillimi harmonik i të gjitha gjinive 240	
<b>SHABAN HADËRI</b> Monumentaliteti i jetës sonë dhe pasqyrimi i tij në skulpturë .....	246

	Faqe
VILSON KILICA Mbi thellimin e psikologjisë së portretit në pikturë .....	249
KSENOFON DILO Piktura monumentale .....	254
SKËNDER MILORI Për një zhvillim të mëtejshëm të pllakatit .....	258
KSENOFON KOSTAQI Përdorimi i materialeve të forta në skulpturë .....	261
<b>NGA NËNREFERATET PËR MUZIKËN</b>	
NIKOLLA ZORAQI Krijimtaria muzikore të lidhet më ngushtë me jetën e popullit ...	267
SIMON GJONI Mbi forcimin e frymës e të fizionomisë kombëtare të muzikës e koreografisë sonë .....	277
FEIM IBRAHIMI Muzika jonë në luftë kundër artit borgjez-revizionist .....	289
BENIAMIN KRUTA Folklori dhe krijimtaria muzikore e koreografike .....	297
ÇESK ZADEJA Pámjet e gjëra të jetës dhe heroi pozitiv në krijimtarinë muzikore ...	306

*Nënreferatet dhe diskutimet botohen me disa shkurtime*

# MESIMET E PARTISE – BURIM I MADH FRYMEZIMI PER PASQYRIMIN REVOLUCIONAR TE REALITETIT TONE SOCIALIST

FJALA E SHOKUT RAMIZ ALIA  
NE PLENUMIN E LIDHJES SE  
SHKRIMTAREVE DHE TE ARTISTEVE

Të dashur shokë dhe shoqe,

Ky plenum i zgjeruar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve është një përpjekje e frutëshme për të zbërthyer e kuptuar më thellë vendimet e Kongresit të 7-të të Partisë dhe për të konkretizuar detyrat e mëdha e të rëndësishme që shtroi ai për letërsinë dhe artin.

Diskutimi në seksione, për letërsinë, artet figurative dhe muzikën që një praktikë e dobishme, sepse krijoi mundësi jo vetëm për një pjesëmarrje më të gjerë në shkëmbimin e mendimeve, por shërbeu edhe për t'u thelluar më mirë në problemet që shtron Partia e shoku Enver para krijimtarisë artistike.

Dëshiroj të theksoj se në punimet e plenumit tuaj, në seksione dhe këtu në mbledhjen plenare, të gjithë shokët mbështetën pa rezerva vendimet e Kongresit dhe



shprehën vendosmërinë e gjithë shkrimtarëve dhe të artistëve për të luftuar me këmbëngulje për vënien në jetë të tyre. Ky unitet me Partinë, me mësimet e vijën e saj ka rëndësi të dorës së parë.

Kongresi i 7-të ishte një ngjarje me rëndësi të madhe historike për fatet e socializmit dhe të revolucionit në vendin tonë. Kongresi, që u karakterizua nga një unitet i çelëniktë i radhëve të Partisë, bëri një përgjithësim shkencor të eksperiencës për ndërtimin socialist të vendit dhe mbrojtjen e Atdheut, si dhe të luftës së saj për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit.

Kongresi i 7-të e në veçanti raporti i shokut Enver janë pritur dhe ndjekur me një interesim shumë të madh

dhe kanë ngjallur një jehonë të jashtëzakonshme si brenda ashtu dhe jashtë Atdheut. Punëtorët, fshatarët e intelektualët, gratë e rinia, gjithë populli ynë janë entuziazuar nga programi optimist që aprovoi Kongresi i 7-të, nga perspektivat e mëdha që hapi ai për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë e të kulturës, për forcimin e diktaturës së proletariatit dhe mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së Atdheut. Tani të gjithë punonjësit i janë përveshur punës me një frymë të lartë revolucionare. Inisiativat dhe aksionet e shumta për të zbatuar vendimet e Kongresit pasojnë njëri-tjetrit si në qytet, ashtu edhe në fshat.

Përpara detyrash të rëndësishme gjenden edhe lehtërsia dhe artet, të cilave Kongresi u hapi horizonte të

mëdha. Ato duhet të pasqyrojnë në art programin madhështor që aprovoi Kongresi për të ndihmuar drejtpërsëdrejti në mobilizimin e masave për vënien në jetë të vijës së Partisë. Kjo kërkon, mbi të gjitha, që të ngrihet në një nivel më të lartë ideoartistik vetë krijimtaria jonë, që çdo vepër artistike të përshkohet nga fryma dhe idetë e Kongresit, që realiteti ynë, tema e heroi, të shtjellohen simbas mësimëve të Partisë.

Për këtë arsye është e domosdoshme që krijuesit të njohin sa më mirë gjithë vijën që shtroi Partia në Kongres, të depërtojnë sa më thellë në direktivat e saj.

Problemet që u diskutuan në Kongresin e 7-të të Partisë janë të shumta dhe me rëndësi të madhe për të sotshmen e të ardhshmen e ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Shoku Dritero Agolli në referatin e vet, si dhe shokët e tjerë në grupe e këtu në mbledhjen plenare, duke folur për to vunë në dukje edhe detyrat që dalin para letërsisë dhe arteve. Unë dëshiroj të tërheq vëmendjen tuaj në disa probleme të politikës së Partisë, të cilat duhet t'i kenë parasysh në krijimtarinë e tyre të gjithë shkrimtarët e artistët.

Kongresi i 7-të hartoi dhe aprovoi një program të madh për mobilizimin e të gjitha forcave dhe energjive të vendit për të çuar përpara në mënyrë të pandalshme revolucionin tonë. Detyrat që caktohen u përgjigjen procesit të zhvillimit të luftës së klasave, përparimit të vendit në të gjitha drejtimet. Në këtë kuadër historik konkret tezat dhe idetë e raportit të shokut Enver Hoxha përbëjnë një zhvillim të mëtejshëm të vijës revolucionare të Partisë, një thellim marksist-leninist të saj mbi bazën e eksperiencës së fituar dhe të përgjithësimit të luftës së popullit tonë për ndërtimin e socializmit. Kjo ka të bëjë me të gjitha fushat e veprimtarisë, me ekonominë, me mbrojtjen, me kulturën, etj. Edhe direktivat, orientimet e detyrat që Kongresi shtroi përpara letërsisë dhe arteve rrjedhin nga një përgjithësim i rezultateve të arritura dhe i luftës së zhvilluar në këtë front për një art të vërtetë revolucionar, popullor e me një frymë e fizionomi të qartë kombëtare.

Kongresi i 7-të do të hyjë në histori si Kongresi që shqyrtoi dhe i dha vendit Kushtetutën e re të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, e cila sanksionon fitoret e arritura deri më sot dhe garanton të ardhmen tonë socialiste. Duke patur në bazë të saj mësimet e marksizëm-leninizmit dhe përvojën revolucionare të popullit tonë në luftën për ndërtimin e socializmit, ajo qëndron në mbrojtje të diktaturës së proletariatit, të lirisë, pavarësisë

dhe sovranitetit tonë kombëtar, të demokracisë dhe të drejtave të mëdha të qytetarëve tanë. Kushtetuta thekson rolin udhëheqës e të pandashëm të Partisë së Punës në Shqipërinë socialiste. Në tërësinë e saj Kushtetuta jonë është një dokument me rëndësi shumë të madhe teorike e praktike, politike e ideologjike ku do të mbështetet zhvillimi ynë shoqëror, ekonomik e kulturor në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Studimi i ligjit themelor të shtetit tonë është një kusht i domosdoshëm për të kuptuar mirë thelbin e sistemit tonë shoqëror dhe procesin e zhvillimit revolucionar të tij.

Kongresi aprovoi një program madhështor për zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit për periudhën e ardhshme. Atdheu ynë ka arritur suksese të mëdha në të gjitha fushat. Është një fitore kolosale, që tani e gjithë buka prodhohet në vend, që industria jonë jep 85 për qind të të gjitha mallrave të konsumit që i nevojiten popullit, që 95 për qind e veglave të këmbimit të makinave e të pajisjeve që kemi në përdorim do të prodhohen në vend. Fitore të rëndësishme janë arritur në zhvillimin e arsimit, të kulturës e të shëndetësisë, në ndërtim e komunikacion, etj. Ndryshimet e shumta që kanë ndodhur flasin për zhvillimin e vrullshëm të forcave prodhuese, flasin për potencialin e ekonomisë sonë. Por ato flasin edhe për aftësitë e talentin e njerëzve tanë, të punëtorëve e fshatarëve që gjithnjë më mirë po zotërojnë teknikën e teknologjinë, shkencën dhe të fshehtat e saj.

Ky zhvillim e përparim i madh na mbush me gëzim. Forca e ekonomisë sonë dhe stabiliteti i saj janë në kontrast të madh me tronditjet katastrofike që po shkakton kriza në vendet kapitaliste e revizioniste. Kudo rritet papunësia, ulet niveli i jetesës, ngrihen çmimet, shtohet pasiguria dhe frika për të sotmen dhe të nesërmen.

Borgjezia e revizionistët kërkojnë rrugëdalje nga gjendja e vështirë në të cilën ndodhen. Kurse tek ne Partia planifikon zhvillime të reja gjithnjë e më optimiste. Vija e Partisë është ta shndërrojë Shqipërinë në një vend industrialo-bujqësor, me industri e bujqësi të përparuar. Kjo do të arrihet nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të industrializimit socialist, ku përparësi, ashtu si deri më sot do t'i jepet industrisë së rëndë, veçanërisht shfrytëzimit të pasurive minerare të vendit, të naftës, kromit, bakrit, etj.

Kongresi i 7-të i Partisë theksoi rëndësinë e madhe që duhet të vazhdojmë t'i japim bujqësisë, e cila mbetet



dega bazë e ekonomisë. Lufta për zhvillimin e gjithanshëm e të shpejtë të bujqësisë është një ndër detyrat më kryesore, është luftë drejtpërsëdrejti për socializmin dhe pavarësinë. Në këtë luftë objektivi kryesor është sigurimi i vazhdueshëm i bukës në vend.

Të gjithë punonjësit, pra edhe shkrimtarët dhe artistët duhet të mobilizohen totalisht për të zbatuar me sukses direktivat e orientimet e Kongresit. Të gjithë duhet të njohin mirë politikën e Partisë në fusha të ndryshme. Për shkrimtarin dhe artistin kjo merr një rëndësi të veçantë, se ai si ndihmës i Partisë, duhet t'i ketë ato në qendër të krijimtarisë së vet, t'i pasqyrojë drejt dhe të luftojë për realizimin e tyre.

Në raportin e shokut Enver një vend të rëndësishëm zënë problemet që kanë të bëjnë me forcimin e pandërprerë të diktaturës së proletariatit, me rritjen e fuqisë mbrojtëse të Atdheut, të lirisë e të sovranitetit kombëtar. Këto çështje marrin rëndësi të veçantë sidomos në gjendjen aktuale, kur kundër socializmit në përgjithësi, por edhe kundër Shqipërisë socialiste në veçanti, thuren plane agresive e bëhen sulme të llojeve të ndryshme për të na larguar nga rruga e drejtë dhe për të na mbytur. Prandaj Kongresi kërkoi nga të gjithë që mbrojtjen e Atdheut ta konsiderojnë detyrë mbi të gjitha detyrat dhe të vënë të

gjitha forcat për të realizuar një për një e deri në fund të gjitha kërkesat që shtron përgatitja luftarake e të gjithë punonjëseve dhe rritja e vigjilencës.

Shoku Enver në Kongresin e 7-të u kushtoi një rëndësi të veçantë problemeve të edukimit komunist të masave me idetë e marksizëm-leninizmit, lidhur ngushtë me përvojën tonë revolucionare. Edukimi komunist i njerëzve është kushti bazë për të realizuar detyrat e mëdha që kemi përpara, sepse dihet që «socializmi është vepër e ndërgjegjshme e masave». Ideologët borgjezë e revizionistë përpiqen të çorodisin njerëzit, bëjnë çmos që të diskreditojnë idealet komuniste, me qëllim që t'i largojnë masat nga rruga e revolucionit. Në këtë drejtim ata përpiqen të influencojnë edhe në njerëzit tanë. Për këto arsye Kongresi shtroi detyrën që të forcohet puna ideologjike e politike e Partisë me masat, që secili të punojë e studjojë pa u lodhur për t'u bërë një luftëtar besnik i Partisë, kurdoherë i gatshëm për t'ia kushtuar energjitë, talentin dhe jetën e vet ndërtimit socialist dhe mbrojtjes së Atdheut, plotësimit të idealeve komuniste.

Letërsia dhe artet janë një front i rëndësishëm i punës së Partisë, që ka të bëjë drejtpërsëdrejti me edukimin komunist të masave. Një vepër artistike militante nuk ka vetëm karakter njohës, ajo nuk pasqyron realitetin në mënyrë pasive. Artisti revolucionar kurdoherë është edhe luftëtar aktiv, edukator e tendencioz. Ai me krijimtarinë e vet synon të mobilizojë njerëzit, t'i frymëzojë e edukojë ata, t'i nxisi që të luftojnë në rrugën e revolucionit për fitore të reja.

Partia dhe shoku Enver kërkojnë nga ne që të rrojmë me situatat. Ky problem u theksua në punimet e Kongresit. Kjo do të thotë, që kurdoherë të kemi parasysh kushtet në të cilat vendi ynë ndërton socializmin, gjendjen e brendshme e të jashtme, luftën e klasave, rrethimin dhe presionin e gjithanshëm imperialist e revizionist, krizën ekonomike që ka përfshirë botën dhe rreziqet e luftës, etj.

Si rrjedhim të jetosh me situatën, do të thotë të punosh me të gjitha energjitë, të prodhosh sa më shumë e sa më mirë, të jesh vigjilent e të mos kursesh asgjë për mbrojtjen e vendit, të mbash lart frymën revolucionare dhe të militosh aktivisht për çështjen e socializmit. Me situatën duhet të rrojnë edhe punëtori e shkrimtari, edhe nëpunësi e fshatari, edhe inxhinieri e propagandisti. Të gjithë, përditë e vazhdimisht duhet të punojnë sa më mirë që Shqipëria socialiste të rrojë e të përparojë, që ajo jo

vetëm ta përballojë me sukses rrethimin, por çka është kryesorja, ta çajë atë.

Vendi ynë i ka të tëra kushtet e nevojshme që të luftojë e të dalë fitimtar në këtë rrugë. Populli ynë është një popull trim, heroik e punëtor. Ai është i bashkuar në një unitet të çeliktë rreth Partisë, Komitetit Qendror të saj dhe shokut Enver. Atdheu ynë nuk është më vendi i analfabetizmit, i skamjes dhe i prapambetjes, por është një vend socialist me një industri e bujqësi të përparuar, me arsim e kulturë të zhvilluar, një vend i lirë me njerëz të lirë, të gëzuar e optimistë. Ne kemi një udhëheqje të sprovuar, Partinë heroike me shokun Enver Hoxha në krye, që për 35 vjet rresht me urtësi të rrallë, me guxim e vendosmëri e kanë çuar vendin nga fitorja në fitore.

Në këtë kuadër rëndësi të veçantë ka kuptimi i drejtë dhe zbatimi me konsekuencë i parimit të mbështetjes në forcat e veta. Ky është një parim me përmbajtje të thellë revolucionare, është një ligjësi e ndërtimit të socializmit e në të njëjtën kohë një domosdoshmëri imperative në kushtet e vendit tonë për t'u bërë ballë e për t'i çarë me sukses bllokatat e rrethimin armiqësor imperialisto-revizionist. Parimi i mbështetjes në forcat e veta ka karakter të përgjithshëm, prandaj duhet zbatuar në fushën e mbrojtjes dhe të ekonomisë, në politikë e ideologji, në arsim, kulturë e shkencë, në të gjitha sferat e jetës e të veprimtarisë së Partisë, të shtetit tonë e të shoqërisë.

Partia jonë, duke zbatuar këtë parim marksist-leninist, asnjëherë nuk ka menduar e as mendon të mbyllet në vetvete, të vetizohet apo të ndjekë politikën e autarkisë. Një gjë e tillë është absurde, e rrezikshme, në dëm të ndërtimit të socializmit. Kuptimi i cekët i këtij problemi çon ngandonjëherë në interpretime të gabuara, në thjeshtësime e vulgarizime të çështjes, gjë që është e dëmshme.

Shoku Enver, duke trajtuar këto probleme, si dhe ato mbi diktaturën e proletariatit, nuk i shtroi vetëm si çështje teorike, por u ndal në to edhe si çështje me rëndësi të madhe për fatet e socializmit dhe të ardhmes së Atdheut tonë. Të marrim çështjen e diktaturës së proletariatit. Sot në botë ideologët borgjezë e revizionistë bëjnë përpjekje të mëdha për të çoroditur njerëzit, për të dobësuar frymën revolucionare të tyre. Më shumë se kurrë spekulohet me fjalët «humanizëm», «liri», «demokraci», etj. Shumë flitet për «hapje» të dyerve, për çarkullim të lirë të njerëzve dhe të ideve, me qëllim që të favorizohet ekspansioni politik dhe ekonomik i imperializmit, i social-



imperializmit dhe i borgjezisë ndërkombëtare. Dhe sulmin kryesor të gjithë e drejtojnë kundër diktaturës së proletariatit, e cila gjoja mbyl lirinë e demokracinë, mbyll në vetvete vendin dhe e shkëput nga bota, etj. etj. Prandaj rekomandojnë zhdukjen e diktaturës së proletariatit, vëllazërimin klasor, «socializmin me fytyrë njeriu», e receta të tjera të këtij lloji, që po ua shohin «hajrin» në Bashkimin e sotëm Sovjetik e vendet e tjera revizioniste ku tashmë nuk ka mbetur asgjë komuniste.

Duke hedhur poshtë këto predikime djallëzore e kundërrevolucionare, shoku Enver argumentoi nevojën e forcimit të pandërprerë të diktaturës së proletariatit dhe theksoi se diktatura e proletariatit është dhunë, ajo është e rreptë kundër armiqve të klasës, kundër armiqve të socializmit, të brendshëm dhe të jashtëm. Ndaj tyre nuk ka vend për humanizëm. Këtë nuk e fshehim dhe s'ka pse ta fshehim, përkundrazi e pohojmë me zë të lartë.

Në të njëjtën kohë shoku Enver vuri në dukje se diktatura e proletariatit është pushteti më demokratik që mund të ekzistojë, sepse është demokraci, liri dhe huma-

nizëm për shumicën absolute të popullit, për klasën punë-  
tore, fshatarësinë dhe inteligjencien revolucionare e pa-  
triote, për të gjithë njerëzit e ndershëm. Demokracia, li-  
ria dhe humanizmi socialist tek ne kanë fushë të gjërë ve-  
primi. Diktatura e proletariatit, duke likuiduar pronën  
private dhe shfrytëzimin e njeriut prej njeriut, ka elimi-  
nuar faktorët kryesorë që kushtëzojnë gjerësinë e shtrirjes  
dhe karakterin e demokracisë, të lirisë e të huma-  
nizmit.

Problemet që shtroi Kongresi janë një program i  
gjerë për punën e shkrimtarëve e të artistëve. Lufta për  
realizimin e direktivave të Kongresit përbën frontin krye-  
sor të krijimtarisë e të aktivitetit të letërsisë dhe të artit,  
përbën edhe shprehjen konkrete të partishmërisë së tyre.

Marksizëm-leninizmi na mëson se partishmëria në  
artet është pjesëmarrja e drejtpërdrejtë dhe konsekuente  
e krijesve për të vënë në jetë vijën politike të Partisë,  
direktivat e orientimet e saj, për ta bërë artin armë të  
luftës së Partisë e të popullit për fitoren e revolucionit e  
të socializmit. Partishmëria është kërkesë dhe detyrë që  
Partia u shtron militantëve dhe ndihmësve të saj për ta  
propaganduar e çuar në masa vijën e vet, për të edukuar  
njerëzit me ideologjinë proletare e mësimet e saj, për të  
luftuar pareshtur për formimin revolucionar të njeriut të  
ri të shoqërisë socialiste. Të mbrosh në art partishmërinë  
do të thotë të luftosh praktikisht e konkretisht për mbroj-  
tjen e marksizëm-leninizmit, të mësimëve të Partisë sonë,  
të jesh frymëzues i idealeve komuniste dhe luftëtar për  
realizimin e tyre.

Partishmëria qëndron, në radhë të parë, në përmbaj-  
tjen ideologjike e politike të veprës, në atë sa militon kjo  
vepër për detyrat aktuale e konkrete që zgjidh Partia,  
sa është e lidhur ajo me preokupacionet e mëdha të po-  
pullit në etapën e dhënë, sa kontribuon në luftën e masave  
për të çuar përpara ndërtimin e socializmit.

Partishmëria është çështje themelore botëkuptimi e  
veprimi, pra ajo nuk është çështje personale, në kuptimin  
që secili në praktikë e realizon vetë sipas mënyrës që i  
pëlqen dhe aftësisë që ka. Ajo është e lidhur ngushtë me  
udhëheqjen e drejtpërdrejtë të krijimtarisë artistike nga  
ana e Partisë. Jashtë udhëheqjes së Partisë nuk mund të  
ketë krijimtari të partishme, nuk mund të sigurohet pas-  
tërtia ideologjike e saj, nuk mund të arrihet tenden-  
cioleteti klasor, nuk mund të bëhet një armë me të  
vërtetë e fuqishme në luftën për revolucionin e socializmin.

Nuk është e rastit që armiqtë e hapët e të kamufluar  
të të gjitha kohëve shigjetat e tyre të helmatisura i kanë  
drejtuar dhe i drejtojnë, në radhë të parë, kundër parti-  
shmërisë proletare në art, që lëshojnë kundër saj shpifjet  
e mallkimet më të tmerrshme. Ata e dinë mirë se çdo  
shmangie dhe largim prej saj çel shtigjet për depërtimin  
e ndikimeve të huaja ideologjike, i hap rrugën degjime-  
rimit borgjezo-revizionist, krijon mundësi për helmimin  
shpirtëror të masave, nxit kundërrevolucionin revizionist.  
Këtë deshën të bënin në vendin tonë armiqtë Fadil Paçra-  
mi, Todi Lubonja etj., të cilët u munduan ta largonin artin  
nga udhëheqja e Partisë dhe ta zhvishnin nga ideologjia  
proletare.

E gjithë propaganda borgjeze e revizioniste sot lufton  
në front të gjerë dhe me të gjitha mjetet për të vërtetuar,  
në kundërshtim me realitetin dhe përvojën historike, se  
ideologjia komuniste dhe politika e Partisë proletare e var-  
fërojnë, gjoja, anën artistike dhe emocionale të artit, niveli-  
zojnë stilet e mjetet shprehëse të tij, shuajnë individualite-  
tet artistike, etj. Qederi i tyre, sigurisht nuk është e «ardh-  
mja» e artit socialist, për të cilin ata derdhin lot krokodili.  
Ata e dinë mirë se art pa ideologji e pa politikë, as ka ekzis-  
tuar e as do të ekzistojë. Por ata nuk duan pikërisht ideo-  
logjinë e politikën proletare, këtë armë të fuqishme të re-  
volucionit, që i kërcënon e i tmerron për vdekje.

Prandaj kuptohet sa e domosdoshme dhe jetike është,  
sidomos në kushtet e rrethimit imperialisto-revizionist  
dhe të agresionit të huaj ideologjik, forcimi i partishmëri-  
së proletare, ruajtja e pastërtisë ideologjike e politike në  
krijimtarinë tonë artistike që i thekson në mënyrë të veçan-  
të shoku Enver në raportin e tij.

Për zhvillimin në rrugë të drejtë të artit dhe forcimin  
e partishmërisë së tij, rëndësi të veçantë ka kuptimi i  
drejtë i luftës së klasave, zhvillimi i saj simbas mësimëve  
të Partisë, si kundër armiqtë të brendshëm e të jashtëm,  
ashtu edhe në vetë gjirin e krijimtarisë artistike. Edhe  
në këtë drejtim Kongresi i Partisë na ka armatosur me  
mësimë shumë të vlefshme, të cilat duhet t'i kemi mirë  
parasysh.

Në raportin e shokut Enver në Kongresin e 7-të çësht-  
ja e zhvillimit të luftës së klasave në etapën e tanishme  
të revolucionit tonë, zë një vend të posaçëm. Partia jonë  
gjithnjë i ka vënë rëndësi këtij problemi dhe e ka bërë  
luftën e klasave me konsekuencë, si në plan kombëtar,  
ashtu edhe në plan ndërkombehtar. Në raportin e  
shokut Enver, si përgjithësim i përvojës së Partisë sonë,



nxirren disa konkluzione lidhur me kuptimin dhe zhvillimin sa më të drejtë të luftës së klasave. Aty theksohet teza e drejtë marksiste-leniniste, e sprovuar nga praktika, se lufta e klasave edhe në socializëm është një fenomen objektiv, forcë kryesore lëvizëse që përcakton zhvillimin e shoqërisë, se ajo zhvillohet e ashpër dhe në të gjitha fushat e veprimtarisë.

Në raport theksohet se gjithë përvoja jonë, veçanërisht ajo e kohëve të fundit, tregon se rreziku dhe armiku kryesor për socializmin në Shqipëri, si dhe për gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare, ka qenë dhe mbetet oportunizmi i djathtë, revizionizmi. Shprehje e theksuar e këtij lloji oportunizmi është liberalizmi, i cili, siç thekson shoku Enver, sido e kudo që të paraqitet, në thelb është heqje dorë nga lufta klasore, është pranimi i bashkëjetesës paqësore me ideologjinë armike. Te ne liberalizmi ka marrë goditje të forta, veçanërisht vitet e fundit, pas Plenumit të 4-të të këtej. Por në asnjë mënyrë e në asnjë rast nuk duhet «harruar» ky rrezik. Lufta kundër liberalizmit, si dhe kundër të gjitha shfaqjeve të tjera të oportunizmit, qofshin këto të djathta apo të majta, duhet zhvilluar me konsekuencë e me vendosmëri. Kongresi i 7-të theksoi nevojën e luftës në të dy krahët. Shoku Enver vuri në dukje se nuk mund të luftohet me sukses kundër oportunizmit të djathtë, po nuk u luftua njëkohësisht edhe sektarizmi dhe anasjelltas.

Lidhur me luftën klasore rëndësi të veçantë ka teza mbi rrezikun që përbëjnë elementët e rinj borgjezë. Në luftën kundër socializmit, armiqtë e ndryshëm brenda vendit, apo imperialistët, borgjezia ndërkombëtare e revizionistët jashtë, shpresat e tyre i mbështesin jo më vetëm në mbeturinat e klasave të vjetra shfrytëzuese, as vetëm në agjentët e diversantët e dërguar nga jashtë, por, në radhë të parë, në elementët e rinj borgjezë, që shfaqen edhe në shoqërinë socialiste. Këta njerëz, që degjenerojnë, që tradhetojnë klasën dhe socializmin, shndërrohen në elementë kundërrivolucionarë dhe bashkohen me kulakët e ish-borgjezët, me revizionistët sovjetikë dhe imperialistët amerikanë, me djallin e të birin për të luftuar socializmin e revolucionin.

Zbulimi e demaskimi i grupeve armiqësore e komplotiste të Beqir Ballukut, Petrit Dumes e Hito Çakos, të Abdyl Këllezit, Koço Theodhosit e Kiço Ngjelës, të Fadil Paçramit e Todi Lubonjës, etj., të cilët në lidhje edhe me të huajt komplotuan kundër socializmit në Shqipëri, e vërtetën plotësisht këtë konkluzion.

Në materialet e Kongresit të 7-të u shpjegua edhe nga pikëpamja teorike mundësia e lindjes së elementëve të rinj borgjezë në kushtet e socializmit. Si nxitje dhe mbështetje nga jashtë për këtë fenomen shërben presioni i vazhdueshëm e i gjithanshëm që ushtron rrethimi imperialisto-revizionist mbi vendin tonë. Prandaj, u theksua në Kongres, në asnjë mënyrë nuk na lejohet ta nënvleftësojmë rrethimin, as të qëndrojmë pasivë përpara tij. Çdo komunist, çdo punonjës, çdo patriot duhet të jetë në sulm për të neutralizuar presionin e këtij rrethimi, në sulm për ta çarë atë.

Në raportin e vet shoku Enver theksoi se socializmi ka forca që fenomenin e lindjes së elementëve të rinj borgjezë, ta kufizojë në maksimum dhe nëpërmjet zhvillimit të drejtë e konsekuent të luftës klasore të mos lejojë që ai të dëmtojë socializmin. Shoku Enver argumentoi se lindja e revizionizmit nuk është një fatalitet i pashmangshëm, si pretendojnë borgjezia dhe oportunistët. Partia jonë e ka treguar në praktikë se çfarë masash të domosdoshme revolucionare duhen marrë, për evitimin e revizionizmit dhe të rreziqeve të tjera që i kanosen diktaturës së proletariatit.

Kuptimi i drejtë dhe i plotë i luftës së klasave si një forcë kryesore lëvizëse në shoqërinë tonë socialiste, zhvillimi i saj korrekt simbas mësimëve të Partisë, ka rëndësi për gjithë Partinë, por ai ka rëndësi të veçantë për shkrimtarët e artistët, të cilët në veprat e tyre ndeshen vazhdimisht me probleme të tilla. Ashtu si vetë realiteti ynë, si vetë jeta jonë zhvillohen në procesin e luftës klasore, dhe krijimtaria artistike, që pasqyron këtë realitet, është e lidhur ngushtë me këtë problem. Ne duhet të kërkojmë që zhvillimi i luftës së klasave të bëhet më shumë objekt pasqyrimi dhe të jetë një nga temat kardinale të artit dhe të letërsisë sonë, fill i kuq që e përshkon atë. Ky është kyçi që i ndihmon artistët të japin tablo të sakta e realiste të jetës shoqërore, të depërtojnë në thellësi të proceseve jetësore, t'i interpretojnë ato në mënyrë materialiste e dialektike, të luftojnë për vënien në jetë të vijës së Partisë dhe të mësimëve të saj.

Pasqyrimi i vërtetë e realist i luftës klasore në art lidhet ngushtë me kuptimin e drejtë të kontradiktave e të natyrës së tyre në shoqërinë socialiste, si dhe të problemeve të tjera që varen nga kjo, siç janë ato të tipikes, të heroit, të rolit të masave, të figurës së njeriut të ri, etj.

Rëndësi të madhe ka, sidomos, të mbahet një qëndrim i drejtë, ashtu siç na mëson Partia, si ndaj kontradiktave

antagoniste, ashtu edhe ndaj atyre joantagoniste. Ne he-  
dhim poshtë teorizimet e revizionistëve sovjetikë, që pre-  
tendojnë se në shoqërinë socialiste, pas zhdukjes së kla-  
save shfrytëzuese si klasë, nuk ekzistojnë më kontradikta  
antagoniste (pas këtyre teorive fshihet qëllimi për të mbroj-  
tur armiqtë dhe për t'i hapur rrugën kundërrevolucionit),  
ashtu si hedhim poshtë edhe tezat e tjera oportuniste, se  
gjoja kontradiktat antagoniste midis nesh dhe armiqve, që  
ekzistojnë akoma në shoqërinë socialiste, mund të zgjidhen  
me «rrugë paqësore» e me metodën e bindjes.

Partia jonë mbron tezën marksiste-leniniste, të vër-  
tetuar nga jeta, se për zgjidhjen e kontradiktave antago-  
niste me armiqtë diktatura e proletariatit në çdo etapë për-  
dor dhunën e detyrimin revolucionar, se me armiqtë, të  
vjetër e të rinj, si dhe me ideologjinë e tyre, socializmi është  
i papajtueshëm. Përsa u përket kontradiktave joantagoniste  
ato zgjidhen gjatë procesit transformues të shoqërisë so-  
cialiste si dhe nëpërmjet metodës së bindjes e të punës  
edukuese të Partisë, të shtetit e të organeve të tyre. Por  
Partia na mëson se edhe ndaj këtyre kontradiktave duhet  
sjellë me seriozitet, se nuk është e lejueshme që ndaj tyre  
të mbahet një qëndrim liberal ose sektar, sepse kjo mund  
t'i shndërronte ato në kontradikta antagoniste e me pasoja  
të rënda për fatet e revolucionit e të socializmit.

➤ Në jetë kontradiktat e ndryshme nuk paraqiten të  
thjeshta, uniforme dhe lehtësisht të kuptueshme. Ato kanë  
shumë pamje, shumë lidhje e ndërvarje. Prandaj edhe në  
art nuk mund e nuk duhet të paraqiten në mënyrë semplit-  
te e të skematizuar. Nga shkrimtarët dhe artistët kërko-  
het që ato t'i pasqyrojnë në mënyrë dialektike e me vër-  
tetësi jetësore.

U ndala gjatë në problemin e luftës së klasave, sepse  
në praktikën letrare e artistike këtu, në trajtimin e kësaj  
çështjeje, bëhen edhe gabime. Nga moskuptimi i tërë kom-  
pleksitetit të zhvillimit të luftës së klasave ka ndodhur që  
në vepra të veçanta, kjo të mos pasqyrohet drejt, të ketë  
pasur shtrembërim të realitetit dhe të fakteve historike,  
rënie në çështje anësore, të imta e të parëndësishme, në  
zgjidhje artificiale e ndonjëherë të gabuara të kontradik-  
tave.

Për të kapërcyer këto vështirësi, për të ndrequr të  
metat e ndryshme që vihen re edhe në disa drejtime të  
tjera, siç është tipizimi i zbehtë klasor i personazheve ose  
për të kapërcyer njëfarë kufizimi ideologjik të disa kri-  
jues, është e domosdoshme të studjohet thellë marksizëm-  
leninizmi e parimet estetike të Partisë sonë. Vetëm mje-

shtëria artistike, sado e lartë që të jetë, në qoftë se nuk  
shoqërohet me njohuri të thella komuniste, me një meto-  
dë dialektike leniniste të analizës së fenomeneve, nuk ësh-  
të e mjaftueshme për të krijuar vepra të arrira, të buku-  
ra e të fuqishme të artit të vërtetë socialist.

Por lufta klasore është jo vetëm objekt pasqyrimi për  
artin, ajo zhvillohet edhe në vetë fushën e krijimtarisë.  
Përvoja jonë, si dhe ajo e popujve të tjerë, vërteton se arti  
dhe letërsia zhvillohen përmes një lufte të ashpër klaso-  
re dhe ato vetë marrin pjesë aktive në të.

Këtë e provon edhe lufta ideologjike e zhvilluar me  
ashpërsi të madhe sidomos vitet e fundit në vendin tonë.  
Plenumi i katërt i KQ të Partisë dhe faktet e mëvonshme  
treguan se presioni e veprimtaria kundërrevolucionare edhe  
në fushën e letërsisë dhe të arteve ishte pjesë e pandarë e  
qëllimit dhe synimit të armiqve për të përmbysur diktatu-  
rën e proletariatit. Partia, duke shpartalluar veprimtarinë  
armiqësore të Fadil Paçramit dhe Todi Lubonjës me shokë,  
duke demaskuar karakterin reaksionar të koncepteve e pik-  
pamjeve borgjezo-revizioniste që ata përhapnin, mbrojtji  
dhe u hapi rrugë të gjerë zhvillimit të letërsisë e të arte-  
ve tona. Këtu duhet kërkuar edhe një nga burimet e për-  
parimeve që janë arritur këto vitet e fundit në letërsi e në  
arte. Partia përgëzon shkrimtarët e artistët, gjithë krijuesit  
tanë për romanet e veprat poetike, për filmat e pikturat e  
bukura, për muzikën dhe skulpturat, tregimet, etj., të ci-  
lat në tërësinë e tyre përshkohen nga ideologjia marksis-  
te-leniniste e mësimet e Partisë sonë dhe militojnë për  
edukimin komunist të masave. Janë këto vepra, është ky  
militantizëm që i ka bërë shkrimtarët dhe artistët tanë ta  
meritojnë plotësisht atë që të quhen ndihmës besnikë të  
Partisë.

Kongresi i 7-të i Partisë theksoi se preokupimi për  
pastërtinë ideologjike të artit duhet të jetë i madh edhe në  
të ardhshmen. Në këtë luftë të ashpër klasash që zhvillo-  
het në plan kombëtar e ndërkombëtar, midis kapitalizmit  
e socializmit, midis ideologjisë borgjezo-revizioniste e asaj  
komuniste, shkrimtarët e artistët duhet të jenë vigjilentë  
dhe aktivë për mbrojtjen e pozitave të revolucionit, ashtu  
siç është Partia jonë. Të mos harrojmë asnjëherë përvojën  
negative që kritikuaam me forcë në Plenumin e 4-t të KQ  
të Partisë, rrezikun e atyre imitimeve e fantazive të së-  
mura, e atyre prirjeve për t'u dhënë pas simboleve ekstra-  
vagante e formale, e nënvleftësimit dhe largimit nga taba-  
ni kombëtar, etj. etj. Rreziku i tyre nuk është zhdukur. Ato  
mund të shfaqen përsëri në këtë ose atë formë. Prandaj

shkrimtarët duhet të jenë kurdoherë vigjilentë, luftëtarë të vendosur kundër çdo shfaqjeje të huaj. Ata duhet të mbështeten fort në mësimet e Partisë dhe të ruajnë frymën kombëtare. Nuk e ul artin theksimi i karakterit kombëtar. Përkundrazi i shkatërron dhe i humb të gjitha vlerat e tij huazimi dhe imitimi i të tjerëve, shkëputja nga tradita, i ashtuquajhuri modernizëm, avanguardizëm, etj.

Artistët tanë kanë luftuar shfaqjet e huaja dhe janë përpjekur të mos i bëjnë asnjë koncension ideologjisë borgjeze-revizioniste. Por, në disa raste, edhe pas Plenumit të 4-t janë vërejtur edhe vepra me të meta ideore. Ka patur raste imitimesh, maniera të huaja interpretimi, shfaqje formalizmi etj. Me ashpërsi duhet të luftojmë kundër objektivizmit borgjez, sepse ka ndodhur që ndonjë shkrimtar o artist, të pasqyrojë fenomene e ngjarje të rastësishme, pa u thelluar në përmbajtjen e thelbin e tyre.

Këto fenomene negative, sado të mëdha apo të vogla që të jenë, çfarëdo shtrirje e thellësi që të kenë, nuk duhet t'i minimizojmë. Ato nuk duhet t'i trajtojmë si dukuri krejtësisht të rastit, as thjesht si reminishenca të ndikimeve të mëparëshme të ideologjisë së huaj. Ato janë refleks të luftës klasore, shprehje të presionit të ideologjisë armiqësore borgjeze e revizioniste mbi letërsinë dhe artin tonë dhe, si të tilla, duhen luftuar me vendosmëri e deri në fund.

Shoku Enver në Kongresin e 7-të të Partisë vuri në dukje se zhvillimi me sukses e në rrugë të drejtë i letërsisë e arteve është i lidhur ngushtë me një angazhim më të madh të krijuesve tanë për trajtimin e tematikës aktuale dhe me domethënie të rëndësishme shoqërore të atyre problemeve kardinale, që qëndrojnë sot në qendër të preokupacioneve të Partisë dhe të popullit tonë, të luftës së tij për ndërtimin e plotë të socializmit. Është fjala për disa tema, të cilat edhe deri tani janë trajtuar, por jo në tërë gjerësinë e thellësinë që kërkojnë, si ajo e rolit hegjemon të klasës punëtore në shoqërinë tonë socialiste, e shndërrimeve revolucionare në fshatin kooperativist, e luftës që bën Partia për revolucionarizimin e saj dhe të të gjithë jetës së vendit.

Të tilla janë edhe disa tema të tjera themelore si lufta kundër revizionizmit modern, ajo e qëndresës së popullit në kushtet e rrethimit imperialisto-revizionist, e luftës klasore dhe e zbatimit të parimit marksist-leninist të mbështetjes në forcat e veta, e patriotizmit dhe e internacionalizmit proletar, tema e mbrojtjes dhe e vigjilencës revolucionare, etj.

Kapja dhe trajtimi i gjerë dhe i thellë i një tematike

të tillë nga letërsia dhe artet i ndihmon ato të afrohen e të lidhen ngushtësisht me jetën e aktualitetin, i orienton krijuesit të venë në qendër të vëmendjes së tyre ato probleme, për të cilat preokupohen më shumë Partia dhe masat. Është e ditur se arti i madh lind e zhvillohet vetëm kur frymëzohet nga ide dhe qëllime të mëdha. Por është e domosdoshme të theksohet se temat e problemet e mëdha mbajnë në vetvete edhe ide të mëdha. Historia ka provuar se veprat e shquara dhe që i kanë rezistuar kohës, kanë qenë ato që kanë pasqyruar e milituar për transformimet revolucionare të popujve e të njerëzve, që kanë trajtuar kontradiktat themelore të shoqërisë dhe kanë parashikuar zgjidhje progresiste të tyre, kanë qenë ato vepra që kanë qenë të lidhura me idealet e përparuara të shoqërisë njerëzore dhe të luftës revolucionare për realizimin e tyre.

Është e nevojshme të theksohet se, kur flasim për temën e madhe, nuk kemi aspak ndërmend të themi që kjo duhet të shprehet në volum, në vepra me përmasa medemos të mëdha dhe pretendime, si të thuash, monumentale. Temat e mëdha nuk u takojnë vetëm e veçanërisht të ashtuquajturave gjini të mëdha të artit. Ato mund t'i trajtojnë të gjitha gjinitë, në çdo formë e çdo përmasë, mjaft që të shikohen drejt ideologjikisht dhe të shprehen bukur artistikisht.

Mbyllja e artit në cikërrimat e hollësitë e jetës personale të individit, e largon atë nga rruga e krijimit të vlerave të qëndrueshme estetike, e shkëput nga jeta, e atrofizojnë. Temat e problemet e vogla e pa rëndësi shoqërore mund t'u interesojnë njerëzve të veçantë, por letërsia e artet tona nuk janë për njerëz të shkëputur, për shije të veçanta individuale ose të papërcaktuara. Por mbi të gjitha, temat e tilla në çdo rast e në çdo rrethanë nuk mund të pasqyrojnë jetën e vërtetë të vendit, të reflektojnë luftën e vërtetë që bëjnë njerëzit tanë për ndërtimin e jetës së re, për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë, të fitoreve të revolucionit socialist.

A mund të shkruhet sot në mënyrë realiste për Shqipërinë, për socializmin te ne, pa prekur luftën kundër revizionizmit modern, luftën për përballimin e rrethimit imperialisto-revizionist, pa treguar transformimet rrënjësore revolucionare që kanë ndodhur? Natyrisht mund edhe të shkruhet, por kjo nuk do të ishte letërsi e sotme shqiptare, e aq më pak e Shqipërisë socialiste.

Kërkesa për të vënë në qendër të vëmendjes së letërsisë dhe të artit temat e mëdha të kohës dhe të jetës sonë, nuk ka asgjë të përbashkët në konceptin vulgar, që e shi-

kon artin si një regjistrim mekanik e fotografik të ngjarjeve. Për ne ky koncept është i huaj, mbasi e pengon artin të arrijë në përgjithësim të mëdha artistike, në një pasqyrim aktiv e të thellë të rrjedhës së jetës, ashtu si është e huaj edhe «teoria e distancës», që e shpëput dhe e largon artin nga problemet e mëdha të kohës.

Kongresi i 7-të i Partisë, krahas përmbajtjes socialiste, që është tipari më esencial i kulturës sonë, theksoi edhe nevojën e forcimit të frymës e të fizionomisë kombëtare të saj.

Partia jonë ka qenë kurdoherë kundër dhe ka luftuar me rreptësi tezat e pikpamjet kozmopolite e moderniste, që mohojnë karakterin kombëtar të artit, ashtu siç lufton edhe qëndrimet skematike e konservatore, të cilat injorojnë të renë, traditën kombëtare socialiste që krijohet, elementët e reja që bie me vete ndërtimi i socializmit. Ajo ka theksuar se përmbajtja socialiste e artit lidhet ngushtë me karakterin kombëtar popullor të tij. Dëshëroj të theksoj se kjo nuk është një çështje forme, por edhe përmbajtjeje. Shoku Enver në raportin e Kongresit të 7-të shprehet qartë; ai flet për «karakter kombëtar popullor», për «karakter kombëtar dhe frymë popullore», për «frymë e fizionomi kombëtare». Këto terma e kategori nuk përdoren rastësisht, ato kanë kuptime të ndryshme, ato i referohen si përmbajtjes ashtu edhe formës. Prandaj nuk është e drejtë të flitet vetëm për fizionomi kombëtare, ashtu siç do të ishte e gabuar që kombëtaren ta kërkonim vetëm në formë e jo edhe në përmbajtje.

Këto pikëpamje e qëndrime të Partisë sonë janë në përputhje të plotë me shkencën marksiste-leniniste, e cila na mëson se socializmi ndërtohet brenda një realiteti kombëtar të caktuar, se në socializëm tiparet themelore popullore të kombit jo vetëm që nuk shuhen, por fitojnë fushë të lirë për të lulëzuar dhe për të arritur caqe të reja edhe më të larta. Vetëm në socializëm dhe mbi bazën e ideologjisë komuniste, traditat kombëtare popullore, krenaria kombëtare, gjuha amtare, tërë konstitucioni shpirtëror i popullit, kthehen në një bashkësi unike ndjenjash, konceptesh e tiparesh, në një unitet moral të qëndrueshëm e në një forcë përparimtare lëvizëse. Për socializmin janë të huaja nacionalizmi borgjez e shovinizmi, përbuzja për popujt e tjerë, për kulturën e vlerat e tyre përparimtare shpirtërore.

Kuptimi dhe vënia në jetë e ideve dhe orientimeve të Partisë lidhur me karakterin kombëtar të arteve tona,

ka një rëndësi të madhe jo vetëm parimore, por edhe praktike. Kjo do të shërbejë për ta ngritur artin në një nivel më të lartë, për ta bërë atë edhe më të aftë që të përmbushë mirë e plotësisht misionin e tij.

Lufta për forcimin e karakterit kombëtar të artit duhet të shërbejë për të ngritur edhe më lart frymën patriotike të masave, për të edukuar te të rinjtë dashurinë për vendin e ndjenjën e devocionit të pakufishëm ndaj Atdheut. Ajo duhet të shërbejë për rritjen e mëtejshme të krenarisë kombëtare, të dashurisë e respektit për krijimet e mrekullueshme të popullit tonë, për kulturën, traditat e shijet e tij, duhet të shërbejë për të përbuzur e hedhur poshtë çdo ndjenjë të përluljes ndaj së huajës dhe për rritjen e besimit në mundësitë, aftësitë e talentet e popullit tonë.

Lufta për forcimin e karakterit kombëtar të kulturës sonë duhet të shërbejë për çelnikosjen e mëtejshme të unitetit moralo-politik të popullit rreth Partisë, për bashkimin e të gjitha forcave materiale e shpirtërore për të përballuar e mposhtur bllokadat e komplotet e armiqve.

Më në fund ajo duhet të shërbejë për të ngritur një barrikadë të fuqishme kundër agresionit ideologjik të imperialistëve e revizionistëve, për të mbyllur shtigjet e penetrimit të ideologjive të huaja armiqësore e të influencës së tyre degjeneruese. Ajo është luftë për zhvillimin e pandalshëm të Revolucionit, për përparimin dhe lulëzimin e Atdheut tonë në rrugën e socializmit.

Në gjendjen e tanishme, të ashpërsimit të luftës së klasave, në shkallë ndërkombëtare, të përpjekjeve të superfuqive për t'u imponuar kulturën dhe mënyrën e tyre dekadente të jetesës kombeve më të vegjël, mbrojtja e karakterit kombëtar të letërsisë e arteve bëhet një çështje edhe më e mprehtë. «Në kushtet e sotme, tha shoku Enver në raportin që mbajti në Kongresin e 7-të të Partisë, kur imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë, të nisur nga qëllimet e tyre për sundimin e botës, për skllavërimin shpirtëror e politik të popujve, përhapin idetë e kozmopolitizmit, të të ashtuquajturit ndërkombëtarizim të artit dhe të kulturës, një rëndësi shumë të madhe merr lufta për të mbrojtur kulturën kombëtare të popujve».

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik, si pjesë përbërëse e agresionit ideologjik, por që synon qëllime në një plan më të gjerë zhvillojnë edhe një agresion të përgjithshëm kulturor kundër popujve të tjerë. Amerikanët e sovjetikët kanë krijuar dhe po e zhvillojnë sot një industri të tërë kulturore, për eksport. Kjo industri i pregatit dhe i konfeksionon mallrat e saj, ashtu si bëhet për

këmishët, apo për çokollatat. Këto janë libra e filma, disqe e programe televizive, revista e gazeta, fotografi e piktura. Padronët e këtyre prodhimeve nuk kanë për qëllim të krijojnë kulturë. Synimi i tyre, ashtu siç veprojnë brenda vendit, është t'i kthejnë masat e vendeve të tjera në konsumatorë të thjeshtë e pasivë të kësaj kulture, në njerëz që ta pranojnë e konsumojnë këtë mall, ashtu siç bëjnë për kafënë ose kakaon.

Puna shkon deri atje sa, duke shfrytëzuar revolucionin teknik shkencor, Shtetet e Bashkuara e Bashkimi Sovjetik kërkojnë tani t'u imponojnë popujve edhe gjuhët e tyre, që ata i quajnë «gjuhë universale, ndërkombëtare». Dhe justifikohet kjo me gjoja nevojën për të shfrytëzuar literaturën shkencore, teknike e teknologjike, të cilën gjithashtu përpiqen ta monopolizojnë. Këtë literaturë në të vërtetë ata kërkojnë ta përdorin si një shtrat nëpër të cilin do të rrjedhë pastaj lumi i tërë ideologjisë, kulturës dhe propagandës së tyre.

Por mbi të gjitha ata kërkojnë t'i detyrojnë popujt të heqin dorë dalngadalë nga kultura e tyre nacionale, për të kaluar në atë shpirtëror që dallon kombet midis tyre e që formon fytyrën e karakterin e tyre të veçantë e të papërsëritshëm. Ata duan të zhdukin çdo barrikadë që pengon ekspansionin politik e ideologjik, skllavërimin e popujve nga ana e tyre. Prandaj sot lufta për fizionominë kombëtare është luftë edhe për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së vendit.

Në qëndrimin ndaj traditës, ndaj krijimtarisë popullore tani tek ne ka një qartësi më të madhe. Në radhët e krijuesve tanë ndihet më mirë përvetësimi artistik i folklorit e i traditës sonë përparimtare. Megjithëkëtë ka përsëri raste, ndonëse më rrallë, kur duken shartime të dëmshme, siç ka ndodhur në ndonjë valle koreografike. Në mjaft vepra ngjyra kombëtare e, në mënyrë të veçantë, gjuha shqipe nuk shprehen qartë e bukur. Ka raste kur karakteri kombëtar shpesh shihet në sipërfaqe, në disa detaje të veçantë. Duke mos depërtuar thellë në krijimtarinë e popullit, por duke u kapur pas disa anëve të jashtme të valleve, të këngëve apo të poezisë popullore, ndodh nganjëherë që të na jepen riprodhime të zbehta, e çfarë është më keq, të shtrembërohet shpirti i popullor.

Vlerësimi i traditës, i folklorit duhet të shikohet si një problem ideologjik, duke mos harruar se, krahas vlerave, anëve përparimtare e demokratike që janë të mëdha, atje gjënden edhe elementë që shprehin një botëkuptim,

apo psikologji të huaj që kanë lënë kohërat, moral mikroborgjez, konservator, që ne nuk e pranojmë.

Populli në krijimtarinë e vet, në këngë, në valle, në kostume ka shprehur botën e vet të thellë e të pasur shpirtërore, mendimin e vet filozofik, ndjenjat e veta. Çdo varg i një kënge të popullit, çdo lëvizje e një valleje, çdo vijë e një kostumi është sintezë e një mendimi të thellë. Dhe kjo, në formën që na ka ardhur ne, aq perfekte dhe shprehëse, është rezultat i një krijimi shekullor ku brez pas brezi krijues anonimë kanë vënë diçka të tyre deri sa ka marrë atë pamje që shohim sot.

Prandaj një lëvizje e lehtë e dorës, apo tundje e krahut, një lëshim i kujdesshëm i këmbës në tokë, ose një përplasje e saj me forcë mbi truall, të gjitha kanë një kuptim, kanë domethënien e tyre. Janë pikërisht këto «detaje» që karakterizojnë vallen e Myzeqesë apo të Labërisë, të Dibrës apo të Kavajës, janë këto që i japin ngjyrën dhe frymën e papërsëritshme kombëtare.

Kur vëmë re prirjen për t'i harruar këto «detaje», për të unifikuar lëvizjet, duke zgjedhur atë lëvizje që koreografit i duket më e mira, sepse mund të ketë ritëm, ose diçka tjetër, kur këto çështje shihen krejt të shkëputura nga përmbajtja, nga ideja që përfaqësojnë, atëherë vëmë re se është deformuar konceptimi i popullor dhe na dalin në skenë çudira: kërcen labi me daulte, hidhet myzeqari si malësori i Dibrës, kërcenjë gratë si burrat, etj.

Pse ndodhin këto deformime? Në radhë të parë, sepse disa krijues nuk e njohin me rrënjë këngën, vallen e kostumin popullore. Të metat në këto fusha vijjnë edhe sepse disa krijues nuk thellohen e nuk studiojnë si duhet mësimet e Partisë, teorinë dhe estetikën marksiste-leniniste, nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme për të njohur thellë rrugën e zhvillimit historik revolucionar të popullit e të kulturës sonë.

Kur flasim për shfrytëzimin e traditës sonë, nuk duhet t'i kthejmë sytë vetëm nga e kaluara, nga tradita e vjetër. Partia dhe shoku Enver kanë theksuar se duhet të shfrytëzohet thellë e gjerësisht tradita e re, socialiste. Kjo traditë e re e artit tonë revolucionar duhet të jetë objekt i rëndësishëm studimi nga duhet të nxirret një përvojë e pasur krijuese.

Për të zbatuar mirë detyrat që shtroi Kongresi i 7-të para krijimtarisë artistike është e nevojshme të rritet më tej roli i kritikës dhe i studimeve letraro-artistike, të bëhen përgjithësime e të nxirren konkluzione teorike nga përvoja

e krijimtarisë sonë. Këtë detyrë e ka theksuar disa herë Partia.

Vitet e fundit kritika jonë e ka zgjeruar tematikën, ka filluar të merret më mirë me problemet kryesore të krijimtarisë. Megjithkëtë asaj i mbetet akoma shumë për të bërë. Kjo kërkesë diktohet nga disa dobësi që vihen re e jo nga ndonjë gjendje kritike e kritikës. Disa studjues shpesh në punët e tyre nisen jo nga problemet që nxjerr krijimtaria jonë, por nga teza të njohura të estetikës apo të teorisë së përgjithshme të letërsisë e të artit, ndërsa krijimtarinë e artistëve tanë e përdorin kryesisht si ilustrim. Kjo praktikë mund të ketë ndonjë dobi të karakterit shkollor, apo instruktiv, por nuk zgjidh probleme, nuk u përgjigjet pyetjeve që kanë krijuesit e lexuesit. Si për çdo fushë tjetër edhe për problemet e letërsisë e të arteve është e domosdoshme që kritika dhe studimet të kenë parasysh kërkesën e Kongresit: të vënë në bazë kurdoherë mësimet e marksizëm-leninizmit e mendimin teorik të Partisë sonë, të mbështeten në përvojën e artit tonë. Mbi këtë bazë të nxjerrin konkluzione e të bëjnë përgjithësime, që u përgjigjen problemeve ideoartistike të cilët kërkojnë zgjidhje, të nxisin krijimin e veprave militante e luftarake, t'i hapin rrugë gjithnjë e më të gjera praktikës.

Vetëm duke u nisur nga përvoja jonë, duke analizuar problemet që dalin nga krijimtaria jonë artistike, do të gjallërohet edhe debati i shëndoshë e konstruktiv, do të rritet edhe niveli i kritikës e i studimeve tona në fushën e artit.

Por studimet e kritikën i dëmton edhe ndonjë prirje që vihet re në disa autorë, të cilët nuk përqendrohen në problemet themelore, ideologjike e artistike të veprës që analizojnë, por largohen në çështje sekondare, ose bëjnë vlerësime të përgjithshme e uniforme, të mira e të përshtatshme për çdo veprë e çdo rast, por që as emocionojnë e as trazojnë njeri. Këto fenomene që e kanë bazën në përgatitjen e pamjaftueshme profesionale, si dhe në tendencën për të qenë brenda, ose për të mos e prishur me këtë ose atë krijues, e dëmtojnë kritikën artistike. Mbi të gjitha kritikë duhet të jetë militant e parimor, që mbi interesat e përgjithshme të artit e të zhvillimit të tij në rrugë të drejtë nuk vë asgjë.

Nga ana tjetër, kritika nuk duhet reduktuar në mendimin e vetëm profesionistëve. Ajo është e mirë kur shpreh, pasqyron dhe sintetizon mendimin e përgjithshëm të masave, të shkrimtarëve dhe të artistëve. Institucionet artistike, si dhe ato të arsimit të lartë, du-

het të organizojnë më mirë punën studimore dhe diskutimet për problemet ideoestetike të krijimtarisë. Një rol të rëndësishëm duhet të luajë edhe shtypi, i cili për problemet e artit e të kulturës duhet të tregojë një kujdes më të madh dhe të zhvillojë një punë më të menduar e më të kualifikuar.

Në Kongresin e 7-të të Partisë, shoku Enver theksoi edhe një herë tjetër se artistët tanë janë ndihmës të Partisë në edukimin komunist të masave. Ky është një vlerësim i lartë që i bëhet misionit dhe veprës suaj. Por ai, tregon, gjithashtu, edhe për përgjegjësinë e rëndë që ka secili prej jush. Arti dhe letërsia jonë, duke pasqyruar me vërtetësi luftën dhe jetën e masave, të udhëhequra nga Partia, duhet t'i frymëzojë ato për vepra të reja, t'u forcojë optimizmin revolucionar dhe besimin në të ardhmen, të ndihmojë në edukimin e tyre ideologjik, në ngritjen e kultures së tyre. Lenini thoshte se «arti duhet të bashkojë ndjenjat, mendimet dhe vullnetin e këtyre masave, t'i ngrëjë ato».

Partia jonë ka theksuar se arti duhet të ndihmojë masat të njohin sa më thellë proceset revolucionare të jetës sonë dhe ta transformojnë më tej atë në rrugën e socializmit. Ajo ka nënvizuar se pasqyrimi me vërtetësi i jetës dhe i kontradiktave që zgjidh shoqëria jonë, analiza e mprehtë klasore e ngjarjeve dhe e fenomeneve e bëjnë artin militant e me forcë të madhe edukuese.

Për të arritur këto objektiva është e domosdoshme të punohet sistematikisht dhe në shumë rrugë nga të gjithë artistët për përvetësimin e ideologjisë marksiste-leniniste, të mësimëve të Partisë sonë e të shokut Enver. Përvoja ka treguar se pa zotërimin e thellë të ideologjisë marksiste-leniniste, nuk mund të bëhet një analizë shkencore e materialit jetësor, nuk mund të arrihet në përgjithësime të mëdha e të drejta të tij. Për shkrimtarët e artistët kjo ka rëndësi të madhe, mbasi çdo dobësi e paqartësi ideologjike shprehet drejtpërdrejt në veprën e tyre e që këtej kalon në masa. Prandaj ngritja ideologjike e artistëve do të bëjë të rritet edhe niveli ideoartistik i krijimtarisë, do të nxjerrin konkluzione e do të bëhen përgjithësime më të mëdha dhe, në këtë mënyrë, do të forcohet më tej edhe ndikimi ideologjik i artit mbi masat.

Shoku Enver na mëson se ideologjia e Partisë nuk mësohet vetëm në libra, por dhe në jetë, midis masave, aty ku ajo konkretizohet në veprimtarinë praktike. Ky kontakt i drejtpërdrejtë me masat për artistin është i domos-

doshëm, jo vetëm se aty sheh si realizohen në praktikë mësimet e Partisë, jo vetëm sepse aty gjen materialin e domosdoshëm për krijimtari, por aty ai verifikon saktësinë e dijeve, njohurive e përfytyrimeve të veta. Midis masave artistike kalitet vetë si revolucionar, përvetëson normat e reja, psikologjinë proletare, kupton dhe më mirë kërkesat e idealet e masave.

Është për t'u përgëzuar inisiativa e disa krijuesve që kanë shkuar në bazë dhe kanë forcuar kontaktet me masat. Kjo është ndjerë dhe në krijimtarinë e tyre. Por ka edhe artistë që nuk po bëjnë përpjekje serioze për një njohje të thellë të jetës, prandaj përsërisin veten dhe nuk kanë rezultatet e kërkuara në krijimtari.

Kongresi i 7-të i Partisë shtroi, gjithashtu, detyrën që arti t'i përgjigjet nivelit të zhvillimit ekonomik-shoqëror të vendit dhe kërkesave kulturore gjithnjë në rritje të masave. Që të plotësohet kjo detyrë është e domosdoshme të rritet më tej niveli artistik i krijimtarisë. Idetë e mëdha të Partisë, transformimet e gjera revolucionare që kanë ndodhur e ndodhin në vendin tonë, mund të mishërohen vetëm në vepra me nivel të lartë artistik. Nënveftësimi që vihet re disa herë për anën artistike të veprës, rëndja pas sasisë pa shikuar cilësinë, dëmton letërsinë e artin tonë e si pasojë, edhe ndikimin edukativ të tyre mbi masat.

Disa gjini të artit nuk po ecin në një hap me llojet e tjera dhe me hapin e jetës sonë si p.sh. estrada, koreografia, dramaturgjia. Nën nivelin e kërkesave të kohës janë edhe disa vepra të gjinive të tjera. Kjo gjendje e ka burimin, ndër të tjera, edhe në thjeshtësimin e uljen e kërkesave, në mosshfrytëzimin e thellë të traditës sonë të artit të kultivuar e atij popullor, si dhe në vetëkënaqësinë e rutinën që kanë disa krijues që merren me këto gjini.

Kërkesat cilësore ndaj letërsisë e artit tani janë të mëdha, sepse janë rritur e zhvilluar shijet e masave, është ngritur niveli i tyre arsimor e kulturor; është zhvilluar e gjithë jeta. Tani është ngritur një industri moderne që punon në një nivel të lartë teknik, bujqësia prodhon duke u mbështetur gjerësisht mbi të dhënat e shkencës; arsimi, shëndetësia etj. po kapin kufij gjithnjë më të përparuara. Këtij niveli të njerëzve tanë duhet t'i përgjigjet edhe një krijimtari me nivel gjithnjë në rritje.

Sot ne mund dhe duhet t'i rrisim pretendimet, sepse tani kemi vepra të arrira ideologjikisht e artistikisht në të gjitha fushat e krijimtarisë, të cilat nuk numërohen më me gishta, por me dhjetra. Tani kemi romane e filma

me vlerë botërore, kemi muzikë e piktura të bukura që janë bërë tanimë klasike, kemi valle e balete që kanë arritur një perfeksionim të lartë. Rritja e kërkesave cilësore ndaj artit nuk do të çojë, si mund të mendojë dikush, në një pakësim të sasisë së veprave, por do të nxisë krijuesit që të punojnë, të studjojnë e të djerstin më shumë. Jo më kot, të parët kanë thënë se krijimtaria është mundim. Por është një mundim i vetëdijshëm që rrjedh nga përgjegjësia e madhe përpara vetes e shoqërisë, nga kërkesa për të qenë kurdoherë ekzigjent e novator.

Nuk mund të shkruhet pa lexuar në mënyrë të vazhdueshme, pa njohur thellë gjuhën e kulturën amëtare, pa njohur mirë historinë e traditat, pa u njohur me shkencat e dijet njerëzore. «Specialisti, thotë shoku Enver, në se do të ecë bashkë me kohën dhe biles të ecë më shpejt se koha, duhet të studjojë me regjim, të jetë në kontakt me librat, me revistat. Njeriu, vazhdon ai, duke qenë kuadër është njëkohësisht nxënës, një nxënës i përjetshëm. Lind detyrimi i dyfishtë, për vete dhe për të tjerët, për shoqërinë. Që të mund të japësh, duhet vazhdimisht të marrësh diçka më tepër nga ajo që ke, të marrësh kulturë të përgjithshme e profesionale, të cilat janë të pafund, ashtu siç është e pafund jeta me problemet e aspektet e saj».

Shoku Enver ka theksuar, gjithashtu, se artin revolucionar e bëjnë artistët revolucionarë, zemra e të cilëve rreh me zemrën e popullit. Kjo porosi e rëndësishme i ngarkon me përgjegjësi, në radhë të parë, vetë artistët që të punojnë më shumë për edukimin e revolucionarizimin e vazhdueshëm të tyre, për të forcuar vetitë morale komuniste, për të rrënjosur marrëdhënie shoqërore revolucionare.

Komitetet e organizatat-bazë të Partisë, nga ana e tyre, duhet të punojnë edhe më shumë për të nxitur e frymëzuar krijuesit, për t'u hapur perspektiva, për t'i orientuar e udhëhequr në krijimtari. Lidhja e ngushtë e artistëve me organet e organizatat e Partisë do t'i ndihmojë këta të njohin më thellë problemet që përballon e zgjidh shoqëria jonë, të kapin e të pasqyrojnë aspektet më të rëndësishme të jetës, ato që i japin forcë e jetë krijimtarisë.

Shoku Enver theksoi në Kongres se udhëheqja e Partisë në të gjithë jetën e vendit është garancia për triumfin e revolucionit dhe ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. «Partia, tha shoku Enver në Kongres, është ajo forcë e ndërgjegjshme që i jep luftës së përditëshme të masave përmbajtjen politike e ideologjike, i përcakton qëllimet, i sqaron objektivat dhe i tregon rrugët për arritjen e tyre».

Forcimi e konsolidimi i pushtetit popullor, mbrojtja e vendit, zhvillimi i ekonomisë socialiste, përparimi i kulturës, edukimi i njeriut të ri dhe në përgjithësi marshimi ngadhënjimtar drejt komunizmit mund të sigurohen vetëm nën udhëheqjen e Partisë. Sigurimi dhe forcimi i rolit udhëheqës të Partisë është vendimtar për fatin e revolucionit dhe të socializmit. Për të gjithë punonjësit, organizatat dhe institucionet, organet shtetërore, ekonomike, arsimore e kulturore, duhet të jetë e qartë se lufta për sigurimin e udhëheqjes së Partisë, për zbatimin me besnikëri të politikës dhe ideologjisë së saj është kushti kryesor për t'i shërbyer më së miri popullit, Atdheut dhe socializmit. Këtë duhet ta mbajnë kurdoherë parasysh edhe krijuesit, se udhëheqja e Partisë është faktori kryesor që të kemi një art të partishëm, një art militant e revolucionar.

Vitet e fundit Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve ka bërë një punë të gjerë e frytdhënëse për të vënë në jetë orientimet e Partisë për letërsinë dhe artin. Një sërë masash janë marrë për t'i nxitur artistët për një njohje të thelluar të jetës, për të diskutuar dhe sqaruar shumë probleme ideoestetike që shtrou krijimtaria. Por Kongresi i 7-të i Partisë shtroi detyrën që Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të bëhet një faktor edhe më aktiv për të frymëzuar e ndihmuar artistët në punën e tyre, që ajo të jetë një qendër ku të rrihen probleme ideologjike, estetike, shoqërore etj.

Zhvillimi i këtij plenumi tregoi se sa me vend është kjo kërkesë e Partisë. Këtu doli se ka mjaft probleme, qoftë në fushën e muzikës, të letërsisë apo të arteve figurative, për të cilat nevojitet të organizohen diskutime të mëtejshme. Kjo punë nuk mund të bëhet vetëm në Plenumet e Lidhjes. Prandaj si në Tiranë ashtu edhe në degët e Lidhjes në rrethe duhet të gjenden forma pune të larmishme, tërheqëse e efektive ku letrarët e artistët, bashkë me punëtorët, fshatarët e përfaqësuesit e tjerë të masave, të diskutojnë për probleme të ndryshme të krijimtarisë, si dhe për vepra të botuara apo për idetë fillestare e projektet krijuese të autorëve të veçantë.

Shokë,

Shkrimtarët e artistët duhet të jetojnë edhe me situatën e sotme ndërkombëtare, me ngjarjet e ndryshimet që ndodhin në botë. Për ta kjo është një domosdoshmëri e nevojë që lidhet drejtpërdrejt edhe me veprimtarinë e tyre krijuese, e cila nuk mund të mos pasqyrojë në këtë ose atë aspekt, aktivitetin ndërkombëtar të vendit tonë,

luftën që bëjnë Shqipëria socialiste e populli i saj kundër imperializmit, socialimperializmit, revizionizmit modern e reaksionit, përkrahjen që ato u japin forcave revolucionare e çlirimtare në vende të tjera.

Në raportin që paraqiti në Kongresin e 7-të shoku Enver na i ka bërë të qarta këto situata si dhe perspektivën e zhvillimit të tyre, duke treguar njëkohësisht edhe vendin e rolin që ka sot në botë Shqipëria, si një shtet socialist, që u përmbahet me besnikëri mësimeve të marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar, që ecën e sigurtë përpara dhe çan pa frikë furtunat e egra të botës borgjezo-revizioniste që e rrethon.

Analiza e thellë shkencore, marksiste-leniniste, e gjendjes së sotme ndërkombëtare na ndihmon të dimë të orientohejmë në çdo rrethanë, të njohim edhe më mirë miqtë e armiqtë, të dimë si të luftojmë e fitojmë kundër imperializmit e revizionizmit, si të mbrojmë lirinë e pavarësinë, si të çojmë kurdoherë përpara çështjen e socializmit e të komunizmit në Shqipëri.

Përmbajtja thellësisht revolucionare, pasuria e madhe e ideve, trajtimi shkencor e i çiltër i problemeve kanë bërë që raporti i shokut Enver në Kongresin e 7-të të ndiqet me një vëmendje të veçantë edhe në vendet e huaja. Pritja ka qenë shumë entuziaste sidomos në lëvizjen marksiste-leniniste dhe në forcat revolucionare të afërta me të, që kanë ngritur lart vlerat e tij teorike e praktike në dobi të revolucionit dhe të socializmit. Jo më pak pozitiv ka qenë reagimi edhe midis lëvizjeve të ndryshme çlirimtare, midis njerëzve demokratë e përparimtarë, si dhe politikanëve realistë.

Fjala e shokut Enver është përkthyer e vazhdon të përkthehet në shumë gjuhë dhe të botohet përjashta në tirazhe jo të vogla. Ajo është bërë objekt artikujsh dhe komentesh në gazeta e revista të ndryshme në shumë vende të botës.

Raporti i shokut Enver në Kongresin e 7-të deri më tani është botuar i plotë në libër në 6 vende, në Francë, në dy edicione, në Kanada në dy gjuhë, anglisht e frëngjisht, në Portugali, në Turqi në dy botime, në Greqi dhe në Gjermani në dy botime. Raporti i shokut Enver është botuar i pjesshëm, veçanërisht 2 kapitujt e fundit në 14 vende, duke përfshirë Anglinë, Japoninë, SHBA, Finlandën, Suedinë, Norvegjinë, Italinë etj. Janë botuar shumë shkrime e komente. Në Greqi, pothuajse në të gjithë rrjetin publicistik të vendit, janë botuar rreth 400 shkrime, artikuj dhe komente të ndryshme. Në Turqi, në rreth 35 organe



të shtypit, mbi 60 shkrime. Në Austri, në Republikën Federale Gjermane dhe në Zvicër janë shkruar rreth 90 shkrime, komente dhe artikuj në rreth 130 organe. Në Suedi janë botuar 83 artikuj në 70 organe, duke përfshirë edhe gazetat më të mëdha të vendit. Në Francë janë botuar 40 artikuj. Në SHBA janë botuar 45 artikuj e komente. Në Tanzani janë botuar 10 shkrime. Në Meksikë 20 artikuj, etj.

Jehona e madhe pozitive e Kongresit lidhet me faktin se marksistë-leninistët e njerëzit progresistë të vendeve të ndryshme, duke u njohur me raportin e shokut Enver vlerësojnë principialitetin marksist-leninist dhe konsekuencën revolucionare, që karakterizon qëndrimet dhe vijën e Partisë sonë, vlerësojnë guximin politik e ideologjik me të cilin trajtohen çështjet më të mprehta dhe përballohen problemet më të rëndësishme që preokupojnë sot njerëzimin.

Në botën e sotme të turbullt, të mbarsur me kërcënime dhe rreziqe të gjithanshme për paqen dhe sigurimin e popujve, të trullosur nga një demagogji mbytëse e një diplomaci e djallëzuar e fuqive imperialiste, në këtë botë që sulmohet nga të katër anët nga oportunizmi i vjetër socialdemokrat dhe oportunizmi i ri, revizionizmi modern, nga forcat fashiste e reaksionare të ndryshme, në botën e sotme të mbërthyer nga kriza aktuale më e rënda dhe më e errëta që nga Lufta e Dytë Botërore, analiza që i bën shoku Enver gjendjes ndërkombëtare hedh rreze drite të fuqishme, sqaron situatat, bën të kuptohen ngjarjet dhe të shikohet drejt rrjedha e tyre.

Duke ndjekur mësimet dhe dialektikën e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, në raportin që mbajti para Kongresit të 7-të, shoku Enver analizon një për një dhe thellësisht kontradiktat kryesore të kohës sonë. Ai nxjerr në pah forcat politike dhe shoqërore që qëndrojnë përballë njëra-tjetrës dhe tregon cila është strategjia e vërtetë klasore proletare për fitoren e revolucionit në kohën e sotme. Shoku Enver në raport flet me një realizëm të madh. Ka rreziqe, thotë ai, dhe tregon konkretisht kush janë armiqtë e popujve, kush e rrezikon paqen sot, kush rrezikon interesat e revolucionit dhe cilat janë detyrat e revolucionarëve. Jo llafe, jo konferenca ndërkombëtare e mbledhje, por luftë revolucionare, thekson shoku Enver. Kundër kujt? Kundër socialimperializmit, kundër imperializmit, kundër borgjezisë, kundër reaksionit. Jo bashkim me njërin për të luftuar kundër tjetrit imperializëm, por luftë në të dy frontet.

Shoku Enver, në të gjithë raportin e vet, gjendjen dhe detyrat që dalin para revolucionarëve, para popujve i shtron duke hedhur poshtë një nga një dhe duke demaskuar thellësisht të gjitha tezat e pikpamjet e përhapura nga ideologë e politikanë të ndryshëm borgjezë e revizionistë, të cilët jo vetëm nuk u japin rrugëdalje të qartë popujve, por synojnë të shkaktojnë një konfuzion të madh ideopolitik në njerëzit.

Raporti i shokut Enver e vë gishtin drejt e në plagët që ekzistojnë sot në botë dhe ndihmon, inkurajon e nxit revolucionarët dhe popujt që t'i shohin këto plagë, të kuptojnë natyrën e tyre dhe të njohin më mirë shkaktarët. Përkërisht për arsye se në raport gjenden përgjigjet e drejta për çështjet më themelore që preokupojnë sot njerëzimin, që preokupojnë popujt e ndryshëm, pikërisht për arsye se u flitet hapur popujve, raporti i shokut Enver është pritur me aq simpati në mjaft vende të ndryshme.

Në raport inkurajohet lufta e popujve të Amerikës Latine, e popujve të Afrikës, e popujve arabë. Shoku Enver nuk u thotë atyre të mbështeten tek kjo apo ajo superfuqi, nuk u thotë p.sh. popujve arabë që t'i varin shpresat tek Kombet e Bashkuara, apo tek Konferenca e Gjenevës, por u tregon rrugën e vetme të drejtë, rrugën e luftës, atë të unitetit arab, si një faktor i rëndësishëm për të zgjidhur në favor të tyre problemet e Lindjes së Mesme. Luftë kundër kujt? Kundër atyre forcave që duan ta mbajnë Lindjen e Mesme nën thundrën e tyre. Dhe këto forca janë imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe shërbëtori i tyre Izraeli. Prandaj raporti i shokut Enver është lexuar me vëmendje dhe ka ngjallur entuziazëm në vendet në zhvillim, qofshin këto të Afrikës, të Amerikës Latine apo të Azisë etj.

Por raporti i shokut Enver dhe idetë që dalin nga ai nuk janë të vlefshme dhe nuk bindin vetëm këta popuj që luftojnë për liri e pavarësi. Ky raport është pritur me simpati edhe nga francezët, edhe nga vendet nordike, etj. Përse? Sepse francezët apo vendet skandinave e shikojnë qartë se si imperializmi amerikan për interesat e veta përpigjet që të manipulojë dhe vende të tilla të lira, si Franca apo vendet skandinave. Prandaj ata kur lexojnë se si demaskohet politika e imperializmit amerikan, apo e socialimperializmit, kur ata shohin pikëpamjen e drejtë të Partisë sonë, se si duhet mbrojtur liria e pavarësia e popujve, kur shohin se në raportin e shokut Enver dënohet qëndrimi i superfuqive, të cilat politikën ndërkombëtare duan ta kenë monopol të tyre, francezët patriotë e demo-

kratë nuk mund të mos thonë se jemi dakord me këtë pikëpamje se kjo duhet të jetë edhe pikëpamja e vetë Francës, e cila nuk dëshiron të ndjekë një politikë të imponuar nga dikush tjetër, por ka luftuar që të ruajë personalitetin e vet.

Kështu është edhe për vendet nordike. Partia jonë thotë se edhe kur rivalizojnë, edhe kur bashkëpunojnë të dy superfuqitë, harxhet i paguajnë gjithmonë popujt. Këtë e thekson shoku Enver në raport. Vendet nordike e ndjejnë një gjë të tillë mbi kurrizin e tyre. Prandaj ata nuk mund të mos thonë se ju shqiptarët flisni të vërtetën, se politika juaj është e drejtë, e qartë, e saktë.

Përmenda jehonën që ka patur raporti i shokut Enver në Greqi. Kini parasysh shokë se midis Greqisë dhe Shqipërisë ka patur kundërshtime të mëdha, që për një kohë shumë të gjatë, gati për 20 vjet u bënë pengesë për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis nesh. E kam fjalën tek e ashtuquajtura gjendje lufte midis Shqipërisë dhe Greqisë dhe tek e ashtuquajtura çështje e Vorioepirit që e ngrinin monarkofashistët grekë. Por tani në Greqi për raportin e shokut Enver po shkruhet kaq shumë, sa që këto dy elemente që ishin bërë, si të thuash, shtyllat e propagandës së reaksionit grek kundër Shqipërisë, që të dyja u shkrinë si bora në diell. Përse ndodhi kjo? Kjo ndodhi sepse në raportin e shokut Enver njerëzit e ndershëm dhe politikanët realistë grekë panë një analizë të saktë të situatave, një gjykim të thellë të kontradiktave të ndryshme, panë sinqeritetin dhe korrektësinë tonë. Kini parasysh tani gjendjen e Greqisë, në ç'situatë është ajo me Turqinë, kontradiktat që ka me të dhe se si imperializmi amerikan po i përdor këto kontradikta për të forcuar hegjemoninë e vet, qoftë mbi Greqinë, qoftë mbi Turqinë. Demaskimi që u bëri shoku Enver të dy superfuqive dhe përpjekjeve të tyre kundër popujve dhe, nga ana tjetër qëndrimi dashamirës, korrekt i Shqipërisë ndaj Greqisë si dhe ndaj Turqisë në këto situata kjo shkaktoi atë reagim aq pozitiv ndaj vendit tonë.

Marksistë-leninistët, por edhe qeveritë e vendet që ndjekin një politikë përparimtare, shohin në raportin e shokut Enver, sidomos në pjesën ku pasqyrohet politika e jashtme e Partisë dhe e vendit tonë se Shqipëria socialiste jo vetëm argumenton nevojën e mobilizimit dhe të unitetit të të gjithë atyre që janë dhe luftojnë kundër shtypjes imperialiste-revizioniste, që janë për revolucionin e progresin shoqëror, por ata shohin se mbi këto parime Shqipëria ka ndërtuar edhe politikën e saj shtetërore. Siç e thek-

son shoku Enver, politika e jashtme e Shqipërisë socialiste është ndërtuar që t'u shërbejë interesave të socializmit në Shqipëri, por edhe interesave të popujve, të luftës së tyre antiimperialiste dhe antisocialimperialiste, interesave të revolucionit. Këtu është edhe burimi i simpatisë dhe i prestigjit që gëzon në arenën ndërkombëtare vendi ynë socialist.

Popujve, njerëzve përparimtarë, por edhe qeveritarëve realistë të vendeve të ndryshme u ka pëlqyer dhe u pëlqen fakti që politika e Partisë së Punës dhe e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë është e hapur, e çiltër, i thotë të katër të vërtetat në fytyrë, pa marrë parasysh se njerit apo tjetrit nuk i pëlqejnë. Partia jonë i thotë me zë të lartë ato që edhe të tjerët i dinë ose i ndjejnë, por që për një arsye ose tjetrën nuk i thonë dot hapur.

Një jehonë të madhe veçanërisht në radhët e lëvizjes marksiste-leniniste ka patur dhe vazhdon të ketë kapitulli i fundit i raportit të shokut Enver mbi luftën kundër revizionizmit modern. Siç dihet, shoku Enver, aty thekson e vë në demaskimin e revizionizmit dhe nevojën e thellimit të luftës ideologjike kundër tij. Jeta ka vërtetuar, tha ai në Kongres, se rruga e luftës së hapur e pa kompromis që zgjodhi Partia jonë në demaskimin e revizionistëve sovjetikë, mbrojtja e vendosur që ajo u bëri parimeve themelore të marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar, ishte e vetmja rrugë e sigurtë shpëtimtare e fitimtare. Kjo na nxiti e na detyron që të jemi kurdoherë të vendosur e të paepur deri në fund në luftën kundër revizionizmit e çdo lloj oportunizmi tjetër.

Shoku Enver godet me forcë e demaskon me rrënjë revizionizmin sovjetik që është më demagogjiku, më i djallëzuari dhe më i rrezikshmi, baza nga frymëzohen dhe ushqehen në tradhëtinë e tyre edhe revizionistët e tjerë. Me të njëjtën forcë e frymë parimore shoku Enver godet edhe korrentet e tjera revizioniste si ato jugosllave, italiane, franceze, teoritë antimarksiste të përhapura nga borgjezia e oportunistët, të cilët kanë për qëllim të çorodisin njerëzit, të mpijnë mendimin dhe veprimin revolucionar të proletariatit, të thyejnë vullnetin e klasës dhe të sabotojnë revolucionin botëror. Duke hedhur poshtë e demaskuar tezat e ndryshme revizioniste, Partia jonë mbron me vendosmëri marksizëm-leninizmin.

Kongresi ynë i shtatë u përshkua fund e krye nga fryma e lartë e internacionalizmit proletar, nga preokupacioni i sinqertë për forcimin e unitetit të partive marksiste-leniniste dhe nga vendosmëria për të punuar pa u lo-

dhur për arritjen e këtij objekti. Vlerësimet e larta që i bënë Kongresit, e veçanërisht raportit të shokut Enver, partitë marksiste-leniniste që asistuan në punimet e tij, dëshmojnë se qëndrimet e Partisë sonë, analiza që ne u bëjmë problemeve kyçe që preokupojnë sot lëvizjen marksiste-leniniste, u përgjigjen pyetjeve të shumta që kanë dalë përpara saj lidhur me strategjinë e taktikën e vërtetë proletare të revolucionit. Ato dëshmojnë se qëndrimet tonë kontribuojnë për forcimin e unitetit të lëvizjes marksiste-leniniste, ndihmojnë për zhvillimin në rrugë të drejtë të luftës revolucionare të proletariatit dhe për fitoren e saj.

Kohëve të fundit ne vemë re me kënaqësi se ka patur disa manifestime të rëndësishme, siç ishin Deklarata e partive marksiste-leniniste të Amerikës Latine, manifestimi internacionalist në Itali dhe manifestimi internacionalist me rastin e mbylljes së Kongresit të 3-të të PK (m-l) të Gjermanisë, ku jo vetëm u pasqyrua uniteti i marksiste-leninistëve, por ku u mbështetën krejtësisht tezat e pikëpamjet e Partisë sonë të Punës. Edhe ky fakt flet për drejtësinë e vijës që aprovoi Kongresi i 7-të i Partisë sonë.

Shokë e shoqe,

Në referatin e diskutimet tuaja ju shqyrtuat gjerë e gjatë, me pjekuri e thellësi detyrat që shtroi përpara punonjësve të letërsisë e të artit Kongresi i 7-të i Partisë. Ju treguat se problemet kuptohen drejt dhe se të gjithë shokët po i studjojnë me kujdes materialet e Kongresit, se ata mendojnë seriozisht dhe përpiqen për të gjetur rrugët e mënyrat më të mira e më të përshtatëshme për të vënë në jetë detyrat që shtron ai.

Partia është e bindur se artistët tanë, jo vetëm tani, por kurdoherë, në materialet e rëndësishme të Kongresit të 7-të do të gjejnë një burim të madh frymëzimi, për të arritur suksese të reja, për të krijuar vepra me një nivel të lartë ideologjik e artistik, të partishme e militante, vepra të denja që të jenë në lartësinë e luftës heroike që bën populli ynë për mbrojtjen e fitoreve të tij e të marksizëm-leninizmit, për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

## LETËRSIA DHE ARTET TE NDJEKIN RITMET E ZHVILLIMIT TE SHOQERISE SONE

Raporti i shokut Dritëro Agolli

### PASQYRIMI I PLOTË DHE I THELLË I TRANSFORMIMEVE SOCIALISTE TË JETËS SONË

1.

Letërsia dhe artet e sotme shqiptare janë të lidhura ngushtë me historinë e vendit, me transformimet e mëdha shoqërore, me luftën, punën dhe jetën e popullit. Ato janë pasqyruese të zhvillimit revolucionar të lëvizjes përpara të socializmit, që është tipari kryesor dhe vendimtar i realitetit tonë, të cilit i nënshtrohen të gjitha mënyrat, mjetet dhe format e artit, që nga tipizimi dhe heroi e gjer te figuracioni. Dinamikën e lëvizjes përpara të socializmit e gjejmë të mishëruar plotësisht në programin e Partisë, të shtruar në Kongresin e 7-të të saj, që është krijim i mendimit kolektiv të Partisë, i bazuar në mësimet e marksizëm-leninizmit dhe në eksperiencën e revolucionit tonë, në ligjet shkencore të zhvillimit të shoqërisë.



Kongresi i 7-të i Partisë mori vendime me rëndësi të madhe historike për ndërtimin e mëtejshëm të socializmit në vendin tonë. Gjithë populli ynë, duke u thelluar vazhdimisht në idetë e raportit të shokut Enver dhe të materialeve të Kongresit të 7-të, rrit çdo ditë besimin në vijën e Partisë për ndërtimin e plotë të shoqërisë së re në Shqipëri, për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit nga çdo shtrembërim, në interes të revolucionit dhe të popujve. Mbrojtja e lirisë dhe e sovranitetit kombëtar, si detyrë mbi të gjitha detyrat, zhvillimi i vrullshëm i industrisë dhe perspektiva e shndërrimit të vendit në një vend industrialo-agrar, përsosja e marrëdhënieve në prodhim, përparimi i mëtejshëm i bujqësisë dhe forcimi i bindjeve të ndërgjegjshme se ajo është çështje e të gjithëve, afrimi i fshatit me qytetin, si pasojë e ecjes përpara të jetës dhe e veprimeve revolucionare që po ndërmer Partia, lufta kundër bllokadës së egër imperialisto-revizioniste, pasurimi i botës shpirtërore të njeriut — të gjitha këto janë për popullin tonë një program i madh pune.

Në realizimin e këtij programi madhështor të Partisë rol të madh luan ndërgjegja shoqërore, gjithë superstruktura socialiste, duke përfshirë edhe letërsinë dhe artin. «Ndërgjegja e njeriut — thotë Lenini, — jo vetëm që e pasqyron botën objektive, po edhe e krijon atë». Në këtë kuptim pasqyrimi i realitetit në art është një proces aktiv me një synim të caktuar, që ka detyrën e vet jo vetëm thjesht të rikrijojë disa anë të realitetit, po edhe të veprojë mbi jetën me një qëllim e me një tendencë për ta ndryshuar dhe transformuar. Këtu shprehet edhe funksioni ideologjik dhe edukativ i artit, i cili duke hyrë në ndërgjegjen e

njeriut, kthehet në forcë materiale për përsosjen e mëtejshme të gjithë shoqërisë.

Ky mision i madh shoqëror qëndron në gjithë përmbajtjen e artit tonë, duke i dhënë atij mundësi të pakufishme zhvillimi në brendi dhe në formë. Këtë e tregojnë gjithë arritjet e tij, të cilat i vlerësoi lart Kongresi i 7-të i Partisë, duke shprehur besimin për realizime të tjera të rëndësishme. «Partia, — tha shoku Enver në Kongresin e 7-të, — ka treguar kujdes të vazhdueshëm që kultura, letërsia, dhe artet të zhvillohen të pastra dhe të shëndosha, të ndjekin hap pas hapi transformimet revolucionare të vendit dhe të forcojnë gjithnjë e më shumë përmbajtjen e tyre socialiste, karakterin militant, frymën popullore dhe fizionominë kombëtare».

Letërsia dhe arti, duke vazhduar procesin e konsolidimit dhe zhvillimit të tyre të mëtejshëm, kanë fituar cilësi të reja dhe kanë zgjeruar frymëmarrjen e tyre. Ato kanë hyrë gjithnjë e më shumë në proceset e zhvillimit shoqëror, në tematikën dhe në problematikën e tij, duke i pasuruar gjinitë dhe llojet me përmbajtjen dhe me formën e re në kushtet e sotme të jetës së vendit. Të bazuara në metodën e realizmit socialist, ato kanë thelluar analizën e fenomeneve shoqërore dhe kanë forcuar realizmin, duke ngritur probleme që kanë preokupuar popullin dhe Partinë. Gjatë gjithë procesit krijues letërsia dhe arti kanë dhënë tablo të gjera të realitetit dhe kanë tipizuar heronj e personazhe të rinj me mendime të thella, me psikologji dhe botë të pasur e me ideale të larta komuniste. Etapë pas etape letërsia dhe arti ynë kanë pasqyruar ato ambiente dhe ata heronj, që ka nxjerrë vetë realiteti dhe jeta jonë. Prandaj ato janë rrethana dhe heronj tipikë, jo të trilluar, por që burojnë nga kushtet e socializmit në Shqipëri, nga kushtet e emancipimit të punës dhe njeriut.

Pesëvjeçari i shkuar, që ka qenë i mbushur me përpjekje dhe që ka ecur përmes ngjarjesh të mëdha, të brendshme dhe të jashtme, në rrethanat e bllokadës së egër imperialisto-revizioniste, në periudhën e një lufte të ashpër klasore kundër agresionit kulturor dhe ideologjik, e forcoi akoma më shumë artin tonë, duke e pasuruar me eksperiencë të gjerë dhe duke ia shtuar frymën e tij luftarake. Plenumi IV i KQ të Partisë, i cili kritikoi ashpër ato shfaqje të dëmshme liberale, të huazuara nga arsenali i kulturave dhe praktikave krijuese regresive e moderniste borgjeze e revizioniste, ato teorizime të huaja për metodën e realizmit socialist, që i kundërviheshin partishmërisë proletare dhe karakterit kombëtar popullor, evidentoi sukseset

e arritura dhe çeli horizonte të gjera dhe mundësi të papara për një zhvillim të mëtejshëm frontal të të gjitha gjinive të krijimtarisë sonë. Duke qenë një eveniment jetik për fatet e mëtejshme të artit tonë, Plenumi IV i KQ të Partisë, jo vetëm forcoi luftën kundër çdo ndikimi të ideologjive reaksionare, por evidentoi, përkrahu dhe nxiti ato tipare të larta të krijimtarisë sonë që qëndronin në trungun e shëndetshëm të saj.

Po ç'tipare të reja fitoi arti ynë në kushtet e ashpërsimit të luftës klasore dhe të bllokadës imperialisto-revizioniste? Tiparet e reja duhen kërkuar në tre aspekte: së pari, në aspektin ideor, së dyti, në aspektin artistik, së treti, në aspektin e ecurisë së gjinive dhe llojeve.

*Në aspektin ideor letërsia dhe artet tona e forcuan partishmërinë komuniste*, duke e pasuruar përmbajtjen dhe thelluar fizionominë kombëtare në papajtueshmëri me shtrembërimet ideologjike dhe shfaqjet e huaja borgjeze e revizioniste. Kjo ngriti më lart frymën e tyre edukuese dhe karakterin luftarak e militant, të realizuara përmes heroit pozitiv, patosit revolucionar dhe tendencës klasore. Me të gjitha këto, në letërsinë dhe artet tona u forcuan bindjet në të vetmin ideal estetik sundues, i cili përputhet me idealin komunist të shoqërisë sonë.

*Në aspektin artistik letërsia dhe artet e forcuan unitetin e përmbajtjes dhe formës.* Në këtë fushë ka ardhur duke u thelluar karakteri kombëtar i të gjitha arteve: letërsisë, muzikës, pikturës, skulpturës, teatrit dhe kinematografisë. Për rrjedhim, u thellua fryma popullore që është shprehje e interesave të përgjithshme të popullit, posqyrimi i jetës së tij, pikëpamjeve ideoestetike dhe idealeve të tij. Parimi i frymës popullore në art filozofikisht bazohet në mësimet e marksizëm-leninizmit mbi popullin si krijues të historisë, si krijues të kulturës materiale e shpirtërore. Shkrimtarët dhe artistët kanë rritur interesin dhe preokupimin për shfrytëzimin e gjerë të vlerave artistike të krijimtarisë së vërtetë të popullit — folklorit, pasurisë së gjuhës, frazeologjisë, mjeteve shprehëse etj.

*Në aspektin e ecurisë së gjinive dhe llojeve letërsia dhe artet janë zhvilluar frontalisht dhe në mënyrë harmonike duke e patur të qartë perspektivën e tyre.* Më parë, në artin tonë vendin kryesor e zinin poezia, tregimi, peizazhi. Gjini të tilla si romani, filmi, muzika simfonike, baleti, piktura kompozicionale dhe skulptura monumentale kanë qenë më pak të zhvilluara. Mirëpo jeta ushtroi një presion të madh mbi gjinitë dhe llojet e arteve tona, duke ven-



dosur raporte të reja më të avancuara. Tani hov më të madh morën romani dhe filmi dhe gjinitë e tjera që kanë mundësi të japin tablo më të gjera të jetës dhe që kanë fushë më të hapur për të analizuar shumë fenomene të jetës sonë e për të trajtuar më thellë luftën e klasave dhe kontradiktat në shoqërinë tonë. Kjo tregon, nga njera anë, zhvillimin dhe pjekurinë e letërsisë dhe arteve tona dhe, nga ana tjetër, procesin e demokratizimit të tyre të mëtejshëm.

Por letërsia dhe artet tona, të ngjitura në stadin e sotëm të zhvillimit të tyre, janë para programit të madh të Partisë. Problemi shtrohet kështu: *Si do ta përballojë krijimtaria këtë program? Si do t'i japë ritmet e zhvillimit ekonomik, ideologjik e kulturor të shoqërisë?*

I shtrojmë këto pyetje, pasi të zbatosh drejt vijën e Partisë në fushën e krijimtarisë artistike, do të thotë të mishërosh në art programin e saj, do të thotë që çdo vepër t'i përgjigjet frymës së Kongresit, analizës së thellë shkencore marksiste-leniniste që iu bë fenomeneve kombëtare dhe ndërkombëtare. Në letërsi dhe arte idetë e programit të Partisë realizohen përmes temës, problematikës dhe heroit të realitetit aktual dhe historik, të përshkuara nga partishmëria proletare.

Një aspekt i rëndësishëm i problemit të partishmërisë është pasqyrimi i aktualitetit, i ritmeve të zhvillimit të shoqërisë sonë, i temës së punës, sepse kjo është një temë qendrore në artin e realizmit socialist dhe këtu mpleksen mjaft probleme, që kërkojnë një trajtim të veçantë. Jashtë pasqyrimit të punës, jashtë rolit të saj transformues në raport me shoqërinë dhe njeriun, letërsia dhe arti nuk mund t'i japin të plota ritmet e zhvillimit të socializmit. Arti ynë gjithmonë e ka patur në qendër të tij njeriun dhe punën, jetën e përditshme e të shumëanshme, marrëdhëniet shoqërore dhe individuale, me idealet dhe rrjedhën e natyrshme të gjërave, me gjuhën e gjallë dhe humorin e popullit, me tërë plastikën e veprimit dhe të ndjenjave. Këto tipare ne i gjejmë edhe në veprat e tanishme, edhe në ato që janë krijuar vite më parë, si «Kënetat» e F. Gjatës, «Përsëri në këmbë» i Dh. Xhuvanit, «Njerëzit e qytezës në mal» e F. Cakajt, «Kalamajt e pallatit tim» e B. Dedës, «Njerëz dhe gurë» të A. Kondos, tregime të Z. Çelës e plot të tjera, në të cilat puna shkrihet organikisht, në gjithë përmbajtjen e tyre dhe nuk mbetet si diçka e shkëputur në vetvete. Në veprat tona ka patur edhe përpjekje për të dhënë formimin shpirtëror të punëtorit, duke kaluar nëpër një rrugë të vështirë, kundër psikologjisë së vjetër, si bie fjala në romanin e V. Koreshit «Mars» e ndonjë tjetër. Letërsia dhe artet tona e kanë trajtuar rolin e punës në formimin e njeriut në shumë aspekte. Të marrim tablonë e S. Shijakut «Punëtorët në studjon e piktorit». Në këtë vepër përnjëherësh ndjehet puna me atmosferën e saj, prandaj vepra ngjall mendime dhe emocione të thella. Dhe jo vetëm kaq. Këtu shkrihet me mjeshtëri artistike puna krijuese intelektuale me punën fizike. Punëtori bashkëkohës, i rritur në kushtet e socializmit, di të mendojë për punën krijuese, di ta ndjejë atë dhe të gjykojë për vlerat e saj. Por të arrish të krijosh një vepër me mendime e ndjenja të forta përnjeriun e punës, duhet ta njohësh këtë njeri në veprimtarinë e përditshme të prodhimit të të mirave materiale dhe në të gjithë aktivitetin tjetër shoqëror e politik, ta njohësh me një tendencë dhe pikësynim të caktuar.

Disa arritje të ndjeshme të arteve tona figurative, që përballuan me sukses dy ekspozita të mëdha kombëtare, për një kohë të shkurtër, si 30-vjetorit të çlirimit të At-dheut dhe e 35-vjetorit të themelimit të Partisë, e kanë burimin në njohjen e realitetit dhe të ndërtuesit të shoqërisë së re. Edhe sukseset e disa piktorëve e skulptorëve

tanë të njohur janë rezultat i vrojtimit të drejtpërdrejta në jetën e vendit, që nga Fierza e gjer në Bistricë.

Në procesin e punës lindin mendimet dhe ndjenjat e mëdha, lindin dëshirat dhe pasionet, kërkimet dhe nxitjet për të ecur përpara, për të mos u vetëkënaqur nga ato që janë arritur dhe për të parë më qartë perspektivën. Përmes punës, qoftë fizike, qoftë mendore, zbulohen ndeshjet e mendimeve, konfliktet dhe debatet për ta çuar shoqërinë përpara, lindin dhe rriten herojtë rinj, pasqyrimi i të cilëve do t'u jepte veprave letrare e artistike dramacitetin dhe epicitetin e epokës. Lindja e herojve të rinj në jetë i ka ndihmuar letërsinë dhe artet tona ta mbajnë përherë të freskët përmbajtjen e tyre. Regjisorit të mirënjohur V. Gjika, vetë jeta ia serviri heroin e filmit «Rrugë të bardha», në të cilin individualizohet figura e punëtorit të thjeshtë Dedë, që për interesin e përgjithshëm të shoqërisë është gati të sakrifikojë jetën e vet. Në këtë figurë gjejmë mishërimin e tyre virtytet e larta të njeriut tonë me moral të ri, të formuar në kushtet e jetës socialiste. Në film është vendosur një raport i drejtë mes idealeve shoqërore dhe jetës intime të njeriut. Prandaj ai ka një tingëllim të përgjithshëm realist dhe një humanizëm të theksuar socialist.

Por me kalimin e kohës problemi i pasqyrimin të punës dhe të figurës së punëtorit në letërsinë dhe artin tonë do të bëhet edhe më i mprehtë, edhe më aktual. Me realizimin e programit të Partisë, socializmi do ta ngrejë në një shkallë më të lartë klasën tonë punëtore, duke e bërë atë edhe më të fuqishme, edhe më të ndërgjegjshme për misionin e saj në shoqëri, edhe më të pasur në botën shpirtërore. Sfondi i punës dhe i veprimtarisë së klasës punëtore, do të ketë përpjestime të mëdha dhe fronti i ndërtimit të socializmit do të jetë më i gjerë dhe më epik. Në raportin që mbajti shoku Enver në Kongresin e 7-të thuhet: «në planin e 6-të pesëvjeçar është parashikuar zhvillimi i mëtejshëm dhe i gjithanshëm i industrisë socialiste, duke i dhënë përparësi, si edhe më parë, zhvillimit të industrisë së rëndë, pararojë e tërë procesit të industrializimit socialist të vendit. Me vënien në shfrytëzim të veprave të reja me nivel të lartë përqëndrimi të prodhimit e të paimit teknik, industria do të marrë përmasa e karakteristika të reja cilësore».

Realizimi i këtyre detyrave i hap fushë të gjerë dhe letërsisë dhe arteve në pasqyrimin e ritmeve të zhvillimit të shoqërisë, veçanërisht të figurës së klasës punëtore. Rritja dhe pjekuria e forcave tona krijuese, konsolidimi

dhe zhvillimi i vazhdueshëm i realizmit socialist e bëjnë të mundshme pasqyrimin më të plotë të figurës së punëtorit tonë të sotëm. Për pasqyrimin e plotë të kësaj figure është e domosdoshme të thyhen disa koncepte të vjetëruara fre-nuese.

*E para, duhet luftuar që heroi punëtor të zerë vendin qendror në veprën letrare dhe artistike.* Aktualisht në mjaft vepra, sidomos romane e drama, ai është anësor dhe përdoret vetëm si mjet për të ilustruar idenë se mendimi punëtor zotëron jetën tonë. Ai në mjaft raste ende ka mbetur një figurë episodike, që shfaqet nëpër faqet e romanit apo dramës duke tundur grushtin për të treguar «shpirtin revolucionar» dhe, si tund grushtin, zhduket duke mos lënë ndonjë gjurmë. Graviteti i veprës anon gjetiu, në figura të tjera, që, vërtet veprojnë në ambientet punëto-re, por nuk janë punëto-re. Të shumtën e rasteve, këto figura janë nëpunës të thjeshtë, apo intelektualë. Doemos, kur figurat e intelektualëve popullorë skaliten në raport të drejtë me ato të punëto-reve, kjo është gjë pozitive, por kur mbetemi vetëm tek ata dhe nuk e shtrojmë më gjerë interesin krijues, atëherë biem në skematizëm dhe përsërisim disa shtampa të njohura, si mbeturinë e një përvoje të kapërcyer. Kështu p.sh. romani «Duel i madh» i A. Abdihoxhës ka merita në kapjen e problemit të përsosjes morale të njeriut përmes punës, në përshkrimin e skenave të përgjithshme të heroizmit të masës, por vlera e tij do të rritej akoma më shumë, po të pasqyroheshin në mënyrë të individualizuar edhe tipa punëto-resh, rreth heroit qendror të saj.

*E dyta, duhet luftuar që figura e punëtorit në veprë të mos zëvendësohet me një masë amorfe,* gjoja për të pasqyruar heroin-kolektiv. Heroi punëtor duhet të jetë tip me fizionomi dhe individualitet të plotë artistik, siç është Din Hyka në romanin «Përsëri në këmbë» të Dh. Xhuvanit, se në këtë mënyrë do të përfaqësojë me vërtetësi klasën punëto-re në kushtet e sotme të vendit. Në kurrriz të figurës së heroit punëtor, vitet e fundit, është abuzuar shumë me teorizimin famëkeq të copëzimit të saj. Ky teorizim është kamufluuar nën idenë hero-masë, sipas së cilës nuk na qenkësh e domosdoshme që të jepet me fizionomi të plotë të individualizuar heroi pozitiv, por mjafton që të pasqyrohet një grumbull njerëzish, që të jetë fizikisht i pranishëm në veprë. Atëherë edhe ambienti, ku jetonte ky grumbull, mund të quhej ambient-hero, barakë hero dhe absurditete të tjera si këto. Sipas këtij «parimi» i ndërtonte dramën e tij të gabuara edhe F. Paçrami, në mënyrë

që ta zbatonte konkretisht një krijimtari. Mirëpo turma amorfe nuk ka të bëjë fare me pasqyrimin e masës dhe rolin e saj në një veprë arti. Heroi i individualizuar, i dalë nga kolektivi dhe në raport të drejtë me kolektivin, pasqyron edhe rolin e masës në shoqëri. Mbeturinën e dëmshme të masës amorfe e gjejmë ndonjëherë nëpër estrada dhe shfaqje teatrale, ku pasqyrohet një grumbull punëto-resh pa individualitet, duke bërëtitur në emër të klasës.

*E treta, duhet luftuar që të pasqyrohen të plota ambiente punëto-re të epokës sonë.* Atdheu ynë ka një industri të përparuar me fabrika, uzina e kombinatet moderne. Në vendin tonë ka një front të madh ndërtimeve që nga ngritja e kullave të uzinave, digave të hidrocentraleve e gjer te montimi i elektroturbinave të fuqishëm. Ky ambient ende ndjehet pak në veprat letrare e artistike. Ngjarjet shpesh vendosen në ndonjë zyrë, barakë apo kafene, duke iu shmangur sfondeve të komplikuar të ndërtimeve të mëdha. Atëherë në vepra nuk ndjehet sa duhet epika e epokës sonë, nuk tregohet ku punon njeriu, me se është preokupuar, përse mendon gjatë ditës dhe si mpleksen në mendjen e në zemrën e tij mendimet dhe ndjenjat që e karakterizojnë heroin e kohës sonë. Në ndonjë rast këto ambiente nuk jepen me vërtetësi, po edhe deformohen, si në disa faqe të romanit «Në kërkim të së vërtetës» të A. Gjakovës, ku përshkruhet në këtë mënyrë familja e një shoferi: «Disa herë ua kishin prerë dritën elektrike dhe përsëri do t'ua prisnin atë muaj. Ajo nuk do të paguante. Nuk kishte. Më mirë pa dritë e të shëndoshë, se me dritë e t'i sëmurëshin e t'i ftohëshin fëmijët». Një përshkrim i tillë i varfëruar i ambientit, ka qenë tipik në jetën e paraqirimit të Atdheut, por jo në vitet 60-të, kur zhvillohet ngjarja e romanit. Nga ana tjetër romani, megjithë se trajton temën e rëndësishme të qëndresës dhe luftës kundër revizionizmit, ka një lloj ahistorizmi, sepse ngjarjet modernizohen dhe personazhet na dalin të qartë për probleme që në ato vite nuk shtroheshin ashtu, si paraqiten atje.

Që të jepen ambiente punëto-re të punës dhe të familjes, duhen njohur thellë dhe shkencërisht. Ne, ndonjëherë, ambiente në vepra i trillojmë me fantazinë tonë, prandaj dalin të zbehta. U hyjmë përshkrimeve të ndërtimeve të një hidrocentrali, fjala vjen, apo të një fabrike, pa njohuri të mjaftueshme të teknikës dhe teknologjisë së re. Në këto raste, vendin e punës dhe objektet e tij i japim të padetajuara dhe të palidhura me herojtë e personazhet. Kur pikturojmë ndonjë tablo nga këto ndërtime, ambienti

dhe veglat e punës duket sikur nuk kanë të bëjnë me njeriun, por qëndrojnë si të huaja për të.

Pasqyrimi me realizëm i ambienteve industriale ka rëndësi të madhe në art, pasi edhe ato, bashkë me heronjtë e rinj, japin tablonë e Shqipërisë industriale. Ne ende nuk jemi shpëputur nga disa koncepte të vjetëruara, të cilat pengojnë për t'i dhënë këto ambiente në mënyrë socialiste. Ka pasur raste kur përshkrimet e tyre janë bërë sipas librave të lexuara: shtyllat e tensionit të lartë i quajmë përbindështa, sirenat e fabrikave lubi, etj. Kjo është mbeturinë e huaj, e ardhur nga leximet e atyre romaneve të letërsisë botërore, të cilët punëtorin e nxjerrin të varfëruar, që e tremb dhe e shkatërron fabrika, ndaj e quajnë: lubi e përbindësh! Kurse tek ne fabrika dhe shtylla e tensionit janë të dashura si shtëpia, se i kemi ngritur për veten tonë.

*E katërta, duhet luftuar që heroi punëtor të tipizojë luftëtarin e sotëm shqiptar, njeriun e epokës në të cilën mbrohen nga revolucionarët idetë e komunizmit në luftë kundër ideologjisë antikomuniste, qoftë me prejardhje nga borgjezia dhe revizionizmi, qoftë nga myku e helmet e botës së vjetër.* Ky njeri mban mbi shpatulla një peshë të rëndë që i ngarkon historia në kohën, kur revizionistët mburren nëpër mbledhje e gostira se duan paqen dhe, në të vërtetë, vazhdojnë me ethe garën e armatimeve, kur supefuqitë duan të vendosin hegjemoninë e tyre në botë, ndërsa popujt luftojnë për pavarësinë dhe lirinë, kur Partia jonë mbron marksizëm-leninizmin dhe vendi ynë fiton gjithmonë e më shumë respektin e komunistëve të vërtetë e të njerëzve të ndershëm të planetit. Kur heroi punëtor të bartë këto ide, në vepër do të ndjehet mirë edhe epoka. Ne kemi nevojë për një hero pozitiv që të përmbledhë në vetvete vetitë më të mira të luftëtarit për të renë dhe të virtyeteve komuniste, që të ketë një horizont të gjerë dhe interesa të mëdha. Ai nuk duhet të mbyllet në katër muret e uzinës e fabrikës së tij dhe të mendojë vetëm për tornon, ose për të zgjidhur ndonjë konflikt me drejtorin apo shefin. Veprimtarinë dhe mendimin e tij ai duhet ta shtrijë përtej këtyre caqeve, si një njeri i gjerë dhe militant.

*E pesta, punëtorin ne nuk duhet ta pasqyrojmë vetëm në momente të jashtëzakonshme, por edhe në veprimtarinë e përditshme në punë dhe në jetë.* Kronika e jetës së punëtorit të shoqërisë socialiste duhet të jetë e plotë. Kur e pasqyrojmë punëtorin në çaste të jashtëzakonshme, shpesh e japim në mënyrë skematike, duke mos hyrë në thelbin e fenomenit, në motivet që e shtynë të marrë një veprim



heroik apo guxim të rrallë. Në këtë mënyrë, raporti i së vërtetës jetësore me idealin shoqëror nuk gjendet në një unitet organik dhe figurat dalin të sipërfaqshme dhe jo gjithmonë bindëse. Kjo ka të bëjë me konceptimin e përgjithshëm të njeriut në një vepër arti, të njeriut si «tërësi e marrëdhënieve shoqërore», siç thoshte Marksi, si qenie social-psikologjike njëherësh. Ne jemi ndeshur me një shikim disi romantik dhe moralizues të punëtorit, pasi nuk jemi thelluar sa duhet në veprimin dhe mendimin e tij revolucionar e transformues.

Njeriu në punë shfaq gjithë botën e tij të pasur shpirtërore, gjithë figurën e tij morale dhe politike. Prandaj duke pasqyruar punën, vetvetiu artisti do të trajtojë shumë probleme që lidhen dhe mpleksen drejtpërdrejt me të. Të tilla janë problemet e përsosjes morale, të edukimit të ndërgjegjes, të kalitjes përmes vështirësive të jetës, të vetmohimit për interesin e gjithë shoqërisë. Me këtë problematikë ne duhet të kemi më shumë vepra, të cilat do të shërbenin për edukimin e gjithanshëm komunist, veçanërisht të moshave të njoma dhe të rinisë. Në këtë fushë letërsia për fëmijë dhe të rritur mund të bënte më shumë.

Problemi i punës dhe njeriut në letërsinë dhe artet tona gjithmonë do t'i preokupojë shkrimtarët, artistët dhe kritikët tanë. Ky është një problem i madh, pasi zgjidhja



e drejtë e tij ka të bëjë me pasqyrimin sa më të plotë të aktualitetit tonë socialist, të ritmeve të zhvillimit të shoqërisë sonë. Puna dhe njeriu i ditëve tona janë objekt i gjithë arteve: letërsisë, muzikës, arteve figurative, kinematografisë, teatrit e koreografisë. Një nga sukseset e dukshme të arteve figurative kohët e fundit, fjala vjen, është edhe pasqyrimi i gjerë i njeriut përmes punës. Megjithatë, edhe në këto arte vihet re një konceptim i sipërfaqshëm i njeriut punonjës dhe i ambienteve ku vendoset. Bota e brendshme e këtij njeriu shpesh është e varfër dhe kemi ende shfaqje të skematizmit.

Tablo në pikturë e kompozime në skulpturë, si «Sup më sup si malet» e U. Hajdarit e «Libri në fshat» e I. Sulovarit, megjithëse trajtojnë tema të rëndësishme të realitetit tonë, kanë pak jetë, pak mendime dhe u mungon emocioni.

Arti ynë gjithmonë e ka pasur në qendër heroin pozitiv, që mbart mbi vetë idealet e revolucionit, por pas Plenumit IV të KQ të Partisë dhe pas fjalës së shokut Enver të 20 Dhjetorit 1974, u tregua një vëmendje edhe më e madhe ndaj tij. Gjatë kësaj periudhe iu bë një luftë e ashpër shfaqjeve të huaja të copëzimit të heroit, të nxirjes apo lustrimit të tij, si edhe teorizimeve në këtë fushë. Në të gjitha llojet dhe gjinitë e arteve tona ka pasur përparime të ndjeshme në krijimin e figurës së heroit pozitiv dhe në interpretimin teorik të saj. Por duke e parë aktualitetin në dritën e vendimeve të Kongresit të 7-të të Partisë, del detyra ta pasqyrojmë më shumë e më mirë dhe kjo kërkon njohje e pregatitje ideologjike, si edhe mjeshtëri më të madhe artistike. Në sytë tanë ndërtohet dhe jep çelikun e parë shqiptar Metalurgjiku i Elbasanit, po ngrihet Fierza e Ballshi; vitin e kaluar, për herë të parë në histori, ne bëmë bukën në vend — këto dhe shumë anë të tjera të jetës, kërkojnë si vepra të frymëzuara e poetike, këngë e valle të bukura, skica e vizatime, sipas kërkesave estetike të gjinive, ashtu edhe vepra që do të nisen nga një njohje e meditim më i thelluar: roman me një shtrirje të gjerë kompozicionale e shumëplanëshe, tablo në pikturë e grupe skulpturale e muzikë, që të hymnizojë punën, bukurinë shpirtërore të njeriut punonjës, filma artistikë, vepra teatrale e baleti.

Ritmet e zhvillimit të klasës sonë punëtore dhe të vepres së saj të pavdekshme kërkojnë aktivizimin e të gjitha gjinive dhe llojeve të artit tonë. Pasqyrimi i këtyre ritmeve duhet të verë në lëvizje edhe gjini të tilla si filmi dokumentar artistik, i cili me mënyrën e tij publicistike të fuqi-

shme ka mundësi të mëdha ta japë flakë për flakë dinamikën e ecjes sonë përpara. Kjo gjini në asnjë mënyrë nuk duhet nënvleftësuar me zhvillimin e filmit artistik. Filmi artistik dhe dokumentari artistik plotësojnë njeri-tjetrin dhe nuk e mohojnë. E themi këtë, pasi vihen re shenja të nënvleftësimit të tij. Përvoja jonë na mëson se disa filma dokumentarë si «Rruga jote, shok» e E. Kekos dhe «Katër këngë për Partinë» e V. Gjikes, për forcën e tyre politike dhe artistike, qëndrojnë në një nivel me veprat më të mira të kinematografisë sonë.

### 3.

Zhvillimi i vazhdueshëm i realizmit socialist përsos edhe harmonizimin e tematikës dhe problematikës së arteve. Kjo buron nga vetë karakteri realist dhe militant i letërsisë dhe arteve tona, nga vetë presioni i jetës që ushtron mbi to, nga vetë orientimi i punës letrare e artistike si një punë partie për t'i shërbyer shoqërisë. Artet tona nuk mund të jenë plotësisht realiste, në qoftë se nuk e përfshijnë gjithë jetën e shoqërisë dhe problematikën e saj në aspektet e tyre kryesore. Duke folur për pasqyrimin e njeriut të punës, nuk mund të mos trajtosh edhe problemin tjetër të lidhur ngushtë me të, problemin e temës së fshatit tonë socialist. Në raportin që mbajti shoku Enver në Kongresin e 7-të të Partisë, duke folur për zhvillimin e bujqësisë, theksoi: «Lufta për zhvillimin e gjithanshëm e të shpejtë të saj është luftë për socializëm e pavarësi, është luftë për moskllavërimin e mosvarfërimin e vendit. Për këto arsye Partia ka hedhur me kohë parullën «bujqësia — çështje e të gjithë popullit». Duke qenë çështje e të gjithë popullit, kjo është edhe çështje e artit, si pasqyrues i popullit, punës dhe shpirtit të tij. Po t'i shohim fenomenet e sotme artistike në dritën e detyrave të Kongresit të 7-të të Partisë, problemi i pasqyrimin të jetës së fshatit socialist dhe të heroit të tij në letërsi dhe arte merr një rëndësi të madhe aktuale. Problemin e fshatit artet tona e kanë shtruar gjithmonë me mprehtësi, duke e inkuadruar jetën e njerëzve të tokës në gjithë veprimtarinë shoqërore të vendit. Në veprat më të mira të shkrimtarëve dhe artistëve çështja e zhvillimit të fshatit tonë ka zënë një nga vendet kryesore. Kjo temë ka fituar cilësi të reja me romanin «Juga e bardhë» e J. Xoxes, në tablotë «Toka i takon atij që e punon» të G. Madhit, apo «Krijimi i kooperativës» e Z. Shoshit. Ka gjetur një thellim të mëtejshëm në aspekte të tjera në



me mësimet marksiste-leniniste të Partisë. Nga kjo e metë nuk ka shpëtuar as romani i J. Xoxës «Juga e bardhë».

E katërta, *ambientet e fshatit të sotëm, nga njohja e pamjaftueshme, shpesh pasqyrohen në mënyrë libreshke, të sipërfaqshme dhe të thatë*. Proçeset e punës në fshat nuk janë të thjeshta si 30 vjet apo 15 vjet të shkuara. Në fshat janë të thjeshta si 30 vjet apo 15 vjet të shkuara. Në fshat ka një ekonomi me potencë e të planifikuar, punohet në bazë të shkencës agroteknike, ka një makineri të tërë që nga traktori e gjer te punishtja industriale apo fabrika e vogël. Të gjitha këto duhen njohur, përndryshe nuk mund të shkruhet me vërtetësi as romani, as tregimi. Pikërisht nga njohja e pakët e punës dhe e jetës së fshatit ne hidhemi shpesh në problemin e fejesave dhe shfejesave. Ndonjëherë, kur e përshkruajmë punën, bëjmë gabime, si p.sh., për të vaditur një arë me misër mblidhet gjithë fshati dhe lëshon ujin e kanaleve. Po hyri gjithë fshati në arë, misri shkelet i gjithë dhe kthehet në ugar! Arën e ujitin dy-tre vetë: njeri në fund dhe tjetri në krye të brazdës.

Duke mos njohur ambientet, nuk njohim as gjuhën e pasur të fshatarit, frazeologjinë dhe humorin e tij. Atëherë heronjtë dhe personazhet fshatarë flasin si studentët dhe nëpunësit, pa kolorit dhe pa individualizëm. Ndryshe mund të flitet për ato vepra, autorët e të cilave e njohin thellë fshatin, si prozatorin K. Kosta, që për një kohë të gjatë punon si mësues në fshatrat e Gjirokastrës. Tregimet e tij, sidomos përmbledhja «Dademadhja» kanë vërtetësi jetësore dhe problematikë të mprehtë. Në to ndjehet qartë preokupimi i fshatarëve tanë për ta transformuar më tej jetën e fshatit.

Por në përgjithësi ka mjaft vepra, që mund të kritikoheshin për trajtim të cekët, episodik dhe pllakatesk të fshatarësisë, si «Buka e duarve tona» e teatrit të Vlorës, ku konflikti mbetet i cekët dhe i sipërfaqshëm. Ka edhe vepra ku debati politik ngrihet mbi raste të thjeshtëzuara. Problemi i debatit, i ngritjes së problemeve të mëdha në dramë apo roman do të thotë shuarje e karaktereve njerëzore, mënjanim i subjekteve të qartë dhe i botës së brendshme të njeriut. Kërkime të bëjmë, po të jemi më ekzigjentë ndaj vetes, sepse tani kemi arritur nivele të atilla, të cilat duhen mbajtur dhe ngritur më lart.

Letërsia dhe artet tona, që janë ngjitur në një stad të lartë zhvillimi, kanë mundësi reale për të ecur përpara në zbulimin dhe konceptimin e karaktereve të fshatarëve tanë të sotëm, të realitetit të madh socialist me ato marrëdhënie të reja në prodhim, me kooperativat e tipit të lartë, me çerdhet e kopshtet që janë hapur, me të gjitha leh-

tësitë që i janë krijuar fshatit. Ne duhet të shohim fshatin në dritën e atyre objektivave dhe detyrave të mëdha që caktoi Kongresi i 7-të i Partisë. Objektivi kryesor i Partisë në bujqësi në pesëvjeçarin e 6-të, është sigurimi i plotë i bukës në vend. Edhe letërsia dhe arti, po të flasim në mënyrë të figurshme, duhet ta sigurojnë bukën në këtë lëmë. «Në kushtet e rrethimit e të bllokadës imperialisto-revizioniste dhe të krizës ekonomike botërore — thotë shoku Enver — bëhet edhe më e domosdoshme që vendi të jetë i pavarur nga tregjet e huaja». Me këtë ndjenjë politike duhet ta trajtojë çdo krijues edhe temën e madhe të fshatit tonë socialist, në mënyrë që letërsia dhe artet të materializojnë idetë e Partisë dhe të bëhen forcë e madhe vepëruese në ndërgjegjen e njerëzve.

Arti ynë, që ka njohur realizime të shquara, ka mundësi të pakufishme të japë më të plotë tablonë e Shqipërisë socialiste, punën dhe luftën e njerëzve tanë në të gjithë frontin e ndërtimit të shoqërisë së re. Gjithë këto forca krijuese, shkrimtarë, kompozitorë, piktorë, skulptorë, kineastë, aktorë, solistë, këngëtarë e koreografë, të brumosur me ideologjinë marksiste-leniniste, kanë energji të pashtershme për t'i pasqyruar ritmet e zhvillimit të të gjithë fushave të vendit tonë: qytetit e fshatit, fabrikës dhe arës, ushtrisë dhe shkollës. Duke pasqyruar të gjitha sferat e jetës, duke tipizuar figurën e bashkëkohësit tonë në gjithë gjinitë dhe llojet e artit: poezi, prozë, pikturë, skulpturë, teatër, muzikë e kinematografi, ne japim edhe shpirtin e epokës sonë në kushtet e luftës së madhe në rrethimin imperialisto-revizionist. Të gjitha indet dhe qelizat e trupit të artit tonë duhet ta ndjejnë misionin e madh historik që ka ndërmarrë populli ynë për ndërtimin e socializmit nën udhëheqjen e Partisë e të shokut Enver. Shoqëria jonë ka të drejtë t'u kërkojë letërsisë dhe artit që ta japin akoma më të plotë seç e kanë dhënë, shpirtin e epokës.

## ZBULIMI I DREJTË I ASPEKTEVE TË RËNDËSISHME TË REALITETIT AKTUAL DHE HISTORIK.

1.

Një nga problemet që shtroi Kongresi i 7-të i Partisë për punonjësit e letërsisë dhe të arteve, është edhe ai i trajtimit të temave themelore të realitetit tonë aktual dhe his-

torik. Ky problem nuk mund të kuptohet kurrsesi jashtë atij për të cilin folëm, trajtimin të temës së punës, të figurës së punëtorit e të fshatarit, duke e parë historikisht e sidomos në procesin e zhvillimit të shoqërisë socialiste. «Pasqyrimi më i mirë i disa temave të mëdha në krijimtarinë artistike, — theksoi shoku Enver në Kongresin e 7-të të Partisë, — si ajo e rolit hegjemon të klasës punëtore në shoqëri, e shndrrimeve revolucionare të fshatit tonë socialist, e forcës revolucionarizuese të komunistëve, trajtimi i temave kardinale dhe i momenteve kyçe të historisë së popullit tonë dhe sidomos të Luftës Nacionalçlirimtare e të revolucionit socialist janë një kërkesë e domosdoshme për t'i bërë letërsinë dhe artet tona edhe më revolucionare».

Në zhvillimin e sotëm të vendit tonë, me përvojën e fituar dhe me mundësitë më të mëdha që kanë fituar në vetvetë letërsia dhe artet, është bërë edhe më i domosdoshëm e më i mundshëm se sa përpara shikimi i realitetit dhe i revolucionit nga një horizont më i gjerë, ku të përfshihen edhe më tepër përgjithësime dhe probleme të mëdha të së sotmes dhe të historisë së popullit tonë. Ky problem do kuptuar në kompleksin e vet, sepse të gjitha problemet që preokupojnë popullin, kur trajtohen drejt dhe me partishmëri, kanë rëndësinë e tyre. Këtu nuk duhet të lindin keqkuptime e të kalojmë në një interpretim të cekët dhe të njëanshëm të këtij problemi. Duke pasqyruar të sotmen, luftën, punën apo të kaluarën historike në aspekte të shumta, që lidhen me jetën e popullit, ne formojmë tablonë e madhe të shoqërisë sonë. Prandaj këtu nuk është fjala për të rënë në grandomani, për të parë vetëm përpjestimet apo numërin e personazheve, sepse mund të ndodhë që të nisesh për shumë e të përfundosh me pak, apo të mbelesh në përshkrime të mëdha në dukje, po të cekta për brenda. Ne kemi nevojë për lëvrimin e të gjitha temave dhe të një problematike sa më të larmishme, duke përfshirë atë epike, lirike, dramatike, me përmasa të gjera, si edhe tema morale të familjes, të shoqërisë e të dashurisë, të shikuara në prizmin e kohës dhe të socializmit. Por këtu duhet që në kompleksin e gjithë temave të tregohet një vëmendje më e madhe ndaj temave kardinale e kyçe, ku t'i hidhet një vështrim i thellë epokës sonë me ngjarjet e saj të mëdha. Gjithmonë, p.sh., kanë për të tërhequr vëmendjen e artistit tema të tilla të mëdha si marshimi i brigadave partizane për çlirimin e Shqipërisë, ndeshja dhe debati politik me tradhëtarët gjatë luftës, beteja heroike të çlirimit të qyteteve tona e shumë ngjarje dhe tablo nga ajo kohë, ashtu si edhe reforma agrare dhe shpronësimi

i çifligarëve dhe kapitalistëve, kolektivizimi i fshatit, lufta në bllokadën e egër imperialisto-revizioniste, ngritja e një hidrocentrali apo uzine, krijimi i një qyteti të ri dhe kalitja e karaktereve përmes vështirësive të punës dhe luftës. Po kështu, mund të merren ngjarje kyçe të historisë, siç janë marrë, nga epoka e Skënderbeut, e unitetit të popullit në luftën kundër pushtuesve, nga periudha e kryengritjeve shqiptare dhe e Lidhjes së Prizrenit e shumë ngjarje historike, që kanë lënë mbresë të pashlyera në historinë e popullit.

Të gjitha llojet e gjinive e arteve tona në specifikën e tyre kanë mundësi të pakufishme për ta përfshirë jetën me tërë tematikën e problematikën e saj të rëndësishme. Letërsia dhe arti ynë e kanë në traditën e tyre të pasqyrojnë hallet dhe fatin e popullit. Fjala vjen, poezia, si lloji më me traditë në artin tonë, gjithmonë është prirë ndaj fenomeneve esenciale të jetës së Shqipërisë, që nga Naim Frashëri e gjer te poeti më i ri i kohës sonë. Kjo traditë e shëndoshë e poezisë sonë ka fituar cilësi të reja në kushtet e revolucionit tonë dhe të ndërtimit të socializmit. Një tendencë e tillë ka hapur horizonte të gjera në pasurimin e mëtejshëm të përmbajtjes dhe të formës së saj. Poetët tanë si Ll. Siliqi, I. Kadare, F. Arapi, L. Qafëzezi, A. Gjakova, R. Marku, A. Mulaj, A. Isaku, Ll. Ruci, H. Aliaj, S. Buçpapaj, P. Jorgoni, A. Istrefi, N. Papeleka N. Gjetja e të tjerë, vazhdojnë ta lëvrojnë dhe ta përsosin përherë e më shumë përmbajtjen dhe mjetet shprehëse të saj. Librat poetikë «Ju flet Tirana» e Ll. Siliqit dhe «Koha» e I. Kadesë, botuar vitet e fundit, të tërheqin vëmendjen për frymën aktuale militante dhe për trajtimin e shqetësimeve të bashkëkohësve tanë në kushtet e rrethimit të egër imperialisto-revizionist. Këto vepra poetike, «Ju flet Tirana» dhe «Koha», edhe pse janë shkruar nga dy poetë me individualitet të ndryshëm artistik, i bashkon një ide e vetme: lufta e popullit tonë për ndërtimin e socializmit, qëndresa dhe optimizmi i tij, rrënjët e thella të patriotizmit dhe shpirti i përparimit. Po ta ndjekim zhvillimin e poezisë sonë të sotme, do ta ndjejmë tendencën e saj të snëndoshë për forcimin e përmbajtjes dhe për të futur në të jetën e gjallë të njerëzve tanë. Është gjithashtu pozitive prirja për të trajtuar në vargje luftën e sotme politike të proletariatit botëror kundër imperializmit dhe socialimperializmit dhe qëndrimin konsekuent të Partisë sonë në parimet e marksizëm-leninizmit. Nga ana tjetër, ka një kujdes më të madh në disiplinimin e vargut dhe në organizimin e gjithë figuracionit të poezisë, duke u mbështetur

më shumë në traditën e folklorit tonë. Sot në poezinë tonë, në përgjithësi, nuk ka cikërrima mikroborgjeze e formaliste. Megjithatë është e domosdoshme që poetët të luftojnë për të thyer një farë uniformitetin dhe origjinalitetin e poezisë. Poezia duhet të ketë më tepër mendime, filozofi dhe ngarkesë emocionale. Ajo duhet të ngjallë ndjenja të larta dhe asociacione të gjalla me gjuhën e saj të figurshme dhe me mendimet e saj të thella. Vendimet e Kongresit të 7-të të Partisë dhe programi i saj për ndërtimin e plotë të socializmit, gjithë puna dhe lufta e popullit tonë janë një burim i madh frymëzimi edhe për poetët dhe hapin horizonte të gjera për lulëzimin e mëtejshëm të të gjitha gjinive të poezisë sonë. Ajo ka fushë të gjerë për trajtimin me patos të thellë poetik të temave kardinale të jetës së vendit, sidomos në gjininë e poemës, ashtu siç kanë bërë Sh. Musaraj me poemën «Epopeja e Ballit Kombëtar» apo A. Çaçi me «Ashtu Myzeqe». E themi këtë se shumë nga veprat tona, duke u ngritur mbi tema të mëdha të zhvillimit të shoqërisë, i kanë rezistuar kohës dhe kanë mbetur në fondin e artë të artit tonë.

Subjekteve origjinale, me një gjetje të veçantë, disa autorë të talentuar kanë ditur t'u japin një frymëmarrje të gjerë, si p.sh. Busti i shokut Enver i O. Paskalit, «Para agimit» i Sh. Musarajt, «Lumi i vdekur» i J. Xoxes, «Ata nuk ishin vetëm» i S. Spases, «Një vjeshtë me stuhi» i A. Abdihoxhës, Monumenti i pavarësisë në Vlorë i K. Ramës, Sh. Hadërit dhe M. Dhramit, «Toka jonë» e K. Jakovës, «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» i I. Kadaresë, «Skënderbeu» i S. Godos, «Refugjatët» e A. Buzës, «Bajram Curri» i F. Dushkut, «Shpallja e Republikës» e F. Haxhiut, «Mbledhja e Moskës» e G. Madhit, «Heroinat e Mirditës» e P. Çulit, A. Manës, Dh. Gogollarit dhe F. Dushkut, portretet për luftëtarët të F. Stamos, operat «Mrika» e P. Jakovës, «Komisari» i N. Zoraqit e shumë të tjera. Letërsia dhe artet janë nisur nga idealet e mëdha dhe problemet më thelbësore të jetës; por ndihet nevoja e një kapërcimi cilësor që të fiksohen tablo të fuqishme dhe të forta të historisë së popullit në etapat më të rëndësishme.

Me këtë sy duhet ta shohim edhe trajtimin e temës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe të së kaluarës sonë patriotike e revolucionare, ashtu si nënvizuam edhe problemin e pasqyrimit më mirë të aktualitetit. Arti ynë është thelluar në këto probleme. Ndihet një unitet më i madh midis përmbajtjes e formës, janë gdhendur tipa që mbartin idealin e Partisë me natyrshmëri jetësore; më mi-

rë gërshetohen kontradiktat antagoniste me ato joantagoniste etj.

## 2.

Pasqyrimi i drejtë i proceseve të revolucionit e të historisë sonë kërkon një interpretim të saktë, sipas metodës së realizmit socialist, të rolit të masave në histori dhe të raporteve dialektike midis heroit dhe masës. Në përgjithësi arti ynë ka ecur përpara nga kjo pikëpamje. Heroizmi i masave dhe i individëve të edukuar nga Partia ka dalë mirë në pah në veprat kinematografike me temën e luftës, si «Në fillim të verës», «Dimri i fundit», apo «Lulekuqet mbi mur». Filmata tanë, ashtu si edhe romanet, kanë ecur drejt një realizmi më të thelluar, në luftë kundër nxirjes së realitetit si edhe kundër liberalizmit dhe skematizmit. Në letërsi janë krijuar vitet e fundit vepra si romani «Nëntori i një kryeqyteti» i I. Kadaresë, «Shtigjeve të zëna» e M. Kallamatës, vëllimi me vjersha «Kënga e maliherit» e F. Gjatës apo tregime të Dh. Shuteriqit, opera «Zgjimi» e T. Harapit apo këngët e A. Mulës. Në to, veçanërisht në librin poetik «Këngët e maliherit» të F. Gjatës, ndjehet me forcë emocionante shpirti i qëndresës, vetmohimit dhe optimizmit të njeriut që lufton për një ideal të lartë. Idealet e njeriut, që kaloi në zjarrin e luftës, lidhen ngushtë me vazhdimësinë e revolucionit.

Në pasqyrimin e luftës apo të heroizmit të sotëm, krahas anëve pozitive, vihen re edhe dobësi që lidhen me njohjen e cekët të realitetit historik e aktual. Ka vepra si p.sh. romani i autorit tonë të njohur e me përvojë I. Kadare «Nëntori i një kryeqyteti», ku me gjithë vlerat në krijimin e atmosferës dhe figurave pozitive, nuk kapet në thellësi procesi i zhvillimit të revolucionit dhe të optimizmit masiv me veçoritë e papërsëritëshme shqiptare të tij, por mbetet shpesh në sferën e simbolikës.

Shkruhen e botohen edhe në shtypin tonë letrar apo nëpër vëllime, tregime të zbehta nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, ku vërehet njohja e pakët dhe një lloj romantizimi tashmë i kapërcyer i ngjarjeve dhe figurave. Në disa tablo të pikturës me këtë temë, lufta jepet si skenë butaforike dhe nuk ndjehet ndeshja e vërtetë për jetë a vdekje. Kjo u vu re edhe në ekspozitën e 35-vjetorit të themelimit të Partisë, ku disa vepra që trajtonin Luftën Nacionalçlirimtare ishin të sipërfaqshme, pa mendimin dhe psikologjinë e kohës. Edhe në disa skena të filmave tanë lufta pasqyrohet si lojë dhe ndjehet fare lehtë

një farë irealiteti dhe trillim i fantazuar, që mund të kënaqë vetëm fëmijët...

Lidhur me pasqyrimin e drejtë dhe të gjerë të realitetit, si e përmendëm, krahas temave që i kushtohen Luftës Nacionalçlirimtare dhe jetës socialiste, me aspektet e veta më të shumta dhe më të larmishme, duhet të përfshijmë edhe temat e mëdha nga e kaluara dhe historia e popullit tonë. Mendojmë se këto tema do të kapen në dy drejtime kryesore, që i shërbejnë një qëllimi: së pari, për të treguar unitetin e popullit në luftë kundër armiqve të huaj, dhe së dyti, për të pasqyruar ndeshjen klasore të brendshme të vegjëlisë, të fshatarësisë e të shtresave të varfra e demokratike të qytetit, me bejlerët e agallarët, kundër shfrytëzimit feudo-borgjez. Është e kuptueshme se qëndrimi klasor duhet të jetë në themel të çdo veprë, por do të merren parasysh edhe veçoritë problemore. Kështu, p.sh. kur trajtohet epoka e Skënderbeut, theksi vihet në unitetin e popullit rreth heroit kombëtar, ndonëse përshkrimi i ngjarjeve mban parasysh ekzistencën e klasave dhe raportet sociale. Ndryshe është puna kur pasqyrohet p.sh. një ngjarje që lidhet me Rrapo Hekalin, ku do të dalë uniteti i popullit në luftë kundër klasës shfrytëzuese dhe pushtuesit. Doemos këto probleme e tema edhe mund të gërshetohen me njëra-tjetrën, po jo të kalohet në eklektizëm dhe të humbasë filli kryesor i një veprë dhe qëllimi për të cilin është shkruar.

Përveç atyre që u përmendën, janë krijuar vepra historike si «Kështjella» e I. Kadaresë, «Skënderbeu» i S. Godos, «Zgjimi» i S. Spasses, «Prijësja e komitëve» e S. Krasniqit, romani social me temë nga e kaluara «Shembja e idhujve» e S. Drinit, vepra koreografike e P. Kanaçit dhe P. Gacit «Kreshnikët e lirisë», tablotë «Shote Galica» e I. Lulanit, «Mic Sokoli» e S. Shijakut dhe «Tregim partizan» e N. Zajmit etj. Në një pjesë të mirë të këtyre veprave sundon patosi patriotik dhe ka një thellim më të madh se përpara në analizën sociale të tipave dhe ngjarjeve.

Në artet figurative ka vepra të realizuara me këtë temë, ku gjen një harmoni të dukshme figura historike me idealin e krijuesit dhe lidhet e shkuara me të sotmen përmes frymës heroike, si tek ekuestret «Skënderbeu» i Tiranës dhe i Krugës, apo monumenti i pavarësisë në Vlorë që e përmendëm pak më lart.

Në një vepër historike, cilido qoftë stili apo mënyra e të krijuarit, ka rëndësi si saktësia për të dhënë thelbin e epokës, ashtu edhe fantazia krijuese, e mbështetur në realitet, duke theksuar lidhjen e kohëve e duke e parë të

kaluarën me syrin e sotëm, gjë që nuk duhet të shpjerë kurrsesi në modernizimin e historisë. Këto probleme në teori janë rrahur, por në praktikë dalin vështirësi dhe bëhen gabime. Përveç veprave të realizuara, ka edhe prirje drejt një deskriptivizmi, ku nuk është i qartë këndi i të shikuarit.

Problemi i saktësisë historike, i gërshetimit të fakteve që pasqyrojnë frymën e kohës me imagjinatën e shkrimtarit, si edhe i zbulimit të kontradiktës kryesore të një kohe, i raporteve të drejta midis llojeve të ndryshme të kontradiktave, ka dalë edhe në vepra si «Pishtarë» të S. Spasses e në ndonjë tjetër. Dihet kontributi që ka dhënë dhe po jep ky shkrimtar në letërsinë tonë. Vitet e fundit ai i hyri një pune serioze për të nxjerrë një cikël romanesh nga periudha e Rilindjes. Por krahas prirjes së përgjithshme pozitive, romani «Pishtarë» ka edhe të meta të rëndësishme. Në roman, lëvizja patriotike popullore e një krahine nuk është parë sa duhet në lidhje me tërë lëvizjen kombëtare dhe nuk del gjerësia e madhështia e kësaj lufte me forcën që duhej të dilte në një vepër me përpjestime të tilla. Nga ana tjetër, do të ishte e përligjur prirja e autorit për të pasqyruar mpleksjen e kontradiktave të karakterit nacional me atë klasor, por duhej të zotëronte më qartë e më mirë problemi nacional, sepse ai shtrohej në atë kohë dhe nuk duhej të kishte vend një avancim jashtë historizimit që vërehet disa herë në vepër. Së fundi, në romanin «Pishtarë» duhej të dilte më qartë e më mirë mendimi se burimi i lëvizjes së masave popullore ka qenë në Shqipëri dhe nuk erdhi si një afsh i flakëve përtej kufirit. Gjithashtu nuk na duket me vend në roman pohimi i autorit në gojën e Bajo Topullit që shqiptarët nuk po luftonin si popujt fqinj për çlirimin e tyre. Bajo Topulli në roman i thotë Mistos: «E shoh, Misto... se si përpiqen grekët për helezimin e tyre, se si përpiqen vllahët e bullgarët për veten e tyre, se si u vranë e u therë e u bënë shkrumb maqedonasit për lirinë e tyre. E më vjen turp nga vetja. Po ne? Ç'bëjmë ne?!» Është e tepërt të themi se s'ka përse t'i vin-te turp Bajos; në atë kohë shqiptarët kishin luftuar e luftonin me heroizëm të madh dhe kanë qenë më krenarë dhe më superiorë nga të tjerët për luftrat që kanë bërë. Ne mendojmë se këto vërejtje autorin do ta ndihmojnë në punën e tij të mëtejshme për mbarimin e ciklit të romaneve nga luftërat e përpjekjet e popullit tonë për liri e pavarësi.

Problemi i saktësisë historike nuk është vetëm në ato vepra që kanë një ose disa figura konkrete historike, po

edhe në vepra që mbështeten në ngjarje të së kaluarës, që kanë një shtrat historik. Dihen meritat e romanit «Lumi i vdekur», por në dramtizimin dhe shfaqjen e Teatrit Popullor të kësaj vepre vihet re një paraqitje e shtrembër e disa skenave dhe tipave fshatarë, të cilët vërtet kanë qenë të varfër, po jo pa personalitet. Në disa raste ata ngjajnë më tepër me robër, që zvarnisen nëpër baltëra, se sa me fshatarë që luftonin kundër shtypjes e shfrytëzimit dhe kishin edhe jetën e tyre. Nga kjo dobësi vuan edhe tabloja në pikturë e Hilmi Banit «Kryengritja fshatare» në të cilën fshatarët paraqiten në ndonjë aspekt edhe me fytyra të raskapitura e të deformuara. Kjo nuk i përgjigjet realitetit historik. Ka qenë ky popull me këtë personalitet që u qëndroi rrebesheve dhe ruajti fizionominë e tij kombëtare dhe nuk duhet ta ulim dinjitetin e tij, qoftë edhe duke tre-guar varfërinë.

### 3.

Të gjitha këto aspekte teorike dhe praktike të krijimtarisë sonë janë të lidhura ngushtë si me idealin pozitiv, ashtu dhe me kuptimin dhe zgjidhjen e drejtë të kontradiktave. Zbulimi i thellë i kontradiktës dhe interpretimi dialektik i saj lidhet me pasqyrimin më të mirë të heroit punëtor, fshatar apo intelektual, me shtjellimin e problemeve dhe temave kyçe të aktualitetit dhe të historisë e të proceseve të zhvillimit shoqëror.

Duke folur për vërtetësinë dhe frymën militante në pasqyrimin e proceseve të revolucionit, duke e shtrirë këtë edhe në të kaluarën e në historinë, vetvetiu dalin probleme që lidhen me pasqyrimin e drejtë të kontradiktave, si shprehje e luftës së klasave në letërsi e arte. Partia e ka ngritur disa herë këtë problem, duke orientuar për zbulimin dhe zgjidhjen e drejtë të tyre. «Ndërtimi i socializmit, thuhet në raportin e shokut Enver, është proces i një lufte të ashpër klasore midis dy rrugëve, rrugës socialiste dhe rrugës kapitaliste, luftë që zhvillohet në të gjitha frontet politike dhe ekonomike, ideologjike dhe ushtarake». Duke theksuar domosdoshmërinë e pasqyrimin të drejtë të kontradiktave, në raport theksohet se artistët revolucionarë duhet «të luftojnë çdo shfaqje të formalizmit e të skematizmit në trajtimin e tyre».

Për zgjidhjen e drejtë të kontradiktave antagonistë dhe joantagoniste është e domosdoshme të njihen thellë orientimet e Partisë dhe realiteti, procesi i gjallë i jetës

dhe lufta që bëjnë punonjësit tanë kundër fenomeneve negative. Konceptimi i cekët filozofik, si edhe njohja e sipërfaqshme shpien në deformimin e realitetit tonë. Arti merr me probleme ideologjike, në specifikën e vet, por kontradiktat në jetë duhen marrë në mpleksjen e tyre, nga fusha të ndryshme të jetës, duke përfshirë problemet politike, ideologjike, ekonomike e shoqërore. Është mirë që tek disa vepra po vihet theksi në kontradiktat antagonistë, po kjo nuk do të thotë që të mos thellohem edhe në atë joantagoniste, në sferën e problemeve shoqërore e morale. Nuk kuptohet mirë, në disa raste, se edhe kur kontradiktat zhvillohen në gjirin e popullit, elementët e ideologjisë së huaj duhen luftuar si shfaqje antagonistë. Në këtë rast ne luftojmë pikëpamjen e jo bartësin, por pikëpamjen duhet ta luftojmë me thellësinë e duhur. Meqë mungon ndonjëherë koncepti i qartë i këtij problemi, ndodh që kalohet nga kontradiktat joantagoniste tek ato antagonistë, sepse pandehet sikur kështu vepra bëhet më intriguese e merr një rëndësi më të madhe. Natyrisht, edhe vepra ku gërshetohen kontradiktat kemi pasur e duhet të kemi, por kjo duhet të vijë e natyrisht dhe të ndihet tendenca kryesore që zotëron në të.

Në zbulimin e kontradiktave rëndësi të veçantë duhet t'u kushtohet ndeshjeve botëkuptimore. Nga kjo pikëpamje me rëndësi është të thellohet lufta kundër ndikimeve borgjeze-revizioniste, kundër mentaliteteve të vjetra e psikologjisë mikroborgjeze. Kjo duhet të ndihet si në interpretimin e fenomenit, ashtu në pasqyrimin e tij konkret.

Në pasqyrimin e luftës së klasave sot duhen mbajtur parasysh mësimet e Kongresit të 7-të, çka është më tipike për kohën e sotme. Përveç elementeve të klasave të ndryshme, agjentëve e diversantëve, armiku e ve shpresën tani sidomos tek ata njerëz të shkëputur, të cilët lindin në vetë gjirin e shoqërisë socialiste, karrieristë e individualistë «të çoroditur nga ndikimet e ideologjisë së sotme borgjeze-revizioniste, që thyhen përpara presionit të armiqve të jashtëm e të brendshëm, që më në fund largohen prej revolucionit e degjenerojnë në kundërrevolucionarë».

Përpara letërsisë dhe arteve del detyra që të forcojnë luftën kundër imperializmit e revizionizmit, kundër armiqve të rrezikshëm më tipikë të kohës sonë, duke theksuar me forcë anët pozitive të jetës, komunistin, heroin e ditëve tona, masën që iu kundërvihet. Lufta kundër burokratizmit, karrierizmit e individualizmit në sferën e punës, të shoqërisë e të familjes duhet të intensifikohen në letërsi, kinematografi, teatër, estradë dhe në gjinitë dra-

matike. Kjo mund të bëhet vetëm po të jenë të qarta idealet e Partisë, të mbrohen këto me forcë dhe të zbulohen rrënjët shoqërore e ideologjike të së keqes.

Veçanërisht gjinia e satirës dhe e humorit ka një fuqinë të gjerë në fshikullimin e fenomeneve negative, duke nxjerrë epërsinë e ideologjisë sonë me triumfin e idealeve pozitive. Por në këtë gjini hasen vështirësi që duhen kapërcyer. Ende ka paqartësi në problemin e tipikes dhe të vendit të heroit pozitiv në satirë dhe humor, sidomos në komedi. Në gjininë e komedisë heroit pozitiv akoma nuk ka formuar fizionominë e tij. Ai, të shumtën e rasteve, pasqyrohet po me ato mjete artistike që përdor drama, por këto nuk i përshtaten tipizimit të heroit të komedisë. Shpesh ky hero apo personazh flet me mënyrën fraziste të një agjitacioni vulgar, me një gjuhë stereotipe, pa kripë dhe shumë të mërzitshme. Heroi pozitiv i komedisë duhet të luftojë me gjuhën e satirës, me ironinë e sarkazmës, në mënyrë që ta verë në pozita qesharake kundërshtarin e vet. Një shembull i mirë në këtë rast është komedia e R. Pulahës «Zonja nga qyteti», në të cilën personazhet pozitivë janë në harmoni me ata që bartin mbeturina të së kaluarës. Ata luftojnë duke shfrytëzuar mjetet shprehëse të humorit.

Të meta të theksuara vihen re edhe në teatrot e estradave. Skeçet e tyre në përgjithësi janë të varfëra, pa probleme shqetësuese; në trajtimin e kontradiktave ka cektësi, formalizëm dhe banalitete.

Qoftë në dramë, qoftë në estradë, me gjithë përpjekjet që po bëhen, ka ende dobësi të theksuara në nivelin e tyre artistik dhe ideor. Është e domosdoshme që me këto gjini të angazhohen forcat e mira krijuese, që kanë një përvojë të pasur artistike. Nga ana tjetër, edhe teatrot duhet të qëndrojnë më afër forcave krijuese për t'i nxitur dhe frymëzuar. Ato duhet të kthehen në qendra me të vërtetë krijuese dhe të mos mbeten si zyra të zakonshme, ku bëhen inventarizime të temave dhe emrave të autorëve si në gjendjen civile...

Pasqyrimi i kontradiktave përmes konflikteve artistike, siç dihet, në arte si muzika, ka specifikën e vet dhe nuk mund të kërkohet si në një roman apo dramë. Megjithatë edhe këtu ekziston ky problem, jo vetëm në gjinitë skenike, po edhe në muzikën simfonike-orkestrale. Ndeshja e mendimeve dhe gjendjeve shpirtërore të kundërta, konflikte me të cilët vepron muzika, është e dukshme, sidomos në gjini të mëdha. Lidhja e heroikes me tragjikën, kapërcimi i dhimbjes dhe ngadhënjimi i ndjenjës optimiste është karakteristikë e muzikës sonë simfonike, si

në poemat simfonike «Borova» e Th. Gaqit, «Alarme të përgjakura» të Sh. Kushtës etj. Të ngarkuar me mendim dhe me zgjidhjen e drejtë të kontrasteve dhe emocioneve janë veprat e Ç. Zadejës, N. Zoraqit, F. Ibrahimit, T. Harapit, K. Larës, P. Gacit, etj. Megjithë këto arritje të dukshme të muzikës simfonike, në ndonjë vepër nuk del gjithmonë e qartë ideja. Kjo vjen si rrjedhim i influencës së formës dhe të mjeteve artistike mbi përmbajtjen. Forma dhe mjetet e ngurtëzojnë mendimin dhe e ndrydhin përmbajtjen. Ky fenomen ndodh sidomos në disa episode apo pjesë të veçanta të veprave muzikore ciklike.

Specifika e konfliktit të gjinisë nuk duhet ta ngushtojë gamën e tematikës dhe trajtimin e problemeve të mprehta politike. Populli me mjaft pjekuri ideologjike dhe mjeshteri artistike i trajton këto tema si Denoncimi i Traktatit të Varshavës e demaskimi i shantazheve të dy superfuqive imperialisto-revizioniste; ai vë në lojë Fordin dhe Brezhnjevin, duke përdorur gjithë armët e satirës: sarkazmën, ironinë, humorin. Ne kemi parë, fjala vjen, grupet amatore folklorike të Pilurit, Vranishtit, Sheperit dhe kemi vënë re se me ç'kolorit dhe me ç'pjekuri politike i trajtojnë këto probleme në këngët e tyre. Këtë tendencë popullore e ka patur gjatë gjithë historisë; ajo kuptohet menjëherë po të lexosh vargjet popullore të kohës së kryengritjeve të Rrapo Hekalit apo Gjolekës, të pavarësisë, të Luftës së 1920-ës dhe gjer në periudhën e Luftës Nacionalçlirimtare. Janë të njohura këngët që demaskonin pushtuesit fashistë, ballistë dhe tradhëtarët e vendit. Qëndrimi ndaj ngjarjeve të forta politike në gjininë e këngës ka një traditë të shëndoshë popullore, ashtu siç ka edhe eksperiencën e shtjellimit të fenomeneve të tilla si talljen me burokratët, servilët, vjedhësit, dembelët. Kjo traditë duhet të shfrytëzohet nga kompozitorët tanë për të trajtuar edhe tema të forta politike, ashtu siç i trajton populli në krijimtarinë e tij.

#### 4.

Të gjitha veprat që militojnë për vijën e Partisë, duke pasqyruar drejt e me thellësi fenomenet e jetës dhe heroin pozitiv, nuk do të ishin konkrete dhe nuk do të kishin origjinalitetin e tyre nëse nuk do të përshkoheshin nga karakteri kombëtar e popullor. «Karakterit kombëtar dhe fryma popullore, thuhet në raportin e shokut Enver, realizohen duke pasqyruar me vërtetësi realitetin, nga pozitativ



*e ideologjisë marksiste-leniniste, duke asimiluar në mënyrë kritike dhe nga pozita klasore gjithë përvojën e kulturës sonë, traditën e vjetër përparimtare dhe të rene revolucionare, duke u mbështetur fort në krijimtarinë e popullit».*

Pasqyrimi i jetës sonë revolucionare, si edhe i së kaluarës, të parë sipas botëkuptimit marksist-leninist, kërkon një konceptim më të thelluar e të saktë të karakterit kombëtar e popullor, të marrëdhënieve midis artit të kultivuar e atij popullor. Ky problem del në mënyrë të veçantë në poezi, në dramë e teatër, në balet, në koreografi dhe në gjinitë muzikore si kënga, opera, simfonia etj. Ne gjithmonë e kemi theksuar rëndësinë e karakterit kombëtar për artet tona të realizmit socialist. Këtu nuk do të ndalemi në gjithë problemet që përfshihen në këtë kategori historike dhe estetike, por do të prekim disa anë që mendojmë se kërkojnë një shpjegim më të qartë edhe nga kritika jonë letrare dhe artistike.

*Së pari, problemin e karakterit kombëtar nuk duhet ta vështirësojmë artificialisht, pasi kjo do t'i ngatërronte kot së koti krijuesit, sidomos ata me përvojë të pakët.* Që të mos e vështirësojmë duhen dy gjëra: a) të studjojmë më thellë klasikët e marksizëm-leninizmit dhe veprën e shokut Enver për këtë problem, b) të studjojmë praktikën tonë letrare e artistike dhe ta zbulojmë konkretisht karakterin kombëtar në tipat, personazhet, heronjtë, ambientet, stilin dhe gjuhën; nga këtej pastaj të nxjerrim konkluzione dhe të bëjmë përgjithësime.

Në bazë të mësimëve marksiste-leniniste karakteri kombëtar në letërsi dhe arte presupozon pasqyrimin e veçorive ekonomike, politike e kulturore të një populli, pasqyrimin e veçorive të mënyrës së jetesës, të psikologjisë, të moralit e të zakoneve; me një fjalë, e të gjithë konstitucionit shpirtëror të popullit, i cili ndryshon dhe zhvillohet dialektikisht, duke ruajtur origjinalitetin e vet. Ky material jepet nëpërmjet gjuhës e mjeteve të tjera shprehëse, nëpërmjet atij stili të veçantë kombëtar të krijuar nga folklori dhe nga gjithë letërsia dhe artet dhe që vazhdon të krijohet nga brezi në brez, duke futur përherë elementë të rinj, tradita të reja. Kjo e ka bërë artin tonë të fitojë origjinalitetin e tij dhe të dallohet si një art i një populli me tipare të tijat, të formuara e të zhvilluara në shekuj. Në kritikën tonë problemi i karakterit kombëtar shpesh trajtohet në mënyrë të përgjithshme dhe mbulohet nga një frazeologji e pakuptueshme. Ky problem ndonjëherë identifikohet me atë të frymës popullore të artit dhe bëhet një

qorbë, që është e vështirë të hahet. Në të vërtetë fryma popullore e artit ka një kuptim të gjerë. Me frymë popullore ne kuptojmë pasqyrimin në art të evenimenteve të rëndësishme të jetës së popullit, pasqyrimin e halleve dhe ëndrrave të tij me një gjuhë të bukur dhe të kuptueshme, të afërt me shijet estetike të tij. Art me frymë popullore sot ne kuptojmë atë art që ka partishmëri të lartë, që ka karakter kombëtar dhe që militon në luftën për ndërtimin e socializmit dhe komunizmit. Pra, arti me frymë popullore presupozon pasqyrimin e karakterit kombëtar, presupozon pasqyrimin e virtyeteve të larta të popullit.

*Së dyti, disa gjini të artit tonë si opera dhe baleti, duhet të thellojnë më shumë karakterin kombëtar dhe frymën popullore, duke u afruar më tepër me shijet estetike kombëtare të popullit tonë.*

Në këtë mënyrë ato do të demokratizohen më tej. Këto, megjithse kanë fituar elementë të rinj, me strukturën dhe mjetet e tyre shprehëse kanë mbetur në atë gjendje që kanë qenë kur kanë lindur si gjini. Atëherë kjo formë pengon futjen e përmbajtjes së re. Kështu, fjala vjen, në balet, për hir të mjeteve të vjetra shprehëse, nuk mund të ngrihet në skenë me duar partizania e armatosur, siç ngrihet një mjelmë në «Liqenin e mjelmave». Kjo e parodizon dhe e vulgëron baletin, duke deformuar edhe vetë përmbajtjen. Edhe për hir të një dueti në opera, nuk mund të bëjnë duet në skenë dy militantë, persona historik partie, siç mund të bëhet në operën «Traviata» apo «Bohema». Prandaj duhet parë në këto gjini, përveç të tjerave, edhe specifika e temës. Por kryesorja është se ato duhet me doemos të demokratizohen më tej dhe t'u afrohen kërkesave të kohës. Koreografit tanë është e domosdoshme të kërkojnë mjete të reja shprehëse brenda traditës sonë kombëtare dhe asaj ndër-kombëtare përparimtare, për të dhënë sa më të plotë dhe sa më të besueshme përmbajtjen e re.

*Së treti, me përpunimin e valles popullore duhet të tregohemi të kujdesshëm, të matur dhe të zgjuar si populli. Atë, duke e stilizuar, nuk duhet ta prishim, siç ka ndodhur me vallen labe të P. Kanaçit, dhe me atë të Këmishtajt të B. Zekthit, autorët e të cilave i kanë shtrembëruar dhe larguar nga origjina e tyre. Sjellja e pamenduar ndaj valles popullore të shpie ose në primitivizëm, ose në modernizëm, që janë dy ekstreme shumë të dukshme. Që të kemi valle të mira, duhet të njohim folklorin, të jetojmë me vlltarët popullorë, të marrim mendimin e tyre e të mësojmë nga ata. Ne duhet të heqim dorë edhe nga ajo mënyrë vulgare e trajtimit të valleve me temë nga pu-*

na. Në mjaft raste tema e punës në valle trajtohet si një ushtrim gjimnastikor me lëvizje akrobatike dhe të he dhura në skenë si në një fushë sportive. Këto gjëra nuk janë në natyrën e valles sonë dhe prishin shijet estetike të njerëzve tanë. Prandaj edhe në këtë fushë duhen kërkuar mjete shprehëse në përputhje me gjininë e valles dhe jo jashtë saj. Mos ta shesim gjimnastikën për art. Gjimnastika është gjimnastikë, arti është art! Në këtë mënyrë duhet të veprojmë edhe për përpunimin e këngës popullore. Në përgjithësi edhe kënga jonë dhe tërë muzika e lehtë ka nevojë ta thellojë më shumë frymën popullore dhe karakterin kombëtar. Është e domosdoshme që këngët e kompozitorëve tanë të bëhen më të thjeshta, më të këndueshme, më melodioze. E themi këtë, pasi ka mjaft këngë që mezi këndohen. Këngën ne e bëjmë që ta këndojnë të gjithë në rrugë e shtëpi, në manifestime dhe gëzime familjare. Atë nuk e bëjmë vetëm për skena festivalesh dhe koncerte. Këngën duhet ta këndojë edhe njeriu i thjeshtë edhe artisti.

Këto e shumë probleme të tjera, që kanë të bëjnë me karakterin kombëtar e frymën popullore, duhen trajtuar gjerësisht me përgatitje të shëndoshë teorike. Shoku Enver që në fjalimin e 11 Korrikut të vitit 1961 para shkrimtarëve dhe artistëve, jep një program të tërë pune, të cilit sa kalon kohë, aq më shumë i rritet aktualiteti dhe aq më shumë i shtohet përgjegjësia jo vetëm çdo artisti, po edhe çdo studjuesi, shkrimtari, intelektual i punonjësi. Shoku Enver thotë: «*Mua më duket se, në këtë fazë të zhvillimit kulturor të vendit tonë, ka ardhur koha dhe janë krijuar mundësitë që me forca të bashkuara të njerëzve tanë të shkencave, të arteve e të njerëzve të punës, të luftohet më me këmbëngulje për të studjuar karakteristikat kombëtare në drejtime të ndryshme të kulturës dhe të arteve tona dhe për zbatimin e tyre në mënyrë krijuese në veprat e sotme të artit dhe në punën kulturore artistike me masat. Dhe kjo duhet të gjej shprehje jo vetëm në veprat letrare e muzikore, në pikturë e skulpturë, por, siç thashë, në ndërtime, në punimet e drurit e të gurit, të hekurit, në industrinë tekstile, të veshmbathjes, të qeramikës, të qelqit dhe kudo ku duhet të ketë art» (vëll. 21, f. 369). Për ta vënë në jetë këtë mendim, duhet një punë në një front të gjerë, e studjuar me kujdes dhe me seriozitet të madh. Në këtë fushë kanë lindur shumë probleme, që kërkojnë zgjidhje, prandaj është e domosdoshme të rrihen gjerësisht mendimet dhe të arrihet në konkluzione të drejta shkencore. Rrahja e mendimeve është e domosdoshme jo vetëm për*

muzikën e koreografinë, po edhe për arkitekturën. Ne vërtet kemi realizime të shquara në arkitekturë, por në këtë fushë ende nuk merret sa duhet parasysh tradita jonë dhe pak studjohen karakteristikat kombëtare të mjeshhtërve tanë popullorë.

Një problem tjetër i rëndësishëm, që lidhet me partishmërinë dhe karakterin kombëtar, është edhe ai i ekzekutimit të krijimtarisë artistike. Orientimi i Partisë në arte është unik në të dy frontet: në krijimtari dhe në ekzekutim. Të dy këta fronte duhet të karakterizohen nga partishmëria proletare dhe nga fizionomia kombëtare e popullorë. Krijimtaria dhe ekzekutimi nuk mund të kuptohen të ndara nga njera-tjetra. Ato zhvillohen në marrëdhënie të ngushta midis tyre në fushën e muzikës, dramaturgjisë dhe kinematografisë, ku veprojnë forcat ekzekutuese. Muzika, dramaturgjia dhe kinematografia nuk mund të zhvillohen pa një lidhje të ngushtë me ekzekutimin. Prandaj duhet t'u kushtojmë një vëmendje të veçantë forcave ekzekutuese, si në përgatitjen profesionale, ashtu edhe në edukimin ideoestetik të tyre. Në këtë fushë më pak të rrahur është e domosdoshme të bëhen diskutime të veçanta, të trajtohen probleme të fizionomisë kombëtare e frymës popullore, në mënyrë që ekzekutimi i veprave dhe loja e aktorëve të zbulojë drejt vlerat e artit tonë. Ne kemi artistë të skenës dhe ekranit me forcë të madhe interpretuese si V. Manushi, S. Prosi, N. Luca, P. Gjoka, R. Ljarja, G. Çako, Z. Haxho, M. Erebara, B. Zekthi, Gj. Shestani, V. Zela, I. Madhi, N. Xhoja, S. Sollaku, T. Banushi, P. Raidhi e plot të tjerë, të cilët, duke u mbështetur në traditën tonë të mrekullueshme të ekzekutimit të lëvruar nga T. Tashko, M. Kraja, N. Frashëri, L. Kovaçi, J. Truja, K. Antoniu e B. Ndoja me shokë, po e pasurojnë me cilësi të reja trashëgiminë tonë artistike.

## ARTIN REVOLUCIONAR E BËJNË ARTISTËT REVOLUCIONARË

1.

Ritmet e zhvillimit të shoqërisë sonë me tërë veprimtarinë njerëzore, me punën dhe luftën për ndërtimin e socializmit, me shqetësimet dhe gëzimet, me ndryshimet dhe transformimet në jetë, me kontradiktat dhe ndeshjet e së resë me të vjetrën, me presionet e ideologjive të huaja mbi

vendin tonë në kushtet e rrethimit të egër imperialisto-revizionist, nuk mund të pasqyrohen plotësisht dhe realisht pa një formim të gjithanshëm ideologjik marksist-leninist të shkrimtarëve dhe artistëve tanë, pa një njohje dhe një përvetësim të thellë të teorisë dhe të praktikës revolucionare, të zhvilluar nga Partia jonë përmes betejave të mëdha klasore. Njohja krijuese e marksizëm-leninizmit është e lidhur ngushtë me gjithë veprimtarinë e artistit si pasqyruar i realitetit socialist dhe si luftëtar i zbatimit të vijës së Partisë. Pa këtë përvetësim nuk mund të orientohesh në fenomenet e komplikuar të jetës, nuk mund të zbulosh me tendencë prirjet themelore të zhvillimit të shoqërisë sonë. Në raportin e shokut Enver në Kongresin e 7-të të Partisë thuhet: *«Marksizëm-leninizmi nuk mësohet për erudicion. Ai mësohet për t'u zbatuar në jetë, që nga parimet e tij të udhëhiqemi në çdo veprim, që çdo gjë ta gjykojmë në frymën e tij. Një studim i tillë i teorisë, i lidhur ngushtë me jetën, me praktikën revolucionare i shërben formimit të vërtetë komunist, krijimit jo vetëm të një botëkuptimi shkencor, por edhe të një karakteri revolucionar, që njerëzit tanë të qëndrojnë kurdoherë luftëtarë të vendosur për çështjen e socializmit, të papajtueshëm me armiqtë e ideologjisë së tyre».*

Përvetësimi i mësimave marksiste-leniniste të Partisë sonë formon atë botëkuptim materialist revolucionar të shkrimtarit dhe artistit, nga i cili përcaktohet edhe partishmëria proletare, që është pozicioni ideoestetik i krijuesit dhe shprehja e interesave dhe synimeve të klasës punëtore në veprimtarinë artistike. Në luftojmë që partishmëria të bëhet kërkesë e brendshme shpirtërore, kërkesë e ndërgjegjshme e çdo artisti, pa të cilën nuk mund të ndjejë, nuk mund të mendojë, nuk mund të krijojë. Duke u bërë partishmëria një nevojë jetike në shpirtin e artistit, do të krijohen, siç janë krijuar, vepra artistike të frymëzuara, jetësore, militante dhe të shtrenjta për popullin. Atëherë partishmëria nuk është vetëm një kuptim politik, po në të njëjtën kohë është edhe një bindje e fortë estetike, një parim i lartë krijimtarie. Në këtë kuptim, artisti në krijimtarinë e tij ka një pozicion dhe një tendencë të caktuar klasore, jashtë së cilës nuk i bën zemra të krijojë, se s'mund të krijojë dot ndryshe. Këtu gjen përputhjen e plotë ideale shoqëror me idealin estetik të artit. Por përputhja e idealit estetik me idealin shoqëror kërkon edhe rritjen e nivelit artistik, që është në papajtueshmëri me paraqitjen pllakateske dhe vulgare të realitetit. Niveli i ulët artistik, forma e zbehtë dhe mjetet e varfëra artistike e

cënojnë parimin e partishmërisë. Ato vinë në ndesh me idealin estetik të artit të realizmit socialist.

Partishmëria proletare është në luftë të hapur dhe pa kompromis kundër çdo gjëje që cënon sado pak atë. Ajo presupozon luftën e pandërprerë të artistit kundër çdo depërtimi të partishmërisë borgjeze e revizioniste në formën e shfaqjeve të huaja antisocialiste.

Të gjitha tendencat, rrymat dhe metodat moderniste e reaksionare, të kamufluara në artin mbiklasor, apo të shfaqura hapur, përbëjnë partishmërinë borgjeze e revizioniste, e cila me dinakëri e hipokrizi, po edhe me agresion mundohet t'i kundërvihet partishmërisë proletare, pasi vetëm duke thyer këtë parim të lartë të realizmit socialist, mund të cënojë tendencën klasore proletare në pasqyrimin e jetës përmes krijimtarisë letrare e artistike. Shfaqjet e huaja, që u kritikuan ashpër në Plenumin IV të KQ të Partisë, në radhë të parë, goditën partishmërinë, goditën tendencën klasore, për ta zëvendësuar atë me një partishmëri borgjeze e revizioniste, me një tendencë reaksionare. Duke u nisur nga përvoja e viteve të fundit, kuptohet qartë se synimet e largëta të armiqtë tanë ideologjikë janë qëllime politike kundërrevolucionare. Për realizimin e këtyre qëllimeve ata duan ta përdorin artin si mjet dhe si armë kundërrevolucionare. Lufta në fushën e kulturës e të arteve është zhvilluar dhe zhvillohet, në radhë të parë, për çështjen se ç'ide dhe ç'ideale duhet të mbrojnë, kujt duhet t'u shërbejnë. Shoku Enver në Kongresin e 7-të të Partisë ka thënë: *«Grupi tradhëtar i Fadil Paçramit e Todi Lubonjës me shokë u orvat të përhapë ideologjinë, kulturën dhe mënyrën e jetesës borgjezo-revizioniste për të krijuar truallin e përshtatshëm të kundërrevolucionit politik».* Prandaj gjithë armiqtë e marksizëm-leninizmit, për ta kthyer artin në armë për synimet e tyre politike, në radhë të parë, janë përpjekur të ndërrojnë tendencën e tij, partishmërinë e tij proletare, që është shtylla verëbrore e krijimtarisë.

Shenjat e para të lindjes së revizionizmit sovjetik në letërsi dhe arte u dhanë pikërisht me goditjet në partishmërinë komuniste, duke e quajtur atë «kornizë», që gjoja mbyll rrugët e kërkimeve të reja dhe frenon lulëzimin e individualitetit artistik.

Pastaj me uzurpimin e Partisë dhe marrjen e fuqisë, revizionistët sovjetikë dhe të vendeve satelite e shkelën përtokë parimin e partishmërisë proletare, duke e zëvendësuar me partishmërinë borgjeze. Me shkeljen e këtij parimi, iu hapën përfundimisht dyert të gjitha izmave dhe

praktikave letrare e artistike moderniste, që nga ekzisten-  
cializmi e gjer te pop-arti apo arti absurd. Po krahas këty-  
re izmave perëndimore, në Bashkimin revizionist Sovjetik  
lulëzon edhe arti specifik i superfuqisë, arti militarist  
i kamufluar me fraza demagogjike partishmërie, i cili hym-  
nizon çizmen dhe bajonetën ushtarake shoviniste të eks-  
pansionit, pushtimit dhe shfrytëzimit. Ky është arti zyrtar,  
që trumpetohet në kongrese partie dhe në kongrese e ple-  
nume shkrimtarësh dhe artistësh në botën e socialimpe-  
rializmit. Ai është agresiv, si vetë përmbajtja shoviniste  
e tij. Rrymat dekadente moderniste borgjeze me metodën  
zyrtare revizioniste të artit reaksionar sovjetik, janë në një  
aleancë të ngushtë dhe formojnë bashkërisht një lëmsh  
gjarpërinjsh plot helm të rrezikshëm jo vetëm për krijim-  
tarinë tonë, por për gjithë artin përparimtar botërorë. Nga  
ky lëmsh mund të derdhen gjarpërinj dhe të futen fshe-  
hurazi dhe haptazi në artin tonë, në qoftë se dobësojnë vi-  
gjilencën revolucionare. Këto nepërka i turren në fillim  
partishmërisë proletare, pasi asaj ia kanë frikën më shu-  
më. Prandaj siç na mëson shoku Enver në Kongresin e  
7-të të Partisë, «*Frontit të bashkuar të armiqve duhet t'i  
bëjmë ballë duke forcuar frontin tonë të brendshëm në të  
gjitha drejtimet, në fushën e mbrojtjes dhe të ekonomisë,  
të politikës e të ideologjisë, duke zhvilluar me konsekuen-  
cë kurdoherë luftën e klasave*». Ne krijuesit jemi luftëtarë  
në këtë «front të brendshëm» për zbatimin e vijës së Par-  
tisë në letërsi dhe arte, për edukimin komunist të njerëz-  
ve. Për edukimin komunist të njerëzve tanë letërsia dhe  
arti e realizojnë me vepra me përmbajtje të shëndoshë dhe  
nivel të lartë artistik. Ruajtja e pastërtisë së përmbajtjes  
dhe ngritja e nivelit artistik të arteve tona, në kushtet e  
ashpërsimit të luftës së klasave, është detyrë e përhershme  
e çdo krijuesi dhe e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve.  
Lufta kundër ndikimeve të huaja duhet të jetë konsekuente  
dhe e vazhdueshme. Edhe këtu është e domosdoshme të  
mos i harrojmë kurrë mësimet e Kongresit të 7-të të Par-  
tisë që porositi: «*Njerëzit tanë duhet të jetojnë përditë  
me situatat politike të jashtme e të brendshme të vendit,  
t'i shohin kurdoherë detyrat e tyre të lidhura ngushtë me  
këto situata, të jetojnë me frymë të lartë vetmohimi e  
sakrificë, të jenë gjithnjë të gatshëm, vigjilentë e luftëta-  
rë të vendosur kundër të gjitha përpjekjeve e presioneve  
të armiqve. Kundër rrethimit imperialisto-revizionist nuk  
luftohet vetëm një herë ose me fushata, por përditë e vazh-  
dimisht*». Në këtë kënd duhet ta vështrojë artisti apo  
shkrimtari i tipit të ri revolucionar detyrën e tij si kri-

jues dhe si qytetar. Pa këtë jetë intensive politike dhe  
ideologjike të çdo artisti, nuk mund të forcohet partishmë-  
ria proletare, nuk mund të zhvillohet lufta e klasave dhe  
nuk mund të shpartallohen plotësisht ndikimet e huaja.

## 2.

Me gjithë arritjet në zbatimin e partishmërisë pro-  
letare, vihen re ende në vepra të veçanta, të publikuara apo  
të papublikuara, çënime të këtij parimi, ndonjë rast i  
nxirjes së jetës, si pasojë e kuptimit të shtrembër apo të  
cekët të kontradiktave. Ka patur edhe vepra, ku mbizoto-  
ron një moral i huaj mikroborgjez, shfaqje të formalizmit  
që dëmtojnë edhe përmbajtjen. Në ndonjë teatër janë pa-  
raqitur edhe drama apo komedi me prirje për nxirjen e  
realitetit socialist, janë dhënë nëpër redaksitë e botimeve  
edhe tregime apo romane me të meta ideore të karakterit  
liberal, po edhe konservator. Këto shfaqje, ndonëse të ra-  
lla, kanë dukuri të ndryshme dhe nuk vijnë njëlloj si tre-  
-katër vjet të shkuar. Më të përsëritshmet janë ato që  
shfaqen në veprat që trajtojnë temën e luftës kundër buro-  
kratizmit. Në këtë fushë ka tregime, pjesë teatrale apo  
vjersha që e ekzagjerojnë rrezikun real të burokratizmit,  
duke e paraqitur atë si diçka fatale e të përgjithësuar për  
tërë administratën socialiste. Kjo vjen nga konceptet e  
gabuar, nga njohja e pamjaftueshme e marksizëm-lenin-  
izmit dhe nga presioni i ideologjive të huaja reaksionare,  
sidomos të botës revizioniste. Por tek-tuk shfaqet edhe  
një lloj tjetër ndikimesh, sidomos në poezi, muzikë dhe ko-  
reografi, siç është çorganizimi i ritmit, muzikalitetit dhe  
melodisë, deformimi i lëvizjeve të ndikuara nga konceptet  
e huaja për vallen, gjë që vështirëson kuptimin e për-  
mbajtjes ose fut shije estetike që s'janë tonat. Në vjersha  
ka ndonjëherë fragmentarizëm dhe ndonjë shenjë të figu-  
racionit të pakuptueshëm. Në muzikë ka edhe këngë të pa-  
këndueshme, të larguara nga tradita jonë. Dhe lloji i fun-  
dit janë ato të humorit për humor nëpër estrada, me shtrën-  
gime e shtrembërime fytyre, me zënka të kota banale. Kë-  
to në thelb vijnë nga mbeturinat e vjetra dhe të reja të  
artit borgjez, të artit bosh e papërmbajtje. Shfaqje të ti-  
lla, sado të rralla të jenë, ndikojnë keq në edukimin estetik  
dhe dëmtojnë partishmërinë. Për këtë, institucionet ku  
paraqiten këto krijime, si Shtëpia Botuese «Naim Frashëri»,  
shtypi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Estrada,  
Teatri Popullor, Teatri i Operas dhe i Baletit, Shtëpia Qen-

drore e Krijimtarisë Popullore, Radio-Televizioni, Kino-studjoja duhet të intensifikojnë luftën dhe të mpreshin vigjilencën. Nga ana tjetër edhe qendrat e punës, ku bëjnë pjesë krijuesit me koncepte të gabuara, edukimin e tyre ta marrin si një çështje me rëndësi partie.

Ruajtja dhe forcimi i partishmërisë proletare në letërsi dhe arte varet nga formimi i botëkuptimit marksist-leninist të shkrimtarëve dhe artistëve, i cili fitohet me studimin e teorisë dhe me pjesëmarrjen aktive në luftën që bën gjithë shoqëria për transformimin socialist të vendit. «Marksizëm-leninizmi, — thotë shoku Enver në raportin e Kongresit të 7-të, — nuk mësohet vetëm nga librat dhe as vetëm në shkollë. Ai mësohet e përvetësohet duke marrë pjesë aktive në luftën e përditshme për ndërtimin e socializmit, duke zhvilluar pandërprerje luftën klasore, duke luftuar me vendosmëri kundër rrethimit imperialisto-revizionist». Ky përvetësim aktiv i marksizëm-leninizmit i jep përmbajtjes së krijimtarisë cilësi të reja e të freskëta, e bën atë më luftarakë, me demokrate dhe më popullore.

Sot, të jesh i partishëm në letërsi dhe arte do të thotë: 1) Të kuptosh thellë vijën dhe programin e Partisë dhe ta zbatosh në të gjitha fushat e jetës, se vetëm atëherë do të dish të orientohesh drejt në gjithë veprimtarinë revolucionare shoqërore; 2) të kuptosh thellë rrethimin imperialisto-revizionist dhe të luftosh për shpartallimin e tij; 3) të kuptosh thellë luftën e klasave, e cila zhvillohet kurdoherë e ashpër qoftë në plan kombëtar, qoftë në plan ndërkombëtar për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit kundër imperializmit e revizionizmit; 4) të kuptosh thellë parimin «me forcat e veta», i cili është një parim i madh marksist-leninist që zbaton Partia jonë për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste; 5) të kuptosh thellë optimizmin e popullit, që i ka rrënjët në besimin e udhëheqjes së Partisë drejt jetës më të mirë dhe në vetë traditën patriotike e revolucionare të tij, në vetë shpirtin luftarak të tij.

Në qoftë se këto ide përvetësohen në mënyrë të ndërgjegjshme, kthehen në një forcë të madhe materiale dhe partishmëria proletare lidhet ngushtë me objektivitetin shkencor, me pasqyrimin e gjerë e të thellë realist të jetës, me trajtimin e temave të rëndësishme të kohës, me pasqyrimin e rolit revolucionarizues të komunistëve e të njerëzve të pararojës.

Pasqyrimi me vërtetësi i komunistit merr një rëndësi të veçantë për forcimin e partishmërisë proletare, pasi me trajtimin e kësaj figure, gjen edhe zbatimin e plotë konkret ky parim i madh i realizmit socialist. Në Shqipëri nuk

mund të kuptohet shekulli i 20-të pa veprimtarinë e komunistëve. Edhe arti nuk mund të kuptohet pa figurën e tij. Pasqyrimi i kësaj figure merr një domethënie të madhe politike, jo vetëm estetike. Prandaj heroi komunist duhet të zerë një vend më të plotë në letërsinë dhe artet tona. Në pasqyrimin e tij duhet t'u largohemi si skemave romantike e moralizuese, ashtu edhe sheqerosjes së liberalizuar dhe të intelektualizuar të kësaj figure. Një shembull i mirë është romani «Përballimi» i T. Laços, në të cilin në mënyrë bindëse jepet shpirti i sakrificës dhe veprimtaria revolucionare e komunistëve, veçanërisht e sekretarit të Partisë Martin Kreka, i cili është një nga heronjtë pozitivë më të realizuar të prozës sonë. Kjo figurë u është larguar atyre skemave që, për fat të keq, përsëriten në prozën tonë të gjatë. Në trajtimin e kësaj figure, d.m.th. të komunistit dhe patriotit revolucionar, arritje të ndjeshme ka patur filmi ynë. Heronj si mësuesi i shqipes të strehës vorfnore në filmin «Lulekuqet mbi mur», apo sekretari i Partisë, Besimi, në filmin «Ilegalët», dalin me një botë të pasur të brendshme, zgjojnë emocione të forta të spektatori dhe mishërojnë idealin komunist. Por që të pasqyrosh drejt dhe me thellësi rolin revolucionarizues të komunistëve dhe me këtë të forcosh më tej partishmërinë, është e domosdoshme të njohësh në mënyrë të gjithanshme vijën e Partisë. Vetëm kur e njeh thellë, kur e bën tënden dhe udhëhiqesh prej saj në jetën dhe në veprimtarinë shoqërore, mund ta brumosësh veprën në gjithë qelizat e saj me ideologjinë marksiste-leniniste. Artisti, për të pasqyruar komunistin në figurën artistike, duhet t'i përvetësojë në mënyrë krijuese të gjitha idetë e Kongresit të 7-të. Në raportin e shokut Enver, në kapitullin e 3-të «Të forcojmë vazhdimisht partinë, të rrisim më tej rolin udhëheqës së saj», u bëhet një analizë e thellë detyrave të Partisë dhe të komunistëve në etapën e sotme të zhvillimit të revolucionit. Shoku Enver thekson: «Udhëheqja e Partisë është një dhe e pandarë. Ajo realizohet vetëm kur zbatohet me sukses ideologjia dhe politika marksiste-leniniste, vendimet e direktivat e saj në të gjitha fushat e në të gjitha drejtimet, në pushtet e në ekonomi, në kulturë e në ushtri, kur gjithë institucionet shtetërore, organizatat shoqërore, tërë kuadrot e punonjësit udhëhiqen në të gjithë veprimtarinë e tyre nga kjo ideologji e politike, nga këto direktiva e vendime». Me këtë gjerësi e thellësi mendimi duhet ta konceptojmë dhe ta pasqyrojmë komunistin në veprat tona letrare e artistike, ndryshe do ta zbehim rolin e tij revolucionarizues. Artisti,

duke jetuar vazhdimisht me këto probleme të partisë, do t'u përgjigjet edhe kërkesave shpirtërore të popullit, pasi vepra e tij do të jetë e mbrujtur me idealet e luftës për ndërtimin e shoqërisë së re. Vetëm atëherë, siç thotë shoku Enver, «Artin revolucionar e bëjnë artistët revolucionarë, zemra e të cilëve rreh me zemrën e popullit».

Artistët tanë, të karakterizuar nga partishmëria komuniste dhe nga ndjenjat e larta qytetare, kanë zhvilluar një veprimtari intensive krijuese, sidomos në ato fusha, ku ka patur nevojë më të madhe shoqëria, siç është p.sh. kinematografia. Ata e zhvilluan më tej këtë lloj të artit, duke dhënë filma me përmbajtje të shëndoshë dhe nivel të lartë artistik. Me krijimtarinë e tyre treguan edhe partishmërinë e lartë proletare, duke e parë problemin politikisht dhe ideologjikisht. Edhe vetë kushtet e krijuara, si pasojë e bllokadës imperialisto-revizioniste, kur ishte vështirë shfaqja e filmave të huaj, bënë që kinematografia të zhvillohet më shpejt në vendin tonë. Kjo vërteton mendimin se forcimi i tendencës klasore në krijimtari dhe i partishmërisë, e çon përpara artin dhe rrit pasinë e cilësinë e tij. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për arritjen e hopit cilësor në romanin tonë. Nga 2-3 romane në vit para 10 vjetëve, tani botohen 20-25. Këtë mendim mund ta shtrijmë edhe në artet figurative, të cilat brenda një kohe shumë të shkurtër dhanë vepra të denja për dy ekspozita kombëtare, të 30-vjetorit të Çlirimit të Atdheut më 1974 dhe të 35-vjetorit të themelimit të Partisë më 1976. I njëjti fenomen ka ndodhur edhe në muzikë, e cila e thelloi frymën e saj popullore, e forcoi përmbajtjen dhe formën. Ky është fenomen që buron jo vetëm nga arritja e forcave krijuese, po edhe nga forcimi i tendencës klasore të letërsisë dhe të artit tonë, nga zbatimi me konsekuencë i parimit marksist-leninist i mbështetjes në forcat e veta.

Kjo do të thotë ta lidhësh artin me detyrat e mëdha të revolucionit tonë socialist dhe ta vësh atë plotësisht në shërbim të tij. «Kulturës e arsimit, letërsisë dhe arteve, — thotë shoku Enver në Kongresin e 7-të të Partisë, — udhëheqja e shëndoshë e Partisë u ka dhënë një zhvillim, një drejtim dhe një përmbajtje më të thellë klasore revolucionare, një forcë më të madhe edukuese e mobilizuese, i ka lidhur më tepër me popullin, me klasën punëtore dhe me fshatarësinë kooperativiste, më detyrat e mëdha të revolucionit tonë socialist». Në këtë mënyrë duhet ta kuptojmë forcën materializuese të tendencës klasore dhe të partishmërisë komuniste në letërsi dhe arte. Duke u nisur nga rezultatet e krijimtarisë, kritika jonë letrare e artistike duhet të

nxjerrë konkluzione më përgjithësuese e më shkencore. Është e vërtetë se kritika letrare e artistike e ka ndjekur procesin e krijimtarisë sonë dhe ka bërë mjaft analiza me vlerë, sidomos për problemet e tendencës klasore në letërsi dhe arte, të karakterit kombëtar e frymës popullore, të raportit të novatorizmit me traditën etj., të cilët kanë ndihmuar në përparimin e mendimit tonë estetik. Mjaft kritikë e estetë si A. Uçi, D. Shaplo, R. Brahimi, K. Bihiku, A. Kallulli, J. Bullo, i kanë trajtuar gjerë fenomenet letrare e artistike dhe kanë sqaruar shumë çështje të përmbajtjes dhe formës së artit. Por me gjithë arritjet e dukshme të kritikës sonë, ajo duhet të bëjë më shumë përgjithësime shkencore dhe të mos niset nga një trajtim frazist i problemeve, duke përsëritur parime të përgjithshme të njohura. Është e nevojshme që kritika të ndjekë më shumë krijimtarinë tonë konkrete dhe prej saj të nxjerrë përgjithësime. Detyra e saj është të zbulojë, në radhë të parë, vlerat pozitive të veprave, lidhjet e artit me jetën, por kjo nuk do të thotë që të bëhen vlerësime të niveluara dhe të mbeten jashtë vëmendjes apo të hezitohet për dobësitë e krijimeve të veçanta. Të aktivizohen më shumë e më me cilësi forcat ekzistuese në kritikë e të zgjerohen radhët me të rinj. Kritika tek ne duhet të shprehë më mirë opinionin shoqëror e artistik, zërin e masave të lexuesve e spektatorëve dhe, natyrisht, mendimin kritik të vetë krijuesve.

Parimin e partishmërisë kritike, në disa raste, e trajton në mënyrë monotone, pa e konkretizuar me proceset artistike të kohës. Doemos, parimi themelor dhe kriteret e përgjithshme janë ata që kanë hedhur klasikët e marksizëm-leninizmit, por duhen parë gjërat në zhvillimin e tyre dialektik, në kushtet e sotme të luftës që bën Partia jonë për ndërtimin e socializmit në situatën e rrethimit të egër borgjezo-revizionist. Në të njëjtin zhvillim dialektik duhet parë edhe problemi i karakterit kombëtar dhe frymës popullore në letërsi dhe arte, duke zbuluar edhe raportin e tij me partishmërinë proletare. Shoku Enver në raportin e Kongresit të 7-të të Partisë na mëson: «Përmbajtja socialiste e artit lidhet ngushtë me karakterin kombëtar popullor. Në kushtet e sotme, kur imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë, të nisur nga qëllimet e tyre për sundimin e botës, për skllavërimin shpirtëror e politik të popujve, përhapin idetë e kozmopolitizmit, të të ashtuquajturit ndërkombëtarizim të artit dhe të kulturës, një rëndësi shumë të madhe merr lufta për të mbrojtur kulturën kombëtare të popujve. Duke mbrojtur e zhvilluar

*kulturën e vet kombëtare, demokratike e revolucionare, popujt mbrojnë pavarësinë, qënien dhe traditat e veta dhe kështu japin kontributin e tyre në thesarin e kulturës botërore».*

Kështuqë, forcimi dhe mbrojtja e karakterit kombëtar në kushtet e sotme, merr një rëndësi të madhe politike dhe ideologjike. Karakteri kombëtar e popullor duhet forcuar e mbrojtur me tendencë, me partishmëri. Prandaj vetë partishmëria proletare shpie në zhvillimin e frymës popullore e të fizionomisë kombëtare, pasi sa më revolucionare të jenë idetë që përshkojnë kulturën dhe artet, aq më mirë do të pasqyrohen jeta dhe aspiratat e popullit, aq më me siguri do të shprehet origjinaliteti kombëtar, aq më me sukses do të bëhet lufta ideologjike kundër kozmopolitizmit modernist. Për të konkretizuar këtë ide le t'i drejtohem i përvojës letrare e artistike të kohëve të fundit.

Lufta për forcimin e partishmërisë shpuri vetvetiu edhe në forcimin e karakterit kombëtar e popullor të artit. Nuk mund të jesh i partishëm jashtë sferës së karakterit kombëtar. Në fushën e muzikës, bie fjala, partishmëria u realizua në unitet me karakterin kombëtar dhe frymën popullore. Para Plenumit të 4-të të KQ të Partisë, Festivali i 11-të famëkeq në Radio-Televizion kishte devijime të rënda në partishmëri, në tendencë, prandaj nuk kishte as karakter kombëtar, as frymë popullore. Festivali e 12, 13-të, 14-të dhe 15-të në Radio-Televizion, duke forcuar partishmërinë, forcuan edhe karakterin e tyre kombëtar e popullor. Doemos, këto probleme nuk janë të lehta për t'u trajtuar, se ende ka paqartësi teorike. Për këtë arsye duhet të thellohet studimi i tyre, të zhvillohen debate, të organizohen konsulta e sesione shkencore për lloje e gjini të veçanta të artit e letërsisë.

Ndonëse Plenumi IV i KQ të Partisë udhëzoi që të merren masa për zgjerimin e punës kërkimore shkencore në lëmin e teorisë dhe historisë së letërsisë, arteve dhe estetikës, kjo detyrë nuk është plotësuar dhe ka një prapambetje të ndijshme të këtyre studimeve. Mungesa e studimeve të mjaftueshme shkencore artistike e favorizon përhapjen e ndikimeve të huaja dhe të pështjellimeve ideologjike. Mjafton të përmendim se tekstat e historisë së arteve dhe letërsisë nuk po përgatiten në kohë dhe nuk i kanë në dorë shkrimtarët e artistët dhe brezi i ri. Studimet shkencore artistike e estetike kanë rëndësi të madhe për edukimin ideo-profesional të masës së artistëve dhe shkrimtarëve për t'u thelluar në zbërthimin dhe konkretizimin e mësimave të marksizëm-leninizmit, e veprave

të shokut Enver dhe të materialeve të Partisë sonë, për t'u dhënë përgjigje shkencore shumë problemeve të rëndësishme që lindin gjatë zhvillimit të praktikës artistike të vendit tonë, për të mbajtur një qëndrim konsekuent e krijues marksist-leninist për gjithë problemet e ndërlikuarra dhe të vështira të zhvillimit të kulturës artistike në kushtet aktuale dhe të luftës klasore ideologjike që bëhet brenda saj. Krahas vendosjes së rregullit në përdorimin e literaturës së huaj, që hyn nga vendet e tjera, është e domosdoshme që të ushqehen shkrimtarët dhe artistët me materialet tona, që mbrojnë vijën e Partisë sonë, të mendimit të saj teorik dhe që duhet të kenë një nivel të lartë shkencor. Mendojmë se forcat që merren me studime janë mjaft të shpërndara dhe s'ka ndojë institucion që t'i organizojë dhe t'i drejtojë mbi një punë të planifikuar, me një tematikë dhe problematikë të caktuar. Prandaj e quajmë të dobishme që të shikohet krijimi i një qendre për koordinimin e studimeve ose pranë Akademisë, ose gjetkë.

### 3.

Zhvillimi i mëtejshëm i letërsisë dhe arteve, duke ndjekur ritmet e përparimit të shoqërisë sonë, do të nxjerrë edhe një varg problemesh të vështira teorike dhe praktike. Prandaj në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe në të gjitha degët e saj në rrethe duhet të organizohen më mirë dhe më shpesh diskutime krijuese dhe rrahje mendimesh për problemet e mprehta të krijimtarisë. Ajo bashkë me degët e saj duhet të bëhet, si të themi, një laborator i mendimit estetik për gjithë krijuesit, se kështu do të gjallërohet më tej jeta intelektuale artistike në dobi të krijimtarisë. Shoku Enver edhe në fjalën e 20 Dhjetorit të 1974-ës, edhe në raportin e Kongresit të 7-të të Partisë, na këshillon që ta kthejmë Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve në një vatër, ku të trajtohen gjerë problemet e arteve tona. Këtu duhet të marrin pjesë me mendimet e tyre gjithë krijuesit, studjuesit dhe kritikët tanë më të mirë. Një veprimtari e tillë krijon një gjendje të shëndoshë shoqërore dhe pasuron botën shpirtërore dhe jetën intelektuale të krijuesve tanë. «Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve, — thotë shoku Enver, — nën udhëheqjen e Partisë të forcojë punën për edukimin ideoestetik e profesional të krijuesve, duke u bërë akoma më tepër një qendër ku të inkurajohet krijimtaria dhe rrihen gjerësisht problemet filozofike, etike e estetike të saj nga pozita e partishmërisë proletare».

Në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve është bërë një punë e madhe për gjallërimin e jetës së saj krijuese. Veçanërisht pas Plenumit IV të KQ të Partisë dhe pas fjalës së shokut Enver në 20 Dhjetor të 1974-ës, krahas krijimtarisë artistike, janë trajtuar shumë probleme të rëndësishme teorike e praktike në diskutime të gjera, në seminare, në sesione shkencore, në takime, në konsulta dhe plenumë. Mjaft probleme aktuale të procesit krijues janë trajtuar në kryesinë e Lidhjes, në degët në rrethe dhe në komisionet e saj të sektorëve të letërsisë, arteve figurative dhe muzikës. Nga ana tjetër, shtypi letrar, «Drita» dhe «Nëntori», kanë ndjekur hap pas hapi zhvillimin e letërsisë dhe të arteve, duke rrahur në faqet e tyre shumë çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin e mëtejshëm të gjinive dhe llojeve të artit. Ato kanë luftuar për pastërtinë e përmbajtjes kundër ndikimeve të huaja, kanë përkrahur prirjet dhe fenomenet e reja në krijimtari dhe kanë analizuar konkretisht veprat e shkrimtarëve dhe artistëve. Megjithatë, edhe Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe shtypi i saj, bashkë me degët në rrethe, është e domosdoshme të thellojnë më shumë veprimtarinë në rrahjen e problemeve që kërkojnë një mendim më të qartë dhe më shkencor, siç janë ato të karakterit kombëtar, të frymës popullore, të traditës dhe novatorizmit dhe të tjera që lidhen me mjeshtërinë artistike dhe me raportin e formës dhe përmbajtjes. Janë të gjitha mundësitë të bëhen përgjithësime më të mëdha shkencore, me baza të shëndosha teorike, me origjinalitet e mendim të ri, jashtë shablloneve dhe jashtë rutinës së ngurtë. Ne ende pak përgjithësime i bëjmë përvojës sonë letrare e artistike, ecurisë së gjinive dhe llojeve të artit, raporteve dhe marrëdhënieve të tyre, fenomeneve të reja pozitive dhe vështirësive në rrugën krijuese. Edhe krijuesit, edhe lexuesit apo spektatorët kanë nevojë për analiza më të thella, fjala vjen, për rrugët e zhvillimit të romanit tonë, për gjendjen dhe perspektivën e poezisë, për shfrytëzimin e folklorit në muzikën e kultivuar, për raportin e krijimtarisë popullore me poezinë dhe muzikën, për tiparet e traditës shqiptare në artet figurative dhe në arkitekturë e plot të tjera. Ne kemi shumë probleme teorike e praktike për të zgjidhur, sidomos në lëmin e arkitekturës. Akoma kërkojnë një sqarim më të plotë çështjet e raportit të arkitekturës së re me traditën kombëtare të ndërtimeve të mjeshtrave tanë popullore. Ende nuk janë të qarta mendimet se ç'lidhje ka arkitektura me kulturën tonë kombëtare, me mënyrën e jetesës së popullit tonë, me etnografinë, çfarë duhet të marrim nga tradita dhe në ç'mënyrë ta

shfrytëzojmë. Arkitektura jonë ka ecur përpara; ajo ka fituar një përvojë të madhe krijuese. Edhe për këtë traditë të re duhet të bëhen studime, siç duhet të bëhen edhe për folklorin tonë të pasur. Me gjithë punën e madhe që është bërë në mbledhjen dhe botimin e folklorit, ende duhen studime përgjithësuese shkencore dhe rrahje mendimesh për raportin e krijimtarisë popullore me artin e kultivuar etj. Këto studime nuk është e thënë që t'i bëjnë vetëm studjuesit dhe shkencëtarët, po edhe vetë krijuesit që kanë një përvojë të pasur në veprimtarinë e tyre letrare e artistike. Faktet dhe mendimet e tyre të qëmtuara gjatë punës krijuese, po të përgjithësohen, shërbejnë për pasurimin e studimeve në fushën e folklorit tonë. Por për një mbarëvajtje më të mirë të punës, duhet një bashkëpunim më i ngushtë me Akademinë e Shkencave dhe institutet e saj dhe me gjithë institucionet kulturore, sidomos të Tiranës. Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve ka bashkëpunuar e bashkëpunon me të gjitha këto institucione, por lidhjet më të mira dhe më të frutshme kohët e fundit, i ka patur me Shtëpinë Botuese «Naim Frashëri», me të cilën shpesh ka diskutuar dhe ka rrahur mendime në dobi të zhvillimit të letërsisë sonë. Megjithatë, analizat dhe studimet që bën Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve nuk duhet t'i mbajë brenda për brenda saj, por t'i diskutojë gjerësisht edhe me institucionet e tjera kulturore e artistike.

Fusha e diskutimeve dhe e rrahjes së mendimeve është e gjerë në veprimtarinë tonë artistike, por duhet të thyejmë disa shabllone dhe një rutinë të ngurtë, që nuk i përshtatet frymës së kohës. Fenomenet krijuese duhet lidhur dialektikisht njera me tjetrën. Ne flasim për sukseset e kinematografisë dhe nuk e zgjerojmë mendimin në raportin e saj me letërsinë, muzikën, artet figurative dhe teatrin. Arritjet e saj e kanë burimin edhe në zhvillimin e letërsisë, veçanërisht prozës dhe fushave të tjera të krijimtarisë, pasi arti kinematografik është sintezë e të gjithë arteve. Në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve duhet formuar një atmosferë e tillë krijuese, ku njeriu të pasurohet shpirtërisht dhe të edukohet me parimet e estetikës sonë marksiste-leniniste. Në klubin e saj mund të ekzekutohen për herë të parë veprat e kompozitorëve, të dëgjohen dhe të diskutohen. Atëherë, do të jetë një festë e vërtetë artistike. Mjaft vepra muzikore, sidomos simfonike, mbeten për një kohë të gjatë pa u ekzekutuar për vështirësi objektive që kanë orkestrat e Teatrit të Operas e të Baletit dhe Radio-Televizionit. Por me orkestra të tjera të



shkollave ato mund të ekzekutohen dhe, siç thashë, të dëgjoen në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve. Këtu, gjithashtu, mund të organizohen më shumë takime e seminare me talentet e reja, ku të diskutohet krijimtaria e tyre e pasur. Kjo do të ishte shumë e dobishme për njohjen e veprimtarisë letrare e artistike të të rinjve dhe për nxitjen e saj të mëtejshme. Në vendin tonë ushtrojnë një krijimtari të pasur me qindra të rinj e të reja, e cila përbën një interes të madh dhe paraqet shumë probleme në përmbajtjen dhe në formën e saj. Këta talente të reja tanimë nuk janë grumbulluar në dy apo tre qytete, që kanë patur një traditë të pasur kulturore, por janë përhapur në gjithë Atdheun tonë, atje ku punohet dhe krijohet. Gjeografia e krijimtarisë së tyre është zgjeruar, ata i gjen në Tropojë, në Kukës, në Lumë e Bicaç, në Bullimë të Lushnjës, në Leskovik të Kolonjës, në Devoll të Korçës, në Vranisht të Vlorës, në Vurg të Sarandës, në Dropull të Gjirokastrës, në Ishmë të Krujës, në Përmet e Memaliaj e gjetiu. Ata kanë botuar librat e tyre të parë apo kanë marrë pjesë në ekspozita të arteve figurative dhe në festivale të këngës. Sot ne, si pasojë e rritjes së talenteve të reja, kemi degë të Lidhjes edhe në Kukës, Tropojë, Peshkopi, Lezhë, Përmet, Sarandë, përveç në qytetet e mëdhenj si Shkodra, Korça, Durrësi, Gjirokastra, Fieri, Elbasani, Lushnja, Berati e Fieri. Dhe këto degë nuk janë formale, por zhvillojnë një veprimtari të gjallë krijuese. Nuk ka degë, sado e vogël që të jetë, që të mos ketë dalë nga gjiri i saj ekspozitë e arteve figurative apo të mos ketë botuar libra. Brenda dy vjetëve të fundit nga dega e Lidhjes së Kukësit, u botuan dy romane, sa ç'botoheshin në shkallë Republike në vitet 50-të. Doemos duhet punuar për t'i forcuar akoma më shumë këto degë dhe për t'i nxitur të bëjnë një jetë më të gjallë krijuese. Ato duhet të shtohen me elementë të rinj, që gjithmonë dalin nga gjiri i popullit. Për këtë arsye i duhet kushtuar vëmendje më e madhe krijimtarisë, shqetësimeve dhe halleve të forcave të reja artistike, se ato janë vlera të mëdha kombëtare.

Zbatimi i programit të Partisë në letërsi dhe arte kërkon nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe nga gjithë forcat krijuese, krahas përvetësimit të marksizëm-leninizmit edhe përpjekjet këmbëngulëse për njohjen e thellë të jetës së popullit, pasi vetëm në këtë mënyrë realizohet edukimi i plotë komunist i artistit të tipit të ri të shoqërisë sonë. «Këto detyra — thotë shoku Enver në raportin e Kongresit të 7-të të Partisë — i realizojnë më mirë ata artistë

që punojnë parreshtur për ngritjen e nivelit të tyre ideologjik marksist-leninist, që zotërojnë mësimet e Partisë, që bëjnë një jetë të gjallë politike, që jetojnë intensivisht me masat dhe që njohin thellë rrugën e zhvillimit historik revolucionar të popullit e të kulturës sonë».

Ne jemi ndihmës të Partisë jo vetëm me veprën tonë letrare dhe artistike, po edhe me punën tonë politike e ideologjike për trajtimin me shtyp e me diskutime të mjaft problemeve që dalin para kulturës sonë të re. Me trajtimin e tyre të thellë dhe shkencor, me gjykimet dhe mendimet tona duhet të japim kontributin tonë në dobi të çështjes së Partisë. Por kjo veprimtari ndihmon drejt për drejt krijimtarinë konkrete letrare e artistike për t'u pasuruar me mendime të mëdha dhe për të rritur frymën militante.

Përvoja jonë krijuese na mëson se veprat më të shquara kanë dalë nga ata artistë, që e kanë njohur thellë jetën dhe historinë e vendit dhe që kanë jetuar intensivisht me gjithë pulsën e shoqërisë. Njohja e jetës ka qenë gjithnjë një nevojë e përhershme dhe jetike për çdo artist. Por sot me ritmet e shpejta të zhvillimit të shoqërisë, me përparimin e industrisë, bujqësisë e kulturës, me forcimin e drejtimit shkencor të ekonomisë, me rritjen e klasës punëtore, me ngritjen e nivelit ideologjik, politik e kulturor të masave të gjera punonjëse, me përdorimin e një teknike moderne në prodhim dhe ndërtim, me ecjen përpara të socializmit përmes një lufte të ashpër klasore, njohja e jetës bëhet akoma më imperative. Në kushtet e sotme të zhvillimit shoqëror të vendit njohja është e vështirësuar, se jeta është bërë me komplekse dhe shumë më e pasur. Të marrësh vetëm aspektin e njohjes së jetës së fshatarësisë sonë kooperativiste, do të ndeshesh me qindra probleme të vështira të mpleksura me njëra-tjetrën, që ndryshojnë si nata me ditën me ato të paraqirimit. Kështuqë, pa njohuri të thella ideologjike e historike, ekonomike, politike, shkencore e sociale nuk mund të trajtosh si duhet fshatin socialist. Kanë lindur dhe do të lindin marrëdhënie të reja morale dhe etike, shpirtërore dhe jetësore, të cilat mund të pasqyrohen vetëm atëherë kur jeton me njerëzit dhe nisësh nga një tendencë e caktuar. Nuk është e rastit që tema e fshatit në letërsinë tonë, sidomos në roman, trajtohet shumë pak. Dikur ajo dominonte në letërsi dhe arte. Doemos, është shumë pozitive që shkrimtarët dhe artistët e drejtuan më mirë vëmendjen nga tema e qytetit dhe e klasës punëtore, por nga ana tjetër duhet ta kthejmë fytyrën më tepër edhe në jetën e fshatit tonë socialist, në problemet e tij. Prandaj është e domosdoshme që të je-

tojmë me periudha të gjata në fshat dhe të shkruajmë për jetën e njerëzve të tokës. Zbrastësitë në temën e fshatit nuk janë në dobi të zhvillimit të plotë të letërsisë dhe artit socialist, pasi cenohet realizmi dhe jeta nuk jepet në tërësinë e saj.

Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve duhet të bëjë një punë më të mirë në shpërndarjen e forcave letrare e artistike me leje krijuese të gjata në kooperativa dhe ndërmarrje bujqësore. Edhe vetë shkrimtarët dhe artistët duhet të jenë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e madhe që ka njohja e jetës në pasqyrimin e plotë e të gjithanshëm të njerëzve, të socializmit dhe të mbrojtjes së fitoreve të revolucionit. Kjo është në dobi të pasurimit të veprës së tyre me ide e mendime të freskëta, me gjuhë e kolorit të gjallë.

Orientimet e përgjithshme të Partisë për ndërtimin e socializmit, për thellimin e revolucionit ideologjik e kulturor, për mbrojtjen e Atdheut dhe për luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit kanë qenë dhe mbeten faktorët më të rëndësishëm për zhvillimin e kulturës e të arteve tona në rrugë të drejtë, për bashkërendimin sa më të plotë të kulturës dhe të arteve me gjithë veprimtarinë politike, ideologjike, ekonomike, ushtarake e shoqërore që kryen populli nën udhëheqjen e saj. Në Kongresin e 7-të të Partisë u përcaktuan objektivat kryesore të zhvillimit të vendit tonë në të ardhmen, perspektivat dhe ritmet e zhvillimit të mëtejshëm të të gjithë shoqërisë. Këto perspektiva janë burim i madh frymëzimi për gjithë punonjësit e kulturës dhe të arteve tona. Të armatosur me mësimet dhe idetë e Kongresit të 7-të, shkrimtarët dhe artistët do të krijojnë vepra të fuqishme, të mbrujtura me partisshmëri komuniste, karakterin kombëtar dhe frymën popullore, ku të lartësohet epoka e madhe e Partisë sonë të lavdishme, që e udhëheq popullin me konsekuencë dhe besim të patundur në fitoren e plotë të socializmit dhe të komunizmit.

## NGA NËNREFERATET DHE DISKUTIMET PËR LETËRSINË

## FORCIMI I VAZHUESHEM I PARTISHMERISE PROLETARE – DETYRE BAZE PER ZHVILLIMIN E ARTEVE TONA

Në raportin e Kongresit të 7-të të Partisë, udhëheqësi dhe mësuesi ynë shoku Enver Hoxha theksoi se forcimi i vazhdueshëm i partishmërisë proletare mbetet gjithnjë një detyrë bazë për zhvillimin e kulturës e të arteve tona, për përparimin e tyre në rrugën e socializmit. Rreth kësaj detyrë bazë është e nevojshme të diskutojmë gjithnjë ne krijuesit, kritikët tanë dhe studiuesit e problemeve të estetikës marksiste-leniniste. Rreth kësaj detyrë bazë duhet tërhequr përherë e më shumë mendimi i klasës sonë punëtore, i fshatarësisë sonë kooperativiste, i lexuesve përherë e më të ngritur të shtresave të ndryshme e të moshave të ndryshme, deri tek lexuesit e shumtë e të pasionuar – të vegjël tanë, që rriten e edukohen në ditët tona, kur ideologjia e Partisë është bërë ideologji sunduese. Diskutimi rreth kësaj detyrë bazë nuk është e nuk duhet të jetë një fushatë.

Të diskutosh me thellësi për problemin e partishmërisë proletare, do të thotë të diskutosh për një parim udhëheqës e të patundshëm, për një kusht që është i domosdoshëm për zhvillimin e letërsisë e të arteve tona në rrugë

të drejtë, gjë që u theksua me forcë shumë të madhe dhe shumë gjerë në kapitullin kryesor të raportit të mbajtur nga shoku Enver në plenumin e 4-t të Partisë në qershor të vitit 1973. Të thellohesh e të kuptosh mirë këtë anë thelbësore të metodës sonë të realizmit socialist, do të thotë të hedhësh dritë mbi të gjitha tiparet kryesore të kësaj metode krijuese, tipare që do të trajtohen në mënyrë të veçantë nga ky plenum i rëndësishëm i Lidhjes sonë të Shkrimtarëve dhe të Artistëve.

Vetëm shndërrimi i partishmërisë në një kërkesë të brendshme të çdo shkrimtari, kërkesë që buron nga njohja e drejtpërdrejtë dhe intensive e jetës sonë socialiste, nga jeta e gjallë intensive shoqërore, nga të jetuarit çdo ditë e çdo çast me të gjitha problemet politike, ideologjike dhe ekonomike, nga ecja përpara me ritmet e zhvillimit të shoqërisë sonë, duke bërë kështu që ajo të depërtojë në çdo qelizë të veprës letrare, vetëm uniteti i plotë dialektik i të gjitha tipareve të realizmit socialist me partishmërinë, si parim udhëheqës, janë garancia e sigurtë e hopeve të reja cilësore, që kërkojnë realizimet e shquara të derisotme në të gjitha fushat në shoqërinë revolucionare. Prandaj Partia në Kongresin e 7-të na shtroi detyrën që ta zbatojmë me besnikëri dhe në mënyrë krijuese metodën e realizmit socialist, që qëndron në bazë të artit proletar, të cilit i takon e ardhshmjia.

Në vitet e para të shekullit tonë Lenini pat theksuar se letërsia duhet të bëhet një pjesë e pandarë e çështjes së përgjithshme të proletariatit, se puna letrare duhet të bëhet një pjesë e pandarë e punës së organizuar, të planifikuar e të bashkuar të Partisë. Në të gjitha dokumentet e Partisë sonë, në fjalimet me rëndësi historike për zhvillimin revolucionar të letërsisë dhe arteve tona, mbajtur nga shoku Enver, midis të tjerave në takimin me shkrimtarët dhe artistët në korrik 1961, në plenumin e 15-të të Komitetit Qendror e në konferencën e 17-të të Partisë për Tiranën, në plenumin e 4-të të KQ e në fjalën e 20 dhjetorit 1974, ashtu si edhe në detyrat që na shtrohen në Kongresin e 7-të të Partisë, është nënvizuar gjithnjë me forcë sigurimi i udhëheqjes së Partisë në fushën e letërsisë dhe arteve, që ato të zhvillohen të pastra dhe të shëndosha. Organizatat e partisë, — thuhet në raportin e Kongresit, — duhet t'i konsiderojnë letërsinë dhe artet «si sektorë të rëndësishëm të veprimtarisë së tyre», «udhëheqja e Partisë, zbatimi me konsekuencë i vijës e i direktivave të saj në këto fusha janë vendimtare për zhvillimin e tyre në rrugë të drejtë». Në një konceptim të plotë e të

gjithanshëm të problemit të partishmërisë proletare, hyn patjetër edhe udhëheqja e letërsisë dhe e arteve nga ana e Partisë, nga flamurtarja e madhe dhe e lavdishme e partishmërisë proletare, hyn lufta kundër çdo çangazhimi ideologjik dhe kundër çdo largimi prej udhëheqjes së letërsisë nga ana e Partisë, në emër të «specifikës» dhe «sekreteve të artit», që qenkan pronë vetëm e specialistëve, e krijuesve, të cilët qenkan të lirë «të krijojnë ç'të duan e kur të duan», jashtë kërkesave të shoqërisë dhe disiplinës shoqërore.

Nga viti në vit Partia, duke nënvizuar përherë me forcë parimin udhëheqës të partishmërisë proletare si tipari themelor i letërsisë së realizmit socialist, i lidhur ngushtë me pasqyrimin prej saj të jetës nga pozitat revolucionare të proletariatit, duke iu përmbajtur kurdoherë me vendosmëri këtij parimi, në të njëjtën kohë ka ardhur duke e thelluar e pasuruar kuptimin e partishmërisë, duke nënvizuar nevojën e zhvillimit të vazhdueshëm të realizmit socialist, si një metodë që gjithnjë zien e përparon, që nuk mbetet kurrë në pozita të ngurta, që harmonizohet gjithnjë e më mirë me frymën popullore e kombëtare, me traditën e shëndoshë realiste.

Duke lexuar në gazetën «Drita» tufën me vjersha nga libri i ri poetik i Dritëro Agollit, «Fjala gdhënd gurin», më bëri përshtypje, midis të tjerave, vjersha «Në gurin e një varri», me anë të së cilës lexuesi ynë edukohet me ndjenjën e drejtë të urrejtjes së pashueshme klasore: «*ti ke qenë i poshtër, or i tretur, — shfren poeti, — dhe poshtërsinë s'ta mbulojnë vitet*». Me partishmëri të lartë, duke nënvizuar idenë e trashëgimit të virtyteve më të mira revolucionare, në vjershën tjetër «Babanë tënd e kisha shok...», poeti ngazëllehët për kalitjen revolucionare të brezit të ri:

*Kjo luftë e madhe klasash dhe kjo botë,  
kjo ndeshje dhe presion ideologjik,  
ta kanë bërë zemrën gur të fortë,  
o shëmbëllim i mikut tim fisnik!*

Fjala, që gdhënd gurin, koha jonë epike revolucionare në vargjet e poezisë, — («Koha» e ka titulluar vëllimin e vet të fundit me të drejtë poeti Ismail Kadare), pasqyrimi i momenteve të rëndësishme të historisë së kaluar dhe të sotme të Shqipërisë, trajtuar me tendenciozitet klasor, me partishmëri të lartë, të gjitha këto janë shprehje konkrete e vitalitetit të pashtërrshëm të artit

revolucionar, që si parim udhëheqës ka partishmërinë proletare.

Forcimi i partishmërisë proletare kërkon nga krijuesit një pregatitje të gjithanshme teorike, kërkon kalitjen e tyre revolucionare dhe shtimin e tendenciozitetit klasor, duke shmangur çdo kufizim ideor e subjektivizëm, kërkon paraqitjen e gjërë dhe frymëzuesë të një populli heroik, plot vitalitet e optimizëm revolucionar, që punon, mendon dhe jeton si në rrethim, kërkon në mënyrë të veçantë pasqyrimin epik të betejave për shpërtallimin e bllokadës imperia-listo-revizioniste, rrethim e bllokadë, që kanë ardhur duke u ashpërsuar.

Forcimi dhe thellimi i partishmërisë proletare në stadin e tanishëm të zhvillimit të letërsisë sonë, kërkon një pasqyrim sa më të gjerë e sa më të drejtë të të gjitha aspekteve të luftës së klasave, që gjithashtu vjen duke u ashpërsuar, si dhe të parimit të madh të mbështetjes në forcat e veta, që, siç u përcaktua në Kongresin e 7-të, «nuk është një politikë e përkohshme e koniunkturale, por një domosdoshmëri objektive për çdo vend, të madh ose të vogël, të përparuar ose të prapambetur, një parim i zbatueshëm si në luftërat çlirimtare e në revolucionin proletar, ashtu edhe në ndërtimin e socializmit e mbrojtjen e atdheut». Në lidhje me pasqyrimin e parimit marksist-leninist të mbështetjes në forcat e veta, krahas temës së madhe të ndërtimit të socializmit, merr një rëndësi të dorës së parë trajtimi i temës së Luftës sonë Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Edukimi klasor i brezave më të rinj, duke filluar që nga fatosat e vegjël, është një detyrë e letërsisë dhe artit tonë në përgjithësi, i letërsisë dhe i artit tonë për fëmijë në veçanti, që, gjithashtu, duhet të përshkohet në çdo qelizë nga parimi i partishmërisë proletare. Dhe shembujt pozitivë nuk janë pak. Mund të na shërbejë si një shembull i freskët filmi artistik i Dhimitër Anagnostit «Lulekuqet mbi mure», xhiruar në bazë të motiveve të romanit të Petraq Qafzezit «Bonjakët. Fëmijët jetimë të së kaluarës, të grumbulluar në Strehën Vorfnore, edhe pse gjysmë të uritur, të rrahur e të përbuzur, të rrethuar si në një burg brenda muresh të larta, e ndjejmë ngrohtësinë e diellit të ri që ka lindur në qiellin e Shqipërisë, diellin e Partisë së themeluar nga shoku Enver Hoxha. Këta fëmijë trajtohen me të drejtë në film jo pa dinjitet e të përulur, si ndodh ndonjëherë kur, nga dëshira e mirë për të paraqitur varfërinë e madhe të popullit tonë në të kaluarën, njerëzit paraqiten jashtë dinjitetit njerëzor, të mbe-

tur burrë e grua me një palë rroba, apo kur deri heroi kryesor paraqitet i shushatur, i përdëlyer pas copës së bukës. Çdo lojë me vuajtjen dhe çdo synim për t'u ndjellur lexuesve apo spektatorëve lotë e përmallime, është e gabuar. Vuajtja duhet të ndjellë gjithnjë revoltën dhe nuk duhet shndërruar kurrë në një qëllim në vetvete. Populli ynë ka ngritur gjithnjë krye kundër shfrytëzuesve dhe zaptuesve. Populli ynë, edhe në mjerimin më të madh, ka ruajtur dinjitetin e vet, ka krijuar këngë të mrekullueshme e të pavdekshme, deri orenditë, pajisjet shtëpiake dhe kostumet i ka punuar, ashtu të thjeshta, por me një ndjenjë estetike të rrallë.

Ne do t'i kufizojmë shembujt pozitivë tek veprat letrare të viteve të fundit, por mund të sillnim edhe shembuj të tjerë të mëparshëm, duke filluar nga vepra të tilla, tanimë klasike, si poema e Shevqet Musarajt «Epopeja e Ballit Kombëtar», apo si epopeja tjetër mbi fshatarësinë tonë të paraçlirimit – romani i Jakov Xoxës «Lumi i Vdekur», që paraqet me realizëm të thellë luftën klasore në fshatin tonë gjatë sundimit të klikës së Ahmet Zogut dhe që ngjarjet i trajton me tendenciozitet të theksuar klasor, nën prizmin e luftës së klasave.

Është meritë, për shembull, e romanit «Përballimi» të Teodor Laços, që luftën me situatat e vështira, të krijuara nga armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm, me vështirësitë ekonomike dhe me armiqtë e klasës, me kulakët dhe spekulatorët, e tregon me vërtetësi, të ashpër, ashtu siç ka qenë. Armiqtë e klasës ai nuk i paraqet skematikë apo të karikaturizuar, siç ndodh ndër disa vepra të dobëta. Ai tregon me realizëm, përmes një skene të gjetur episodike, edhe se si kthetrat e lubisë shekullore, pronës private, mund t'i ngulen thellë në mish edhe një njeriu të mirë politikisht dhe se si, më në fund, ai vjen në vete dhe radhitet me ata që, nën udhëheqjen e vendosur të komunistëve, luftojnë për sigurimin e bukës së qytetit në vështirësi, duke nënvizuar kështu edhe një ide tjetër të rëndësishme – aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë. Është meritë e veçantë e shkrimtarit që në krye të luftës së ashpër klasore, në vitet e para të krijimit të shtetit të ri të diktaturës së proletariatit, ka vënë komunistë si Martin Kreka dhe Miti Vozari, duke vazhduar me sukses atë rrugë që vite më parë pati hapur shkrimtari Fatmir Gjata me figurën e realizuar artistikisht të drejtuesit komunist, sekretarit të Partisë Stavri Lara në romanin «Kënetë».

Një figurë drejtuesi komunist nga më të realizuarat ka krijuar edhe Jakov Xoxa me Adnanin e romanit «Ju-

ga e bardhë», vepër që trajton me realizëm luftën e klasave në fshatin tonë në rrugën e ecjes përpara të kooperativave bujqësore. Dhe sa mirë do të qe sikur kritikë Adriatik Kallulli, i cili ka analizuar gjerë e thellë figurën tjetër, gjithashtu nga më të realizuarat e prozës sonë, figurën e Kiu Korroziut, e kryetarit të kooperativës që degjeroneron i pushtuar nga lakmia e pronës private, sa mirë do të qe sikur në artikullin e tij kritik «Në frontin e letërsisë», për figurën e Adnanit të mos ishte kufizuar me fare pak radhë.

Luftën e klasave dhe ashpërsimin e saj në vitet '60 në fshatin tonë kooperativist ka trajtuar me sukses, siç është vënë në dukje në shtypin tonë, romancieri i ri Ferhat Cakaj në romanin e vet të dytë «Nesër do të jetë vonë», duke treguar edhe jehonën e kësaj lufte të klasave në botën shpirtërore dhe në marrëdhëniet shoqërore të njerëzve.

Luftën me vështirësitë dhe me armiqtë e klasës në ditët tona, në vitet 70, por në të njëjtën kohë pikërisht këtë jehonë të luftës klasore në ndërgjegjen dhe në marrëdhëniet shoqërore të njerëzve, duelin me vetveten, ka paraqitur shkrimtari Ali Abdihoxha në romanin «Dueli i madh», duke treguar solidaritetin e njerëzve tanë, heroizmin masiv, që bën mrekulli, edukimin e njeriut përmes punës, vënien e interesit të përgjithshëm mbi interesin e ngushtë personal. Është meritë e autorit që është ndalur edhe te kjo luftë klase, që zhvillohet në ndërgjegjen e heroit kryesor të veprës, inxhinierit Agron Dafa. Dëshiroj të shtoj se, duke mos lënë në heshtje asnjë mangësi e dobësi të një vepre të tillë si «Dueli i madh», nuk duhet lënë në heshtje (përkundrazi, për arsye parimore, duhet nënvizuar mirë) si trajtimi i luftës së klasave në planin e kontradiktës antagonistë (Selim Bulla) dhe në planin e kontradiktës jo antagonistë (Meritë-Agron), dhe pikërisht në vitet shtatëdhjetë, ashtu edhe fakti se romani hyn në radhën e atyre veprave, të cilat merren me trajtimin e temës madhore të ndërtimit të socializmit e të problematikës aktuale që buron nga ajo.

Duke përkrahur me tendencë çdo iniciativë për të trajtuar temën e madhe të klasës punëtore, rolin e saj hegjemon, temën e luftës së klasave, në të njëjtën kohë duhet theksuar kërkesa që ky trajtim të bëhet me një nivel sa më të lartë artistik, sepse vetëm kështu do të ndrisë me gjithë shkëlqimin e vet partishmëria proletare.

Duhet të përkrahet, gjithashtu me tendencë, çdo iniciativë për të pasqyruar në veprat letrare aspektet më të

ndryshme të luftës klasore në fshatin e ri shqiptar. Dhe këtu, vemë në dukje me kënaqësi, si një fenomen të ri e shumë pozitiv, faktin se, ndryshe nga shumica e veprave të kaluara, ku qytetari i përparuar bëhet edhe në gjirin e «e prapambetur», ky riedukim bëhet edhe në gjirin e fshatarësisë së re kooperativiste, aleates besnike të klasës sonë punëtore. Kështu ndodh me qytetarët Beni, në romanin për fëmijë të Kiço Blushit «Beni ecën vetë» dhe Ollgën në komedinë e Ruzhdi Pulahës «Zonja nga qyteti», që kanë gjetur pasqyrim të shkëlqyer edhe në filmat më të njëjtin emër të regjisorëve Xhanfise Keko dhe Pirro Milkani.

Kongresi i 7-të i Partisë theksoi se nga shkrimtarët dhe artistët kërkohet që ata të pasqyrojnë drejt në veprat e tyre proceset dhe prirjet themelore të zhvillimit të revolucionit tonë, kontradiktat e jetës dhe të luftojnë çdo shfaqje të formalizmit e të skematizmit në trajtimin e tyre. Ne, sipas mësimëve të Partisë, luftojmë në të dy krahet, kundër modernizmit, ashtu edhe kundër konservatorizmit, që kanë asgjë të përbashkët me partishmërinë proletare. Ne jemi për vepra letrare të thella e plot optimizëm revolucionar, të qarta e të kuptueshme për masat e popullit, por jo banale e pa ide, jo me deklarata të jashtme, se partishmëria nuk është një shtesë, një deklaram i thatë i pikëpamjeve tona, një rrobë që i hidhet trupit të veprës. Ne jemi për vepra të shkruara me vërtetësi, pa nxirjen dhe pa lustrimin e realitetit, për vepra në të cilat idetë themelore që përmbajnë, dalin nga vetë logjika e karaktereve, nga pasqyrimi me tendenciozitet klasor i kontradiktave të kohës midis nesh dhe armiqtë si edhe në gjirin e popullit, nga zgjidhja e konflikteve dhe kontradiktave gjithmonë në favor të pozitives, nga karakteret tipike në rrethana tipike. Ne luftojmë kundër heronjve pozitivë skematikë e moralizues, të zbehtë e të varfër emocionalisht, të konceptuar në mënyrë idilike.

Pa parimin e partishmërisë proletare, si parim drejtues, ne do të lejonim një konfuzion të madh ideologjik në problemin me rëndësi vitale të tipikes, siç ka ndodhur, kurse «tipikja në art e letërsi», — ka nënvizuar me forcë në aktivin e partisë të rrethit të Tiranës shoku [i] ( «Nëntori», numri 2, 1974), — ka karakter thellësisht ideologjik dhe përbën sferën kryesore të shfaqjes së tendenciozitetit, domethënë të partishmërisë proletare në letërsinë, artin dhe kulturën e realizmit socialist. . . Për të zbatuar si duhet parimin e partishmërisë proletare në letërsi, në tipizimin e personazheve apo të fenomeneve, duhet të

*nisesh, medoemos nga këndi i vështrimit dialektik-leninist. Në qoftë se largohesh nga ky kënd vështrimi, atëherë i je shmangur besnikërisë së pasqyrimin të realitetit, ke shkëlur parimin e partishmërisë proletare, duke shtrembëruar realitetin dhe dashur pa dashur, ke çuar ujë në murallirin e ideologjisë borgjeze dhe revizioniste... Vendi ynë po ndërton socializmin i rrethuar ideologjikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht nga armiku i klasës, nga imperializmi dhe revizionizmi. Kjo nuk duhet harruar kurrë. Të tipzosh sot fenomene dhe personazhe jashtë këtij realiteti historik, kur është fjala për temën aktuale, do të thotë t'i largohesh realitetit».*

Plenumi ynë është një plenum pune, në të cilin edhe botuesit tanë mund të japin një kontribut të vlefshëm, sepse ata janë në dijeni jo vetëm të veprave që botohen, por edhe të veprave që, për shkak dobësish ideore dhe artistike, mbeten pa u botuar, të veprave që dëshmojnë për përpjekje akoma të pamjaftueshme në ngritjen ideologjike të autorëve përkatës dhe në ndjekjen hap pas hapi të marshimit triumfues përpara revolucionit tonë, që dëshmojnë për një njohje të pamjaftueshme të jetës dhe për një kulturë të pakët artistike, për zbehje të partishmërisë proletare, duke e pasqyruar realitetin në mënyrë subjektive apo objektive. Bile, në ndonjë vepër të pabotuar, ka pasur edhe ndikime të hapura moderniste. Veprat që mbeten pa u botuar janë, pra, një dëshmi se lufta kundër ndikimeve të huaja nuk është zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme dhe në nivelin e duhur nga autorët. Këto vepra mjaft herë kanë edhe një nivel të ulët artistik, gjë që na bën të theksojmë se edhe niveli i ulët artistik shpie, në të vërtetë, në dobësi ideore.

Nevoja e rritjes së ndjenjës së përgjegjësive për punën tonë letrare, në çdo gjini qoftë, duke vënë sigurisht theksin tek ato gjini ku jemi më pas, që kanë akoma një nivel jo të kënaqshëm artistik, po nënvizohet tani me të drejtë shpesh e më shpesh nga krijuesit tanë si edhe nga kritika jonë. Autori i librit «Estetika, jeta, arti», Alfred Uçi, e quan «një kusht tjetër të domosdoshëm për forcimin e parimeve të metodës së realizmit socialist» ngritjen e nivelit të mjeshtërisë artistike. «Estetët borgjezë e revizionistë, — shkruan me të drejtë ai, — në luftën e tyre kundër realizmit socialist, janë kapur e kapen pas veprash të dobëta, që u mungon mjeshtëria artistike, të cilave shpejtojnë t'u ngjiten etiketën e «modeleve» të realizmit socialist, kurse çdo vepër të përsosur, të krijuar brenda rrymës së realizmit socialist dhe në të cilën mishërohen parimet e kësaj

metode, me lloj lloj dredhish e akrobacish teorike, përpigjen ta paraqesin si diçka që ka qenë krijuar në kundërshtim me realizmin socialist». Ngritja e nivelit artistik të veprave tona është, pra, edhe një detyrë ndërkombëtare. Dhe është detyrë e madhe dhe fisnike e kritikës sonë, që të analizojë dhe të evidentojë veprat më të shquara letrare të realizmit socialist në vendin tonë, që ato të shërbejnë si shembull për talentet e reja letrare dhe si një përgjigje e të gjitha sulmeve të estetëve borgjezo-revizionistë. Këtu problemi i ngritjes së mjeshtërisë, del padyshim edhe përpara vetë kritikës sonë letrare.

Detyrat tona janë të mëdha dhe jo të lehta për t'u zbatuar. Por Partia na dha në Kongresin e 7-të mësimin e madh se «këto detyra i realizojnë më mirë ata artistë që punojnë pareshtur për ngritjen e nivelit të tyre ideologjik marksist-leninist, që zotërojnë mësimet e Partisë, që bëjnë një jetë të gjallë politike, që jetojnë intensivisht me masat dhe që njohin thellë rrugën e zhvillimit historik revolucionar të popullit e të kulturës sonë. Artin revolucionar e bëjnë artistët revolucionarë, zemra e të cilëve rreh me zemrën e popullit». Revolucionar duhet të jetë krijuesi, që të jetë në gjendje të krijojë vepra të vërteta revolucionare, revolucionar duhet të jetë kritiku letrar, që me busullën e mësimet të Partisë në dorë dhe me patosin e domosdoshëm revolucionar, të jetë në gjendje t'i ndjejë, t'i kuptojë e t'i interpretojë veprat letrare nga parimi i partishmërisë proletare, ashtu siç i ndjejnë e i kuptojnë masat punonjëse revolucionare, të cilat kanë të drejtë për një art të madh proletar, të cilat janë objekt i artit dhe e krijojnë vetë atë.

Me të drejtë në kritikën tonë, si në artikullin e Razi Brahimit «Tipare kryesore në unitet e në zhvillim» («Drita», 30 janar 1977) janë demaskuar pikëpamjet e revizionistëve sovjetikë, që «në trajtimin e tipareve themelore të realizmit socialist, ia nënshtrojnë ato realizmit në art, i cili, sipas tyre, siguron edhe tendenciozitetin klasor, edhe partishmërinë proletare, edhe karakterin popullor e kombëtar». Por zhvillimi i derisotëm i artit revolucionar ka provuar se «partishmëria proletare zë vendin kryesor drejtues. Nuk ka patur dhe nuk mund të ketë realizëm konsekuent revolucionar socialist jashtë një botëkuptimi koherent shkencor e revolucionar, siç është në kohën tonë vetëm marksizëm-leninizmi. Kufizimet e realizmit të vjetër, si edhe kufizimet e lëkundjet e mëdha të realizmit kritik të kohës sonë e kanë burimin, para së gjithash, në botëkuptimet idealiste ose materialiste jo konsekuente të shkrim-

tarëve e artistëve përparimtarë, në pozitë klasore mikro-borgjeze të tyre si dhe në presionin që ushtrojnë mbi ta rrymat filozofike të subjektivizmit borgjez dhe drejtimet artistike moderniste». Kurse kritikun ynë Dalan Shaplo ka nënvizuar faktin («Zëri i Popullit», 13 Maj 1973) se «letërsia jonë ecën në traditat e artit përparimtar dhe revolucionar kombëtar e botëror dhe nuk shkëputet nga këto tradita të ideve të mëdha, të misionit për t'i shërbyer shoqërisë dhe jo interesave të ngushta vetiake, pasqyrimin të njeriut, bartës të idealeve shoqërore dhe të prirjeve klasore të caktuara, të artit të qartë e të kuptueshëm, demokratik në thelbin e vet, por në asnjë mënyrë vulgar. Dhe me traditat e veta, në rrugën historike relativisht të shkurtër, ky art i ri shqiptar është një shembull i besnikërisë ndaj parimeve të estetikës marksiste-leniniste».

Forcimi i parimit të partishmërisë kërkon nga të gjithë ne mprehjen e vazhdueshme të vigjilencës revolucionare, qoftë në krijimtarinë letrare, qoftë në gjykimet tona mbi letërsinë.

Armiqtë e jashtëm e të brendshëm të realizmit socialist, midis tyre diversanti ideologjik Fadil Paçrami, i janë kundërvënë gjithnjë metodës së realizmit socialist, duke goditur në radhë të parë parimin e partishmërisë proletare, duke e identifikuar atë me agjitacionin, me deklaratat e thata. Kurse ne parimin e partishmërisë e shpallim botërisht e me ndjenjë krenarie si parim udhëheqës, që kur zbatohet me konsekuencë siguron atë art të vërtetë realist revolucionar, që dëshiron e pëlqen populli, që pëlqehet e vlerësohet përherë e më shumë edhe nga lexuesit e spektatorët e huaj.

Vetëm duke u udhëhequr nga parimi i partishmërisë proletare, ne do të bëjmë që armiqtë tanë, të jashtëm dhe të brendshëm, të kenë vetëm diziluzione të hidhura, të mos e shohin kurrë të realizuar në Shqipëri dëshirën e tyre që njerëzit tanë të kulturës e të arteve «të braktisin partishmërinë proletare për t'i hapur rrugën lulëzimit të gjithfarë rrymave dekadente borgjeze e revizioniste» (Plenumi i 4-t i KQ të Partisë).

Është e nevojshme të theksohet se për t'u bërë letërsia dhe artet tona edhe më revolucionare, të gjitha problemet kryesore të ngritura në raportin historik të Kongresit të 7-të duhet të gjejnë vend edhe në faqet e librave tanë, duke hedhur tutje çdo «teori të distancës», duke vënë në qendër të veprave tona më të rëndësishme edhe betejat klasore ndërkombëtare, ndër të cilat Partia jonë merr pjesë me lavdi, duke fituar respekt dhe admirim në radhët

e marksistë-leninistëve të vërtetë, midis popujve të botës. Partia, epoka e sotme, revolucionin ynë fitimtar kërkojnë rritjen e ndjenjës së përgjegjësisë historike të krijuesve tanë, kërkojnë rritjen e forcës vepruese, kushtuese dhe mobilizuese të letërsisë, që ajo ta kryejë përherë e më mirë detyrën e saj të nderit si ndihmëse e Partisë në edukimin komunist të punonjësve, në formimin dhe përsosjen e njeriut të ri, që ajo të riprodhojë artistikisht, për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, etapat e revolucionit tonë, historinë shumëshekullore të popullit tonë, të vështruar nga letërsia e botëkuptimit më të përparuar të botës, nga pozitë e marksizëm-leninizmit.



## TE FORCOJME KARAKTERIN KOMBETAR POPULLOR TE LETERSISE SONE

Në letërsinë tonë të realizmit socialist, duke nisur nga letërsia e Luftës Nacionalçlirimtare, fizionomia kombëtare popullore ka qenë e ka mbetur tipari i saj dallues. Në veprat tona të para, si në vjershat, skeçet, skicat dhe sidomos në poemën «Epopeja e Ballit Kombëtar», pasqyrohet jeta në luftë e masave të popullit tonë, të udhëhequra nga Partia, të ngritura me armë në dorë kundër pushtuesve fashistë dhe veglave të tyre, tradhëtarëve të vendit.

Me zhvillimin e mëtejshëm të artit tonë të realizmit socialist, në kushtet e revolucionit popullor e të ndërtimit socialist, problemi i fizionomisë kombëtare popullore mori një rëndësi të veçantë dhe u lidh pazgjydhshëmrisht me karakterin socialist e revolucionar, me qëndrimin proletar dhe internacionalist. Sot, kur ne kemi arritur të zhdokim shfrytëzimin e njeriut prej njeriut dhe kur tek ne ekzistojnë dy klasa mike, klasa punëtore dhe fshatarësia kooperativiste si dhe shtresa e inteligjencies popullore të udhëhequr nga klasa punëtore me Partinë në krye, ne mund të flasim për atë unitet të çeliktë moralo-politik të popullit tonë, i cili e bën atë të pamposhtur. Ky unitet, i pasqyruar me forcë artistike në veprat tona letrare, i jep letërsisë sonë atë fizionomi të tiellë kombëtare e popullore që e dallon

në mes të tjerave dhe që e bën armë të fuqishme lufte kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste, kozmopolite e çkombëtarizuese. Nga kjo anë, forcimi i fizionomisë kombëtare popullore të letërsisë sonë merr një karakter jo vetëm të estetik, po edhe politik, merr një rëndësi jo vetëm të brendshme, por edhe të jashtme. Në raportin e mbajtur në Kongresin e 7-të, shoku Enver Hoxha tha: «Në kushtet e sotme, kur imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë, të nisur nga qëllimet e tyre për sundimin e botës, për skllavërimin shpirtëror e politik të popujve, përhapin idetë e kozmopolitizmit, të të ashtuquajturit ndërkombëtarizim të artit dhe të kulturës, një rëndësi shumë të madhe merr lufta për të mbrojtur kulturën kombëtare të popujve. Duke mbrojtur e zhvilluar kulturën e vet kombëtare demokratike e revolucionare, popujt mbrojnë pavarësinë, qënien dhe traditat e veta dhe kështu japin kontributin e tyre në thesarin e kulturës botërore».

Fizionomia popullore është sfera, brenda së cilës marrin trajtën artistike origjinale veçoritë e përmbajtjes e të formës në metodën e realizmit socialist. Është pikërisht kjo fizionomi e veçantë kombëtare popullore, e cila ngjyron në veprat letrare artistike problemet, temat, idetë, konfliktet, kontradiktat, karakteret, tendenciozitetin, tipiken, individualizimin, ambientet, subjektin, gjinitë dhe llojet letrare, kompozicionin, gjuhën, mjetet shprehëse stilistike, metrike, dramaturgjike etj. Pra fizionomia kombëtare popullore në letërsi nuk është vetëm çështje forme, por, në radhë të parë, është çështje përmbajtjeje. Ky kuptim i drejtë shkencor kërkon që vlerësimi i kësaj fizionomie kombëtare popullore në veprat letrare artistike të nisë nga përmbajtja e të kalojë në formë e jo të nisë nga forma e të qëndrojë te forma, siç është bërë ndonjëherë lidhur me mjetet teknike të vargëzimit, të cilat, në ndonjë rast, janë marrë si tipari themelor për të përcaktuar në se një vepër poetike ka apo nuk ka karakter kombëtar, popullor.

Me që fizionominë kombëtare popullore duhet ta kërkojmë në radhë të parë në përmbajtje e pastaj në formë, del vetiu rëndësia e njohjes së momenteve kyçe të historisë sonë, në të cilat është formuar dhe zhvilluar ndërgjegja jonë kombëtare, e pasqyruar pastaj në krijimtarinë letrare artistike.

Lufta Nacionalçlirimtare e popullit tonë, e udhëhequr nga Partia, është një nga momentet kardinale të historisë sonë, pasqyrimi i së cilës në veprat letrare u jep atyre jo vetëm një karakter të partishëm e militant, por edhe një

fizionomi të qartë kombëtare popullore. Këtë ne e gjejmë para së gjithash në veprat më të rëndësishme me këtë temë, si «Para Agimit», dhe «Epopeja e Ballit Kombëtar», «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», «Një vjeshtë me stuhi», «Prishtina», «Proletarët», «Partizani Benko», «Familja e peshkatarit», «Komisari Memo», «Njeriu me top», «Kohë lufte», «Kronikë e viteve të paharruara», «Dikush më buzëqeshte», «E pabesueshmja», «Gratë e fshatit», «Të nënës», «Dyshimet e Jonuz Raxhës» etj. Megjithatë, ne shkrimtarët i jemi borxhli, në sasi e cilësi, një teme të tillë kyç në historinë tonë, e cila i hapi popullit perspektivën e revolucionit proletar e të ndërtimit socialist, një teme me aq rëndësi në procesin e zhvillimit të letërsisë sonë e të kristalizimit të fizionomisë së saj kombëtare popullore.

Etapat e ndryshme të zhvillimit të vullshëm industrial dhe të transformimit numerik e cilësor të klasës punëtore, të cilat japin mundësi të mëdha me dinamikën e tyre të brendshme të zhvillimit, për vepra të fuqishme artistike, janë pasqyruar pak në letërsinë tonë. Ne kemi disa vepra të mira rreth etapës së parë të formimit masiv të klasës sonë punëtore, etapën e shndërrimit të fshatarit në punëtor përmes evoluimit të ndërgjegjes proletare në kantieret, uzinat, fabrikat, si romanet «Kënetat», «Mars», «Fan Smaçli», novela «Borë në bjeshkë» etj., por i kemi shumë të pakta veprat për etapën e tjerë të zhvillimit tonë të vullshëm revolucionar, etapa në të cilat është kristalizuuar tashmë profili dhe psikologjia e punëtorit, si «Përsëri në këmbë», «Në kërkim të së vërtetës», «Dueli i madh», drama «Lezja», poema «Mes jush», etj.

Etapat e shndërrimeve revolucionare të fshatit tonë socialist, janë pasqyruar përmes veprave më të shumta letrare nga ç'janë pasqyruar në letërsinë tonë etapën e transformimeve industriale. Megjithatë, edhe përse i përket kësaj teme të madhe të realitetit tonë socialist, kemi boshllëqe e mungesa të ndjeshme.

Kemi romane dhe novela mbi ëndërrën e fshatarit të varfër për një copë tokë, si «Ata nuk ishin vetëm», «Legjenda e Vadave», «Zot e rob» etj. por nuk kemi romane dhe novela mbi realizimin e kësaj ëndërre. Nuk mund të themi se një mungesë e tillë në letërsinë tonë shpjegohet me atë që gjatë zbatimit të reformës agrare nuk pati kontradikta dhe konflikte, se ajo që vetëm festë për popullin tonë etj. Një dramë si «Toka jonë», dhe tregime si «Litari i zjarrtë», e hedhin poshtë këtë mendim.

Në mes të momenteve kyçe të reformës agrare dhe kolektivizimit, populli ynë kaloi një periudhë të vështirë, periudhë e cila, në kujtesën e fshatarit e të qytetarit lidhet me emrin «bukë». Ky që një moment i vështirë në jetën e popullit tonë dhe kapërcimi i tij që një fitore e Partisë dhe masave tona punonjëse, e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë mbi armiqtë e jashtëm e të brendshëm. Pikërisht për këtë kjo temë jep dorë për vepra të rëndësishme, gjë që e tregoi qartë romani «Përballimi».

Edhe kolektivizimi i bujqësisë dhe zhvillimi i fshatit kooperativist është një moment kyç në historinë e popullit tonë. Madje, për karakterin e konflikteve dhe kontraktave, për ashpërsimin e luftës së klasave, është një nga temat më të fuqishme e më të larmishme për zbërthim klasore, psikologjike. Këtë e kanë ndjerë shkrimtarët, prandaj për kolektivizimin dhe zhvillimin kooperativist janë shkruar disa vepra në prozë e në dramë, si romanet «Afërdita përsëri në fshat», «Tokë e ashpër», «Brezat», «Diell në kreshta», «Nesër do të jetë vonë», novela «Dritë», drama «Shënomeni dhe mua» etj. Megjithatë veprat e mira edhe në këtë temë janë të pakta, sidomos ato për zhvillimin e kooperativave malore, në të cilat, siç theksoi shoku Enver Hoxha në Kongresin e 7-të, «*banon gati gjysma e popullsisë fshatare të vendit dhe gjendet rreth 45 përqind e sipërfaqes së tokës së punueshme. Kjo ka rëndësi të madhe si për ndërtimin e socializmit, ashtu edhe për mbrojtjen e vendit.*»

Etapat e zhvillimit të fshatit tonë socialist përbëjnë një proces të tërë. Ky proces ka të bëjë me problemin e kallimit në socializëm në bujqësi me ballë sa më të gjerë e me mundësi ekonomike sa më të fuqishme, me problemin e nivelimit në mes të kooperativave të varfëra e të pasura, me problemin e zhdukjes graduale të dallimeve në mes të fshatit e qytetit dhe me shndërrimin gradual të fshatarit kooperativist në punëtor të fermës, forma më e lartë socialiste në bujqësi. Është me të vërtetë për t'u shqetësuar që për jetën e punëtorëve të bujqësisë në këto njësi të zhvillimit të lartë bujqësor socialist, që të kujtojnë qytezat e ardhshme bujqësore, të cilat sa vinë e shtohen, nuk kemi ndonjë dramë, roman, novelë të shënuar. Vepra të tilla do t'i jepnin fshatarit kooperativist atë pasqyrë artistike të së ardhmes, të cilën në kohën dhe jetën tonë e japin fermtat bujqësore.

Letërsia jonë e realizmit socialist ka realizuar disa tipa të fuqishëm si përgjithësim sociale historike dhe si individualitete njerëzore, me një rreze të madhe vepri e

ndikimi edukues, të cilët janë bërë jo vetëm të dashur për masat e lexuesve, por edhe modele për t'u ndjekur në jetë, siç janë Qemal Orhanaj, Stavri Lara, Dritani i poemës «Mësuesi», Komisari Memo, Petriti dhe Lumtoja, Cuca, Miti Vozari, Murashi, Ziguri, Korabi, Kalosh Cami, Shpresa e romanit «Zbulimi», Petriti i dramës «Familja e pesh-katarit» etj. Një Mato Gruda e një Kalosh Cami, për baktaritet etj. Një dramë dhe një Kalosh Cami, për baktaritet etj. Një Mato Gruda e një Kalosh Cami, për baktaritet etj. Një dramë dhe një Kalosh Cami, për baktaritet etj.

Por duhet të pranojmë se këta tipa e karaktere, me fizionomi të qartë kombëtare popullore, janë pak për morinë e veprave që janë botuar mbi sfera të ndryshme të jetës sonë në prozë, në dramë dhe në poemën me subjekt.

Kemi përshtypjen sikur romanet tanë me temë historike, me temë Luftën Nacionalçlirimtare dhe vitet e para të Çlirimit, përsa u përket tipave dhe karaktereve me fizionomi kombëtare, janë më të pasur nga disa romane të fundit, me temën e ditës. Mendojmë se karakteret dhe tipat janë dhënë më të plotë si përgjithësime dhe individualitete, përmes temash të mëdha, ku ata kanë zënë vende qendrore, përmes tablosh të gjëra dhe atmosferës kombëtare, përmes konfliktesh e kontradiktash të fuqishme klasore dhe marrëdhëniesh shoqërore komplekse, kurse në disa nga romanet e fundit barra përpjestohet dhe u ndahet disa karaktereve pa dalë asnjë i plotë, duke menduar, ndofta, se këstu del më mirë në pah masa, duke harruar se në art, realizimi i fuqishëm artistik i një karakteri shpreh në mënyrë po aq të fuqishme edhe masën që përfaqëson përmes përgjithësimit (tipizimit) artistik. (Kuptohet se skenat masive kanë pasur dhe do të kenë vendin e tyre sipas natyrës së veprës letrare).

Lidhur me pasqyrimin dhe filtrimin shpirtëror dhe klasor të momenteve dhe veprave të mëdha të realitetit tonë aktual, mund të përmendim romanet dhe ndonjë dramë të kohës së fundit, të cilët trajtojnë luftën parimore të Partisë kundër revizionizmit, luftën për ndërtimin e socializmit me forcat tona dhe në kushtet e rrethimit e të bllokadës së egër imperialisto-revizioniste, romanet mbi problemet e luftës së klasave që u ashpërsua në fshat e në qytet në vitet 60-70, si romanet e Kadaresë, Kondos, Cakajt, Gjakovës, një dramë e Stefës etj. Këto vepra janë ende të pakta dhe jo të gjitha në nivelin e realizimeve artistike të veprave tona më të shquara për të kaluarën historike,

për të kaluarën e afërt, për Luftën Nacionalçlirimtare dhe për vitet e para të ndërtimit socialist. E kemi fjalën këtu për romanin dhe dramën, se në poezi kjo temë kyçe është realizuar me forcë të madhe artistike në gjininë e poemës lirike.

Ana tjetër e rëndësishme e forcimit të fizionomisë kombëtare popullore në letërsi është ndriçimi dhe zgjidhja e problemeve nga pozita e ideologjisë marksiste-leniniste të Partisë, kthimi i karaktereve, tipeve, heronjve në përçues e luftëtarë të kësaj ideologjie për triumfin e socializmit e të komunizmit, ideologji e cila, siç tha shoku Enver Hoxha në Kongresin e 7-të, është bërë tek ne «ideologji sunduese», ideologji që i bën «njerëzit të kuptojnë më mirë të sotmen dhe të kenë akoma më shumë besim në të ardhmen».

Përmbajtja artistike, me fizionomi të qartë kombëtare popullore, kushtëzon edhe formën artistike për nga kjo fizionomi. Dhe e kushtëzon jo vetëm se e kërkon në përputhje me veten, por edhe sepse ia përcakton atë fizionomi. Te «Epopeja e Ballit Kombëtar», ishte përmbajtja artistike kombëtare e ngritur mbi kontrastin në mes të fjalëve të mëdha dhe punëve të vogla të një organizate politike, e cila e hiqte veten si «ballin» e kombatit, ishte përmbajtja qesharake e groteske e eksponentëve të kësaj organizate tradhëtare, që e mbanin veten si «baballarë» të kombatit, e cila i sugjeroi autorit atë formë kombëtare popullore si gjini, stil, gjuhë, varg, të satirës therëse, formë që mishëroi fuqishëm qëndrimin ideoemocional të një autori komunist dhe të një personazhi thellësisht popullor, siç është Daj Ceni; është pikërisht ajo përmbajtje kombëtare e realizuar përmes një forme po aq kombëtare popullore që e bëri atë shumë shpejt një vepër të dashur e shumë të njohur të një populli të ngritur me armë në dorë, i cili në atë kohë ishte 80% analfabet.

Do të ishte shumë gabim sikur, duke dashur t'i largohemi atij kuptimi të njëanshëm që e merrte kombëtarin e popullorin vetëm si formë, siç ka ndodhur në disa raste në kritikën dhe teorinë tonë letrare, sidomos para plenumit të 4-t të KQ të Partisë, të ulim rëndësinë që ka forma artistike, si në poezi dhe në prozë nga ana e kësaj fizionomie.

Romani «Njeriu me top» ka një fizionomi të përcaktuar kombëtare popullore jo vetëm për temën, problemin dhe idetë, jo vetëm për ndjenjën e fortë të hakmarrjes së drejtë, veçori e shqiptarit, e cila bren një jetë të tërë nje-

riu, e mishëruar në një tip të fuqishëm siç është Mato Gruda, por edhe për të gjitha elementet e formës, që nga subjekti, i cili mbahet mend dhe tregohet me lehtësi, për shkak të fabulës interesante e të shtjelluar logjikisht në ravijëzimin e saj dramatik dhe gjer te gjuha e frazeologjia e sidomos te replikat e Matos ndaj ish-ushtarit italian që ka në shtëpi, ku spikat më shumë kjo gjë për shkak të dialogut të dy personazheve me kombësi dhe mentalitete të ndryshme.

Gjallëria e naracionit, gjetja e subjekteve interesante e të shtjelluara në mënyrë të tillë që të mbajnë gjallë interesin, dialogu i shkathët, individualizimi i fuqishëm me anë të një gjuhe e frazeologjie karakterizuese, gjuha e pasur popullore, epiciteti i subjektit, dramaciteti dhe kontrastet e fuqishme, janë ku më shumë e ku më pak veçori dalluese kombëtare popullore të të gjitha veprave tona të shquara në llojet e ndryshme të prozës. Megjithatë nuk duhet të themi në asnjë mënyrë se proza jonë nuk ka të meta edhe nga forma, lidhur me këtë fizionomi. Deskriptivizmi që vihet re në disa romane, mosshpjegimi organik dhe interesant i subjektit, mungesat në individualizimin e personazheve, karaktereve, tipave me anë të gjuhës së tyre, përzierja e zhanreve gjer në atë pikë sa të humbasin veçoritë që i karakterizojnë si të tillë etj., janë dobësi të formës nga ana e fizionomisë kombëtare, të cilat zbehin edhe fizionominë kombëtare të përmbajtjes së tyre.

Edhe poezia jonë, në të gjitha llojet e saj, ka arritje të shënuara në vëllimet më të mira të poetëve të brezave të ndryshëm lidhur me fizionominë kombëtare popullore.

Paçosi i lartë qytetar, fryma e partishme, ndërtimi i zhdërvjelltë organik e logjik, figurat e gjalla me ide e emociione të thella, gama e gjerë dhe e shëndoshë tematike, ndjeshmëria e hollë, mbrendia realiste dhe notat romantike revolucionare, karakteri militant, vargjet e fuqishme dhe gjuha shprehëse poetike etj., janë ku më pak e ku më shumë veçori të saj nga ana e kësaj fizionomie. Megjithatë vihet re në disa poezi dhe sidomos në disa poema mungesa e ndërtimit organik e logjik. Ato vuajnë nga verbalizmi dhe shpesh herë janë një grumbull figurash pompoze, që duket sikur thonë shumë e nuk të thonë asgjë, gjë që bie në sy nga ajo që të mbetet në mend pas leximit ose dëgjimit të tyre. Kjo çon në rrezikun e zëvendësimit të retorizmit dhe emfazës së vjetër me një retorizëm dhe emfazë të re.

Populli ynë, përmes krijuesve të tij të mrekullueshëm, ka krijuar ritmet e veta në këngën, poezinë apo poemat e tij të bukura, në përputhje me temperamentin dhe ndjeshmërinë e vet. Fakti që në poezinë tonë popullore sundon vargu trokaik, me goditje theksi që në rrokjen e parë, shpreh një farë rreptësie, dinamike, të temperamentit të shqiptarit, një rrahje që të kujton shukjen e këmbës në tokë në vallet popullore të burrave. Kur përdoret në një krijim poetik një ritëm që përputhet me ritmin që ka fenomeni jetësor, atëherë kemi një vepër të plotë, ku përmbajtja me formën kalojnë te njera tjetra, karakteristikë e krijimeve të bukura popullore dhe e poetëve të mjeshtërisë së lartë. Fan Nolit, p.sh., ka ditur tu japë anatemave të tij kundër armikut të popullit, Zogut, përmes mjeteve ritmike të anapestit vrambullimën e tamburit, i cili godet me një ritëm gati marcial. Shembullin e poezisë popullore dhe asaj të kultivuar duhet ta ndjekin të rinjtë, për të forcuar më tej fizionominë kombëtare popullore të krijimtarisë së tyre dhe të poezisë sonë të realizmit socialist.

Fizionomia kombëtare popullore, si një fenomen dialektik, nuk mund të jetë diçka inerte, metafizike, e dhënë në një herë e përgjithmonë, të cilën një shkrimtar mund ta marrë e ta pasqyrojë në veprën e tij po me ato veçori, shfaqje e tipare, siç e kanë marrë e pasqyruar shkrimtarë të tjerë para tij.

Të konceptuarit e veçantë të jetës nga një popull dhe reagimi i tij ndaj fenomeneve të jetës sipas këtij konceptimi të veçantë, shprehur në tiparet, zakonet, shijet e tij, është produkt i kushteve të veçanta ekonomike, politike, shoqërore. Kështu, p.sh., në shoqërinë tonë socialiste është hedhur poshtë zakoni i vjetër i trajtimit të pabarabartë të gruas në shoqërinë patriarkale. Nga «Fisheku në pajë» i dramës me të njejtin titull, te gjeologia e romanit «Zbulimi», e cila shkon në mal, bashkë me shokët, për të kërkuar mineralin e çmuar, duke marrë në dorë jo vetëm profesionin që do, por edhe fatin e dashurisë së saj të rrezikuar nga thashethemet, kemi të bëjmë me një revolucion të vërtetë në pozitën dhe rolin e femrës sonë, arritur nën udhëheqjen e Partisë e të shokut Enver dhe pasqyruar bukur në letërsi.

Kështu ka ndodhur edhe me zakone, shprehi, shije dhe tipare të tjera të karakterit kombëtar, si p.sh. besa, mikpritja etj. Tani shqiptari nuk i jep besën kujtdo dhe nuk është mikpritës për këto, kur dikush i shkon në shtëpi dhe i dorëzohet në besë. Tani ai di të bëjë diferencimin, duke ia dhënë besën Partisë, komunistëve dhe gjithë atyre që pu-

nojnë e luftojnë për nderin, begatinë dhe lumturinë e At-dheut socialist. Në dramën «Gjëmimi i atij dimri» krushkut ballist, Kabashit, i tregohet dera, megjithëse ai përpigjet që t'i kujtojë të zotit të shtëpisë, Hodos, zakonin e mikpritjes shqiptare dhe besën e dhënë, lidhur me anë të krushqisë. Hakmarrja e njohur e shqiptarit ka qenë një zakon i përcaktuar nga kushte që dihen. Kalosh Cami, malsori fisnik i malësisë në romanin «Shembja e idhujve», mban plumbin e armikut, me të cilin ky i fundit e ka plagosur, në kutinë e duhanit (një detaj ky i hollë jetësor), duke pritur që t'ia kthejë. Mato Gruda ëndërron një jetë të tërë një armë të tillë, që t'i shfarosë Fizët megjithëse dhe, kur i zë syri topin e braktisur, e merr në shtëpi, me atë pikësnyimin e hakmarrjes së tmerrshme e totale, që i është ngulur si thumb në tru. Por, ky zakon i ashpër e i dëmshëm patriarkal, filloi të marrë goditjet e para në Luftën Nacionalçlirimtare, e cila bashkoi popullin rreth një hakmarrjeje të vetme: kundër armikut pushtues dhe tradhtarëve të vendit. Komunisti Murat Shtaga, megjithëse pa e ditur përmes fjalëve dhe veprimeve të tij (dhe kjo është një nga anët më origjinale të këtij romani) ia shkul Mato Grudës, dalngadalë, që të mos i dhëmbë, atë thumb në tru, gjersa më në fund ai, Mato Gruda, ia largon grykën e topit Fizëve dhe ua drejton *Fritçëve*, nazistëve gjermanë, që janë armiku i popullit të tij.

Sigurisht, jo të gjitha veçoritë kombëtare, të formuara në shekuj kapërcehen apo evoluojnë njëllë. Në mes të shijeve shpirtërore dhe atyreve lëndore, ato shpirtërore evoluojnë me ngadalë, duke ruajtur thelbin e tyre pozitiv e duke e kristalizuar atë vazhdimisht, siç janë ndjenjat ndaj të moralshmes, që nuk e pranon pornografinë dhe banalitetin në art, ndjenjat ndaj së bukurës, të cilat nuk pranojnë deformimet formaliste moderniste. Një pikturë kubiste, apo abstraksioniste, të cilën e mban në këmbë vetëm gozhda në të cilën është varur në mur, nuk mund t'i pëlqejë një populli si i yni, me shije të shëndoshë realiste. Një poezi hermetike, idetë e turbullta të së cilës nuk i vendosin dot në rresht as shkronjat e shtypit, nuk mund të kapërdihet, gjithashtu, nga një popull si yni, i mësuar të kërkojë një poezi të qartë në thellësi, si deti, dhe jo një poezi të turbullt në cektësi, si kënetë, të cilat tashmë janë tharë tek ne. Shijen e vet shpirtërore ndaj së bukurës një popull nuk mund ta veshë e ta zhveshë, ta mbathë e ta zbathtë si teshat e këpucët, ashtu siç duan përfaqësuesit e artit abstrakt, formalist, reaksionar, përmes sprovave të vazhdueshme formaliste avanguardiste.

Duke i marrë mësimet e shokut Enver Hoxha në Kongresin e 7-të si udhërrëfyese edhe për realizimin e kësaj detyre të rëndësishme, ne shkrimtarët dhe artistët e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë duhet të mbajmë gjithmonë parasysh porosinë e tij se: «Këto detyra i realizojnë më mirë ata artistë që punojnë parreshtur për ngritjen e nivelit të tyre ideologjik marksist-leninist, që zotërojnë mësimet e Partisë, që bëjnë një jetë të gjallë politike, që jetojnë intensivisht me masat dhe që njohin thellë rrugën e zhvillimit historik e revolucionar të popullit e të kulturës sonë. Artin revolucionar e bëjnë artistët revolucionarë, zemra e të cilëve rreh me zemrën e popullit».

## ZHVILLIMI I LETERSISE SONE NE LUFTE ME PRESIONIN BORGJEZ E REVIZIONIST

Një nga detyrat kryesore që shtroi Kongresi 7-të i Partisë përpara letërsisë dhe arteve tona është zhvillimi i luftës së parreshtur kundër presionit të artit borgjez-revizionist. Në raportin e shokut Enver, mbajtur në Kongres, thuhet shprehimisht: «Arti ynë i realizmit socialist, me idealet e tij revolucionare dhe me synimet për t'i shërbyer socializmit dhe popullit ngrihet përballë artit të çoroditur dekadent borgjez dhe revizionist...»

Rrethimi kulturor është pjesë përbërëse e rrethimit borgjez revizionist, pra rrjedhimisht, lufta që bëjnë shkrimtarët dhe artistët tanë kundër presionit të tij është pjesë përbërëse e luftës që bën populli ynë i udhëhequr nga Partia për shpartallimin e rrethimit në tërësi.

Historia ka njohur shumë luftra midis shkollave të ndryshme letrare, midis rrymave dhe drejtimeve. Lufta e artit realist socialist kundër artit borgjez revizionist, është e pangjashme me to. Kjo është një luftë e një tipi të ri, pjesë e luftës së klasave, luftë e revolucionit kundër kundërrevolucionit, një luftë për jetë ose për vdekje e artit tonë të shëndoshë kundër artit të sëmurë, prej

të cilit vjen erë vdekje, të borgjezisë dhe revizionizmit. Lufta e parreshtur kundër presionit borgjez revizionist është një përmasë e domosdoshme e letërsisë dhe arteve tona. Vetë zhvillimi i artit realist socialist e presupozon këtë luftë dhe përkundrazi, pushimi i kësaj lufte, do të vinte në dyshim vetë qënien e tij. Duke u zhvilluar dhe lulëzuar nën presionin e valëve goditëse të njëpasnjëshme të artit rrethues borgjez revizionist, kundërshtimin ndaj tyre arti ynë e ka si një veti themelore të tij. Kjo luftë është një nga format e ekzistencës së tij. Nuk ka si të kesh art realist socialist pa u futur në këtë luftë. Nuk ka se si vepra jote të jetë e afërt për popullin jashtë kësaj lufte.

Kongresi 7-të i Partisë e ritheksoi edhe njëherë nevojën dhe rëndësinë e kësaj ndeshjeje. Ajo ka qenë dhe duhet të bëhet akoma më tepër një aksion i vazhdueshëm i shkrimtarëve dhe i artistëve tanë, një shkollë e madhe për ta. Prej kohësh ajo ka hyrë, dhe duhet të hyjë edhe më shumë akoma në procesin e madh të njohjes së jetës nga krijuesit. Vetëm duke u konsideruar si e tillë, ajo do të zërë vendin e duhur në jetën dhe krijimtarinë tonë.

Lufta kundër presionit borgjez revizionist, si pjesë përbërëse e luftës së klasave, është e vazhdueshme dhe nuk ka karakter fushate. Historia e zhvillimit të letërsisë sonë realiste socialiste ka qenë, përveç të tjerash, edhe historia e përlëshjes me artin kundërrevolucionar. Veçanërisht vitet e fundit ky presion ka ardhur duke u rritur vazhdimisht.

Në vitet që do të vijë nuk pritet asnjë dobësim i këtij presioni, përkundrazi pritet një forcim dhe rafinim i tyre i mëtejshëm. Rrjedhimisht, edhe detyrat tona në luftën për të përballuar këtë presion janë gjithmonë në rritje, gjithmonë më serioze dhe më të mëdha.

Në fjalimin e 20 dhjetorit të shokut Enver theksohet se propaganda e imperializmit nuk ka njohur kurrë një larmi kaq të gjerë sa në ditët e sotme për degjenerimin e njerëzve dhe të shoqërisë në tërësi. Armata të tëra letrarësh bëjnë pjesë në këtë ushtri të kundërrevolucionit botëror. Guzhina e saj prodhon ditë e natë lloj-lloj ushqimesh të helmuara për degradimin e njeriut. Guzhinës së vjetër borgjeze i është shtuar dekadat e fundit guzhina revizioniste, më e trashë në disa pikëpamje, por më e rafinuar në disa të tjera. Aleanca e tyre e shëmtuar, plotësimet që i bëjnë njëra-tjetrës, për ta

bërë sa më të plotë rrethimin kundër forcave përparimtare në botë, i kanë bërë ato edhe më të rrezikshme.

Letërsia e sotme borgjeze dhe revizioniste, duke shprehur në tërësi gjendjen shpirtërore të borgjezisë dhe revizionizmit, përshkohet tejmbanë nga një frymë e sëmurë. Pavarësisht nga lustrat dhe pudrat me të cilat përpiqet të mbulohet, asaj i ka rënë çerja e vdekjes. Apo predikon humbjen sepse është vetë e humbur, bashkë me bazën që e ka pjellë; predikon pesimizmin sepse s'ka të ardhshme, predikon çthurjen, absurden, humbjen e logjikës, sepse vetë ekzistenca e saj është jashtë kohës dhe logjikës së zhvillimit të mbarë të njerëzimit. Ashtu si mikrobet, që kanë frikë nga dielli, kjo letërsi tmerrohet nga drita, shëndeti, qartësia, jeta. Ajo ka frikë nga arti i madh i revolucionit, nga realizmi socialist, ka frikë nga krijimtaria madhështore popullore e gjithë popujve të botës, madje ajo ka frikë edhe nga klasikët e mëdhenj të së kaluarës. Siç shihet, megjithëse në pamje të parë duket sikur kjo letërsi e ky art kanë vendosur tiraninë e tyre anembanë globit, ata në të vërtetë janë të izoluar e të vetmuar. Sundimi i tyre është iluzor, sepse marksizëm-leninizmi na mëson se nuk ka asnjë forcë që të ndalë zhvillimin e historisë. Prandaj lufta kundër artit borgjez revizionist është një luftë që mund të fitohet dhe do të fitohet patjetër. Në këtë luftë qysh tani arti ynë ka arritur fitore të rëndësishme dhe do të arrijë fitore akoma më të rëndësishme në vitet që do të vijë.

Duke e ndjerë dhe vetë këtë rrezik të madh, si borgjezia ashtu dhe revizionizmi, përpiqen herë pas here të riorganizojnë strukturën e forcave të tyre letrare-artistike. Ajo ndodhet në një lëvizje të vazhdueshme: zëvendësohen rrymat njëra pas tjetrës, ato që demaskohen më shpejt zbresin në thellësi, për të nxjerrë në ballë rryma të reja, të cilat gjithashtu tërhiqen nga skena, sapo u del boja. Kjo stratagjemë e vazhdueshme, që tek njerëzit naivë krijon iluzionin e ritmit të zhvillimit, s'është veçse një ardhje vërdallë brenda një rrethi të mbyllur, në të s'ka asnjë gjurmë zhvillimi, por ka vetëm përsëritje dhe amulli.

Në të vërtetë arti dekadent borgjez dhe ai revizionist që rend pas qerres së tij, përdorin një bagazh të vjetër e të përsëritur, të cilit i ndërrojnë vetëm ambalazhin. Deformimi i realitetit, dehumanizimi, antiideologjizmi,

apolitizmi, hermetizmi, shturja e formës, deheroizmi, zhdukja e angazhimit e të tjera si këto, janë synime të preferuara të qëmtuar nga borgjezia e sotme me kujdes të madh. Ato janë qëmtuar nga arti dekadent më i vjetër borgjez, nga dekadencia e mesjetës, apo e barbarisë.

Po të shikojmë p.sh., disa aspekte të letërsisë dhe artit të supershteteve të sotme, do të gjejmë se ato janë të përsëritur në etapa të ndryshme të historisë. Përpjekja për të krijuar një superart është bërë nga të gjithë shtetet e mëdhenj agresorë në të kaluarën. Teza e sotme «brezhnjeviane e «ndërkombëtarizimit të kulturës», ka variantet e saj të ndryshkur në muzeun e historisë. Militaristët e vjetër romakë u përpoqën të krijonin një art të tillë për të bërë më të lehtë nënshtrimin e popujve. Të njëjtën gjë u përpoqën të bëjnë perandorët e Bizantit, fashistët italianë që ishin hije e pushtonjësve romakë, nazistët gjermanë më pas dhe imperialistët amerikano-anglezë e sovjetikë sot.

Këto «superkultura», megjithë mbështetjen e madhe të maqinës burokratike të supershtetit, kanë dështuar gjithmonë. Ato s'i kanë dhënë asgjë kulturës botërore, krijesit e të cilës kanë qenë dhe do të jenë gjithmonë popujt, të vegjël e të mëdhenj, por kurrsesi superfuqitë. Dhe kjo është vërtetuar.

Letërsia «ndërkombëtare» që vazhdonte të shkruhej në gjuhën latine në Mesjetë, në një pjesë të madhe të Evropës, është shumë më inferiore nga letërsitë kombëtare të asaj kohe të popujve të këtyre vendeve, (kujtoni Shekspirin, Servantesin, Fransua Vinjonin). Madje ajo është shumë më inferiore edhe nga letërsia kombëtare bashkëkohore e vetë popullit italian që jetonte në truallin e mirëfilltë latin (kujtoni Dante Aligerin). Po kështu letërsia «ndërkombëtare» helenistike qëndron shumë më poshtë se letërsia e popujve që jetonin në truallin e perandorisë bizantine. Akoma më vonë letërsia «e ndërkombëtarizuar» islamike në perandorinë shumëkombëshe otomane, s'ka krahasim për nga nivelin e saj i ulët me letërsitë kombëtare të popujve ballkanikë. (Kujtoni Naim Frashërin tonë të madh përballë turmës së bejtexhinjve etj.). Dhe kështu me radhë. «Letërsitë e ndërkombëtarizuara» që përpiqen të krijojnë superfuqitë e kohës sonë nuk do të jenë veçse hije të zbeta, kufoma të ftohta përpara letërsive kombëtare të popujve të ndryshëm.

Këto përvoja të vjetra i shfrytëzojnë imperialistët e

sotëm për të bluar letërsinë dhe artet e popujve. Karakterin kombëtar të letërsisë ata përpiqen ta reduktojnë në një folklorizëm banal, në një kuriozitet turistik. Atë që kanë bërë imperialistët amerikanë me karakterin kombëtar të kulturave të popujve indianë të të dy Amerikave, socialimperialistët sovjetikë, natyrisht në një formë më të maskuar, përpiqen të bëjnë sot me kombësitë e tyre. Sado që ata flasin e gërthasin për të ashtuquajturin «lulëzim të frymës kombëtare», brenda për brenda letërsisë sovjetike dihet fare mirë se çfarë shkretimi kulturor ka në republikat e ndryshme të BS, popujt e të cilave në pikëpamje të letërsisë trajtohen si indigjenë.

Përpjekja për krijimin e një lloj arti të supershtetit, është një nga shprehjet më të qarta të dekadentizmit të sotëm borgjez revizionist. Ajo përmbledh në vetvete një pjesë të aspiratave të këtij dekadentizmi. Pseudomonumentalizmi të kujton pseudomonumentalizmin e kohës së revanshizmit në Gjermani. Gjigandomania e artit imperialist borgjez ose revizionist është një formë e shantazhit që iu bëhet proletariatit botëror si dhe popujve përparimtarë e shteteve demokratike. Me këtë gjigandomani ata duan t'u kujtojnë të tjerëve shtatin e tyre, numrat e kilometrave katrore dhe të banorëve e pasurive që kanë. Por prapa këtij viganizmi të sëmurë, prapa kësaj fryrjeje mburravece nuk fshihen veçse temat e vogla. Arti i superfuqive është i gjithi, nga kreu e në fund, art i temave të vogla, dhe mania për forma të stërholluara, për tekniçizëm, për trajtimin e temave kozmike, nuk fsheh veçse këtë varfëri dhe vogëlsi tematike. Përmasat e vogla të ideve, përbëjnë një cilësi kryesore të artit borgjez dhe revizionist të sotëm.

Pra, siç e pamë më lart, i ashtuquajturi ritmi i lulëzimit të artit borgjez dhe revizionist nuk fsheh veçse një amulli të thellë, gjigandomania e tij e jashtme nuk fsheh veçse një xhuxhmaxhuxhllëk të brendshëm, kurse lustra e tij pseudomoderne, nuk mbulon veçse një vjetërsirë të pafund. Shoku Enver, duke zberthyer në mënyrë të thellë marksiste-leniniste esencën konservatore të borgjezisë dhe revizionizmit të sotëm, ka thënë për ta: «konservatorë janë ata që na quajnë ne konservatorë». Dhe kjo është në logjikën e gjërave. Për deri se ata përpiqen për të ruajtur ose për të rivendosur në botë një rend të vjetër, pavarësisht nga çdo emërtim që mund t'i bëjnë vetes, në esencë mbeten konservatorë dhe stërkonservatorë. Të njëjtën gjë mund të themi dhe për artin e

tyre. Nuk është e rastit që shumë vepra të letërsisë së sotme dekadente borgjeze, me frymën e tyre, përmbajtjen, madje edhe stilin dhe intonacionin të kujtojnë Biblën, ungjijtë, Kuranin, Talmudin dhe paçavuret e tjera të errësirës shekullore të botës. Dhe kjo është një nga përvojat e lakmuara që arti revizionist huazoi nga ai dekadent. Sbulosa e Shën Joanit, apo Apokalipsisi, u bë motiv i preferuar i pacifistëve revizionistë. Dhe Apokalipsisi për ta është revolucioni dhe lufta revolucionare.

Katastrofizmi, që është përhapur aq shumë në librat dhe sidomos në filmat amerikanë dhe të Evropës Perëndimore, s'është gjë tjetër veçse variant i ditës së kiametit, që të gjitha fetë e botës e kanë përdorur për të çmobilizuar njerëzit revolucionarë e përparimtarë. Shumë gjëra kanë marrë dhe vazhdojnë të marrin borgjezët dhe revizionistët nga pusët e helmuar të feve. Nga kjo pikëpamje artit të tyre i vjen era myk. Nuk është e rastit që një nga modelet revizioniste e kundërrevolucionarë, libri «Një ditë e Ivan Denisoviçit» i Sollzhenicinit është shkruar me një gjuhë arkaike, më afër rusishtës së vjetër se të sotmes. Po kështu idoli tjetër kundërrevolucionar, romani «Doktor Zhivago» i Pasternakut të kujton vende-vende psallmet e vjetra.

Bashkëjetesa e liberalizmit me konservatorizmin është një fenomen i takuar shpesh në letrarët dekadentë e reaksionarë. Ambiguiteti i shkrimtarëve të tillë reaksionarë si Fishta, Koliqi e Konica, të cilët bashkuan në vetvete liberalizmin më të skajshëm me konservatorizmin më të skajshëm, është një shembull i qartë për këtë. S'është e rastit që Konica, ky bej në shërbim të mbretërisë arkaike shqiptare, ishte i afërt me rrethet moderniste dekadente evropiane, madje edhe meccenat i tyre.

Një gjendje të përafërt vemë re sot në letërsinë sovjetike. Në raportin e Kongresit të 7-të, për shkrimtarët e artistët sovjetikë thuhet se «janë shndërruar në një kastë në shërbim të kundërrevolucionit e të politikës shoviniste e ekspansioniste të socialimperializmit sovjetik». Në BS ekzistojnë sot dy grupe shkrimtarësh, liberalë dhe konservatorë. Këto grupe duket sikur janë në kundërshtim me njëri-tjetrin, madje bëjnë edhe debate e polemika dhe grumbullohen rreth revistave të caktuara. Udhëheqja sovjetike jo vetëm e lejon ekzistencën e tyre, por edhe e nxit atë. Del pyetja: përse bëhet kjo? Përgjigja është e thjeshtë: socialimperialistëve sovjetikë iu duhen të dy këto grupe sepse të dy ata janë njëlloj anti-



marksistë, njëloj kundërrevolucionarë. Nga polemika e tyre klasa punëtore s'ka asnjë fitim, veç ka çoroditje. Sepse njëri grup, liberalët, janë për afrimin sa më të shpeshtë me perëndimin, kurse grupi tjetër, konservatorët, janë kundër kësaj, por jo në emër të diçkaje përparimtare, po në emër të sllavjanofilizmit shekullor carist. Modernizmit të të parëve këta u venë përballë lashtësinë dhe shovinizmin rus. Kurse arkaizmit të këtyre të fundit, liberalët u venë modernizmin perëndimor.

Qeverisë sovjetike i duhen të dy grupet që t'i përdorë sipas konjunkturave politike. Kur përgatit ndonjë flërt me Perëndimin, vë në lëvizje grupin liberal. Kur i duhet të nxitë histerinë shoviniste, ndërseñ grupin konservator.

Kështu shpjegohet karakteri i dyfishtë, edhe pacifist edhe militarist i letërsisë sovjetike të sotme. Kur është fjala për shuarjen e zjarrmisë revolucionare të lëvizjes punëtore botërore, letërsia sovjetike lëshon erërat e pacifizmit. Mirëpo kur është fjala për agresivitetin e vet, ajo lëshon frymën e militarizmit. Për të shuar zjarrin në Kili i duhet pacifizmi i liberalëve, kurse për të sulmuar Çekoslllovakinë i duhet shovinizmi i konservatorëve. Prandaj si pacifizmi, si «kombëtarizmi» e «patriotizmi» në letërsinë sovjetike janë unilaterale. Pacifizëm, por vetëm për jashtë. Kombëtarizëm, por vetëm për brenda Ruisë.

Ky karakter i dyfishtë i letërsisë së socialimperialistëve është tepër i ngjashëm me klimën e artit reaksionar të borgjezisë. Edhe atje bashkëjetojnë pacifizmi me dhunën më të egër, butësia çmobilizonjëse me egërsinë dhe agresivitetin.

Kongresi i 7-të i Partisë nënvizoi me forcë se ç'rëndësi jetike ka për gjithë artet tona vazhdimi dhe çuarja më tej e aksionit të madh luftarak të gjithë shkrimtarëve dhe artistëve tanë, përlëshja ditë për ditë e orë për orë me presionin borgjez-revizionist. Kjo është një luftë e komplikuar, e cila mund të bëhet e suksesshme vetëm po të jetë e plotë dhe në të gjitha drejtimet.

Një fushë e rëndësishme, ku ajo është zhvilluar e duhet të zhvillohet akoma më tej është sfera e kritikës, e mendimit letrar, teorik e filozofik. Jo vetëm kritikëve e studjuesve tanë, por gjithë krijuesve, u del për detyrë të ndihmojnë për të pikasur në kohën e duhur, për të parandaluar dhe për t'i bërë të padëmshme shfaqjet e ndryshme të ndikimeve, qofshin këto nga borgjezia, qof-

shin nga revizionistët, qofshin të natyrës Garodi apo Fisher, qofshin të natyrës Shollohov apo Sollzhenicin.

Një sferë tjetër ku kjo luftë mund të zhvillohet me sukses dhe në një mënyrë të drejtpërdrejtë, është ajo pjesë e krijimtarisë letrare, që merret me pasqyrimin e luftës kundër bllokadës borgjezo-revizioniste në përgjithësi. Në këto vepra, krahas luftës kundër borgjezisë dhe revizionizmit botëror, zhvillohet edhe lufta kundër ideologjisë, mendimit dhe artit të tyre, që janë pjesë përbërëse e rrethimit të dyfishtë kundërrevolucionar.

Por, lufta kundër presionit borgjez revizionist do të ishte e mangët në qoftë se do të kufizohej vetëm me këto dy sfera që përmendëm më lart, në mendimin letrar dhe në praktikën letrare të asaj krijimtarie që rreh temën e bllokadës. Lufta kundër presionit borgjez-revizionist është e plotë dhe efikase, kur është çështja e të gjithëve, kur në të marrin pjesë të gjithë, specialistë të mendimit kritik dhe poetë, krijues që lëvrojnë temën e bllokadës dhe ata që rrahin temat e tjera të mëdha të socializmit; romancierë e dramaturgë që merren me pasqyrimin e momenteve kyçe të historisë dhe ata që pasqyrojnë aktualitetin etj. Vetëm kështu, të ngritur në këmbë të gjithë, do ta përballojmë vendosmërisht këtë presion, i cili megjithëse është i fortë, është plotësisht i përballueshëm dhe i shpartallueshëm.

Forcimi i partishmërisë proletare dhe i karakterit kombëtar popullor të letërsisë sonë, është një goditje e rëndë që i jepet presionit borgjez revizionist. Ata e dinë mirë sa të vështirë e kanë të depërtojnë në një letërsi të tillë, prandaj edhe sulmet e tyre i drejtojnë në radhë të parë kundër partishmërisë proletare dhe kundër karakterit kombëtar. Por, në sfondin e shpifjeve të tyre, partishmëria dhe ngjyra kombëtare shkëlqejnë akoma më tepër.

Lidhja e shkrimtarëve me popullin, me jetën, hallet, mendimet, zemrën e tij, njohja e thellë e jetës, «leximi i librit të hapur të jetës», siç thuhet në fjalën e 20 dhjetorit të shokut Enver, të gjitha këto janë faktor tjetër lufte kundër presionit. Jeta e gjallë, gjerësia e popullit, janë një klimë e papërshtatshme për mikrobin borgjez revizionist. Ato e ndjejnë veten keq midis popullit dhe jetës, sepse ato zhvillohen e marrin vrull pikërisht në ambjentet e mbyllura, jashtë jetës, jashtë popullit, në skutat e errëta të subjektivizmit e të egocentrizmit. Prandaj, sa më shumë që krijuesit tanë të jenë

midis klimës shpirtërore popullore, aq më të mbrojtur do të jenë ata nga ndikimi i keq i botës së vjetër.

Trajtimi i temave të mëdha, që është një nga porositë e veçanta të Kongresit të 7-të të Partisë, është gjithashtu një faktor luftarë e qëndrues kundër presionit. Siç u tha më lart, karakteristikë e artit borgjez dhe revizionist është tema e vogël, e mbështjellë me gjigandomanë. Arti i vërtetë realist socialist është, në radhë të parë, arti i temave të mëdha. U përket shkrimtarëve të realizmit socialist të vazhdojnë traditat madhështore të artit majakovskian, gorkian apo brehtian, të braktisur prej revizionistëve. Enciklopedinë e komunizmit nuk do ta bëjnë dhe s'mund ta bëjnë dot as revizionistët dhe as emigrantët, qofshin këta me banim në Moskë, qofshin me banim në Svicër. Atë do ta bëjnë bijtë e revolucionit, shkrimtarët e vërtetë revolucionarë.

Një faktor jo me më pak rëndësi luftarë është përpjekja për ngritjen e nivelit artistik të letërsisë sonë, të seriozitetit dhe soliditetit të saj. Përpara tyre do të duken edhe më qesharake ekstravagancat dhe karagjosllëqet e artit borgjez apo revizionist.

Në luftën e përditshme për parandalimin e shfaqjeve të ndikimeve të dëmshme, duhet të udhëhiqemi gjithmonë nga udhëzimet e Partisë. Të mos harrojmë asnjëherë esencën e gjërave dhe të mos gabohemi asnjëherë nga forma dhe anët e jashtme. Porositë që ka dhënë shoku Enver në fjalën e 20 dhjetorit kanë një rëndësi të madhe për orientimin e drejtë të luftës sonë për parandalimin e shfaqjeve të dëmshme. Vigjilenca jonë duhet të jetë e madhe dhe gjithmonë e partishme. Të mos e zëvendësojmë asnjëherë vigjilencën e madhe revolucionare me dyshimin e vogël mikroborgjez. Një ngatërrim i tillë nuk do ta forconte, por përkundrazi, do të dobësonte e do ta çorodiste luftën tonë.

Duke trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me kundërshtimin e presionit të letërsisë dhe artit reaksionar borgjez dhe revizionist ne i përmendim ato bashkarisht, këto dy presione, sepse ashtu ato janë, pjesë përbërëse të një fronti, pjesë përbërëse të rrethimit të dyfishtë borgjezo-revizionist. Por, duke i konceptuar kështu nga pikëpamja e përgjithshme ne jemi të ndërgjegjshëm se arti borgjez me atë revizionist, kanë ndryshimet dhe kontradiktat midis tyre; ndryshime dhe kontradikta që rrjedhin nga kontradiktat midis grupit të shteteve borgjeze

me në krye SHBA dhe grupit të shteteve revizioniste me në krye BRSS.

Në raportin e Kongresit të 7-të, shoku Enver thotë: «Partia jonë mbron tezën se, si atëherë kur superfuqitë afrohen, ashtu edhe kur ato grinden, harxhet i paguajnë të tjerët. Bashkëpunimi e rivaliteti midis superfuqive paraqesin dy anët e një realiteti kontradiktor... Ato përbëjnë të njëjtin rrezik... prandaj nuk mund të mbështetesh kurrë te një imperializëm për të luftuar ose për të shpëtuar nga tjetri».

Duke e zbatuar këtë tezë të thellë marksiste-leniniste në sferën tonë të letërsisë dhe të artit, mund të themi se grindjet ose afrimet midis letrarëve borgjezë dhe atyre revizionistë, nuk janë gjë tjetër veçse vazhdim i grindjeve dhe afrimeve të padronëve të tyre. Prandaj nuk mund të mbështetesh në argumentat e njërit art për të luftuar ose demaskuar tjetrin. Për ne shkrimtarët e realizmit socialist, letrarët revizionistë qofshin këta shkrimtarë zyrtarë në vendet e tyre, qofshin disidentë të ikur në Perëndim, janë dy anë të një medaljeje, sepse të dy palët kanë tradhtuar artin e revolucionit në emër të artit të kundërrivolucionit. Prandaj ata janë njëloj të huaj dhe të rrezikshëm për komunizmin.

Të dy këto arte dhe letërsi borgjeze dhe revizioniste, megjithëse kanë mobilizuar armata të tëra letrarësh, janë në thelb të dobët, sepse s'kanë të ardhshme. Prandaj, në luftën tonë kundër tyre, duhet të na karakterizojë sulmi dhe jo mbrojtja. Pikërisht nga ideja e sulmit duhet të përshkohet edhe puna organizative për të nxjerrë në arenën ndërkombëtare mendimin tonë revolucionar letrar si edhe veprat e letërsisë sonë.

Pavarësisht nga kompleti i heshtjes me anë të të cilit armiq të do të përpiqen të rrethojnë artin tonë, ai do të çajë përpara. Për këtë ai ka një shembull të madh: fjalën e Partisë sonë, mendimin e saj të madh revolucionar, të cilën asnjë pengesë borgjezo-revizioniste nuk e ka ndaluar dot të shpërndahet në botën mbarë.

## FOLKLORI LETRAR DHE LETËRSIA E KULTIVUAR

Historia e letërsisë shqipe të realizmit socialist, që nga fillimet e saj të Luftës Nacionalçlirimtare, ka qenë edhe historia e thellimit të karakterit popullor të saj, — në përmbajtjen socialiste dhe kombëtare, në formën shqiptare, në afrimin përherë e më shumë me masat e lexuesve dhe të spektatorëve, në shumëzimin e radhëve me krijues të prejardhjes fshatare dhe punëtore. Vetëm një periudhë të shkurtër të zhvillimit të letërsisë sonë po të merrnim, atë të këtyre katër viteve të fundit, që nga Plenumi i 4-t i KQ të Partisë, dhe do të shihnim sesi ai karakter popullor i letërsisë është rritur e forcuar në mënyrë të ndieshme, përmes një numëri të konsiderueshëm veprash dhe një vazhde suksesesh gati në tërë gjinitë. Kjo shpjegohet me drejtimin e Partisë, me largpamjen marksiste-leniniste dhe konsekuencën e një partie gjer në fund besnike të idealeve të saj, me udhëheqjen e ndritur të shokut Enver Hoxha.

Shoku Enver, si ngaherë, edhe në Kongresin e 7-të të Partisë, na mëson se «karakterit kombëtar dhe fryma popullore realizohen duke pasqyruar me vërtetësi realitetin, nga pozitë e ideologjisë marksiste-leniniste, duke asimiluar në mënyrë kritike dhe nga pozitë klasore gjithë përvojën e kulturës sonë, traditën e vjetër përparimtare dhe të reë

revolucionare, duke u mbështetur fort në krijimtarinë e popullit». «Jeta e popullit, — na mëson shoku Enver, — fjala e mprehtë e tij, psikologjia dhe humori popullor, të zënë më shumë vend në veprat tona letrare e artistike».

Duke ecur në këtë rrugë, të cilën duhet ta forcojë ngaditë, letërsia jonë socialiste ngaditë e më shumë u mbështet në krijimtarinë e popullit, në folklorin shqiptar, i cili shquhet si për pasuritë e tij të pashtershme, ashtu edhe për vitalitetin e rrallë, që e karakterizon edhe sot e kësaj dite. Këtë mbështetje, letërsia jonë e kultivuar ose profesioniste ka meritën ta ketë kërkuar e arritur edhe në të kaluarën. Kohët e reja që erdhën me Partinë, nuk e vështroan si të shterur mbështetjen në folklor, apo të mjaftueshme përvojën e çmuar të De Radajve, Naimëve, Çajupëve dhe Nolëve me të tjerë; përkundrazi, ato e quajtën të domosdoshme dhe të përhershme atë mbështetje, jo thjesht të mundshme, porse një imperativ e një detyrë në kushtet e reja historike dhe shoqërore të zhvillimit të letërsisë e përgjithësisht të kulturës sonë. Pa atë mbështetje, nuk mund të kuptohet një letërsi e realizmit socialist tipikisht e thellësisht shqiptare, nuk do të plotësohej karakteri i saj popullor, në përmbajtjen socialiste dhe në formën kombëtare, nuk do të kishte letërsia jonë forcën e plotë të komunikimit me masat, të cilave u drejtohet.

Që nga krijimet e M. Metos, të Sh. Peçit apo Sh. Mularaj, e gjer më sot, letërsia shqipe e realizmit socialist ka nderjtur përherë pranë burimit popullor, ka pirë e është freskuar në të, ka marrë shpesh aty shkasat e frymëzimit. Po të kujtonim emra nga më të ndryshmet të poetëve, prozatorëve dhe dramaturgëve, apo dhe të krijuesve të filmit tonë, të ndryshëm për nga individualiteti krijues, për nga interesat tematike dhe mjetet e shprehjes, — si Ll. Siliqi, e I. Kadareja, D. Agolli e F. Arapi, N. Bulka e S. Çomora, B. Levonja, K. Jakova, F. Gjata, Dh. Xhuvani e A. Kondo, T. Laço e V. Koreshi, Dh. Anagnosti e V. Gjika, midis shumë të tjerësh, — përmes kaq individualitetesh krijuese do të zbulonim edhe kënde të ndryshme të interesit për folklorin, mënyra të ndryshme të mbështetjes në krijimtarinë e popullit, të cilat shpjegohen me afinitetet shpirtërore, interesat tematike apo stilistike, çastet e fazat e krijimtarisë së secilit dhe të krijimtarisë së përgjithshme, të cilat kanë edhe shtrirje dhe intensitet të ndryshëm nga njëri autor në tjetrin. Vetëm emrat e përmendur dëshmojnë se asnjëherë nuk është rasti i një qëndrimi të tillë pranë folklorit, që shkrimtari dhe artisti të

ketë bërë gati punën e rapsodit, në mos dhe të etnografit, — po të përjashtojmë disa vepra të veçanta. Zakonisht, edhe në rastet kur autorët, p.sh. poetët, kanë përdorur format strikt popullore, kemi pasur të bëjmë me një përvetësim krijues, i cili, pa dyshim, matet edhe me forcën e shkathësinë e talentit, por edhe me fazën e zhvillimit të një gjinie e të një tjetre. Të tjera mundësi ka poezia, — sot mund të themi edhe proza, — me përvojën e gjatë të saj, dhe të tjera skena dhe ekрани për mbështetjen në folklor, pa harruar se këto dy gjini të fundit as i kanë korespondentët e tyre në artin e popullit. Po ky është një shembull më shumë për të treguar se mbështetja në artin e popullit ndryshon jo vetëm nga një individualitet artistik në tjetrin, por edhe nga një gjini në tjetrën. Një gjë duhet të jetë e përbashkët, — mbështetja krijuese dhe kritike, jo imitimi mekanik.

U bë më lart një pohim dhe u muar për evidente mbështetja në krijimtarinë popullore të një numëri autorësh nga më të ndryshmit e nga më të njohurit. Po nëse do të thuhej që një autor si ai i «*Epopesë së Ballit Kombëtar*», apo një tjetër, si ai i «*Nënës Shqipëri*», nuk kërkojnë të komentosh veprat për të zbuluar rrënjët që ato kanë në poezinë popullore, e po kështu edhe autorë të tjerë, si të romaneve «*Lumi i vdekur*» e «*Përballimi*», pjesëve «*Toka jonë*» e «*Karnavalet e Korçës*», për vepra të tjera kjo nuk është evidente. Nëse do të merrnim dy poema kaq të ndryshme në formë dhe të së njëjtit autor, si «*Përse mendohen këto male*» dhe «*Shqipëria dhe të tri Romat*», ka rrezik që «maniera» popullore me të cilën u shkrua poema e dytë dhe vargu i lirë apo i çliruar i poemës së parë të na bëjnë, gabimisht, të pohojmë se, në të parën, zor se kemi ndonjë mbështetje në krijimtarinë e popullit.

S'ka dyshim se përdorimi i teknikës popullore të artit është një mënyrë e të ndejturit sa më pranë folklorit. Po mjetet e shprehjes popullore janë të shumta e nuk përmbledhen vetëm në teknikën e vargut e të ndërtimit të vjershës. Sintaksa poetike, mjetet e figuracionit etj., janë të një larmie pa fund. Ato kanë edhe karakteristika krahinore, që, në tërësinë e tyre, përbëjnë një pasuri kombëtare të një larmie të veçantë në Shqipëri dhe me vlera të rra-lla.

Po do të ishte, pa fjalë, e gabuar sikur ta pandehnim mbështetjen në folklor vetëm në mjetet e shprehjes, të cilat kanë rëndësinë e madhe si mjete të komunikimit. Është vetë përmbajtja e folklorit dhe fryma e kësaj përmbajtjeje, me jetën që ka vërshuar në të, me historinë e

popullit e domethënien që merr historia në art, me filozofinë dhe aspiratat e masave, me psikologjinë e tyre dhe konstitucionin shpirtëror të nacionit, janë tërë këto dhe të tjera, të shprehura me vërtetësi dhe realizëm të madh, me një pasuri dhe larmi të jashtëzakonshme përmbajtjeje, lidhur ngushtë me aktualitetin dhe që i përgjigjen atij në çast, — është ajo përmbajtje dhe fryma e saj që duhen njohur në themel. Mbi to është mbështetur e duhet të mbështetet ngaherë e më shumë shkrimtari ynë i realizmit socialist. Dhe këtë ai nuk mundet ta bëjë pa u impenjuar, në mënyrën e vet, edhe me mjetet shprehëse të artit popullor, edhe me gjuhën e popullit. Përdorimin e gjuhës si «materie të parë» të artit të letërsisë, ku më mirë se në artin letrar të popullit do ta njihete shkrimtarin?

Këtu mund të prekeshin dy çështje dhe të luftoheshin dy koncepte. Së pari, pretendimi i mundshëm, sipas të cilit mbështetja në folklor, në një stad të avancuar të zhvillimit të letërsisë së kultivuar, zor të jetë më tej e frutshme; së dyti, pretendimi tanimë i njohur armiqësor, antikombëtar, sipas të cilit mbështetja në folklor është «anakronike», duke e quajtur folklorin si diçka të perënduar ose të prapambetur. Këto s'janë pa lidhje midis tyre.

Po të vështrohej konkretisht problemi, do të thuhej, — sipas pretendimit të parë, — se çdo letërsi e kultivuar, në fillimet e saj, mund edhe duhet të niset nga letërsia popullore; kështu bëri, p.sh., letërsia jonë e Rilindjes dhe kjo që një domosdo historike. Po tanimë a nuk u shterua ajo përpjekje e begatë e paraardhësve tanë të talentuar? — mund të pyetet. Nga ana tjetër, — mund të vazhdohet, — vetë folklori letrar, që po zhvillohet përherë e pasurohet, është duke u afruar përditë e më fort me letërsinë e kultivuar, posa që krijuesit dhe bartësit e folklorit po fitojnë përditë e më shumë kulturë të përgjithshme e kulturë letrare. Ky afrim a nuk po i sjell masat popullore te letërsia e kultivuar, jo vetëm si lexues, por edhe si krijues?

Të tilla pyetje mund të bëhen dhe të tilla pohime. Por-se ato, nga njëra anë, i mohojnë letërsisë së kultivuar mbështetjen edhe sot, edhe nesër, në traditat e lashta popullore, në një pasuri artistike mijëra vjeçare, që është pjesë e pashkëputur e thesarit kombëtar të kulturës, kurse, nga ana tjetër, u mohojnë krijuesve mundësinë e mbështetjes secili, edhe sot, edhe nesër, sipas individualitetit të vet krijues e sipas kërkesave të zhvillimit të krijimtarisë së vet personale e të gjinisë, në krijimtarinë e popullit. Ato s'kanë parasysh se bashkëjetesa midis letërsisë popullore

dhe asaj të kultivuar e bën të natyrshëm e të domosdoshëm ndikimin reciprok dhe jo vetëm atë të njëanshëm të folklorit nga letërsia profesioniste. Anakronike do të ishte sikur fusha e krijimtarisë profesioniste të ndahej me mur nga fusha e krijimtarisë folklorike, dhe më se anakronike, — kriminale. Ishte krimi që synonin armiqtë si Fadil Paçrami e Todi Lubonja.

Në se në të kaluarën artet profesioniste të klasave shfrytëzuese e kanë pasur të natyrës së tyre tendencën për t'u larguar nga krijimtaria popullore, — dhe në fakt i janë larguar shpesh, — në fazat e jetës së tyre, kur ato klasa loznin role progresiste në zhvillimin, e përgjithshëm të shoqërisë, ato kërkonin sadokudo të afroheshin, në një mënyrë a në një tjetër, me artin e popullit, sepse tek populli gjenin mbështetjen për të luajtur rolin e tyre historik në periudhën e caktuar. Në një vend ku është në fuqi klasa punëtore dhe ku u zhdukën klasat antagonistë, ku shoqëria ecën përpara e mbështetur vazhdimisht e kudo në jetë në veprimin e masave, është e natyrshme që arti profesionist të mbështetet vazhdimisht në artin popullor, paralel të cilit ai krijohet, — duke u mbështetur edhe në atë të së kaluarës, dhe doemos në mënyrën kritike dhe nga pozitë tona klasore.

Duke mos gjetur në popull as gjininë e romanit, as atë të dramës, kozmopoliti, që është edhe formalist, do ta shihte me skepticizëm, për ta mohuar pastaj, zhvillimin e mëtejshëm të romanit shqiptar të realizmit socialist dhe të dramës sonë. — Për kinemanë, ai nuk do të nguronte të mohonte me të çelur gojën. — Duke përbuzur atë përpjekje fillestare që u bë tek ne në të kaluarën për ato dy gjini dhe duke e quajtur të paktë përpjekjen e re që është bërë pas luftës, ai do të mërgohej për të importuar modele. Po këto modele nuk do t'i merrte as në të kaluarën progresiste të botës, se edhe modelet e saj do t'i cilësonte për sot të vjetëruara. E kështu, mohim pas mohimi, ai do të miratonte dhe pranonte vetëm provat e fundit të rrymave letrare që lindin në sabah dhe vdesin në aksham. Sigurisht, kjo nuk do të ishte një çështje forme, ashtu si parazitet në vështrim të parë, po në themel një çështje përmbajtjeje. Dhe kozmopoliti, përpara se të jetë një formalist, është kozmopoliti në thelb. Tek naracioni popullor, atij nuk do t'i vinte mendja se mund të gjenden mësimet mëdha të vëzhgimit e të trajtimit realist e origjinal të jetës, karaktere dhe ambiente të krijuara mjeshtërisht, dialogje, humor, gjuhë e thesare palë-palë, mençuria e

breznive të panumërta dhe rruga e afrimit ngaherë e më të ngushtë me masat.

Teorizimi se arti popullor i përket tashmë së kaluarës dhe se prej së kaluarës vështirë se mund të mësojmë ndonjë send, ishte shkëputja nga populli e nga nacioni, çkom-bëtarizimi i kërkuar, përmes braktisjes dhe mohimit të estetikës marksiste-leniniste, të mësimave të Partisë sonë e të shokut Enver, mësimet të bëra jetë në praktikën tonë socialiste të artit dhe që na provojnë se format e vjetra mundet t'i shërbejnë përmbajtjes së re, se përmbajtja e re i krijon gradualisht e në kohë format e reja që asaj i nevojiten, duke u shërbyer nga të vjetrat, se, nga ana tjetër, mbështetja në folklor nuk duhet kuptuar thjesht si një mbështetje forme, po në themel e në radhë të parë si një mbështetje përmbajtjeje. Largimi nga tabani kombëtar, pra edhe nga ai popullor, është pikërisht një rrugë çarmatosjeje shpirtërore të artit dhe të njerëzve që e përdorin atë. Armët në duart e njerëzve që s'janë të armatosura mirë shpirtërisht, s'e kanë barutin të thatë. Pikërisht këtë kërkojnë të arrijnë borgjezët e revizionistët me agresionin e tyre «të qetë» ideologjik, dhe këtij agresioni i kanë shërbyer armiqtë e brendshëm në frontin ideopolitik.

Qëndrimi formal ndaj krijimtarisë popullore, kur është fjala për folklorin bashkëkohës, harron se ky folklor përbën një shembull për kapjen e temës aktuale dhe të temës qëndrore në letërsi. Shoku Enver, në Kongresin e 7-të, na fton, ndër të tjera, për trajtimin e temave kardinale të kohës. Këto tema, ku gjenden e nga burojnë, veçse tek jeta e nga jeta e popullit punonjës? Po kush, nga ana tjetër u bën atyre jehonë më në ballë, në mos punëtori e fshatari në krijimtarinë e vet, populli që i zgjidh ai vetë nga jeta e tij? Kjo krijimtari është «autobiografia» e tij, siç e ka quajtur poeti. Folklori është një shkollë e madhe e trajtimit të jetës në art, e kapjes së temës së re kardinale dhe, përgjithësisht, të së resë, e kapjes me kohë, pa ngurim e pa prituri, dhe e trajtimit të temës me përvojën jetësore të protagonistit vetë të ngjarjeve dhe të transformimeve shoqërore, artistit-popull.

Gjithmonë shoku Enver çështjen e mbështetjes në krijimtarinë e popullit e ka ngritur si një parim qendror për letërsinë dhe artet tona socialiste, në mënyrë që këta të rriten mbi baza të çeliktë, rrënjët t'i kenë thellë në realitetin e në kulturën e vendit, të ruajnë e të forcojnë origjinalitetin kombëtar, pa të cilin s'mund të kenë jetë vër-

tet të tyren. Kështu u krijua dhe përparoi tek ne një art thellësisht revolucionar e realist, i frymëzuar nga jeta e masave punonjëse dhe që e ndihmon atë jetë për t'u shtjelluar mbarë e më tej. Jo një art epigon, i cili, midis arteve të botës, do të vegjetonte dhe nuk do të sillte veçse një imitim e nënshtrim ideologjik më shumë, ashtu siç nisi të ngjiste dhe ngjau në Varshavë, Pragë, Budapest, e kështu në Moskë e në tërë hapësirën revizioniste, ku, ndër të tjera, të mbështeturit në krijimtarinë popullore vulozet si jashtë kohës e shterp, tek sajohen letërsi, të cilat robtisen e robërohen për rikthimin tek e kaluara kapitaliste, të cilat për popullin janë sa armike aq edhe anakronike, që pikërisht janë shterpa sepse nuk pasqyrojnë më jetën dhe aspiratat socialiste të popullit, por i shtrembërojnë dhe i falsifikojnë ato, ose i zëvendësojnë me jetën e interesat e borgjezisë së re burokrate, që realizoi kundërrevolucionin. Në zhvillimin e artit botëror, ato letërsi sjellin shembulla «të reja» të zvetënimit të artit, të dekadencës dhe të dekadentizmit.

Partia jonë i ka bërë fërtele teorizimet revizioniste mbi artin, bashkë me teorizimet e borgjezisë, nga të cilat ato kanë mbirë, duke na mësuar se teoria dhe praktika e artit shqiptar të realizimit socialist zhvillohen e duhet të zhvillohen në luftë të papajtueshme me artin borgjez e revizionist, kurse për sa i takon mbështetjes në krijimtarinë e popullit, kjo është një kërkesë jetësore për artin tonë. Kjo është kërkesa e mbështetjes në forcat e veta, d.m.th. në praktikën e vetë popullit në art, pa harruar edhe praktikën tonë profesioniste. Ne s'e mënjanojmë as praktikën progresiste dhe revolucionare botërore, sa herë që ajo i shërben artit tonë socialist gjatë zhvillimit të tij.

Qëndrimi i përgjithshëm i shkrimtarëve tanë ndaj folklorit ka qenë, si thamë, pozitiv. Në këtë drejtim ne kemi ecur përpara dhe hopet e reja të letërsisë sonë socialiste kanë qenë ngaditë e më të mëdha, me pasurimin e përvojës e me shumëzimin e talenteve, me thellimin e mendimit estetik marksist-leninist të Partisë sonë, në luftë me ideologjitë reaksionare. Suksese janë dukur jo vetëm në krijimtarinë e disa talenteve kryesore, por edhe në përpjekjen e përgjithshme të kolektivit, në debutimin e më shumë të rinjve. Ato flasin për lidhjet shumë të forta të shkrimtarëve me politikën e Partisë dhe për vënien e kësaj politike në jetën e krijimtarisë letrare. Kështu, ndër të tjera, edhe për mbështetjen në krijimtarinë e popullit. Kjo po vihet re tek një numër poetësh të gjeneratave të fundit, por edhe prozatorësh të rinj. Ajo diktohet më shpejt në

përvetësimin e ritmeve dhe të kadencave popullore, të vargjeve dhe të përzierjes së tyre, të mënyrës së ndërtimit të rimave dhe ngjasërimeve, etj., po të flasim vetëm për formën. Edhe në rastet e veçanta, kur s'ka dhënë rezultat të vërtetë, ajo ka qenë një provë që meritonte të bëhej. Nuk është fjala tek prova mekanike e imitimit formal, po te përpjekja që i buron talentit nga një konviksion e nga një shtytje e brendshme. Ajo i përgjigjet edhe stadi në të cilin gjendet letërsia jonë dhe që mendojmë se kërkon një kthim edhe më të efektshëm e më të dukshëm në gurrën popullore.

Kërkesat e Partisë në këtë drejtim nisen pikërisht nga çasti historik i përpjekjes së gjithanshme të kulturës sonë për t'u mbështetur edhe më fort në tabanin kombëtar, për t'u zhvilluar edhe më gjallërisht në rrugën e afimit sa më të plotë me masat e me kulturën që ato mbartin e zhvillojnë, për ta afirmuar në mënyrë edhe më të gjithanshme, më të thellë e më të spikatur, origjinalitetin e kulturës sonë amtare, d.m.th. për të rritur e forcuar cilësitë autentike të saj, si kulturë e një populli me tradita dhjetrashekullore progresiste dhe me tradita të reja e revolucionare nga më të shquarat, me aftësi të admirueshme asimilimi dhe pasqyrimi të së resë.

Le të ndalemi në një shembull.

Ajo si «e çpënguar» që realizoi poezia jonë, sidomos që nga vitet 60, në mjetet e saj të prozodisë, me vargun e lirë e gjysëm të lirë, që kultivoi e po kultivon në masë, me disa liri poetike që morën përhapje, edhe pse solli një përvojë të gjerë pasuronjëse, përmes krijimesh nga më të ndryshmet, — epike, lirike, apo satirike, — po të kup-tohet në mënyrë të cekët, ka reziqet e veta. Dhe rreziku i parë është ai i mosdrejtimit sa duhet, në mos edhe i largimit të talentit të ri prej gurrës së folklorit dhe përvojës sonë profesioniste, të djeshme e të sotme, që shfryt-zoi edhe mjetet e prozodisë popullore. Një rrezik i dytë është ai i ngutjes në të shkruar, pa njohur ende ose duke i njohur pak mjetet strikte të prozodisë, duke e marrë lirinë në të shkruar si një kollajxhe, artin si diçka që kollaj krijohet. Rreziku i tretë është ai që talenti të mënjanohet nga lexuesi, të komunikojë pak me të, të krijojë një letërsi për një palë e për një pakicë.

Letërsitë klasike, tek të cilat format letrare dhe mjetet prozodike janë fiksuar në mënyrë të rreptë, folklorin s'e kanë përfillur si përvojë, sepse e gjenin «tepër të çpënguar e të çlirët», apo «të neglizhuar» në mjetet e tij,

— pa harruar se e quanin shpesh «të ulët», gjë që, edhe më qartë, rrëfen pozitën klasore të tyre, pozitë e klasave shfrytëzuese, të cilave ato letërsi u shërbenin. Letërsitë tepër «të çliruara» nga format, ato modernet, edhe kur, në rastin e mirë, folklorit s'ia kanë mohuar vlerat, nuk drejtohen ose drejtohen pak tek ai, sepse e gjejnë veten ngushtë në format strikte që folklorit nuk i mungojnë, sepse nuk dinë ose nuk duan të shërbehen prej tyre, duke qenë se ato forma kërkojnë një disiplinë që letërsi të tilla nuk e çmojnë e nuk duan t'i nënshtrohen. Vargjeve të lira u mungon shpesh një minimum discipline, kur këto trajtohen ashtu si vinë, pa njohje të saktë të disa ligjeve të gjuhës. Mbështetja në prozodinë popullore mund t'i sillte talentit të ri atë disiplinim pa të cilin arti s'mund të bëjë. I thomi këto duke përsëritur se të mbështeturit në krijimtarinë e popullit fillon e mbaron në të mbështeturit tek përmbajtja dhe tek fryma e asaj krijimtarie. Po mjeshteria e të shkruarit ekziston dhe, për këtë, duhet të mbështetemi veçanërisht tek mjeshtri i madh popull, kurse problemet e formës e të përmbajtjes venë kurdoherë çift e bashkë, ato kurrë nuk ndahen në jetën e artit.

Kthimi edhe më shumë në format strikte të vjershërit, duke nisur nga ato të popullit, do të sillte një element disiplinimi të mjeshterisë, të cilin poezia jonë, në stadin e sotëm të zhvillimit, ka nisur ta ndjejë me përfitim të vërtetë. Këtë fenomen e vemë re si në krijimtarinë e disa të rinjve, ashtu edhe në atë të brezave më me përvojë. Shkrimtarët e këtyre brezave, në vargjet e kadenat popullore nuk gjejnë thjesht kënaqësinë e mjeshtrit që ka ëndje ta provojë veten në teknika të ndryshme, por edhe vetëdisiplinimin si nevojë të brendshme, apo temperimin, si të thuash, të mjeteve të tyre, përgjithësisht një rifreskim e një pasurim prozodik, që u jep pas-taj kënaqësinë e madhe të një takimi edhe më të afërt me masat popullore të lexuesve dhe spektatorëve.

Po të flitim për prozën, mund të ndaleshim te nevoja që edhe më mirë prozatorët tanë të rinj të njihen me naracionin popullor. Është formuar një mendim, qoftë edhe i pashprehur, se naracioni popullor konsiston kryesisht, në mos vetëm, në një të treguar shtruar, «vend-she», si thomi, me fraza të gjata, që e endin mendimin për-mes përsëritjeve stilistike, epiteteve që i shtohen njëri-tjetrit, krahasimeve të shkallëzuara. Proza jonë e kultivuar ka pasur sukseset e saj me këtë mënyrë tregimi dhe ka ngjallur traditën e saj, ku mundet dhe duhet mbështetur

me përfitim. Por e vërtetë është se populli, edhe më zakonisht, është mjaft i përkorë në artin e të treguarit. I përkorë në përshkrime, epitete, figura, gjer edhe në dialogje e përgjithësisht në gjuhë. Tekstet e mbledhura prej gojës së tregimtarëve popullorë janë të një lakonizmi naracioni që bie në sy. Le të vemë re se pak vend zenë ato në faqet e një libri me përralla. Netët e dimrit janë të gjata, përrallat të shkurtër. Tek mjeshtri popullor do të gjejmë ndjenjën e masës, e cila ka, si vetijë të parë; edhe të treguarit ngjeshur. Kadencimi i prozës së tij dhe mjetet kompozicionale që ai mjeshtër përdor, rrjedha e dialogut, gjallëria e replikës, jepen zakonisht përmes një teksti të kursyer, çka u mungon mjaft tregimeve tona, pa harruar romanet. Në tregim s'është vështirë të zgjatesh, në roman është më se lehtë. Përvoja popullore na e zhvillon atë ndjenjë të masës, që në art duhet mprehur posaçërisht(...).

Mësimet e Partisë e të Kongresit të 7-të të saj na tregojnë se si duhet t'i mbajmë këmbët të ngulura fort në tokën mëmë, në kulturën kombëtare dhe veçanërisht në kulturën popullore, që ta shpiem edhe më tej, me hapa edhe më të shpejta e përherë të sigurta, kulturën tonë socialiste, letërsinë tonë të realizmit socialist. Thellimi në ato mësimet është për ne të gjithë një detyrë jetike. Këtu u prekën dhe vetëm u prekën, disa çështje, që kërkojnë trajtim shumë e shumë më të plotë, shkëmbim përvoje, konkretizim që e pasuron teorinë dhe e përçon edhe më mirë tek njerëzit. Kjo do të bëhet sidomos përmes luftës me teorizimet që nënçmojnë ose përçmojnë mbështetjen në krijimtarinë popullore, përfitimin që nxjerr prej saj arti profesionist, për të zhvilluar edhe më tej e forcuar karakterin popullor e revolucionar të tij, si art i realizmit socialist, që ne ndër-tuam dhe që mori zhvillimin e madh të sotëm, pikërisht sepse u udhëhoq nga Partia dhe shoku Enver, për t'u bërë, ashtu siç u bë në fakt, një art që buron nga populli dhe që i drejtohet popullit.

## TEMAT E MEDHA DHE MISHERIMI I KARAKTERIT TE HEROIT POZITIV

Këto dhjetë-pesëmbëdhjetë vjetët e fundit vihet re një pasurim i theksuar i problemeve të trajtuara në letërsi. Qoftë kur i janë drejtuar epopesë së Luftës Nacionalçlirimtare, qoftë kur kanë vënë në bazë të veprave të tyre karakteret e njerëzve tanë, të ndërtuesve të shoqërisë socialiste, shkrimtarët kanë bërë përpjekje të ndriçojnë aspekte dhe probleme të rëndësishme, të pandriçuara ose pak të ndriçuara më parë. Veprat më të mira të kësaj periudhe: «Para agimit», «Komisari Memo», «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», «Tri ngjyrat e kohës», «Zgjimi i Nebi Surelit», «Kronika e viteve të paharruara» etj., si dhe një varg romanesh, tregimesh dhe veprash të llojeve të ndryshme, kanë ndihmuar që lexuesi të marrë një ide më të plotë të epopesë heroike kundër pushtuesve fashistë. Në këto vepra kanë gjetur mishërim shumë tipare të rëndësishme të viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar si diferencimi i thellë që ngjau në shoqërinë shqiptare në vitet e pushtimit të huaj, rritja e shpejtë e lëvizjes popullore antifashiste, forca e saj organizative, zgjimi dhe vetëdija e lartë historike që shquajti masat në ato vite, roli drejtues i komunistëve, ndikimi i

fortë i tyre në popull, tradhtia që u bënë klasat shfrytëzuese interesave të atdheut dhe bashkëpunimi i tyre i gjithanshëm me pushtuesit nazifashistë për të shtypur luftën e masave popullore dhe shumë aspekte me interes nga ato vite. Me sa shihet, tema e Luftës Nacionalçlirimtare po vjen duke u përpunuar gjithnjë e më thellë; shkrimtarët po synojnë të rrahin probleme të paprekura më parë, sidomos të tregojnë se zgjimi dhe emancipimi shpirtëror e politik i disa kategorive të masave popullore nuk ka qenë i lehtë: e vërteta e madhe e luftës për çlirim kombëtar dhe shoqëror ngadhënjëu mbi paragjykimet dhe konceptet e vjetra prapanike, por kjo u bë përmes vuajtjesh, luhajtjesh dhe mëdyshjesh që u dhanë ndonjëherë jetë konflikteve të forta shpirtërore. Këtu duhet ta gjejmë rëndësinë dhe vlerën e disa veprave të kohëve të fundit, si të romanit «Njeriu me top» dhe të dramës «Gjëmimi i atij dimri» etj. Prirja për të zgjeruar tablonë e Luftës Nacionalçlirimtare në letërsinë tonë është sot prirja kryesore; duke u mbështetur në përvojën e pasur artistike të mbledhur deri tani në këtë fushë, po hidhet dritë në anë të pandriçuara, po preken probleme që po japin dorë të dalë më në pah madhështia dhe kompleksiteti i kësaj kthese të madhe historike në jetën e vendit.

Edhe në trajtimin e temës aktuale kemi një përparim të ndieshëm. Shkrimtarët, duke vënë në jetë porosinë e shokut Enver Hoxha në Konferencën e 17-të të Partisë të Tiranës që të kapërcehej prapambetja e theksuar që vihej re në krijimtarinë letrare, i shtuan përpjekjet për t'u lidhur më fort me jetën, me njerëzit tanë, që punojnë në frontet e ndryshme të ndërtimit socialist. Si rezultat i forcimit të kontakteve me realitetin, panë dritën e botimit një sërë veprash, në të cilat tregohen shfaqjet e reja në jetën e vendit, lufta e masave për të shkallmuar konceptet, shprehitë dhe traditat prapanike, lufta për emancipimin e gruas nga verigat e normave të kanunit, lufta kundër ndikimit të fesë, lufta kundër shfaqjeve të huaja ideologjike, tema e bllokadës etj. Një varg veprash transmetuan përpjekjet dhe entuziazmin në punë të njerëzve tanë jetën dhe preokupimet e rinisë etj. Prej prodhimit letrar të viteve të fundit, që flet për aktualitetin, po përmendim disa syresh si: «Juga e bardhë», «Nënë Shqipëri», «Baballarët», «Përse mendohen këto male», «Vitet 60», «Lulja e shëgës», «Cuca e maleve», «Përballimi», «Zbulimi», «Mars», «Zonja nga qyteti» etj. Ndonëse vitet e fundit hapësira e jetës aktuale në letërsi është zgjeruar, prap shkrimtarët janë ako-



ma borxhli ndaj lexuesve përsa i përket trajtimit të problemeve më kryesore të jetës socialiste. Po të krahasojmë ngjarjet dhe faktet e paraqitura në veprat letrare me jetën e gjallë, do të vëmë re se realiteti ynë është më i pasur, më i larmishëm dhe më kompleks se ç'është pikturuar në veprat letrare. Dihet se, duke nisur me shpalljen e Letrës së Hapur të KQ të Partisë, shpërtheu një luftë e madhe për revolucionarizimin e pandërprerë dhe të gjithanshëm të jetës së vendit. Masat e guximshme të Partisë për shrrënjosen e burokratizmit, të intelektualizmit, të teknokratizmit, të liberalizmit dhe të të gjitha shfaqjeve të tjera të huaja ideologjike, gjetën jehonë të gjallë në ndërgjegjen e masave punonjëse, të cilat shfaqën vendosmërinë e tyre për të kapërcyer çdo pengesë dhe vështirësi në rrugën e revolucionit të pandërprerë. Ky proces i madh transformues ka çuar në forcimin e diktaturës së proletariatit, në forcimin e rolit udhëheqës të klasës punëtore në shoqërinë tonë, në rritjen e mëtejshme të inisiativës dhe të vetmohimit të masave, në shtimin e interesimit të njerëzve për problemet e gjithë shoqërisë. Këto dukuri themelore dhe një varg dukurish e ndryshimesh të tjera, pa të cilat nuk mund të përfytyrohet jeta e shoqërisë sonë, po të përjashtojmë disa vepra që njihen, nuk kanë gjetur pasqyrimin e duhur në krijimtarinë letrare artistike. Mungojnë tablo që përfaqësojnë përgjithësime artistike të rëndësishme. Lexuesi nuk ka marrë ende në dorë vepra ku të paraqitet me ngjyra të gjalla artistike veprimtaria e dendur politike e klasës punëtore, pjesëmarrja e saj aktive në zgjidhjen e problemeve të mëdha të jetës së vendit, zgjerimi dhe forcimi i kontrollit të saj mbi këdo dhe kudo për të siguruar zbatimin e drejtë të politikës së Partisë në të gjitha fushat. Të gjithë jemi dëshmitarë të rritjes së mëtejshme ideologjike, politike dhe kulturore të klasës sonë punëtore; klasa jonë punëtore nuk është sot ajo që ka qenë para dhjetë vjetëve. Rritja e aftësive dhe e vetëdijes për rolin udhëheqës që i takon asaj në shoqërinë socialiste, ushtrimi realisht në një shkallë më të gjerë i këtij roli etj., ka sjellë tipare të reja në fizionominë e saj shpirtërore. Të gjitha këto ndryshime të rëndësishme dhe shumë kuptimplote për shoqërinë tonë nuk kanë gjetur ende pasqyrim të gjallë në veprat e shkrimtarëve. Po kështu edhe një varg problemesh të rëndësishme duhet të kishin tërhequr më shumë vëmendjen e shkrimtarëve tanë.

Siç dihet, kohët e fundit, lufta klasore u thellua më tej në vendin tonë. Në veprimtarinë e tyre të rrezikshme

armiqtë mbështetën në liberalizmin dhe burokratizmin të cilat i ushqejnë me të gjitha mënyrat për qëllimet e tyre kundërrevolucionare. Këto si edhe disa shfaqje negative, siç janë qëndrimet oportuniste dhe sentimentaliste, indiferentizmi, euforia etj. nuk janë fshikulluar me rreptësinë e duhur në letërsi. Ne kemi pak vepra që t'u ndihmojnë lexuesve tanë të shohin qartë dëmin që i sjellin këto shfaqje të huaja shoqërisë sonë. Duke stigmatizuar me forcë këto të meta, në emër të idealit pozitiv, shkrimtarët mund të jipnin një kontribut më të madh në revolucionarizimin e mëtejshëm të ndërgjegjes së njerëzve tanë, në pastrimin e shoqërisë nga ferrat dhe barërat helmuese. «Në radhët e Partisë e në popullin tonë — tha shoku Enver në raportin e mbajtur në Kongresin e 7-të të Partisë, — ekziston një frymë e shëndoshë militantizmi të gjallë dhe kjo përbën një fitore të madhe të Partisë. Por kjo nuk duhet të na çojë në vetëkënaqësi e të mbyllim sytë para shfaqjeve të indiferentizmit, që vihen re në mjaft punonjës, bile edhe te një numër komunistësh e kuadrosh. Lufta kundër shfaqjeve të indiferentizmit mbetet një detyrë aktuale e Partisë dhe e levave të saj».

Kohët e fundit, janë botuar disa vepra mbi klasën punëtore, tregime, drama dhe romane, të cilat kanë sjellë një lëndë të re e me interes në letërsi, duke mbushur «pjesët e bardha» që ishin krijuar në hartën tonë letrare nga mungesa e trajtimit në mënyrë të gjerë të temës së klasës punëtore. Duhet vënë në dukje se përveç autorëve të njohur, në pasurimin e letërsisë me vepra mbi jetën dhe punën e klasës punëtore, një kontribut me vlerë kanë dhënë një varg autorësh, që kanë dalë nga gjiri i vetë punëtorëve.

Kështu, si rezultat i përpjekjeve të të gjithë shkrimtarëve, në letërsinë tonë ka nisur të zerë vendin që i përket përfaqësuesi i klasës punëtore, punëtori i ditëve tona, që lufton me partishmëri dhe frymë të lartë mobilizimi në frontet vendimtare të ndërtimit socialist. Ndër krijimet më të shënuara që përpiqen të vizatojnë tiparet e klasës sonë punëtore, heroizmin dhe frymën e saj revolucionare, vlen të përmenden një varg krijimesh të Dh. Xhuvanit, A. Kondos, Z. Çelës, Sh. Tiganit, S. Kabës, G. Miçinotit, V. Koreshit, T. Laços, N. Priftit etj.

Megjithë këto arritje, letërsia ende nuk e ka dhënë me forcën e duhur artistike karakterin e punëtorit tonë, pasurinë e mendimeve, të ndjenjave dhe të synimeve të tij, veprimtarinë krijuese që zhvillon në fushën e ndërtimit të

shoqërisë socialiste. Ne kemi sot një varg krijimesh që japin portrete të goditura të punëtorit të sotëm, të përfaqësuesit të klasës sonë punëtore, siç janë «Mos ardhsh më, o Sheme Mara», «Njeriu që propozoj për hero», «Njerëz të mirë», «Tomë Zhegu, njeri i lumtur», «Mars» etj. Por mendojmë se krahas këtyre krijimeve, pa dyshim me vlerë, duhet të kemi edhe vepra, që të mos kufizohen me përshkrimin qoftë edhe nga afër të botës së brendëshme të punëtorit, apo me dhënien e mbresave që u ngjall autorëve takimi me një punëtor të dalluar, por ta pasqyrojnë atë në veprim, ta zbulojnë karakterin e tij në një moment të rëndësishëm të jetës së tij. Del nevoja që ta tregojmë punëtorin edhe në punën e tij, sepse kjo do të jipte mundësi që veçoritë e tij thelbësore të dilnin më në pah. Sigurisht, ne kemi vepra që mirren me paraqitjen e punës së njerëzve tanë, por duhet pranuar se në letërsinë tonë ende nuk është paraqitur me nivelin e duhur artistik puna si burim gëzimi dhe lumturie, puna si sfera kryesore ku shfaqet fizionomia e re e njeriut tonë.

Siç ka vënë në dukje me të drejtë kritika, në vepra me temë nga jeta e puna e klasës punëtore, në qendër është vendosur elementi që vjen nga gjiri i fshatarësisë patriarkale, plot koncepte dhe shprehje prapanike. Vëmendja e autorëve në romanin «Vdekja e një nate» dhe dramën «Mbas dy vjetësh» është përqëndruar në paraqitjen e mendimeve, përjetimeve, ndjenjave, që ky karakter shoqëror-historik provon në ambientin e ri, në të cilin vjen të punojë dhe të rrojë. Këta njerëz tregohen kryesisht në mencë apo në klub, ose në fjetore, duke u përpëlitur në darën e kontradiktave nga të cilat nuk dinë se si të shpëtojnë. E metë tjetër që vihet re në romanet kushtuar pasqyrimin të jetës në kantieret e mëdha të ndërtimit, është përshkrimi shumë i përgjithshëm i ambientit të punës, i atmosferës së jetës në një kantier. Në disa vepra duken dhe zhduken profile punëtorësh, dëgjojmë copra dialogesh që zhvillohen në qendrën e punës, por të gjitha këto nuk arrijnë të na japin portretin konkret të njeriut të punës, botën e tij shpirtërore. Si rezultat i kësaj nuk kanë dalë njerëzit e gjallë, detyrat që zgjidhin herojtë, vendi që ze puna në jetën e njerëzve, në mendimet dhe synimet e tyre.

Është folur me të drejtë në mbledhje dhe është shkruar në shtyp, se kemi pak vepra të llojit të gjerë rrëfimtar, për fshatin socialist. Po të lemë mënjanë romanin «Juga e bardhë», i cili mbetet vepra më e mirë që paraqet aspekte

të rëndësishme të ndërtimit të jetës së re në fshat, do të vemë re se kemi pak krijime të llojit epik, kushtuar kontradiktave të ndryshme që karakterizojnë jetën e fshatit në fazën e tanishme, ndryshimeve të rëndësishme që kanë ndodhur në jetën dhe në ndërgjegjën e njerëzve etj. Pa dyshim, dalja kohët e fundit e disa veprave të shkruara nga penat e reja, si «Dademadhja» e K. Kostës, «Mëngjes prilli» të Xh. Martinit etj. tregon se interesimi për këtë sferë të rëndësishme të jetës sonë nuk ka rënë; disa autorë nga brezi i ri po bëjnë përpjekje për të ndjekur zhvillimet e reja të fshatit dhe për t'i fiksuar ato në artin e fjalës. Por, megjithatë, duhet të pranojmë se prapambetja e formuar kohët e fundit është e ndieshme.

Duke e parë problemin me kujdes, del se boshllëqet e krijuara në sferën e pasqyrimin të jetës së fshatit kooperativist në letërsi, përbëjnë më tepër një problem organizativ se sa krijues. Një varg shkrimtarësh të njohur, që deri dje kishin ndjekur nga afër jetën e fshatit dhe krijuan një varg veprash, në të cilat treguan luftën midis së resë dhe së vjetrës në fshatin e pasqyrimin, rrënjësien e formave dhe të marrëdhënieve socialiste në jetë, për arsye të ndryshme, ka kohë që janë shkëputur nga jeta e fshatit, prandaj në krijimtarinë e tyre nuk gjetën pasqyrim shumë procese dhe ndryshime që kanë ndodhur kohët e fundit në fshatin socialist. Nga ana tjetër, ka pak forca të reja krijuese të lidhura me jetën e fshatit. Kuptohet se, për të bërë që letërsia të japë në mënyrë sa më të gjerë konfliktet dhe dukuritë e realitetit të sotëm të fshatit tonë, del nevoja që shkrimtarët të lidhen më tepër me këtë sferë të jetës, që përmes formave të ndryshme të ndihmohen ata për ta njohur atë më mirë dhe më thellë. Por, nga ana tjetër duhet të mendohet edhe për perspektivën; është një nevojë e domosdoshme të shtohen rradhët e shkrimtarëve që punojnë në këtë fushë, duke inkurajuar më shumë talentet që punojnë dhe rrojnë në fshat, që janë në kontakt të përhershëm me njerëzit e rinj të fshatit tonë socialist, që i jetojnë nga afër zhvillimet e jetës dhe, për këtë arsye, janë në gjendje të pasqyrojnë në veprat letrare tipe të rinj dhe dukuri të reja, që nuk i ka prekur letërsia më parë.

Nuk ka dyshim se letërsia do ta kryejë detyrën e saj si ndihmëse e Partisë, në qoftë se veprat e shkrimtarëve kushtuar problemeve kryesore të shoqërisë sonë, do të lenë gjurmë të thella në ndërgjegjën e lexuesit. Kjo kërkesë përputhet plotësisht me thelbin e realizmit socialist si art

që jo vetëm e njeh botën, por synon ta shndërrojë atë. Letërsia jonë përmes paraqitjes me besnikëri të jetës, përpjet të ndihmojë në zhvillimin e saj përpara. Këtij qëllimi ia arrijnë ato vepra që u hapin horizont njerëzve, që u ndihmojnë atyre të punojnë dhe të rrojnë si revolucionarë. Duke folur për përmirësimin e punës propagandistike të Partisë, shoku Enver Hoxha ka thënë: «Shkrimet dhe librat duhet të shërbejnë për të mësuar diçka të re që të na ndihmojnë për ta çuar punën përpara, për të spastruar të këqijat, të panevojshmet, ferrat që na ngatërrojnë këmbët». Ky udhëzim i shokut Enver ka rëndësi të drejtpërdrejtë edhe për letërsinë. Fjala është që të rritet më tej ndikimi i letërsisë në jetë, që roli i saj në shndërrimin revolucionar të jetës të bëhet sa më efikas. Sipas nesh, ky problem duhet konsideruar një nga problemet më të ngutëshme të letërsisë në përpjekjet që ajo po bën për të rritur më tej rolin e saj si ndihmëse besnike e Partisë. E themi këtë, sepse ka akoma vepra që nuk i lenë mbresa të thella lexuesit, i cili, ndodh që e kthen faqen e fundit të librit me një ndjenjë indiferentizmi, për të mos thënë pakënaqësie, kur e sheh se nuk përfitoi gjë nga libri, nuk mësoi diçka të re, të vlefshme. Përvoja e letërsisë sonë si dhe historia e letërsisë përparimtare botërore na mëson se në ndërgjegjen e njerëzve mbeten ato vepra që u japin mundësi atyre t'i shikojnë dukuritë dhe gjërat nga një kënd i ri shikimi, i cili ndihmon që të dalë më në pah ajo që është më thelbësore, më karakteristike në to. Por këtij qëllimi ia arrijnë ato vepra, që nuk kufizohen me përshkrimin e një ngjarjeje ose të disa ngjarjeve, sado tërheqëse qofshin ato, por përpjeten të prekin përmes tyre një problem të rëndësishëm shoqëror. Për fat të keq, në disa vepra bie në sy një anim i tepëruar nga përshkrimi i fakteve dhe i ndodhive, të cilat fitojnë rëndësi në vetvete, dhe nuk ndihmojnë sa duhet për sqarimin e problemit, që ka synuar të trajtojë shkrimtari. Një gjë të tillë e vëmë re edhe tek autorët të njohur. Në romanet «Brezat», «Zjarrret», «Shtigjeve të zëna», «Fan Smajli», «Dueli i madh», problemi artistik nuk është sqaruar, sepse faktet dhe ngjarjet nuk janë përshkruar sa duhet në funksion të zbulimit të karaktereve të heronjve, të veçorive të tyre klasore dhe individuale. Prandaj nuk del qartë zhvillimi i tyre ideologjik dhe shpirtëror, ndryshimet që ata pësojnë në procesin e praktikës sociale. Këto vepra kanë trajtuar probleme të rëndësishme të jetës së shoqërisë sonë, por autorët nuk ia kanë arritur qëllimit sepse përgjithësimi

artistik i fakteve dhe të ngjarjeve të jetës, është realizuar në mënyrë të dobët. Mund të përmendim edhe krijime të tjera, ku gjejmë fakte, mbresa, vëzhgime, shpesh herë me interes, por të paorganizuar sa duhet nga pikëpamja e idesë së veprës. Të gjitha këto na çojnë në konkluzionin se, për të shtuar forcën vepruese të letërsisë, duhet të kapërcehen një varg të metash si deskriptivizmi, empirizmi, rrëshqitja mbi sipërfaqen e dukurive dhe të ngjarjeve të jetës etj. Sot më tepër se kurrë duhen vepra që ta bëjnë lexuesin t'i punojë më shumë mendja për jetën, për problemet që preokupojnë shoqërinë tonë. Dhe vepra të tilla lindin atëhere, kur artisti e ka të qartë se detyra e tij nuk është që të thurë një subjekt interesant, ose të përshkruajë ngjarje të ndryshme nga jeta, marrë si qëllim më vete, por t'u mësojë lexuesve diçka të re, të panjohur, dhe, pa dyshim, të rëndësishme dhe të nevojshme nga pikëpamja e pasurimit të përvojës së jetës së tyre.

Vitet e fundit shkrimtarët kanë arritur një varg suksesesh në mishërimin artistik të karakterit të komunistit. Në romanet «Para agimit» dhe «Komisari Memo» është vizatuar tipi i militantit komunist të viteve të Luftës Nacionalçlirimtare. Në përputhje me interesat e tyre ideore dhe artistike, autorët kanë theksuar në personazhet e tyre veçori dhe aspekte të ndryshme të karakterit të udhëheqësit komunist të kësaj periudhe. Qemal Orhanaj është militanti udhëheqës, i cili vepron në kushtet e punës ilegale të qytetit, duke pasë përballë pseudonacionalistët dhe pseudodemokratët, që orvaten në çdo mënyrë të pengojnë zgjimin dhe lëvizjen e masave. Autori tregoi se, nga pikëpamja politike, komunistët qëndronin më lart nga forcat e tjera politike, sepse kuptonin kushtet dhe kahun e drejtimit të zhvillimit historik, qëndrimin e drejtë që duhesh mbajtur për të shpëtuar atdheun. Te Memo Kovaçi spikat lidhja e ngushtë e komunistëve me njerëzit, aftësia e tyre për të tërhequr masat në luftë kundër pushtuesit fashistë, duke riedukuar një palë dhe duke shkëputur nga ndikimi i armikut të tjerët. Stoicizmi, qartësia e qëllimit, gjakftohtësia, thjeshtësia, dashuria e madhe për popullin dhe urrejtja e thellë për armikun — këto janë veçoritë karakteristike të komisarit Memo.

Kohët e fundit janë botuar vepra ku është mishëruar karakteri i komunistit të periudhës së ndërtimit socialist, si Adnani («Juga e Bardhë») dhe Martin Kreka («Përballimi»). Adnani përfaqëson komunistin e bazës që vepron në

gjirin e masës; karakteri i tij zbulohet në dritën e një konflikti të ashpër që zhvillohet midis masës së kooperativistëve dhe kryetarit të kooperativës, i cili ka degjeneruar në një burokrat të pandreqshëm. Duke u mbështetur në luftën e tij kundër shtrembërimeve burokratike në masën e gjerë të kooperativistëve, duke udhëhequr me zgjuarsinë e forcës së shëndosha në këtë luftë dhe duke treguar durim, gjakftohtësi dhe energji të pashtershme, Adnani arrin më së fundi të ndalojë veprimet arbitrare dhe shkeljet e demokracisë socialiste në fshat.

Martin Kreka është tipi i udhëheqësit komunist të periudhës së pas Çlirimit. Në figurën e tij është paraqitur roli i Partisë në vitet e para të vendosjes së pushtetit popullor, puna e madhe që ajo zhvilloi për të shpartalluar klasat shfrytëzuese dhe për të ngritur masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit në rrugën e ndërtimit të jetës së re. Tek ky personazh spikatin cilësitë karakteristike të militantit komunist: devotshmëria ndaj Partisë, vullneti i papërkulur në arritjen e qëllimit, zotësia për të shikuar larg, aftësia për të punuar me njerëzit, me të cilët di të ndërtojë marrëdhënie të drejta dhe t'i udhëheqë me urtësi për të mundur qëndrueshmërinë e armiqve.

Siç shihet, puna për të krijuar karaktere të gjalla komunistësh është në rrugë të drejtë; tipat e tyre që janë mishëruar në veprat letrare janë sukses i rëndësishëm, por lexuesi ynë kërkon më tepër prej shkrimtarëve. Ndihet nevoja për më shumë vepra që të pasqyrojnë rolin e madh të komunistëve për revolucionarizimin e jetës së vendit. Kjo ka vlerë jo vetëm kur flasim për mishërimin e karakterit të komunistit, por edhe të heroit pozitiv në përgjithësi. Jeta jonë është plot me karaktere të lartë dhe të bukur, që janë interesante në vetvete si njerëz, por edhe nga pikëpamja e njohjes së atyre ndryshimeve që kanë ndodhë dhe po ndodhin në jetën tonë. Mirëpo, pak syresh janë futur në letërsi. Galeria e heronjve pozitivë duhet të pasurohet më tej. Kjo kërkon që shkrimtarët të shtojnë përpjekjet që në krijimtarinë letrare të kemi shumë personazhe, që të mishërojnë karakterin e njeriut të përparuar të shoqërisë sonë, punëtorin që çon me guxim përpara revolucionin tekniko-shkencor, kooperativistin, në sja të punës vetmohuese të të cilit në bujqësinë tonë u krye një revolucion i vërtetë, gruan e sotme, e cila ka zënë vendin që i përket në shoqëri si një forcë aktive dhe e rëndësishme e ndërtimit socialist, të riun dhe të renë, që punojnë me entuziazëm atje ku e kërkon atdheu.

Kur lexon disa vepra kushtuar jetës sonë socialiste, duket sheshit se, përveç njohjes së pamjaftueshme të jetës së njerëzve tanë, personazhet kanë dalë të zbehtë në to, sepse figurat e tyre nuk janë vizatuar me kujdesin dhe përgjegjësinë e duhur artistike, se jo gjithnjë janë vënë në punë të gjitha aftësitë profesionale për ta dhënë heroin pozitiv me ngjyra të gjalla. Rritja e kërkesave ndaj krijuesve shtrohet sot si detyrë e ngutshme dhe plotësisht e realizueshme, po të kemi parasysh pjekurinë e shënuar që ka arritur në përgjithësi letërsia jonë dhe shtimin e theksuar të numrit të talenteve me origjinalitet të spikatur. Na duket se, kryesisht vëmendja duhet të tërhiqet në skalitjen më mirë të veçorive individuale të heronjve, çka bën që karakteri i tyre të dalë më i besueshëm, më i gjallë. Zbulimi i pamjaftueshëm i botës së brendshme të heronjve, i individualitetit të tyre është shkaku kryesor që disa romane me temë aktuale, me gjithë konfliktet e tyre interesante, nuk patën suksesin që pritesh tek lexuesit. Që të dalë në mënyrë sa më të plotë bota e brendshme e heronjve është e nevojshme që këta të mos mbeten si të veçuar në zhvillimin e veprimit, të mos futen mekanikisht në ngjarjet e veprës. Inkuadrimi i tyre në veprimin e subjektit duhet të jetë i natyrshëm dhe organik. Ambienti, ngjarjet që përshkruhen, duhet të jenë më tepër në funksion të zbulimit të ndjenjave, të mendimeve dhe të dëshirave të heronjve; ngjarjet nuk duhet të eklipsojnë njerëzit.

Të metat e mësipërme po kapërcehen krahas forcimit të përgatitjes ideologjike të shkrimtarëve, vendosjes së lidhjeve më të ngushta të tyre me jetën, me njerëzit tanë, krahas rritjes së aftësive profesionale artistike të krijuesve. Shkrimtarët i janë përveshur punës për të vizatuar njeriun tonë të ri me tërë madhësinë e vet të edukuar nga Partia në betejat për ndërtimin e shoqërisë socialiste, dhe në këto përpjekje ata do të arrijnë pa tjetër suksese të reja.

## TE NJOHIM ME THELLE KLASËN PUNETORE

Është e vështirë të gjesh një krahasim të vetëm, me të cilin të mund të japësh ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur në vendin tonë gjatë këtyre 32 vjetëve. Edhe krahasimi më i njohur që thuhet: *si dita me natën*, është pak.

E nisa diskutimin kështu, i shtyrë nga vetë detyra jonë e madhe dhe e rëndësishme, që është pasqyrimi i realitetit, i ndërtimit të socializmit në Shqipëri, pra i këtyre ndryshimeve të mëdha që transformuan Shqipërinë gjysmë feudale, gjysmë kapitaliste në Shqipëri socialiste, me pushtetin më të përparuar në botë.

Pra, për 32 vjet punë e luftë në shumë fronte, një-rëzit tanë, me në krye Partinë e me mësimet e shokut Enver, me duart e mendjen e tyre krijuese shembën të kaluarën e errët, ndërtuan të renë dhe po pasurojnë vetveten deri në përsosmërinë e figurës morale të njeriut tonë të ri.

Për të kuptuar drejt çdo etapë, çdo fenomen, çdo ndryshim sado të vogël, ne na orienton busulla e pagabueshme e marksizëm-leninizmit, materialet e dokumentat e Partisë, mësimet e shokut Enver.

Më lejoni të zgjatem pak në një nga temat e rëndësishme të artit tonë të realizmit socialist, në temën e dashur të klasës punëtore që i jep tonin jetës së vendit dhe që përbën një fushë krijimi të gjerë e të larmishme.

Në trajtimin e kësaj teme ne kemi një radhë veprash të shëndosha e të arrira, qoftë në poezinë e Llazar Siliqit, të Dritero Agollit, të Ismail Kadarese, të Fatos Arapit, të Agim Gjakovës, të Ndoc Gjetës, Xhevahir Spahiut, Ndoc Papelekës, Spiro Dedes etj. qoftë në prozë, në tregimet e Dh. S. Shuteriqit, të A. Kondos, të N. Priftit, T. Laços, Z. Çelës, K. Blushit, V. Koreshit, deri te shkrimtarët më të rinj, Fahri Balliu, etj., qoftë dhe në një radhë romanesh si «Mars», «Kënga e Dritës», «Dhjetor i shqetësuar», «Brigada e shtatë», «Njerëzit që shpejtojnë vitet», «Vdekja e një nate», etj.

Gjithë këto vepra e autorë e shumë të tjerë që nuk përmenda, përbëjnë një eksperiencë të mirë të trajtimit të kësaj teme, me pozitivitetin e tyre, si dhe me ato dobësi ose të meta të vetë rritjes.

Nga kjo krijimtari e deritanishme me këtë temë, ne duhet të nxjerrim mësimet të rëndësishme, në radhë të parë, duke bërë pyetjen se sa i përgjigjen realitetit historik, a i pasqyrojnë ato ndryshime të mëdha të kohës sonë, ato etapa të rëndësishme, sa e si e kemi shprehur në veprat tona ideologjinë e Partisë dhe sa kemi arritur të bëjmë hero qëndror të veprave tona heroin e ditës, punëtorin komunist, njeriun e thjeshtë, por me ideale të mëdha që transformoi vendin. Ç'botë shpirtërore ka ky hero që bëri luftën, rindërtoi vendin, që i vuri shpatullat industrializimit socialist të vendit, që ngriti hidrocentralet dhe ndriçoi Shqipërinë!

Ky hero është kudo; në shembullin e tij punojnë e jetojnë skuadra, sektorë e brigada të tëra, që nderohen nga të gjithë. Ky hero i gjallë, jetësor, si Llazar Papamihali, Hasan Bekteshi, Mehmet Bekteshi, Gani Gabo, Maço Polena, Gani Tuçepi, Shyqyri Kanapari, Lezan Pislari; Pilo Lera e sa e sa të tjerë, duhet të reflektohet edhe më shumë si prototip letrar në veprat tona.

Po të tregojë biografinë e njërit prej tyre p.sh. të Llazar Papamihalit, do të më duhej të përsërisja këtu historikun e ndërtimit të socializmit, sepse ai e nisi rrugën e ndërtimit që nga Maliqi, në Cërrik, në Kombinatin Stalin, në Hidrocentralet me radhë, në Azotec e deri në Metalurgji. Llazar Papamihali ndërtonte socializmin dhe socializmi mësonte Llazarin, e rriste, e edukonte, derisa e bëri dhe hero.

Kjo rrugë e gjatë, e vështirë dhe e bukur e rriti Lllazin nga një çirak teneqexhiu në ndërtues të hidrocentraleve, nga nxënës në brigadën e parë të ndërtimit monti-

mit në Maliq, në brigadier në Cërrik, e mësues montatorësh në Vaun e Dejës, në Metalurgji. Jeta e Llazit apo e shokëve të tij duhet të na shërbejë si model për të njohur e pasqyruar procesin e rritjes së njeriut tonë të ri, luftëtar të socializmit. Ose të marrim Hasanin, apo Mehmet Bekteshin, që para çlirimit hodhën trastën në kurriz, vunë sqeparin në brez e dolën fshatrave, duke thirrur në se kishte kush ndonjë mur për të bërë, shtëpi apo kasolle për të ngriturë. Këtë gjë e bënin që të mbushnin trastën me një dorë bereqet e t'ua çonin njerëzve të shtëpisë. Socializmi hapi për këta dy fshatarë portat e tij, shkollën e tij dhe ata u bënë binjakë me të.

Solla këto raste nga jeta për të bërë një lloj paralelizmi me heronjtë e veprave tona letrare kushtuar klasës punëtore. Ne nganjëherë, nga mungesa e njohjes së plotë të jetës e zvogëlojmë sferën e veprimeve të saj, në probleme familjare ose dashurie, i mbyllim heronjtë nëpër dhoma, apo barake, i vëmë të bisedojnë ngusht rreth prodhimit, i kufizojmë e nuk u japim horizontin kombëtar, ndonëse në realitet ata kanë përmasa shumë më të mëdha edhe në jetën familjare, edhe në dashuri, edhe në punë, apo në drejtimin ekonomik e politik të fabrikës, të kantierit dhe të qytetit. Heroi punëtor nuk është ashtu siç e japim ne disa herë në tregimet, romanet e mëdobët në dramata, apo skeçet e estradave, të veshur me kominoshe, me një çelës në dorë e që përplas grushtin dhe bërtet. Punëtori ynë s'ka përse të bërtasë. Ai punon, ai drejton, ai i jep tonin jetës së vendit nëpërmjet shembullit të tij personal, nëpërmjet veprimeve të tij të shkëlqyeshme.

Nga mosnjohja e thellë e tij, ka raste kur ne kapemi pas gjërave të jashtme, të dukshme dhe, pa dashje, e skematizojmë atë. Dhe kur paraqitet në këtë mënyrë, është faji ynë e jo i punëtorit. Po të qe se ai duhet me të vërtetë të bërtasë, nuk duhet t'u bërtasë spektatorëve në sallë, po ne, shkrimtarëve. Por ai, siç duket, është i urtë dhe në urtësinë e tij duhet ta marrim si qortim dhe jo vetëm kaq, por të përpiqemi që ta njohim atë ashtu si është.

Tema e klasës punëtore, pa nënvleftësuar temat e tjera, më shumë se kurrë sot është në rend të ditës dhe paraqet një interes të gjithanshëm në prizmin kombëtar e ndërkombëtar, aq më tepër për specifikën e saj që, nën udhëheqjen e Partisë e të mësimeve të shokut Enver, ndërton socializmin duke u mbështetur në forcat e veta në kuadrin historik që jetojmë, të rrethuar nga imperializmi

e revizionizmi. Që ne t'i përgjigjemi më së miri misionit tonë, si ndihmës të Partisë për edukimin komunist të popullit, duhet, në radhë të parë, ta njohim thellë klasën punëtore dhe gjithë materialet e Partisë që hedhin dritë mbi rrugën e zhvillimit të saj.

Po njohja e saj s'mund të jetë spontane, ajo nuk mund të arrihet me një vizitë në hidrocentral, apo në Metalurgji, në fabrikë apo kantier. Njohja e jetës, së pari, duhet të rrjedhë nga pjesëmarrja jonë aktive në jetën e përditshme të vendit. Dhe, së dyti, njohja e jetës duhet të bëhet më e organizuar, me qëllim të caktuar, me tendencë të theksuar për këtë objekt, për këtë vepër industriale, për këtë fshat etj.; kjo njohje, aktive gjithashtu, duhet të jetë e përgatitur edhe nga ana teorike. Pa qënë vetë të qartë e të formuar ideologjikisht për atë problem që do të njohim, do ta kemi të vështirë ta gjejmë në jetë qoftë në embrion, qoftë në zhvillim atë që kërkojmë.

Më falni që po sjell prap një shembull: në romanin që po përgatis për klasën punëtore, për zhvillimin e saj, më duheshin disa tipa. I kërkoja nëpër metalurgji, ku herë i gjeja e herë jo. Dhe kur i gjeja, nuk më kompozoheshin në unitetin e tërë veprës, në ato tri apo katër etapa që kisha dëshirë t'i inkuadroja; më rrëshqisnin e më hynin në plan të parë heronj të tjerë që nuk kisha dëshirë të zinin aq vend.

Rilexova me kujdes Historinë e Partisë dhe dokumentet kryesore të PPSH si dhe disa fjalime të shokut Enver për kohën që do të trajtoja e gjeta në to të kristalizuar periudhën, gjeta boshtin kryesor të ecurisë dhe heroin kryesor: të dërguarin e klasës punëtore në fabrikat kapitaliste, fill mbas çlirimit. Ky hero u bë tani qëndror në veprën time dhe unë dola i kënaqur nga kantieri nr. 1 i metalurgjisë dhe fillova të kërkoj fatin e heroit punëtor të ditëve të para të pushtetit popullor në lagje, në qytet, në Komitetin Ekzekutiv, në Komitetin e Partisë e sërish, në periudhën e dytë të ndërtimit të socializmit, u ktheva prapë në Metalurgji. Kështu figura e punëtorit m'u zgjerua, zuri atë vend që i takon për t'i dhënë tonin e jetës së vendit, dhe vetë kantieri nr. 1, për të cilin unë kisha vendosur apriori që të ishte në qendër të veprës, tani më doli në një plan të barabartë me tërë qytetin.

Tema e klasës punëtore, kjo temë kaq e rëndësishme, nuk mund të realizohet drejt e bukur nëse ne nuk do të bëjmë atë që bën vetë klasa në kryerje të misionit të saj: të vëmë të gjitha energjitë tona fizike e shpirtërore për të kryer misionin tonë.

## KONFLIKTI DHE KARAKTERI NE DRAME

Në praktikën krijuese tani, vërejmë se vëmendja e dramaturgëve është drejtuar nga momentet kyçe të jetës së popullit, nga fenomenet karakteristike ku shpalesen kontradiktat e realitetit konkret historik, për të cilin bëhet fjalë, nga herojtë pozitivë që kanë në dorë frerët e ecurisë së shoqërisë e që janë në ballë të ngjarjeve. Suksesit e mirëpritja që u bën spektatori dramave tona më të mira e jetëgjata si «Toka jonë», «Familja e peshkatarit», «Cuca e maleve», «Fytyra e dytë», «Mulliri i Kostë Bardhit» apo disa veprave të arritura në këtë gjini pas plenumit të 4-t, si «Zonja nga qyteti», «Gjergj Kastrioti», «Shpartallimi», «Lulet e shegës», «Mësim nga historia» etj. e ka burimin tek vërtetësia ideore me të cilën ato pasqyrojnë realitetin, tek kontradiktat tipike që shtrojnë e zgjidhin, tek specifika dramatike e konflikteve të tyre e tek realizmi i karaktereve që janë të dalë nga jeta e përfaqësojnë tiparet më të qënësishme të shtresës shoqërore së cilës i përkasin. Ndërkohë për dramën kanë dalë plot probleme të reja, veçanërisht për specifikën e konfliktit dramatik. Ai i lejon dramës, bile, deri diku edhe ia imponon asaj, që të merret me momente kulminante kthesash ose ndryshimesh cilësore në jetën e shoqërisë. Pasqyrimi i realitetit bëhet nëpërmjet një subjekti të shtrënguar në disa kufij, brenda

të cilëve dinamika e ngjarjeve është e shpejtë dhe po ashtu ndryshimet, kthesat apo përmbysjet në jetën e personazheve. Realiteti zbulohet nëpërmjet dialogut, bisedës e debatit të personazheve, ballafaqimit, luftës së opinioneve e normave të kundërta social estetike.

Nga ana tjetër, drama është një «seizmograf» nga më të ndjeshmit ndaj zhvillimit të realitetit të përditshëm dhe kjo e ka fillin prapë tek mundësia për të kapur konflikte të mprehta. Në dramaturgji janë bërë mjaft përpjekje: ka disa drama të ngjitura në skenë që synojnë të sjellin motive nga jeta e sotme si p.sh. «Zonja nga qyteti», «Djem të mbarë», «Era e lartësive», «Lezja», «Shpërthimi», «Djemtë e Bato Gorës», «Buka e duarve tona», «Duar të fuqishme», «Rruga e madhe», «Diell mbi Kastër» etj. Pavarësisht nga niveli e vlerat e tyre relative, ato kanë mbajtur skenën dhe kanë sjellë në të problemet korente. Në këtë pikëvështrim, drama është përpara gjinive të tjera. Atëherë pse bëhet fjalë shpesh për një prapambetje të dramaturgjisë? A qëndron ky shqetësim?

Për mendimin tonë, ai qëndron, natyrisht pa i dhënë përmasa të tepruara, siç ndodh t'i jepen ndonjëherë nga mosnjohja si duhet e dramës dhe sidomos e teatrit. Një nga shkaqet e kësaj gjendjeje duhet kërkuar, sipas mendimit tim, te thellësia e pasqyrimin të kontradiktave, te mënyra e thurjes së konflikteve në këto vepra.

Pasqyrimi me vërtetësi i kontradiktave të jetës, ka të bëjë me karakterin realist e militant të një veprë. Vepra që paraqet kontradikta të paqëna të jetës ose i pasqyron ato në një dritë të shtrembër, nuk është as realiste e jo më militante. Vepra që pasqyron në mënyrë të mangët ose të cekët kontradiktat e jetës, i shmanget deri diku realizmit dhe shkakton një ndjenjë pakënaqësie tek spektatori, i cili, gjithashtu, e njeh jetën e përditshme dhe bile shpesh herë më mirë se krijuesi. Kështu ndodh edhe kur konflikti në jetë është i mprehtë, kurse në skenë zbutet ose, e kundërta, kur acarohet artificialisht, ose kur ai zgjidhet në jetë nga brenda, kurse në dramë nga jashtë, me ndërhyrje etj.

Natyrisht, në veprat më të mira të kësaj periudhe, vërejmë se kontradiktat e jetës janë pasqyruar në mënyrë realiste dhe kjo gjë, përveç nivelit të tyre cilësor, u ka siguruar atyre suksesin. Në këto drama, lufta e klasave jepet në shfaqjet e saj kryesore në mënyrë bindëse. Kështu p.sh. në dramën «Lulet e shegës», «Shënomëni dhe mua», «Flamur në dallgë», kjo luftë është konkrete, nde-

shja me armikun e klasës është e pamëshirshme dhe fitorja është bindëse. Këto drama dhe të tjera, të shkruara kohët e fundit, duke e marrë temën në momente kulminante të historisë së popullit, me të drejtë shtrojnë si primare kontradiktat me armikun. Edhe në drama të tjera, që pasqyrojnë fenomene të jetës së sotme, e gjejmë këtë pikësynim. Megjithatë, duke marrë për ilustrim dy drama, shfaqur në festivalin e fundit të teatrove, do të shtroja ndonjë çështje që ka të bëjë me mënyrën e ndërtimit të konflikteve. Në dramën «Buka e duarve tona» të M. Stefës, shfaqur nga teatri i Vlorës, pasqyrohen konflikte në fshatin e sotëm. Si nënkuptohet nga titulli, problemi themelor i saj është buka, prodhimi në vend i saj. Ngjarjet vendosen në një moment, kur zhvillohet intensivisht lufta për revolucionarizimin e prodhimit bujqësor, pra edhe të koncepteve të njerëzve. Kjo luftë, në sferën e koncepteve, është një luftë ideologjike, luftë klasash, prandaj, me të drejtë, autori ka synuar të japë edhe armikun e klasës. Autori shtjellon konflikte në dy terrene: kundër armikut të fshehur që saboton direkt, dhe në gjirin e popullit, ku antagonistit është një brigadier kapadai. Konflikti me armikun jepet me cektësi dhe nuk dalin rrënjët e koncepteve, kundër të cilëve duhet luftuar. Në këtë aspekt të jetës lozin rol të madh edhe kontradiktat joantagoniste, të cilat duhet të zërthehen e të zgjidhen drejt. Vendosja më mirë e konflikteve edhe në këtë terren, duke e gërshetuar në mënyrë më harmonike me atë kundër armikut të klasës, do t'i jepte dramës një frymëmarrje më të gjerë realiste. Në dramën «Rrënjë të hekurta» të S. Drinit (Teatri «Migjeni») mund të bëjmë fjalë për paraqitjen e armikut të klasës dhe luftës kundër tij, në mënyrë disi të vjetëruar e anakronike. Në këtë dramë, armiku i klasës e ka të shkruar në ballë se është armik. Aq i demaskuar është ky personazh, sa punëtorët nuk e lënë të hyjë as brenda territorit të ofiçinës. Si mund të mbartë ngarkesën dramaturgjike të antagonistit një tip i tillë? Këtu qyrku që i ka veshur autori personazhit, është i dalë bojë, kurse realiteti na sugjeron që armiku i klasës maskohet, ndërrohet lekurë, zakone, forma e marrëdhënie. Deri diku më mirë gërshetohet në konflikt një figurë e tillë tek drama e F. Krajës «Diell mbi Kastër». Në këto dhe në drama të tjera, shpërndarja, grimcimi i konflikteve, është një nga shkaqet e tjera të dobësive të tyre. Nuk është e mundur të mbartë një dramë e vetme gjithë problemet që sugjeron një realitet i caktuar: p.sh., edhe

shpirtin novator e krijues të klasës punëtore, edhe edukimin e njeriut në punë, edhe luftën kundër sabotatorëve, edhe lindjen e dashurisë në bazë të njohjes në punë etj. etj., siç ndodh në disa drama me tema të jetës së sotme. Këtu vendin e konflikteve do ta zënë mikrokonfliktet.

Mundësitë e dramaturgjisë për zbulimin, shtruarjen e zgjidhjen e kontradiktave në jetën e sotme, janë të mëdha. Jeta jonë është dinamike, revolucionare, kthesat e ndryshimet janë të mëdha, në të gjitha sferat e jetës. Le të përmendim se ç'terren i favorshëm janë për dramaturgjinë p.sh. lufta e Partisë sonë kundër revizionizmit e imperializmit, heroizmi në jetë, kapërcimi i vështirësive, raportet e njeriut ndaj punës etj. Në sferën e kontradiktave joantagoniste mundësitë për dramaturgjinë gjithashtu janë të mëdha. Pasqyrimi i tyre nuk është i lehtë. Për të pasqyruar ato, duhet njohje e thellë, e gjerë e jetës së popullit, e gjendjes së punëve në përgjithësi. Dhe kjo «gjendje e punëve» asimilohet duke jetuar realitetin në mënyrë të drejtpërdrejtë e jo tërthore. Në pamjen e parë kjo duket e lehtë, sepse shkrimtari nuk është jashtë rrjedhës së ngjarjeve, po jeta është shumë më e larmishme e komplekse se sa jeta e çdo autori; ajo, herë pas here, e lë atë pas dhe këtë prapambetje autori e zbulon, kur krahason veprën e tij me lexuesin, me jetën.

Një problem tjetër, që rrjedh nga mënyra e ndërtimit të konflikteve dramatike, specifika e vërtetësia e tyre, është edhe ai i karaktereve në veprat dramatike. Konfliktet, qofshin të ndërtuar në bazë të një intrige dinamike, apo në mënyrë më të brendëshme, psikologjike, mishërohen nëpërmjet karaktereve. Pa karaktere të spikatura e realiste, edhe konflikti më i mprehtë e interesant, zbehet e zhvlerësohet. Ndeshen drama p.sh., ku konflikti dramatik është i tendosur sipas të gjitha rregullave, në kulm — (dhe nuk është ndonjë mundim i veçantë ta arrish këtë tendosje), mirëpo, palët që hyjnë në konflikt, mbeben në kufijtë e zëdhënësive të mendimeve të kundërta, pa u bërë karaktere, njerëz që t'i ndjesh e t'i prekësh. Ka edhe raste kur konflikti zhvillohet në mënyrë më të heshtur e më pak të tensionuar, mirëpo ai perceptohet prej spektatorit, sepse janë karakteret që e mbajnë. Kështu p.sh. tek «Fytyra e dytë» (pjesa e parë) konflikti i Bektashit me xhaxhanë (Halilin), nuk është i tensionuar, ai, si të thuash, kalon nëpër nënshtresa, mirëpo është shumë më i arritur artistikisht, sepse karakteret që e mbartin konfliktin kanë individualitet të theksuar.



Ka edhe mjaft raste në drama, kur konflikti dramatik është i zbehtë nga prania e narracionit, përshkrimeve, nga parahistoritë e shumëta që tregojnë personazhet duke dashur të bëjnë biografinë e njëri-tjetrit.

Pra, problemi i konfliktit dramatik, është i ndërvarur tepër nga forca e vërtetësia e karaktereve dramatike, nga bartësit e tij. Në këtë pikëvështrim, ka rëndësi të madhe të pasqyrohen me realizëm heroj pozitivë. Ky hero në jetë është, si të thuash, njeriu i rendimenteve të larta (në punë, në ndërgjegjen shoqërore politike). Ai ndodhet aty ku jeta është më e vrullshme, ku zjen, dhe është pjesëmarrës drejtpërdrejt në zgjidhjen e konflikteve, pra, është bartës konfliktesh. Teorizimet borgjezo-revizioniste thonë se drama është e heroit të lëkundur, që ka një dramë personale për të zgjidhur. Kjo s'është gjë tjetër veçse një shfaqje e filozofisë idealiste të shkëputjes së njeriut nga shoqëria. Drama është plotësisht edhe e heroit pozitiv, e njeriut të përparuar, i cili ka gjithashtu dramë për të zgjidhur, por shumë më të madhe se sa drama e çdo heroit të lëkundur sepse ajo është një dramë shoqërore, zgjidhja e drejtë e së cilës mplekset ngushtë me jetën e tij personale dhe i shërben jo më individit, por shoqërisë, ideologjisë së saj revolucionare. Përkundër dramës së njeriut që rropatet midis së mirës e së keqes, heroit pozitiv ka dramën e luftëtarit, që ndeshet për ideale të larta, që lufton, vuan, bile edhe sakrifikohet për triumfin e tyre.

Në skalitjen e herojve pozitivë, letërsia jonë ka sukses të dukshme në shumë gjini, midis tyre edhe në dramaturgji. Le të kujtojmë figurën heroike të Cucës, ose në dramën e viteve të fundit: Lajen të «Lulet e shegës», apo personazhet pozitivë tek dramën «Njeriu me top» (Murati), «Me gjuhën e pushkës» (Qazo Farka) etj., po ashtu edhe në vepra me temën e sotme. Por vërehen edhe mjaft dobësi në skalitjen e herojve pozitivë. Shpesh ata nuk e kanë mishin e gjakun e njerëzve, janë skematikë e anemikë mirëpo përkundër kësaj anemie letrare, bëjnë deklarata të bujëshme. Nganjëherë, ky hero nuk ka dramë fare, ai inkadrohet në rolin e arbitrit që jep këshilla, zgjidh situatat e të tjerëve dhe pastaj largohet në punë të vet. Kështu p.sh. edhe tek drama e mirë «Shënomëni edhe mua», sekretari i Partisë vjen e ikën menjëherë, pasi jep disa këshilla. Një dobësi tjetër e këtyre figurave është gjuha e tyre, e cila më pak se çdo gjë është gjuha e tyre, pra individuale. Ata i mundon deklarativizmi, slloganet, frazat e gatshme e me zhurmë. Me siguri herojve të vërtetë,

u skuqen veshët kur dëgjojnë që nëpërmjet gjuhës së tyre, këshillat jepen me fraza të tilla.

Popullariteti që gëzon drama tek ne është i madh. Gjitha gjinitë e letërsisë janë të bukura, por drama ka një privilegj, — jetën e skenës që, nga komunikimi, është masiv. Pohimi i këtij fakti duhet të rritë përgjegjësinë e autorëve që merren me këtë gjini dhe duhet të tërheqë edhe krijues të tjerë me përvojë e të afirmuar në gjinitë e tjera, edhe drejt dramës.

## PASQYRIMI I DREJTE I KONTRADIKTAVE NE LETERSI

Periodha midis dy Kongreseve e pas Plenumit të 4-të karakterizohet nga një zhvillim i ndieshëm në të gjitha llojet e gjinitë, gjë që duket edhe në zbulimin dhe zgjidhjen më të drejtë të kontradiktave.

Po të shohim shkurtimisht arritjet dhe disa probleme që dalin, nga kjo pikpamje, në gjinitë e ndryshme letrare, do të vemë re p.sh. se në kuptimin, që folëm, poezia jonë ka ecur pas gjurmëve të saj më të mira dhe ka njohur suksese. Në forma të përgjithësuara e sintetike, si edhe përmes episodesh e faktesh konkrete, poetët tanë më me përvojë e më të rinj kanë pasqyruar drejt partishmërinë dhe kontradiktat e kohës, duke e vënë më tepër theksin tek ato antagonistë. Kjo ndodh sepse poezia jonë është militantë e polemizuese, ajo ngrihet kundër botës borgjeze-revizioniste dhe pohon me forcë realitetin tonë. Është karakteristikë se në poemat tona të kohëve të fundit lidhet në një lufta e popullit dhe e Partisë kundër armiqve të djeshëm e të sotëm dhe theksohet, përmes fjalës poetike, gatishmëria revolucionare e popullit. Rrahja e mendimit dhe zotërimi i ndjenjës pozitive, antagonizmi, bashkudhëtar i çdo kohe në shoqërinë me klasa, siç është zbuluar nga Marksi e Engelsi që në Manifestin komunist, e siç

tha shoku Enver kur foli për problemet e artit në 20 dhjetor 1974, këto hyjnë në themel të poezisë sonë, më të mirë si edhe të gjinive të tjera; le të kujtojmë poema si «Nënë Shqipëri» e D. Agollit me përmasa të gjëra të plotësuar më mirë në variantin e tanishëm, poema të Ll. Siliqit, për të cilin ka qenë organike poezia qytetare si «Mesazhi» etj, «Drejt qindra shekujsh shkojmë» e F. Arapit, vëllimi me poezi «Koha» i I. Kadaresë me karakter militant e kombëtar e gjer te poema të më të rinjve si «Buka e tokës së lirë» e Xh. Spahiut, poezi të V. Qurkut, N. Gjetjes, Ll. Rucit, Q. Shemaj etj. Midis të tjerash desha të përmend, për motivin e saj një poezi të Ll. Rucit kush-tuar revolucionares paraguajane, Margarita Baez, që u torturua nga reaksioni dhe nuk erdhi dot në Kongres. Ne kemi tradita të temave të tilla të internacionalizmit proletar, që duhet të zhvillohen edhe më tej.

Për poezinë është e nevojshme të thuhet se tani ka koncepte më të qarta që janë në kundërshtim me shikimin tepër të përgjithshëm dhe disi përshekruar të realitetit. Natyrisht, poezia jonë është në radhë të parë, afirmative, por ideja e unitetit tregohet më mirë përmes rrugës së kontradiktave, përmes vështirësive dhe kapërximit të tyre.

Drama është gjinia ku spikat ndofta, më tepër se kudo konflikti. Dhe, siç është pohuar, pas Plenumit të 4-t e këtej, ajo ka ecur përpara edhe në aspektin për të cilin flasin. Në trajtimin dhe zgjidhjen e drejtë të kontradiktave drama të kohëve të fundit si «Gjëmimi i atij dimri» e T. Laços, «Lulet e shegës» e K. Jakovës, «Shënomëni dhe mua» e H. Minarollit, «Djem të mbarë» e F. Krajës etj. kanë sjellë në skenë pamje të jetës dhe konflikte të përiudhave të ndryshme të ndërtimit të socializmit.

Me gjithë arritjet, është e nevojshme të thuhet se prej kësaj gjinie pritet shumë më tepër, sepse drama dhe teatri janë mjete të fuqishme të mbrojtjes së ideve të Partisë, komunikojnë drejtpërdrejt me spektatorin dhe ndihmojnë në edukimin e masave. Lidhur me interpretimin më të thellë të jetës, sidomos në dramë, me tipet e konflikteve që shquhen sot me konceptimin ideologjik të tyre, dalin probleme që meritojnë vëmendje të veçantë.

! Së pari, është e domosdoshme që zbërthimi i problemeve të realitetit, i ndeshjes së të kundërtave, sidomos në gjinitë epike, po edhe në gjithë krijimtarinë të kuptohet më në thellësi, me një tendencë të qartë, e cila duhet të gërshetohet më mirë me faktet reale. Një qëndrim dhe



pikëpamjeje dramë quhet vetëm ajo kur ka dilema të bren-  
dëshme një njeri dhe po u zgjidh kjo dilemë, vetëvetiu  
duhet të mbarojë edhe vepra. (Ky problem është trajtuar  
në kritikën tonë) Edhe vepra të tilla kanë të drejtën e vet  
kur nuk kalohet në drama të heroit të lëkundur, sepse  
është fjala për të formuar njeriun, për ta spastruar atë  
shpirtërisht. Po problemi nuk mund të shtrohet gjithmonë  
kështu. Dramat personale mund të gjejnë një zgjidhje në  
gjirin e shoqërisë dhe të jenë në harmoni me problemet  
e përgjithëshme. Një dramë, siç dihet, mund të ketë një  
problem të madh që përbën konfliktin kryesor dhe kon-  
flikte të dorës së dytë, të cilët lidhen me të natyrshëm e  
jo artificialisht. Kështu te «Gjëmimi i atij dimri» që u  
përmend, nuk mund të thuhet se drama mbaron me zhduk-  
jen e luhatjeve shpirtërore të Hodos (një nga personazhet  
qendrore), sepse konflikti është më i gjerë: fshati, masa e  
fshatarëve kundër gjermanëve e ballistëve, figura e parti-  
zanes që kërkohet etj. Po kjo gjë ndodh edhe me dramën  
«Shënomëni dhe mua», ku nuk mbaron konflikti që nga  
çasti kur Rustemi (një personazh që hesitonte të hyjë në  
kooperativë), vendos të futet, sepse problemi shtrohet më  
gjerë (ka të tjerë që nuk kanë hyrë). Në të dy dramat ske-  
nat masive me ato të veçantat janë të pranishme dhe kon-  
flikti merr përpjestime më të gjera. (Natyrshët edhe për  
këto drama, si për të tjerat, mund të bëhen vërejtje për  
mjeshtrinë, etj.) Të gjitha këto nuk duan të thonë se kon-  
fliktet duhet të mbeten amorfe dhe të pakonkretizuara në  
vepër e situata, përkundrazi. Puna është për një kuptim  
më të drejtë të tipeve të konflikteve që na ofron jeta dhe  
krijimtaria e realizmit socialist dhe për të kuptuar më  
thellë prirjen e dramës drejt evoluimit.

Përvetësimi i mësimëve të Partisë e të shokut Enver,  
njohja më e thellë e jetës, e proceseve të revolucionit, dis-  
kutimi konkret i veprave artistike, do të shpien në një in-  
terpretim dhe zgjidhje më të plotë e më të saktë të këtij  
problemi, duke shtuar dramaticitetin dhe militantizmin e  
veprave tona.

## FRYMEZIMI MILITANT E I PARTISHEM I POEZISE SONE

Për të kuptuar e zërthyer më mirë ecurinë e fe-  
nomenit artistik, është e nevojshme që nga rrje-  
dha e botimeve të përditshme, të veçojmë e të anali-  
zojmë ato më të mirat, më të goditurat e më të bukur-  
rat. Janë pikërisht krijimet më të mira ato, që ashtu si  
një qelizë përmban më vete gjithë tiparet e funksionet  
e zhvillimit të jetës, ato përmbajnë në vetëvete anët më  
pozitive, drejtimet dhe tendencat kryesore të zhvillimit  
të poezisë, po ashtu mund të kapen më shkencërisht e  
më thellë edhe anët negative, apo edhe ato shfaqje të  
huaja, që çënojnë brendinë e shëndoshë. Studimi në  
arritjet më të mira të krijimit artistik i jep mundësi  
edhe mendimit kritik, që problemet që ai shtron para  
krijuesve e para vetes të mos jenë të vjetëruara, të ezau-  
ruara për procesin krijues, dhe e ndihmon atë, që edhe  
ai vetë, mendimi kritik, të renditet me vijat e para, të  
luftojë aktivisht për të sugjeruar një zhvillim të vërtetë  
të letërsisë dhe të vetë kritikës letrare.

E parë kështu, periudha që nga Plenumi IV i KQ të  
Partisë, prej fjalimit programatik të shokut Enver e gjer  
më sot, karakterizohet nga suksese edhe në poezi. Me  
krijimet e tyre më të mira gjatë kësaj periudhe kanë  
kontribuar poetë me një stazh të mirë krijimi, si Dritero

Agolli, Ismail Kadareja, Llazar Siliqi, Fatmir Gjata etj., ashtu si edhe të tjerë, me një stazh më të ri, si Xh. Spahi, N. Pappleka, R. Marku, K. Petriti, N. Gjetja, B. Londo etj.

Krijimet më të mira të kësaj periudhe tregojnë udhën e shëndoshë që ka ndjekur e ndjek poezia jonë, luftën kryesore të saj në dy drejtime: në drejtim të pastrimit të saj nga çdo ndikim i huaj liberalo-revizionist, dhe në drejtim të forcimit të mëtejshëm të lidhjeve, të përvetësimit të natyrshëm të tipareve më progresive të poezisë sonë të kaluar demokratike kombëtare. Si të thuash, zisë sonë të kaluar demokratike kombëtare. Si të thuash, nëpër damarë të poezisë sonë të re, më lirshëm dhe më i vrullshëm qarkullon gjaku i poezisë së N. Frashërit, De Radës, Migjenit etj.

Ky proces u shoqërua dhe u zhvillua më tej edhe nëpërmjet lidhjes më të drejtpërdrejtë dhe më të ndërgjegjshme me poezinë popullore. Poetët tanë e kuptuan më thellë, se jo vetëm që është në të mirën e tyre, por është në të mirën e vetë krijimit poetik, që ata të njohin më mirë e ta shfrytëzojnë në mënyrë më krijuese poezinë e madhe, që populli ynë ka krijuar në shekuj. Konceptimi poetik popullor, sistemi figurativ e ritmik i pasur, fjala poetike popullore, i erdhën në ndihmë drejtpërsëdrejti poezisë sonë të realizmit socialist, i dhanë asaj shpirt e fizionomi më të theksuar popullore e shqiptare. Këtë tendencë, është detyra jonë ta çojmë më tej.

Rezultat i këtij procesi është edhe poema madhore «Nënë Shqipëri». Do të ishte gabim, në qoftë se atë do ta shihnim si një rast të veçantë dhe si një arritje thjesht individuale e poetit. Në art — dhe jo vetëm në art — arritjet më të mira, sintezat artistike, në kuptimin e veprave të krijuara, nuk janë thjesht rezultate të mundimeve individuale të krijuesve. Kush e sheh çështjen ashtu, ai gabon. Edhe në ekonomi rendimenti dhe cilësia e prodhimit, nuk janë tregues thjesht individualë. Ata janë tregues shoqërorë. Poema «Nënë Shqipëri», ashtu si dhe krijimet e tjera poetike më të mira të kësaj periudhe, mishërojnë në vetvete atë frymëzim militant e të partishëm, atë konceptim të gjerë popullor, atë realitet jetësor socialist, ato përpjekje e mundime për një ngritje të mëtejshme ideo-artistike, për të cilat, nën udhëheqjen e Partisë, u angazhua e gjithë poezia jonë në këtë periudhë. Në këtë poemë tiparet më pozitive të poezisë së mëparshme të autorit — lidhja e tij me

baltën e vendit, besimi në idealet e komunizmit, dashuria për popullin, fryma polemiste, ndjenja e humorit etj., — janë zhvilluar më tej, kanë fituar hapësira më të mëdha dhe, të shkrira me detyrat e reja historike dhe realitetin tonë shoqëror, — na dhanë këtë poemë, që është, pa dyshim, një nga arritjet më të mira të poetit dhe që sintetizon anët më pozitive të poezisë sonë në këtë stad të zhvillimit të saj. Këtë fenomen ne e shohim edhe në krijimet më të mira poetike të kësaj periudhe të Ismail Kadaresë, Llazar Siliqit, Fatmir Gjatës, apo tek dy poemat e fundit të Xh. Spahiut, etj.

Por në qoftë se kemi patur këto suksese, nuk do të thotë se gjatë kësaj periudhe poezia jonë nuk ka patur të meta e dobësi që na bëjnë të shqetësohemi. Sukseset e poezisë sonë tregojnë se poetët tanë kanë bërë përpjekje e gjithnjë e më mirë e kanë përvetësuar botëkuptimin materialist dialektik të klasës punëtore, mësimet e Partisë e të shokut Enver. Po, në të njëjtën kohë, duhet të pranojmë se pikërisht në botëkuptimin e disa poetëve shfaqet një farë mungese, e cila me gjithë përpjekjet e mira, nuk i lejon ata akoma të pasqyrojnë artistikisht gjithë atë dinamizëm jetësor, atë intensitet e ashpërsi të luftës klasore, ato tablo të gjera e atë zhvillim të botës shpirtërore të njeriut të ri, — që karakterizojnë jetën tonë dhe që kushtëzojnë, midis të tjerash, edhe zhvillimin e vetë poezisë. Tanimë, në fazën e caktuar të zhvillimit tonë ekonomiko-shoqëror, si dhe në stadin ku gjendet poezia, zhvillimi i mëtejshëm i saj është e do të jetë i lidhur drejtpërsëdrejti me përvetësimin gjithmonë e më thellë të filosofisë marksiste-leniniste, botëkuptimit shkencor të klasës punëtore. Është e vërtetë që nuk është vetëm tema e klasës punëtore ajo që përmbledh gjithë poezinë e realizmit socialist, por gjithashtu është e vërtetë, se as që mund të bëhet fjalë për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj poezie të realizmit socialist, jashtë dhe pa temën e klasës punëtore. Nuk flas vetëm për qytetin, që është e kuptueshme, por edhe vendosja e perfeksionimi i marëdhënieve të reja në fshat, do të thotë edhe transformim rrënjësor i botëkuptimit dhe jetesës së fshatarësisë kooperativiste, futja gjithnjë e më shumë e mendimit materialist punëtor në të konceptuarit e fenomeneve të jetës dhe të formimit të psikologjisë së re socialiste. Kështu që jo vetëm tema e mirëfilltë mbi klasën punëtore, por cilado temë tjetër, çdo aspekt e fenomen i jetës, nuk mund të pasqyrohet me një nivel të

lartë artistik, pa një përgatitje të mirë e të shëndoshë filozofike e kulturore materialiste.

Gjatë periudhës historike që po diskutojmë, vendi ynë, nën udhëheqjen e Partisë e të shokut Enver, zhvilloi një luftë të ashpër kundër revizionizmit modern, u forcua roli udhëheqës i klasës punëtore në revolucion, u bë një mobilizim i përgjithshëm i forcave materiale, shpirtërore e morale të popullit për ndërtimin e shoqërisë socialiste. Poezia nuk mundi të ecë sa duhet me këto ritme të zhvillimit të jetës. Monotonia e mendimeve klinike që ndeshen në poezi të ndryshme, një përsëritje e po atyre temave, madje, edhe e po atyre mendimeve e figurave, deklarativizmi herë herë bajat, inflacioni i fjalës, një farë historizmi naiv e primitiv që ndeshim ndonjëherë, karakteri ilustrativ etj., tregojnë, ndër të tjera, edhe mungesën e një kulture të plotë materialiste.

Lenini thoshte se komunisti duhet të përvetësojë gjithë kulturën përparimtare që ka krijuar njerëzimi. Neve poetëve të realizmit socialist, na duhet të përvetësojmë këtë kulturë, që pastaj të krijojmë poezinë, që është gjithashtu kulturë. Nuk mund të krijohet kulturë, pa kulturë. Njohja e jetës, të jetuarit me popullin, rrahja e zemrave të poetëve për zemrat, luftërat, përpjekjet dhe hallet e njerëzve të thjeshtë, — duhet kuptuar gjithashtu edhe si një kulturë e gjallë, e domosdoshme, vitale për krijuesin. Prandaj shoku Enver porositi që të mësojmë të lëçitim librin e madh të jetës. Njohja e jetës nuk bëhet si një qëllim në vete. Ata që nisen kësh-tu, që dalin të bëjnë nga një «peripato», qoftë kjo edhe njëmuje, gjashtëmuje, apo njëvjeçare, por që mbetet prapë një shtetitje, — në të vërtetë, këta nuk arrijnë kurrë ta njohin jetën. Njohja e jetës, zhytja e poetëve në rrjedhën e vrullshme të jetës së njerëzve të thjeshtë, është vitale për ta, në radhë të parë, për të krijuar vetë ata një bagazh sa më të pasur jetësor, horizonte e njohuri të gjera mbi jetën, konceptione të drejta materialiste mbi zhvillimin e fenomeneve shoqërore. Gabon ai krijues, i cili mendon se, duke shkuar një farë kohe «poshtë», bën detyrën para klasës punëtore. Në radhë të parë, ai bën detyrën ndaj vetes. Klasat nuk gabojnë. Dhe klasa punëtore, edhe me intuitën e vet klasore e ndjen se sa me të vërtetë çdo qelizë e mendimit, çdo qelizë e veprës, çdo qelizë e karakterit dhe e formimit të personalitetit të krijuesit, është e saj, e klasës punëtore.

Në disa krijime poetike bie në sy një konceptim metafizik, herë herë një shmangie të kontradiktës. Nuk jepen sa duhet lufta, përpjekjet, zikzakët. Duket sikur fitoret arrihen lehtë. Kjo zbeh realizmin, frymën luftarake dhe krijon një lustër të dëmshme.

Kështu, p.sh., lexojmë ndonjëherë vjersha, ku i këndohet nizamit njësoj si komitetit të çetave të Rilindjes, i këndohet Gjo Lekës njësoj si Bajram Currit, etj., pa shkallëzimin me përmbajtjen e epokave historike, që ata përfaqësojnë. Po kështu, rastis që t'u këndohet ambienteve punëtore, duke i përqsaur me elemente mitologjike, duke menduar se kështu nxjerrim më në pah madhësinë dhe heroizmin e ditëve tona, po në fakt e primitivizojmë dhe e minimizojmë atë.

Poezia jonë do të vijë duke u thelluar e duke forcuar botëkuptimin e saj marksist-leninist, sa më tepër të ngjishet me jetën dhe me mendimin e Partisë.

## PER NJE PASQYRIM ME TE DREJTE TE FIGURES SE GRUAS NË LETERSI

Vetë jeta e shoqërisë sonë ka dëshmuar e dëshmon për rolin e madh që ka luajtur e luan gruaja shqiptare në të gjithë jetën e vendit. Këtë rol duhet ta pasqyrojë sa më mirë edhe letërsia.

Në vitet '50, po edhe më parë, letërsia jonë e realizmit socialist e paraqiti zgjimin e madh të gruas shqiptare, daljen e saj në jetën politike, në jetën prodhuese shoqërore si një fitore të madhe. Autorët e veprave të ndryshme, të botuara në vitet e mëvonëshme si «Cuca e maleve», «Një lindje e vështirë», «Kullat», «Dasma», «Fisheku në pajë», etj., në figurat e grave mishëruan ndryshimet e mëdha cilësore që po ndodhnin në jetën e tyre, sidomos luftën e madhe ideologjike të udhëhequr nga Partia për emancipimin e plotë të gruas. Veprat që dolën pas këtyre shënuan një hap tjetër përpara në trajtimin e figurës së gruas, sepse e sjellin në një plan më të gjerë. Autorët e japin atë jo vetëm se si transformohet në rrjedhën e revolucionit, por edhe si forcë që e çon atë përpara, që përpiket kudo të japë kontributin e saj, siç e gjejmë në romanet «Tokë e ashpër», «Juga e bardhë», «Zbulimi», «Mars», «Rruga Budi 723», «Dueli i madh», në dramën «Lezja», në vëllimin me poezi «Marsi brenda nesh» apo në filmin «Fije që priten», në komedinë «Zonja nga qyteti» etj. Edhe në shumë vepra, ku trajtohet tema e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, te «Komisari

Memo», «Kohë lufte», «Gjëmimi i atij dimri», «Nusja dhe shtettrrethimi», etj. tingëllon aktuale trajtimi i figurës së gruas si një forcë që luan rol të rëndësishëm në zgjidhjen e problemeve të mëdha që preokuponin popullin atëherë e tani — çlirimi i vendit, mbrojtja e lirisë dhe e pavarësisë.

Vlen të vihet në dukje se tani kemi mjaft vepra me të cilat janë kapërcyer disa dukuri negative që viheshin re më parë si shtjellimi skematik i konfliktit brenda jetës familjare, midis burrit e gruas. Tani shohim në vepra të ndryshme të pasqyrohet gjithnjë e më mirë fakti i madh i realitetit socialist se problemet e familjes janë edhe të krejt shoqërisë dhe anasjelltas.

Pasqyrimi në rritje i personalitetit dhe i rolit të gruas në letërsi flet edhe për një kuptim më të drejtë nga ana e shkrimtarëve të punës dhe vendit të saj në shoqëri, për një njohje më të mirë të problemit të saj. Kjo ka një rëndësi të madhe jo vetëm për vendin tonë, sepse pasqyron drejt një realitet, nxit, frymëzon dhe edukon njerëzit tanë, por edhe për lëvizjen komuniste revolucionare në botë. Sot, kur ideologë e teoricienë borgjezë e revizionistë mbjellin e shpërndajnë konfuzion mbi aftësitë e kufizuara të gruas, mbi inferioritetin e saj, kur letrarë të panumërt epërsinë e burrit mbi gruan e kanë kthyer në mit, kur teori të ndryshme reaksionare, duke synuar ta kthejnë gruan në shtëpi, ta mënjanojnë nga çështja e proletariatit, bëjnë fajtor burrin, fëmijën për gjëndjen e saj të mjeruar, trajtimi i drejtë i kësaj teme, i rolit të gruas në revolucion e në ndërtimin e socializmit, është një detyrë e rëndësishme e letërsisë dhe e arteve tona.

Në Kongresin e 7-të të PPSH shoku Enver Hoxha tha: *Gruaja shqiptare ka dalë në arenën e luftës për socializëm plot dinjitet, shquhet për frymë të lartë revolucionare, për vendosmëri e patriotizëm, dallohet në punë e në jetë.*

Me gjithë sukseset e arritura në trajtimin e figurës së gruas, shtrohet pyetja: A e ka paraqitur, siç duhet, të plotë, letërsia jonë këtë grua të re, të kalitur nga Partia në luftën revolucionare të të gjithë popullit?

Mendojmë se pasqyrimi i figurës së gruas në letërsi nuk i përgjigjet kurdoherë ritmeve të zhvillimit të shoqërisë. Në jetë e gjen shpesh gruan që të frymëzon me punën e saj, me cilësitë e saj të mrekullueshme, me gatishmërinë e shpirtin e sakrificës, gruan me dije e aftësi të mëdha, me personalitet të gjithanshëm. Po një grua të tillë pak e gjen të pasqyruar në letërsi. Këtë mendim e kanë shfaqur edhe mjaft lexues në biseda, e takime

të ndryshme. Dikush, për ta ilustruar mendimin e tij nisi të citojë fragmente nga një artikull i botuar në gazetën «Drita» mbi figurën e komunistit, ku në vargun e një sërë personazhesh dinjitozë gjeje vetëm një grua. Dhe kjo vërejtje nuk ishte në adresë të gazetës, as të autorit të artikullit, por të shkrimtarëve që nuk e kanë pasqyruar ashtu si duhet figurën e gruas. Edhe pse janë bërë hapa për të kapërcyer disa dukuri negative, që ishin të dukëshme para një dekade, p.sh., ndarja e roleve të burrit e të gruas — aty ku flitej për punë, për mendim krijues, ishin burrat kryesorët; aty ku flitej për luftën kundër zakoneve prapanike, ishin gratë, — përsëri mbetet për të bërë në këtë drejtim. Sidomos, duhet të na tërheqë vëmëndjen romani dhe drama, në të cilët akoma i gjejmë këto shfaqje të skematizmit, që janë ushqyer edhe prej një lloj subjektivizmi.

Në romanet «Përsëri në këmbë», «Fan Smajli», «Përballimi», «Nesër do të jetë vonë», etj. gjen personazhe qëndrore të goditura, që mishërojnë njeriun tonë të ri, të kalitur në betejat për ndërtimin e socializmit. Kjo, kuptohet, është gjë e mirë. Por mendojmë se figura e gruas duhet të zëjë një vend më të madh në letërsi edhe si figurë qëndrore. Në qoftëse se në dramën «Gjëmimi i atij dimrit», «Lulet e shegës», në komedinë «Zonja nga qyteti» e në ndonjë tjetër përgjithësohet drejt e me realizëm figura e gruas, këtë gjë nuk e gjejmë në shumë vepra të tjera dramatike. Kështu, në mjaft drama të dorëzuara vjet në konkurs, ku autorët synonin të ngrihnin probleme të gruas, vëreheshin dy të meta: emancipimi i gruas jepej si qëllim më vete, i shkëputur nga problemet e tjera të shoqërisë, dhe e dyta, kjo luftë, nga që nuk kuptohet gjithmonë si një aspekt i rëndësishëm i luftës së klasave, jepej cekët, pa konflikte të mprehta e të thella.

Ka raste që mendimi përgjithësues filozofik i Partisë për problemin e gruas nuk zotërohet tërësisht nga të gjithë krijuesit tanë. Prandaj, ndodh që në disa vepra, sidomos novela, tregime, por edhe romane, duke trajtuar problemin e luftës për emancipimin e gruas, jepen momente e detaje anësore, jo kardinale, problemi trajtohet i thjeshtëzuar dhe vetëm sa ilustrohen disa ide të njohura. Kurse dihet, shkrimtari shikon dukurinë shoqërore në zhvillim, përgjithëson tipiken dhe jep tendencën e zhvillimit. Kështu, vepra mbetet e freskët, aktuale, të xhit e të frymëzon.

Krahas trajtimit më dëndur të problemeve të emancipimit të gruas, duhet parë dhe problemi i figurës së gruas si hero pozitiv, që përmban në vetvete tiparet më të mira të njeriut të ri sot dhe cilësitë e njeriut të nesërm. Për këtë, duhet theksuar me forcë se jeta jonë shoqërore jep material të bollshëm, që gruaja të trajtohet gjërësisht si hero pozitiv. Po ashtu, nga ana tjetër, heroin pozitiv ne nuk mund ta kuptojmë edhe pa ato veti të njeriut të ri, që shprehen edhe në marrëdhëniet e drejta njerëzore, që po vendosen çdo ditë e më mirë midis burrit e gruas, në punë, në familje e në shoqëri. Kështu, në qoftë se ka një farë javashllëku në paraqitjen e këtyre dukurive, ka njëkohësisht dhe një farë ngurimi për t'i paraqitur më shpesh përfaqësueset e së resë në krijimtari. Ngurimi këtu vjen nga mungesa e inisiativës, nga paqartësia e problemit, por dhe nga një farë konservatorizmi që vërehet te ndonjë shkrimtar, redaktor e kritik. E themi këtë, pasi ka ndodhur që edhe kur jepen figura grash me tipare të reja, të fituara në luftën e përditshme për ndërtimin e socializmit, siç është qëndrimi parimor ndaj çdo problemi pa marrë parasysh interesat vetiake, familjare e bashkëshortore, nuk bëhen përpjekje sa duhet për të kuptuar tamam idetë që ka dashur të shprehë shkrimtari përmes personazhit në veprën e tij. Kam parasysh Shpresën tek romani «Juga e bardhë», që u quajt «e parakohshme». Po ja që realiteti ynë sot ka pohuar sa e sa Shpresa të tjera!

Mendime të tilla të shpejtuara janë shfaqur edhe për figurën e Merita Lisit, në romanin «Dueli i madh». Pavarësisht nga disa të meta në realizmin artistik të kësaj figure, nuk është e drejtë të qëmtojmë disa fraza tek debati i Meritës me të shoqin për t'i vënë etiketën «skematike», duke mos parë kryesoren te kjo figurë interesante dhe e besueshme. Merita nuk pranon mendimin e të shoqit që gabimi është bërë nga nxitimi. Dhe inxhinier Dafa i gjendur nën presionin e heroizmit masiv dhe qëndrimin të palëkundur e të partishëm të së shoqes, në këtë rast do të thosha të shoqes së vërtetë të jetës, bëhet i ndërgjegjshëm për gabimin e tij. Çfarë ka këtu të pranueshme?

Debate ka ngjallur edhe Ema e romanit «Rruga Budi 723». Edhe në realizimin e kësaj figure nga ana artistike mund të ketë ndonjë të metë, për të mund të diskutohet, por në asnjë mënyrë nuk mund të mendohet se «skematizmi» i saj qëndron në përsosmërinë si njeri. Ema është



vajzë e kohës, e drejtë, e çiltër, parimore, me ideale të mëdha, me një fjalë një vajzë me personalitet, që nuk pajtohet kurrsesi me ngushtësinë mikroborgjeze. Përse do të quhej kjo e re revolucionare e «avancuar»? Tiparet e reja që mbartin Emat, Shpresat dhe Meritat janë një realitet objektiv. Ato egzistojnë në jetën tonë. Dhe ky është një fakt i gëzueshëm. Përveç të tjerash, dihet botërisht detyra e shkrimtarit të realizmit socialist për të sjellë në faqet e librit të tij, jo vetëm të sotmen po edhe të nesërmen.

Duhet të na preokupojë edhe një problem tjetër lidhur me figurën e gruas. Me gjithë sukseset që kemi arritur në trajtimin e saj në skeçet, kupletet apo monologjet në estrada, në se më parë na shqetësonte fakti që në mënyrë banale jepej gruaja llafazane, thashethe-mexhie, tani është kaluar në një ekstrem tjetër — gruaja e përsosur dhe në mënyrë skematike. Ajo gjen gabimet e burrit, të drejtorit, të shokut të punës dhe është pa asnjë të metë. Nuk është vendi këtu të zgjatemi për trajtimin e heroit pozitiv në satirën e humorin tonë. Por duhet thënë se, edhe në këtë sferë, figura e gruas duhet të pasqyrohet me realizëm, sepse, pikërisht, paraqitja realiste thyen edhe kornizat skematike edhe ato idealizuese e të meta të tjera.

Më lart thamë se vërehet, në disa raste, një farë zbutje në pasqyrimin e luftës së klasave, që kanë të bëjnë me çështje të emancipimit të gruas. Ka raste në ndonjë novelë, tregim dhe dramë që i japin të kuptojnë lexuesit që në fillim rrjedhën e ngjarjeve. Kjo ndodh edhe për shkak të konceptimit të sipërfaqshëm nga ana e shkrimtarit të problemeve, por edhe për faj të redaktorëve botues, sepse edhe ata, për të qenë brenda, (nga që pak i njohin këto çështje), bëjnë propozime të tilla, që ndonjëherë e çorientojnë shkrimtarin.

Përse të ketë ngurrime kur shkrimtari tregon se lufta e klasave te ne zhvillohet e ashpër dhe ndonjëherë s'kalohet pa dhëmbje, e prapë e reja gjithmonë del fitimtare? Përse të mos themi se në këtë luftë edhe pse ndonjëherë diçka humbasim, fitojmë një botë të tërë?

E theksova këtë problem se edhe në trajtimin e problemit të emancipimit të gruas, si një luftë me karakter ideologjik, ku ndeshja midis forcave të kundërta është vërtetë e ashpër, ka ndonjë shfaqje të zbutjes së kontraktave, gjë që dëmton sa paraqitjen realiste të dukurisë, aq edhe figurën e gruas sonë.

## ASPEKTE TE MBESHTETJES NE FOLKLOR

Mbështetja krijuese në folklor është një ndër treguesit e novatorizmit të letërsisë sonë. Gjithashtu, kjo mbështetje shërben si një ndër argumentët e shumtë të novatorizmit të vetë folklorit, i cili zhvillohet dhe jep material të pasur e mundësi të mëdha për të thelluar e forcuar origjinalitetin kombëtar të letërsisë. Prandaj letërsia jonë e ka patur dhe e ka domosdoshmëri mbështetjen në folklor. Pas Plenumit të 4-t të KQ të Partisë, ndriçuar prej tij dhe prej mësimëve të shokut Enver, mbështetja në folklor u fuqizua, u pasurua përvoja kolektive dhe ajo e individualiteteve të ndryshme. Kjo mbështetje ishte dhe është faktor i rëndësishëm në luftën kundër ndikimeve të huaja.

Janë luftuar teorizimet që pretendonin rënien në folklorizëm, arkaizëm, përmes mbështetjes në folklor. Ne kemi folur për rënie në modernizëm, rreziku i të cilit egziston. Ndonjë ndikim i tillë është shfaqur në poezi, tek përshtatja e konceptit të mbijetesës, metamorfozës, tek prirja për të përzier mitin me realitetin. Këtë të fundit mund ta gjejmë dhe në ndonjë krijim në prozë, në rastet kur merret ndonjë element nga folklori, historia, psikologjia e një populli tjetër. E kjo ka ndodhur jo për shkak të elementit vetë, por pse autori

nuk e ka përdorur atë drejt. Ndërkohë, janë përdorur drejt elemente e simbole si *maratonomaku*, *kali i Trojës*, që janë të pëlqyeshme e të përshtatur shijeve ideoestetike të masave, lexuesit tanë. U ndalëm në këtë pikë, jo për të nënvleftësuar shfaqje të ndryshme të arkaizmit që mund të vërehen edhe tani, dhe as për të egzagjuar ndikimet moderniste në praktikën tonë artistike, në poezi. U ndalem për të kuptuar e theksuar më fort rëndësinë që ka tendenca me të cilën krijuesi i drejtohet folklorit. Por, kur kjo tendencë është e shëndoshë (siç është tipike për krijuesit tanë), nuk mund të nënvleftësohet psikologjia artistike me të cilin i drejtohet folklorit krijuesi. Ka një mentalitet në përtëritje, në zhvillim te autorët, kur mbështeten në folklor te «Devoll, Devoll» apo «Nënë Shqipëri», «Përse mendohen këto male» apo «Shqipëria dhe tri Romat», «Drashovica» apo «Alarme të përgjakura», «Firma e popullit tim» apo «Ura e Bushtricës», «Baladë shqiptare për Leninin» apo «Buka e tokës së lirë» etj. Po kështu nuk mungojnë raste kur, pas një krijimi interesant, mbështetur mirë në folklor, ka ardhur një krijim tjetër, ku kjo mbështetje nuk ka dhënë frytin e dëshiruar, pikërisht pse krijuesi nuk i është drejtuar folklorit nga një këndvështrim i ri. Këndejuam të kalojmë tek nevoja e të kuptuarit mirë të evoluimit të psikologjisë artistike popullore, lidhur ngusht e ndërvarur nga psikologjia shoqërore — kusht për të dalluar e kapur vlerat e reja apo elementet më dinamike të folklorit. Me këtë moskuptim dhe me njohjen e përjetimin e pamjaftueshëm (e jo me pakicën e modeleve të shquara, siç mund të pandehet), duhet shpjeguar mbështetja e pamjaftueshme në krijimtarinë popullore të Pasçlirimit, në psikologjinë socialiste që u rrënjos në të. Mentalitetin e prapambetur ne e shikojmë dhe në atë që, mbështetja në folklor, bëhet ose quhet e nevojshme, kryesisht, në krijime që flasin për të kaluarën dhe për fshatin. A nuk ka sadopak lidhje kjo dukuri me mendimin se folklori është psikologji e së kaluarës, psikologji fshatarake? Të mbështetesh në folklor edhe për të pasqyruar aspekte nga bota punëtore, nga aktualiteti socialist — ja një kërkesë e përsëritur, një hapësirë ende e papushtuar. (Sa mund të përfitojë poezia p.sh. nga trajtimi me aq sukses i temës politike në këngën e sotme popullore!)

Të kuptosh mirë kërkesat e kohës dhe, nga ana tjetër, të kuptosh e të nisësh nga psikologjia e përparuar

shoqërore e artistike në folklor e në jetë, është kusht për të trajtuar me sukses edhe probleme të aktualitetit kombëtar e ndërkombëtar. Ky të kuptuar do të ndihmojë poetin që t'i japë një përmbajtje origjinale politike e ideologjike poezisë së tij, t'i japë thellësi e gjerësi idesë së vigjilencës; të krahasojë daljen e revizionizmit modern në stepat ruse me një bajloz të zi, t'i drejtohet edhe këngëtarit zezak, për t'i thënë se duhet të bëhet Gjergj Elez Ali për të mbrojtur nderin, të drejtat e tij e të vëllezërve. Synimi për të forcuar fizionominë kombëtare të poezisë në çdo qelizë e detaj, bëri gjithashtu që poeti të vendosë përballë pegasit të lashtë, të huaj e jo tokësor, mushkën e poezisë — simbol tokësor, nga jeta e psikologjia shqiptare. Gjithashtu i sugjeroi shkullin e XX ta konceptojë tashmë si një bari me katër kërraba në duar. Kjo prirje është pozitive dhe duhet forcuar.

Bie në sy se ka mbështetje kryesisht në motivet luftarake e më pak në motivet shoqërore të poezisë popullore. Motivi shoqëror disa herë ngushtohet tek kurbetliu, nizami, kaçaku (shpesh si koment i motivit). Ndjehet nevoja për mbështetje më të madhe në ato krijime popullore, ku pasqyrohen ndeshjet klasore dhe pozita klasore proletare.

Partia na mëson që folklorit të mos i drejtohem vetëm për mësim mjeshhtërie, por, së pari, për ndjenjat e fuqishme patriotike, demokratike dhe revolucionare, për vyrtytet morale dhe shijet e shëndosha estetike që mishëron.

Mbështetja në folklor nuk ka gjë të përbashkët me stilizimet libeske të motiveve të tij, që, siç është vërejtur dhe nga mendimi kritik, ndonjëherë ushqehet nga koncepti intelektualist për të «zbukuruar» motivin popullor. Nuk ka gjë të përbashkët edhe me citimin pa kriter të vargjeve apo motiveve të tëra nga folklori.

Aspekt tjetër, i cili lidhet ngushtë me mbështetjen në folklor, është mbështetja në gjuhën e gjallë, në ligjërimin popullor me pasurinë, gjallërinë dhe aromën e tij të papërsëritshme. E folura popullore në krijimtarinë popullore poetike vërshon gati pa rezerva dhe, në mënyrë të natyrshme, gati të vetvetishme, merr vlerë e funksion artistik. Në këngën kushtuar heroit popullit thotë: «O *Xheladini me halle!*» Mund të zbulosh disa shtresa kuptimore në fjalën epitete «me halle» (si: i varfër, me mundime e preokupime në jetë, që u nxjerr shu-

më punë armiqve), por është ca vështirë të kuptosh si e fiton fjala një mbingarkesë të tillë. Mbështetet në folklor e në gjuhën e folur të popullit poeti, kur shkruan «Baladë për Muço Matohitin» e jo për Mustafanë, por letrari i ri nuk vepron mirë kur vargun «Selami ç'i mbloodhi djemtë» e përshtat: «Xha Selami mbloodhi djemtë». Kjo jo vetëm për faktin që Selami, ndonëse flokëbardhë, është për popullin bir, por edhe se fjalëza «xha», sikur ia zbeh emrin. Me këtë imtësi nuk duam t'i mëshojmë aq asaj që populli është i pakorregjueshëm, se sa që gjuha e folur e tij nuk bëhet mekanikisht gjuhë artistike.

Duke theksuar dobinë e vërshimit më shumë të gjuhës së gjallë, të folur, edhe në poezi, nuk mendojmë aspak që t'i imponohet asaj naracioni apo sintaksa e prozës, të dhunohet inversioni apo liri të tjera, që janë në specifikën e gjinisë.

Është fjala për të përvetësuar, ndjekur e pasuruar atë përvojë që sjellin në poezi krijime si «Epepeja e Ballit Kombëtar», krijimet si ato të D. Agollit, Sh. Peçit, apo më të riut Q. Shemaj, ku harmonizohen natyrshëm mbështetja në folklor me mbështetjen në gjuhën e gjallë të popullit. Për një plastikë e mbështetje të tillë dëshmon edhe poema «Shqipëria dhe tri Romat» e I. Kadaresë, e cila shënon një pozicion të ri krijues të autorit ndaj poezisë popullore dhe shfrytëzimit të motiveve e mjeteve të saj shprehëse.

Është me vlerë të dalë në pah përvoja krijuese e D. Agollit në këtë drejtim. Jo rrallë, heroi i tij lirik, partizani Meke e të tjerë, bëjnë autoportretin e tyre përmes ligjërimit. Poeti mjaft mendime, koncepte të rëndësishme marksiste-leniniste, mjaft konkluzione e konsiderata të Partisë dhe të shokut Enver për probleme të mëdha të kohës sonë i jep në formën e gjykimeve e filozofimeve popullore, pa i thjeshtësuar. Kështu vepron, kur flet për problemin e madh të brezave tek «Baballarët», për modën e modernen në krijime të ndryshme etj. Në poemën «Nënë Shqipëri» vargjet «pak të na ngasin / flakë merr stralli e flakë e bëjmë dynjanë», na kujtojnë sa qëndrimin, psikologjinë shqiptare kundrejt armikut, aq edhe fjalët e shokut Enver nga tribuna e Kongresit të Frontit Demokratik të Shqipërisë. Këta e të tjerë shembuj, tregojnë si mund të harmonizohet mendimi më i përparuar shoqëror me forma të ashtuquajtura tradicionale. Kjo është dukuri novatore.

Poeti mund të mësojë mjaft nga lakonizmi dhe thjeshtësia e bukur e shprehjes në poezinë popullore, ta bëjë krijimin e vet më komunikues (madje, më të përshtatshëm dhe për recitim). Mbase nuk është parëndësi të mësohet nga shija, me të cilën populli përdor fjalët e vjetra apo barbarizmat, e me sa maturi përdor fjalët e reja të huajtura.

Mbështetja në folklor, në ndonjë rast, kuptohet si thjeshtësim i gjuhës poetike, si rendje pas fjalëve me ngarkesë leksiko-emocionale të vjetëruar; kalohet edhe në një vulgarizim të shijeve estetike të përfutuara nga folklori.

Është folur e mund të flitet përsëri për nevojën e përdorimit më gjerë të vargjeve të poezisë popullore. Përdorimin e tyre e gjejmë si prirje të ndërgjegjshme që nga poetët e Rilindjes deri tek autorët e shumtë të ditëve tona. Poetët janë të ndërgjegjshëm se kjo ndihmon për forcimin e komunikimit dhe të aromës popullore të poezisë. Në përgjithësi, kjo prirje ka dhënë frute të mira, sikundër në raste të tjera nënvleftësimi i këtyre vargjeve, i disiplinës poetike, ka qenë një ndër arsytet e suksesit të pakët. Mbështetja te folklori ka patur dhe ka rëndësi jo vetëm për origjinalitetin e stileve të veçanta poetike, por për të gjithë poezinë tonë.

## SHKRIMTARI DHE NJOHJA DIREKTE E JETES

Një hallkë shumë e rëndësishme në procesin krijues është ajo e njohjes së realitetit. Këtej varet shumë se ç'anë e jetës do të vijë në letër dhe si do të pasqyrohet. Ky doemos është një problem poliedrik, por do të ndalemi vetëm në disa anë.

Me rëndësi të madhe është ajo se ku duhet përqëndruar vëmendja gjatë procesit të njohjes. Partia dhe shoku Enver na kanë porositur herë pas here që në qendër të krijimtarisë të vihen heronjtë e kohës sonë: punëtorët, fshatarët, ushtarët, intelektualët popullorë dhe kuadrot revolucionarë, njerëzit e rinj të edukuar nga Partia. Jeta e popullit, njerëzit e pararojës, ky është objekti themelor i njohjes dhe i pasqyrimin artistik, burimi kryesor i vlerave ideore e estetike. Duke ndjekur hap pas hapi këta njerëz, biem natyrshëm në kontakt të gjallë me problemet e kontradiktat kryesore të realitetit, me prirjet përcaktuese të zhvillimit shoqëror, që janë ushqimi kryesor i letërsisë. Pa njohur shumë mirë, në radhë të parë, këta tipa, nuk njeh dot thellësitë e jetës së sotme kombëtare, pasuritë e saj më të çmuara. Po edhe antagonistin ynë, armiku, nuk mund të njihet e të pasqyrohet saktë, pa njohur thellë njeriun tonë të pararojës.

Të njohësh e të pasqyrosh tipat kryesorë të përparuar të kohës, të klasave e shtresave tona shoqërore, sigurisht që është një punë e madhe. Po ajo përballohet me përpjekjet kolektive të shkrimtarëve. Problemi është që t'i njohësh në një shkallë të tillë, sa të mund të thuash se për ty shpirti i tyre, në përgjithësi, nuk ka sekrete. Kjo njohje, e bashkuar me përgatitjen e shëndoshë ideologjike e profesionale, hedh dritë, vërtetësi e bukuri në veprat letrare. Ja, kështu, do të shpjegohej, p.sh., forca që buron nga një poemë e tillë madhore si «Nënë Shqipëri» apo dhe nga poema interesante e Xh. Spahiut për bukën. Këtë cilësi e gjejmë në tregimet më të mira të T. Laços, N. Priftit, A. Kondos, Dh. Shuteriqit, F. Ballancës, Z. Çelës apo tek komedia «Zonja nga qyteti» e R. Pulahës etj.

Mendojmë se kjo njohje e thelluar e njeriut pararojë të ditëve tona u duhet doemos si atyre që merren me temën aktuale, ashtu dhe atyre që lëvrojnë tema nga e kaluara. Epokat kanë lidhjet e kushtëzimet e tyre organike. Po ashtu bota shpirtërore e njerëzve të këtyre epokave të ndryshme. Nuk ka dyshim se një njohje e thelluar jo vetëm e periudhave të caktuara historike, po edhe njohja e gjallë e direkte e realitetit të jetës dhe e psikologjisë sonë socialiste kanë kushtëzuar suksesin e veprave «Kështjella», «Ali Pasha», «Skënderbeu» ose dhe «Njeriu më top», «Përballimi» apo «Lulet e shëgës».

Natyrisht, jo gjithçka na shkon mbarë në këtë drejtim. Ka edhe vepra ku ndjehet qartë se «sonda» e krijuesit nuk gërvish, veçse shtresa sipërfaqësore. Ajo nuk depërton në thellësi për të zbuluar vlera të vërteta ideore e artistike, që vënë në lëvizje letërsinë. Këtë përshtypje ke, kur lexon mjaft lirika të mbushura me thirrje të një «uni» poetik monoton. Këtë përshtypje ke gjithashtu, kur lexon disa tregime apo vepra dramatike, që nuk të hapin dyert e botës shpirtërore të popullit. Këtu nuk është puna thjesht tek mungesa e aftësive krijuese dhe dobësi stili, se sa te fakti që autorë të ndryshëm nënvlehtësojnë apo nuk e kuptojnë si duhet çështjen e njohjes së heroit të vërtetë të jetës.

I rëndësishëm është dhe problemi që ka të bëjë me mënyrën, «teknikën» e njohjes. Prej shkrimtarit kërkohet një metodë njohjeje që ka veçansi të caktuar. Shkrimtarit i nevojitet patjetër një njohje shumë konkrete, vëtiake, i nevojitet një kontakt i përhershëm, i drejtpërdrejtë dhe i shumanshëm me njerëzit, një intimitet shpirtërore.

tëror psikologjik shumë i sinqertë. I duhet ajo që shoku Enver e ka cilësuar qëndrim «gju më gju me popullin». Nuk janë quajtur më kot shkrimtarët inxhinierë të shpirtit njerëzor. Po shpirtin e vet njeriu ia hap vetëm mikut e shokut të denjë, tek i cili gjen mirëkuptim e simpati, respekt, qëndrim parimor. Nuk më duket e drejtë metoda e njohjes që ndjek ndonjë shok, që bën takime të ngutura, të sipërfaqshme, thuasjse zyrtare. Apo kur kënaqet që shënon ndonjë detal, episod ose shprehje të veçantë «pikante». Këto vetëm se i sillen rrotull objektit, shpirtit të njeriut tonë dhe nuk zbulojnë veçse gjera të përcipta e të rastit.

Përvoja letrare na vërteton se ka ende shkrimtarë, kryesisht fillestarë (po jo vetëm ata), që nuk e kanë të qartë si duhet thelbin e punës paraprake njohëse, nuk e zotërojnë «teknikën» e saj. Kritika jonë letrare mund të bënte një gjë shumë të dobishme, po të merrej edhe me këtë aspekt të procesit krijues. Në veprat e pjekura të D. Agollit apo të I. Kadaresë, të S. Godos, apo të T. Laços, të F. Arapit, Ll. Siliqit, K. Jakovës, Dh. Shuteriqit etj. kuptohet se ata e dinë secili, sipas mënyrës e talentit të vet, mjeshtërinë e njohjes së shpirtit të njerëzve të popullit, mjeshtërinë e kontaktit të thelluar, me takt e sinqeritet, ku shprehet botëkuptimi i shkrimtarit, etika e tij, aftësia vëzhguese, partishmëria e humanizmi i tij socialist. Shembulli i mjeshtërisë së lartë profesionale edhe në këtë drejtim duhet analizuar, vlerësuar e sistemuar nga kritika. Po për këtë nevojitet që kritika jonë të ndjekë edhe më mirë se tani krijimtarinë letrare dhe vetë jetën tonë përgjithësisht.

Realiteti ynë është në lëvizje e përtëritje të paprerrë. Ai zhvillohet me ritëm revolucionar. Bashkë me të ndryshon, zhvillohet dhe bota shpirtërore. Pra, kurrë nuk bën të vetëkënaqemi me shkallën e njohjes së jetës së popullit që kemi arritur në një çast të caktuar. Ta pasurojmë fondin e njohjes, se ai mund të na dalë pas-taj defiqitar apo dhe i amortizuar, kur të ulemi të shkruajmë.

Natyrisht, me këto s'duam të nënvleftësojmë aspektin e tërthortë, me rrëfime të të tjerëve, nëpërmjet shtypit, studimeve shkencore etj. Veçanërisht studimi i thelluar i dokumentave të Partisë, sidomos thellimi në dokumentat e Kongresit të 7-të, ku bëhen përgjithësimet themelore politike, ekonomike, ideologjike, estetike, etj., na orientojnë së tepërmi edhe në procesin e njohjes. Ato

na zbulojnë ligjshmërinë e përgjithshme të dukurive në fushat kryesore të jetës, zbulojnë kontradiktat e realitetit dhe perspektivat e zhvillimit. Veç kësaj, tek ne, tani shkencat shoqërore kanë bërë hapa të rëndësishme përpara. Rezultatet e tyre lehtësojnë punën njohëse të shkrimtarëve dhe ndihmojnë të përforcohet tabani realist e kombëtar i letërsisë. P.sh. më duket se sukseset e historiografisë sonë janë një nga burimet e suksesit të romanit tonë historik. Do të na dukej e pabesueshme që një shkrimtar, i cili kërkon të kapë gjerësisht një problem themelor mbi klasën tonë punëtore sot, të mos thellohej në tezat parimore të Partisë mbi këtë çështje, në materialet e Konferencës së dytë të studimeve shoqërore kushtuar posaçërisht kësaj çështjeje apo në disa studime të tjera interesante sociologjike e ekonomike tonat. Psikologjia shoqërore e ajo individuale dihet se pasqyrojnë marrëdhëniet materiale, ekonomiko-shoqërore e ndryshimet që ndodhin në këtë lëmë. Prandaj duhen njohur më mirë studimet teorike përkatëse prej nesh.

Partia e socializmi kanë krijuar kushte të shkëlqyera për ta njohur sa më mirë jetën, zhdukën barrierat që shoqëria e vjetër vinte midis artit e jetës, u krijuan një unitet i pashembullt ideologjik e moral midis shkrimtarëve e popullit. U krijuan edhe kushtet materiale e organizative. Puna është se sa dimë të përfitojmë e t'i shfrytëzojmë këto kushte. Ato duhen përdorur gjithnjë e me racionalisht, doemos sipas detyrave të reja, të mëdha që na shtron jeta, Partia.

Kjo çështje ka të bëjë drejtpërdrejt edhe me një problem shumë të rëndësishëm: sa e qysh do të mund të trajtohen më shumë disa tema kardinale. P.sh., si një moment kyç jo vetëm në fushën ekonomike, por edhe ideologjike, psikologjike e etike të fshatarësisë sonë sot, e në vitet që vinë, është formimi i kooperativave të tipit të lartë. Kjo është ndër shfaqjet thelbësore të së resë revolucionare në fshatin tonë. A mund të formohet sot një ide e saktë për jetën e fshatit tonë, pa i hyrë thellë edhe pasqyrimin të atyre dukurive, kthesave, kontradiktave shoqërore, që shfaqen e zhvillohen në kooperativat e tipit të lartë? Padyshim që jo. Ose, a mund të formohet një ide e saktë dhe pak a shumë e plotë për atë që ndodh në jetën e gjithanshme të klasës punëtore, veçanërisht në ndërgjegjen e saj, po të mos njohim atë që po ndodh në kolosin e Elbasanit, në atë të

Fierzës, në Ballsh e në objekte të tjera kryesore industriale? Këto janë ndër vatrat më të fuqishme, më karakteristike të formimit e të kalitjes së ndërgjegjes së klasës sonë punëtore në tërësi, në shkallë kombëtare. Bile, ato ndikojnë fuqimisht mbi psikologjinë e tërë kombit tonë socialist, duke përforcuar anët më pozitive të kësaj psikologjie. Po a kemi ne shkrimtarë që i njohin këto vatra, këto procese, këto momente kyçe, në një shkallë të tillë, sa që të mund të presim veprat letrare që meritojnë këto tema? A mund të themi ne se jemi përgatitur (nga pikëpamja e shkallës së njohjes së objektit) për t'i pasqyruar denjësisht këto probleme në mënyrë realiste, e jo më përshkrime të jashtme manifestive? Nuk duhet të presim deri sa të krijohet deficieti i madh tematik në anë të rëndësishme, e pastaj të lëshojmë kushtrimin. Partia na e ka bërë të qartë se detyrat e letërsisë e të arteve tona tani janë të mëdha. Prandaj edhe kryerja e tyre kërkon një stil më të lartë. Prej nesh kërkohet njohje më e thelluar e realitetit socialist, e njerëzve tanë më të përparuar dhe, përgjithësisht, një organizim më i lartë i procesit të kësaj njohjeje artistike.

## PUNETORI – HERO I MADH I KOHES SONE

Karakteristikë e zhvillimit të artit dhe të letërsisë sonë revolucionare të realizmit socialist, është edhe pjesëmarrja në të e krijuesve që vinë drejtpërdrejt nga prodhimi. Lidhja ka në gjirin e vet anëtarë dhe kandidatë që punojnë në qendra prodhimi.

Edhe unë jam punëtor, siç është edhe Burhan Kuke-li, Sulejman Kaba, Guri Miçinoti, Siri Sulejmani, Petraq Kita, e plot të tjerë. Ne kemi botuar nga një apo dy vepra. Na janë thënë fjalë të mira për freskinë e materialit jetësor, por me të drejtë, na janë bërë dhe vërejtje për të meta në mjeshtërinë artistike, në kompozicion, etj. Por mjaftojnë vetëm përpjekjet tona? Ne, për një arsye ose tjetrën, ndoshta nuk kemi vazhduar edhe shkollat dhe shumë gjëra të teknikës profesionale nuk i njohim mirë, por pasioni dhe dashuria për artin nuk kanë munguar dhe lodhjen fizike e kemi mundur me kënaqësinë e krijimit. Por, kur ke kulturë të mangët, vetëm me talent nuk ecën përpara, aq më tepër sot që niveli i lexuesit dhe i letërsisë sonë është i lartë. Prandaj ne kemi nevojë për ndihmë dhe këshillë. As deri tani ndihma nuk na ka munguar, por mendoj se ajo duhet organizuar më mirë nga vet aparati i Lidhjes. Dikur është organizuar në Durrës një kurs dy-tre mujor

me krijues nga klasa punëtore, në bashkëpunim me Bashkimet Profesionale të Shqipërisë. Mendoj se përsëri ka vend për t'u thelluar në format dhe metodat e tjera për kualifikimin tonë, ndoshta edhe ndonjë kurs njëvjeçar pranë Fakultetit të Gjuhë-letërsisë, me leksione apo seminare, etj. Gjithashtu duhet lavdruar redaksia e gazetës «Drita» me rubrikën interesante «Bisedë me talentet e reja», ku janë botuar materiale të rëndësishme teoriko-praktike mbi procesin krijues. Mendoj se do të bënte mirë Shtëpia Botuese «Naim Frashëri» që këto materiale të botuara jo vetëm në «Drita» por dhe në «Nëntori», t'i përmbledhë në libra të veçanta dhe njëkohësisht ajo vetë të gjurmojë edhe për krijime të përkthyer të shkrimtarëve dhe artistëve të mëdhenj.

Shokët kritikë nuk duhet të mërzhiten për këtë kritikë që po u bëj: ata ulen rrallë të shkruajnë të paktën një parathënie për veprën e një autori të ri të panjohur. Ne e presim fjalën e tyre, vlerësimin dhe vërejtjet për krijimet tona, sepse do të na ndihmojnë për të përvetësuar mjeshtrinë e të shkruarit, për të nxjerrë vepra më të bukura e të dobishme.

Jeta jonë e bukur socialiste na sugjeron tema nga më të larmishmet, nga më të rëndësishmet. Fshati ynë kooperativist po zhvillohet me ritme të mahnitshme. Bujqësia tek ne është problem i gjithë popullit. Ndërsa në vendet kapitaliste fshatërat rrënohen e boshatisen, tek ne ata lulëzojnë, qyteti e ndihmon fshatin jo vetëm me aksjone, teknike bujqësore, apo plehra kimike, por edhe me njerëz që shkojnë të banojnë përgjithmonë në të. Ja një origjinalitet i zhvillimit tonë. Këtu del një fushë e madhe veprimi për penën e shkrimtarit, për të pasqyruar këto dukuri.

Punëtori, gjithashtu, është një hero i madh i kohës sonë që duhet të pasqyrohet denjësisht në letërsi. Ai shfaq vitalitetin e tij kudo që të ndodhet. Të marrim fjala vjen, detarin shqiptar. Ai ndodhet më në kontakt me rrethimin e egër imperialisto-revizionist, të cilin e mposht me trimëri. Ai thyen stuhitë e valëve të detit e të valëve të armiqve.

Ja pra sa e sa figura e tema na dalin përpara që presin penën dhe penelin, daltën dhe pianon, për t'ia dhënë klasës punëtore në art shëmbëlltërinë e vet.

## JETA TË PASQYROHET ME VERTETESI, NE ZHVILLIMIN E SAJ REVOLUCIONAR

Synimi që letërsia dhe artet tona të ndjekin hap pas hapi ritmet e zhvillimit të shoqërisë sonë socialiste është i lidhur ngushtë me vetë thelbin e tyre shoqëror, me rolin e tyre si mjete të fuqishme të edukimit komunist të masave punonjëse. Arritja e këtij synimi bën të mundur që letërsia dhe artet tona të realizmit socialist të mos mbeten kurrsesi në bisht të ngjarjeve dhe të dukurive të reja shoqërore, por të ecin përpara tyre, t'u prijnë këtyre dhe të bëhen një pararojë e idealit pozitiv të shoqërisë sonë, e cila zhvillohet me ritme të shpejta dhe çan shtigje të parrahura. Edhe ritmet e zhvillimit të krijimtarisë sonë letrare-artistike janë të pakrahasueshme jo vetëm me të kaluarën, por edhe nga dekada në dekadë. Por megjithatë, sot del domosdoshmëria e një mobilizimi më të madh për të pasqyruar me një nivel sa më të lartë ideo-artistik shndërrimet e thella materiale e shpirtërore të Atdheut tonë socialist.

Nuk ka dyshim se faktorët që do të çojnë në një hop të ri cilësor të letërsisë e të arteve tona të realizmit socialist janë të ndryshëm e të shumanshëm, por mua

më duket me vend të ndalem në analizën e njërit prej tyre, pikërisht në domosdoshmërinë e njohjes së thellë të jetës sonë të re. Mendoj se ky faktor lidhet jo vetëm me një nga parimet më të qënësishme të drejtimit tonë letrar e artistik, siç është pasqyrimi i jetës me vërtetësi dhe në zhvillimin e vet revolucionar, por edhe me të gjitha parimet e tjera.

Në veprat e shokut Enver, e veçanërisht në fjalën e mbajtur më 20 dhjetor 1974, një vëmendje e posaçme i kushtohet pikërisht njohjes së thellë të jetës, të realitetit tonë socialist. «*T'i mësojmë letrarët dhe artistët e rinj si ta lexojnë librin e hapur të jetës socialiste të vendit tonë, si ta studiojnë dhe si ta kuptojnë brendinë e këtij libri të mrekullueshëm. Të bëjmë që ata të dashurohen me çdo «gërmë» të këtij libri të jetës, të shohin dhe të ndiejnë rrahjen e fuqishme të forcës, të ndjenjave dhe të dëshirave të zjarra të popullit*», na mëson shoku Enver. Dhe ky mësim i madh ka vlerë për të gjithë brezat e krijuesve. Vitin e kaluar qëndroi disa muaj në rrethin tonë, në Tropojë, piktori i popullit Foto Stamo. Njohja nga afër dhe e thelluar e jetës së masave punonjëse të këtij rrethi, e natyrës së tij të bukur e të madhërishtme, të shndërruar rrënjësisht nga pesëvjeçarët, i përtëriu energjitë krijuese këtij piktori, i dha dorë të krijojë një varg punimesh dinjitoze, të cilat s'do t'i kishte krijuar kurrë pa këtë njohje. Piktori Zef Shoshi jo vetëm njohu nga afër natyrën dhe tipat, që do të vendoset në kompozimin e tij «Gju më gju me popullin», por skicë-idenë e kompozimit e paraqiti për diskutim para kooperativistëve të Margegajt, të cilët i dhanë disa mendime interesante për thellimin e vërtetësisë jetësore të veprës. Këto mendime ndihmuan për rritjen e vlerave ideo-estetike të kompozimit në fjalë.

Dihet mirëfilli se veprat më të mira të realizmit socialist, me tematikë e problematikë aktuale, janë pikërisht ato që janë mbështetur mbi një njohje të gjërë e të thellë të realitetit tonë. Këto vepra shquhen për brendinë e pasur, idetë e thella e të rëndësishme, formën e goditur artistike, fizionominë e qartë kombëtare, karakterin popullor, për frymën militante dhe rolin e madh edukativ. Ato ngjallin një interesim jo të zakonshëm të artdashësit dhe gëzojnë një popullaritet të gjërë, duke u bërë kështu pjesë e vetë ndërgjegjes shoqërore.

Është e domosdoshme dhe e natyrshme që në lehtësinë dhe artet tona të pasqyrohen epokat e mëdha të historisë së popullit tonë, por «borxhlinj» më të mëdhenj,

në radhë të parë, i jemi kohës në të cilën jetojmë, socializmit. Fakti që tematika e sotme nuk zë ende vendin e dëshiruar, nuk ka si të shpjegohet ndryshe, veçse me një njohje të kufizuar e ndoshta të përciptë të jetës sonë, e cila, siç thotë shoku Enver, «... është aq e madhe, aq e gjërë, aq e larmishme, aq e bukur dhe aq e hapur sa që po të zhytesh në të, nuk ka si të mos frymëzohesh të shkruash çfarë të duash, romane, poezi, drama, muzikë, komedi etj.». Kanë ndodhur e po ndodhin shndërrime epokale në fshat e në qytet, është krijuar një realitet i ndritur socialist dhe, mbi të gjitha, është formuar njeriu ynë i ri. Këto shndërrime jo sa duhet e kanë gjetur vetveten në krijimtarinë letraro-artistike. Jam i mendimit se moskapja sa duhet e problemeve të mëdha aktuale ngjet kryesisht nga që këto probleme nuk njihen në tërë thellësinë e duhur, nuk jetojnë nga krijuesit gjer në atë shkallë sa t'i ngacmojnë, t'i nxitin për t'i trajtuar në veprat e veta. Jo rrallë, disa tema mbeten djerrë ose trajtohen shkarazi. Do të përmend një fakt nga rrethi ynë. Në Tropojë, midis aq përparimesh kolosale, radhitet me të drejtë edhe mënyra socialiste e jetës. Por është gjithashtu e vërtetë se në këtë rreth me afro 35 mijë banorë (unë mendoj se kjo ngjet edhe në rrethe të tjera të veriut) martesat brenda fisit e fshatit numërohen me gishtat e dorës. Megjithatë për këto martesë s'është shkruar gjer tani gjë prej gjëje. Njohja e thelluar e kësaj dukurie të re, parë në kuadrin e gjërë të luftës për emancipimin e plotë të gruas, do të bëhej patjetër nxitja e fortë për të krijuar vepra letrare e filma. Këto krijime jo vetëm do të pasqyronin një temë aktuale me rëndësi shoqërore, por edhe do të ndihmonin në zhvillimin e mëtejshëm të një dukurie të re. Mendoj se edhe një temë kardinale, siç është ajo e ndeshjes së madhe të Partisë e të popullit tonë me reaksionin botëror e sidomos me revizionizmin modern, nuk është trajtuar ende me përpjestimet e mëdha dhe ngjyrat e forta reale të saj. Trajtimi i temave të rëndësishme aktuale afërmon gjithësesi edhe shkallën e përgjegjësisë së krijuesve ndaj popullit dhe kohës së vet forcon karakterin militant, madje, edhe karakterin origjinal të krijimeve.

Ne na shqetëson jo vetëm numri i veprave që i bëjnë jehonë të sotmes, por edhe cilësia e tyre, pasuria ideore dhe forma artistike e tyre. Që të dy këta tregues janë të lidhur organikisht me njohjen e thellë të jetës.



Po të shqyrtojmë poezinë tonë të sotme, vëmë re se niveli artistik i saj qëndron më lart se sa ai i poezisë së dekadës së mëparshme; është pakësuar në masë të ndieshme fryma e përgjithshme, skematizmi, deklarativizmi. Gjithashtu një luftë e ashpër është zhvilluar e po zhvillohet kundër shfaqjeve të formalizmit, si hermetizmi, figuromania etj.. Megjithatë, bie në sy zbehtësia e një numri krijimesh, që reflektohet qoftë në brendinë, qoftë në formën e tyre. Ekziston një numër i caktuar temash që shtegton nga vëllimi në vëllim, që sjell uniformitet tematik e artistik, kushtëzon frymën libeske, krijimin e vargjeve «pa substancë». Një poet yni ka vërejtur me të drejtë, se në ndonjë rast është gati e pamundur të kuptosh nga vëllimi poetik se nga vjen autori i tij, ç'punë bën, cilat janë problemet e vërteta të ambientit ku ai jeton, cili është angazhimi i tij në zgjidhjen e problemeve politike e shoqërore që e rrethojnë. Kam dëgjuar të diskutohet shpesh edhe për një dukuri tjetër. Shumica e vëllimeve të dyta të poetëve të rinj sjellin fare pak ose relativisht pak vlera të reja në krahasim me vëllimin e parë. Kjo dukuri gjithsesi shpjegohet me akumulimin e një materiali jetësor të kufizuar dhe me asimilimin e pamjaftueshëm të tij. Njohja e thelluar e me pikësynim të caktuar të ndihmon të kapësh temën e ta trajtosh atë, kështuqë nuk ka nevojë të shtrydhësh trurin për të gjetur ç'të shkruash apo për të fabrikuar figura të bujshme.

Megjithë rolin e pazëvendësueshëm të njohjes praktike të jetës, kuptohet mirëfilli se ajo s'është e mjaftueshme dhe s'ia arrin qëllimit pa aspektin tjetër, pa njohjen teorike të jetës, e cila bëhet duke studiuar me ngulm e ngaherë, sidomos materialet e Partisë dhe veprat e shokut Enver. Kjo njohje teorike është e domosdoshme, jo vetëm për njohjen sa më të plotë të së sotmes, por sidomos për njohjen e të nesërmes, për zbulimin e atyre «sythave» që përmbajnë të nesërmen. Këtu krijuesi me një qartësi të madhe ideologjike është në gjendje të dallojë të renë, ka një sy aq të mprehtë sa, siç thuhet në një këngë kreshnikësh, «po e sheh barin kah po rritet». Gërshetimi i njohjes teorike me atë praktike është një prej kushteve të domosdoshme për të krijuar vepra të bukura e të partishme, që militojnë në edukimin komunist të njerëzve.

## PROZA E SHKURTER DHE AKTUALITETI

Ai zhvillim i vrullshëm, që karakterizon krejt letërsinë tonë këto vitet e fundit, vihet re qartë edhe në prozën e shkurtër, brendinë ideore të së cilës e përbëjnë problemet e rëndësishme të jetës shoqërore. Proza e shkurtër e ka rritur militantizmin e vet. Partishmëria komuniste, tendencioziteti i theksuar klasor proletar përshkajnë si fill i kuq krijimtarinë aktuale të saj. Dhe jo vetëm brendia e shëndoshë ideore, por edhe forma artistike e krijimeve të prozës së shkurtër ka ardhë gjithnjë duke u përkryer. Sot kemi tregime e novela, që hyjnë denjësisht në fondin e zgjedhur të letërsisë botërore. Këto arritje të rëndësishme, që spikatën në mënyrë të veçantë vitet e fundit, dëshmojnë edhe një herë se sa vendimtare për fatet e letërsisë dhe arteve është udhëheqja e Partisë, e cila, jo vetëm nuk e cënon lirinë krijuese të artistit, as nuk e frenon frymëzimin e talentin e tij, si qahen me hipokrizi kalemxhinjtë borgjezë-revizionistë, po përkundrazi është busull e pagabueshme që i ndriçon rrugën artit të madh, artit në shërbim të popullit e të revolucionit.

Prirja kryesore që vihet re sot në prozën e shkurtër është pasqyrimi i jetës sonë socialiste, shtrimi dhe zgjidhja e drejtë e problemeve më të rëndësishme të saj.

Kështu, shqetësime të tilla të jetës bashkëkohore mbar-tin tregimet e novelat më të mira të Dh. S. Shuteriqit, N. Priftit, T. Laços, D. Agollit, I. Kadaresë, D. Shapllës, A. Kondos, V. Koreshit, S. Drinit, E. Kadaresë, A. Cer-gës, K. Kostës, B. Kukelit, Sh. Tiganit, Z. Çelës, N. Le-rës dhe të shumë talenteve të reja, që po afirmohen këto vitet e fundit si: Kristaq Balli, Mihallaq Qillari, Xhafer Martini, Petrika Dragoti, Agim Hila etj.

Por, duke u mbështetur në prirjen e drejtë për të pasqyruar jetën e sotme, tregimi dhe novela kanë mundësi ta forcojnë edhe më shumë frymën aktuale të pro-blematikës që trajtojnë dhe të ideve që shprehin.

Rolin militant të ndihmësit të Partisë në edukimin komunist të masave e luajnë më mirë ato vepra, që arrijnë në të fusin në unison pulsën e realitetit të pasqyruar, me pulsën e jetës sonë socialiste në dinamikën e zhvi-llimit të vet revolucionar. Këtë mundësi e ka vërtetuar vetë praktika krijuese e atyre shkrimtarëve, të cilët, du-ka u zhytur thellë në jetën e popullit, duke bërë një jetë intensive ideologjike së bashku me të, duke përje-tuar thellë gëzimet e shqetësimet që provojnë masat gja-të punës për ndërtimin e socializmit, kanë arritur të krijojnë vepra të bukura me theks aktual të fuqishëm. Pa hyrë në listë autorësh e veprash, le të kujtojmë tre-gimet e novelat e shumta, që u shkruan në gjurmët e freskëta të lëvizjeve e inisiativave revolucionare, pas fjalimit historik të 6 shkurtit të shokut Enver Hoxha dhe Letrës së hapur të KQ të Partisë. Duke lexuar novela e tregime të tilla si: «Historia», «Njeriu i mirë», apo ato të përmbledhura në vëllimet «Këngë në minierë», «Li-tari i zjarrtë», «Ajri i ftohtë i mesnatës», «Njerëz dhe gurë», «Ndërrimi i qiejve», «Kumbimet e reja të pyje-ve», «Yje mbi lumë» etj. për nga aktualiteti i problema-tikës ke përshtypjen se ke në dorë shkrime publicistike, të shkruara në gjurmët e freskëta të ngjarjeve të jetës, bashkëkohore. Kjo për arsye se brendinë ideore kësaj krijimtarië ia dha jeta e gjallë. Mirëpo nuk ngjet gjithnjë kështu. Jeta ec e zhvillohet gjithënjë me temp ritmik revolucionar, pa u ndalur, kurse tregimi e novela, ka raste që nuk e ndjekin dot këtë zhvillim të vrullshëm të saj dhe mbeten prapa. Dhe krijohet kështu një mospër-puthje: të tjera probleme nxjerr jeta, të tjera trajtojnë krijimet e këtyre gjinive. Të tilla krijime, që zvarriten prapa jetës, nuk e kanë freskinë e atyre, për të cilat folëm, dhe duken si kronika të vonuara.

Duke theksuar nevojën e forcimit të frymës aktuale në prozën e shkurtër, nuk dua të them aspak që ajo të mos e pasqyrojë të kaluarën. Krahas jetës së sotme, e cila, si në krejt artin tonë edhe në tregimin e novelën zë vendin kryesor, pasqyrohet edhe e kaluara, po kurdo-herë e parë në prizmin e detyrave aktuale të ndërtimit socialist. Kjo kërkesë nuk është ndonjë recetë, por do-mosdoshmëri. Edhe në krijimet më të mira të prozës sonë të shkurtër kështu janë ndriçuar epokat, në priz-min e problemeve aktuale. Le të kujtojmë me këtë rast, një nga krijimet e kohëve të fundit të Ismail Kadaresë «Emblemën e dikurshme». Në të zbulohet me anë ta-blosh të qarta, të vizatuara me realizëm se si lidhen me fije të shumëta, të dukshme e të padukshme, armiqtë e jashtëm e të brendshëm të revolucionit e të socializmit. Kështu pasqyrimi i jetës së sotme fiton theks të fortë aktual.

Dhe jo vetëm jeta e mbasçlirimit, por edhe Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare me të drejtë quhet temë aktuale dhe e tillë duhet trajtuar në krijimtari. Kjo sepse jeta e sotme është një vazhdimësi e pandërprerë e Luf-tës, periudhë e realizmit të idealeve për të cilat u bë ajo. Në veprat më të mira të prozatorëve tanë, Lufta vësh-trohet drejt, në prizmin e problemeve e detyrave të ko-hës sonë, pra, si temë aktuale. Le të kujtojmë se si edhe një vepër e tillë e madhe, si «Komisari Memo», jo vetëm në anën e jashtme kompozicionale, po edhe në thelbin e brendisë së vet ideore është endur e mpleksur nga fi-llimi në fund me problemet e jetës aktuale.

Megjithëse mund të sillen plot shembuj të mirë dhe megjithëse trajtimi i temës së Luftës ka pasur vazhdi-mësi të pandërprerë, përsëri pohimi se i jemi ende bor-xhli kësaj teme, e cila nuk ezaurohet kurrë, është i drej-të. Lufta Nacionalçlirimtare, si epopeja më e lavdishme në historinë e popullit tonë, ka shumë aspekte të rën-dësishme që duhen ndriçuar nga arti ynë, në mënyrë që të arrihet të jepet sa më e plotë tabloja e madhe epi-ke e saj.

Duke mënjanuar disa tregime e novela të paarrira, që janë reminishenca të dobëta dhe jo pasqyrim i rea-litetit të njohur, proza jonë e shkurtër mund të bëjë më shumë për zbulimin e botës së brendëshme aq të pasur të heroit të Luftës, të vetëdijes së tij të lartë për idea-lin, të cilit i ishte kushtuar, prej nga buronin të gj-

tha tiparet e karakterit të tij si guximi, trimëria, heroizmi, ndershmeria, altruizmi, humanizmi i lartë etj.

Partia e shoku Enver vazhdimisht na e kanë theksuar nevojën për të mësuar nga mësuesi i madh e i pagabueshëm popull. Edhe në forcimin e frymës aktuale në art mund të mësohet shumë prej tij. Populli në krijimtarinë e vet evokon dendur Luftën, po kurdoherë e vështron nga lartësitë e jetës socialiste që kemi ndërtuar, të cilën e vlerëson si realizim të idealeve të saj, si shihet në vargjet e njohura: «Kur më merr malli për tynë / Dal e shikoj Shqipërinë / Si kopësht me trendelinë / Ashtu si e doje tinë».

Në prizmin e jetës aktuale dhe të problemeve të saj shihet çdo gjë që bëhet objekt arti, pra edhe e kaluara. Nuk do të kishte vlerën që ka romani «Kështjella», sikur të ishte vetëm letrarizim i historisë së luftërave të popullit shqiptar, nën udhëheqjen e Skënderbeut. Vepra zgjoi interesin e bashkëkohësve, sepse i ndihmonte ata në jetën aktuale, i mbushte me optimizëm e me besim në fitore në kohën e bllokadës së egër imperialisto-revizioniste, duke u zbuluar se si populli ynë ka qenë i rrethuar edhe herë të tjera nga fuqi të mëdha, të cilat ia shtrënguan pa mëshirë darën e rrethimit dhe ai jo vetëm nuk u gjunjëzua, por qëndroi i pamposhtur në rrethim deri sa fitoi. Romani, pra, pati jehonë, sepse në kohën e arrogancës dhe prepotencës së superfuqive afirmonte idenë se popujt që luftojnë për një çështje të drejtë janë të pamposhtur dhe do të fitojnë kundër çdo armiku, sado i fuqishëm dhe i madh në numër të jetë. Kështu, në prizmin e jetës aktuale vështrohet historia edhe në shumë tregime e novela të shkrimtarëve tanë. Këtë prirje proza e shkurtër duhet ta thellojë më tej, duke u prerë rrugën krijimeve që letrarizojnë fakte e ngjarje historike, që i «përkthejnë» ato në gjuhën e figurave, që e «derdhin» lëndën historike në kallëpet e veprave letrare. Historia, si shkencë më vete, nuk ka nevojë që të dublohet nga letërsia. Letërsia, nga ana e saj, ka liri të plotë t'i pasqyrojë të gjitha epokat, po, kurdoherë, jo si qëllim më vete, po në shërbim të aktualitetit. I shikuar me këtë sy problemi i artit dhe i aktualitetit, mendoj se është e nevojëshme që proza e shkurtër ta rrisë edhe më shumë militantizmin e vet, duke reaguar me ndjeshmëri edhe më të lartë ndaj fenomeneve të rëndësishme të jetës sonë socialiste. Asaj i del detyrë që, duke u përqëndruar në jetën e sotme, ta rrokë tablo-

në e saj në gjithë gjerësinë e thellësinë që ka, pa lënë asnjë aspekt të rëndësishëm të pandriçuar, si u la këto vitet e fundit jeta e fshatit socialist. Tregimi dhe novelo jonë, që e kanë nisur jetën e vet dhe kanë arritur vlera të larta ideoartistike duke pasqyruar jetën e fshatit, do të pasurohen edhe më shumë me vepra të mira, kur shkrimtarët të futen thellë në detin frymëzues të jetës që lulëzon atje, në problemet e mëdha aktuale të rritjes e të perspektivës. Drejtimi i vëmendjes së shkrimtarëve tregimtarë nga jeta e fshatit është i nevojshëm, po, natyrisht, duke bërë kujdes për të mos lejuar shfaqjen e njëanëshmërive të reja. Këtë e theksojmë, sepse që tani më duket se nxjerr krye një njëanëshmëri e re: pasqyrimi i njeriut vetëm në sferën e punës. Në përgjithësi, kjo prirje është e drejtë, sepse puna është ajo sferë e veprimtarisë shoqërore ku njeriu, objekti kryesor i artit, i shfaq në mënyrë më të plotë tiparet e karakterit të vet. Mirëpo, bukuria e madhështia e njeriut tonë të ri shfaqet me gjithë shkëlqimin e vet edhe në familje, edhe në miqësi e dashuri, pra, edhe në aspektet «intime», në të cilat kurdoherë ai udhëhiqet nga parimet e larta të moralit komunist.

Zhvillimi aktual i prozës së shkurtë dëshmon se ajo ka hyrë tanimë në një fazë të rëndësishme të pjekurisë së saj ideoartistike, ka arritur vlera të shquara, të cilat, në dritën e mësimave të Kongresit të 7-të të Partisë, do të shtohen e pasurohen më tej.

## PASQYRIMI I FIGURES SE KOMUNISTIT NE LETERSI

Në gjithë punën tonë, në procesin krijues, në shkri-  
met, diskutimet, bisedat dhe në mbledhje të tilla  
pune, është i vetëdijshëm preokupimi revolucionar për  
t'i dhënë popullit vepra që ndihmojnë në edukimin e tij,  
vepra që ta ngrenë shpirtërisht, ta frymëzojnë e mobi-  
lizojnë atë. Kjo është e kuptueshme: nga shkalla e for-  
cës vepruese të letërsisë dhe artit mbi masat, nga roli  
i tyre edukues, nxitës e frymëzues, varet se sa shkrim-  
tarët dhe artistët e kryejnë misionin e tyre si ndihmës  
të Partisë për edukimin komunist të masave. Arti bëhet  
i afërt për masat duke qënë në një front me ta, në vijën  
e parë të zjarrit. Mijëra e mijëra punëtorë e koopera-  
tivistë, kuadro dhe ushtarakë, që bëjnë një jetë me të  
vërtetë heroike, që me mund e sakrifica kapërcejnë vësh-  
tëritë e rrethimit, kërkojnë të gjejnë më shumë jetën  
dhe veprën e tyre në letërsi, sidomos në gjënitë e më-  
dha, ku ka më tepër boshllëk. Duke realizuar më mirë  
këtë kërkesë, letërsia bëhet më dinamike, ndikuese dhe  
mobilizuese.

Natyrisht, duke shkruar për qëndresën e ilirëve ndaj  
pushtuesve romakë, të Skënderbeut ndaj turqve, të luf-  
tëtarëve të periudhës së Pavarësisë, etj. krijohen vepra  
me theks aktual, që i shërbejnë edukimit të punonjësve.

Tema të tilla janë lëvruar me sukses nga shkrimtarët  
tanë dhe veçanërisht ajo e heroizmit partizan në kohën  
e Luftës Nacionalçlirimtare kërkon të pasqyrohet akoma  
më gjerësisht në të ardhshmen. Por ato nuk mund të  
kompensojnë domosdoshmërinë e paraqitjes së luftës dhe  
qëndresës që bën sot Partia dhe populli ynë. Kjo luftë  
e qëndresë bëhen në kushte të tjera, nga forca të tjera  
dhe në emër idealesh më të mëdha.

Prandaj është e nevojshme që njeriu pararojë i di-  
tëve tona, heroi pozitiv, duhet të sundojë dhe më shu-  
më në veprat letrare apo skenike, sepse vetëm kështu,  
— na mëson Partia, — «sundon komunisti shqiptar, sun-  
don klasa punëtoare revolucionare, sundon populli ynë  
trim e patriot që, në unitet të çeliktë me Partinë dhe  
nën udhëheqjen e saj, po përballojnë me guxim e ven-  
dosmëri të pashoqe këtë »stuhi« prej nëntë ballësh të  
luftës klasore dhe për ndërtimin e socializmit...».

Pohimi që u bë në Kongresin e 7-të se roli udhë-  
heqës i Partisë në shoqërinë e në shtetin tonë përbën  
jo vetëm një kërkesë themelore të marksizëm-leninizmit,  
por përfaqëson edhe një realitet historik, është burim  
i madh frymëzimi për krijuesit tanë. Ky realitet histo-  
rik duhet të gjejë një mishërim më të gjerë artistik në  
krijimtarinë letrare. Kjo është një detyrë me rëndësi të  
madhe politiko-ideologjike, mbasi dihet se me rolin udhë-  
heqës të Partisë është i lidhur fati i revolucionit dhe i  
ndërtimit me sukses të socializmit. Vetë historia e Par-  
tisë sonë është një epike heroike, e mbushur me një  
intensitet të madh ngjarjesh dramatike dhe me një op-  
timizëm të rallë. Është vështirë të gjesh qoftë edhe një  
vit në jetën e Partisë sonë, ku të mos ketë ngjarje të de-  
nja për vepra të mëdha letrare. Lufta ndaj tradhëtisë  
revizioniste në fillim të viteve 60-të, për të cilën është  
shkruar ndonjë vepër, është vetëm një kapitull i kësaj  
historie të madhe. Duke pasqyruar me nivel të lartë ar-  
tistik edhe momente të tjera kyçe të kësaj epikeje të  
lavdishme komuniste, do të rritej shumë forca mobilizuese  
e letërsisë, do t'i bëhej një shërbim i madh çështjes së  
revolucionit e të socializmit.

Partia e ka siguruar dhe e siguron rolin e saj udhë-  
heqës jo vetëm me forumet, drejtuesit dhe kuadrot e  
zgjedhur, por, në radhë të parë, me organizatat bazë,  
që janë themeli i Partisë, dhe me rolin pararojë të çdo  
komunisti. Të pasqyrosh drejt e me thellësi figurën e se-  
kretarit të Partisë, të drejtuesit të pushtetit, etj. kjo

është e domosdoshme. Ata janë bijtë më të mirë të Partisë, që mbajnë një peshë të rëndë mbi shpatulla dhe që me punën e veprën e tyre bëhen burim nxitjeje e frymëzimi revolucionar. Por këta duhet të dalin në gjirin e masës e bashkë me komunistë dhe figura të tjera pozitive nga masa, sepse del më në pah roli i tyre dhe ndikimi i ideve të Partisë tek njerëzit tanë.

Nga ana tjetër, figura e komunistit dhe njeriut pararojë, duhet paraqitur në aspekte dhe në ambiente të ndryshme. Ata i gjen kudo ku punohet e prodhohet. Partia ka porositur dhe porosit vazhdimisht që shumica dërmuese e komunistëve të shkojnë në prodhim dhe atje të jenë në ballë të punës e të sakrificave, shembull në çdo drejtim. Siç u tha në Kongresin e 7-të të Partisë, kjo porosi është bërë e po bëhet realitet gjithnjë e më mirë. 66.5 për qind e komunistëve janë punëtorë dhe kooperativistë. Po letërsia? Kuptohet që edhe kjo duhet t'i «demokratizojë» më shumë figurat e komunistëve, t'i paraqesë në kudhrën e revolucionit, atje ku janë frontet më të vështira, si punëtorë të thjeshtë dhe drejtues njëkohësisht, se Partia ka theksuar që komunisti i mirë drejton duke punuar, me shembullin e tij.

Kuptohet që për realizimin e këtyre mangësive kërkohet një njohje akoma më e thellë e jetës së Partisë dhe e njerëzve të pararojës. Veprojnë mirë mjaft shokë shkrimtarë e artistë që venë në bazë herë pas here. Por duhet thënë se edhe atje nuk mund të arrihet një njohje e thellë brenda një kohe të shkurtër. Mysafiri nuk i njeh dot, thotë populli, hallet e një shtëpie jo me një natë, por as me tri e pesë... Kështu që lidhjet me bazën duhet të jenë akoma më të forta e të shumanshme. Por kryesorja, mendoj, mbetet ajo, për të cilën na ka porositur vazhdimisht Partia: të jetuarit intensivisht e ditë për ditë me jetën e popullit, pjesëmarrja aktive e shkrimtarëve dhe artistëve në të gjithë jetën politike, ekonomike e shoqërore të vendit.

## JETA E SOTME – BURIM TEMASH TË REJA

**F**litet me të drejtë se tema aktuale e fshatit, me proceset e reja që kanë lindur e zhvillohen në të, ka krijuar aktualisht një prapambetje të theksuar në pasqyrimin e saj në letërsi. Sigurimi i bukës në vend, për herën e parë, në historinë shumëshekullore të popullit tonë, si një fitore e madhe historike, a nuk është një temë aq e gjerë për vepra të shumta letrare, ku do të gjente pasqyrim një jetë e madhe revolucionare, që përgatiti këtë arritje? A mund të mbetet një fakt i tillë historik, ta zëmë, pa një roman të madh të denj për këtë temë? S'ka dyshim se vepra madhore me këtë temë, ku të pasqyrohej nëpërmjet tablosh të gjalla të jetës se si masat punonjëse e zbatojnë parimin e madh revolucionar «me forcat e veta», do t'i përgjigjeshin orientimit të Partisë që letërsia të pasqyrojë temat kardinale të jetës.

Veprat tona letrare me temën e fshatit, veçanërisht janë prapa në dhënien e njeriut të sotëm të fshatit tonë të ri. Ne ende nuk kemi një hero, ta zëmë, si Din Hyka, në veprat tona mbi fshatin, ndonëse edhe në fshat ka shumë të tillë si Riza Burja që sulmon drejt vitit 2000. A nuk është kjo një prapambetje, që duhet të kapërcehet. Ose të marrim temën e klasës punëtoare. Ende si ndër heronjtë më të realizuar me këtë temë mbetet Din Hyka. Pa dyshim, Din Hyka ishte një realizim dinjitoz i një stadi të caktuar zhvillimi, por letërsia do pasuruar me karaktere të reja heronjsh, sepse edhe në jetë, në

gjirin e klasës punëtore, shembujt e heroizmit të lartë janë të shumët.

Duke folur për temën e klasës punëtore, le të ndalemi te revolucionin tekniko-shkencor, i cili, siç dihet, në radhë të parë, është vepër e vetë masave punonjëse. Po çfarë terrene i pasur dhe i gjithanshëm është ky përveprat letrare, për të pohuar edhe artistikisht të vërtetën e tij jetësore se shkencën tek ne e bëjnë masat e gjëra popullore, të cilat çajnë çdo bllokadë, se si revolucionin tekniko-shkencor zhvillohet e përsoset më tej në luftë me prapambetjen, me qëndrimet liberale dhe konservatore, se si kalitet dhe aftësohet njeriu ynë i ri me ndërgjegje dhe psikologji revolucionare, me tiparet e moralit komunist.

Në këtë mënyrë, tema e revolucionit tekniko-shkencor do të krijonte mundësi të pasqyrohej edhe lufta kundër pikpamjeve borgjeze dhe revizioniste, duke demaskuar falsitetin e «tezave» të tyre në lidhje me këtë problem.

I shtrirë në këto përpjestime, pasqyrimi i kësaj teme në veprat letrare do të përbënte një problem kardinal të jetës e të punës së klasës punëtore. Në këtë mënyrë do të silllej material i ri e i gjerë jetsor, do të pasurohej figura e heroit pozitiv, duke pasë si prototipa njerëzit tanë revolucionarë të periudhës aktuale të zhvillimit e të luftës së sotme klasore, në kushtet e rrethimit imperialisht-revizionist. Vetë rrethimi borgjezo-revizionist dhe bllokada e tyre e egër do të jepej në një kuadër më të gjerë, ashtu si është në realitet dhe s'do të ngushtohet vetëm në ca konflikte me ish specialistët e huaj. Për të pasqyruar më mirë njeriun dhe jetën tonë në stadin e sotëm të zhvillimit, në këtë drejtim mund të bëhej më tepër edhe me figurën e intelektualit, duke iu larguar shtampave dhe konflikteve të kërkuara në pasqyrimin e tij, duke e parë atë më tepër në zhvillim e sipër, në përpjekjen që bën edhe ai, së bashku me punëtorët dhe fshatarët, për të futur në vetvete cilësitë e thjeshtësisë e të karakterit proletar. E kështu me radhë, mund të bëhej më tepër edhe në pasqyrimin e figurës së gruas, duke e dhënë në shkallën e re të emancipimit të saj, duke zbuluar rolin përherë më të madh që po luan ajo në tërë jetën shoqërore. Letërsia jonë mund ta pasqyrojë më mirë lëvizjen e gjërë të të rinjve e të rejave për të punuar e jetuar përgjithmonë në fshat, si lëvizje masive revolucionare.

Po kështu, duhet pasqyruar më mirë në letërsi shkolle jonë, e cila ka zhvilluar një revolucion të tërë në përmbajtje dhe në strukturë, duke u lidhur ngushtë me jetën, që t'i përgjigjet më mirë detyrave të zhvillimit aktual e prespektiv të jetës. Kjo është një detyrë e rëndësishme, sepse edhe këtu, si në çdo sferë tjetër, zhvillohet një luftë këmbëngulëse për kapërcimin e vështirësive, për afirmimin e koncepteve dhe praktikave revolucionare, kundër atyre liberale dhe konservatore, duke krijuar edhe në shkollë një jetë aktive në fushën e mendimit e të praktikës pedagogjike. Si e tillë, shkolla i ofron letërsisë subjekte e problematikë të rëndësishme dhe të larmishme. Prandaj, për pasqyrimin e jetës së shkollës, ku jeton e militon një armatë e tërë mësuesish e pedagogësh, nxënësish e studentësh, duhet bërë më shumë.

Veçanërisht pas Plenumit të 4-t të KQ të PPSH, letërsia jonë, pothuajse, në të tërë gjinitë shënoi suksese të rëndësishme. Në poezi u krijuan vepra të tilla të rëndësishme si poemat «Mesazhi», «Drejt qindra shekujsh shkojmë», «Firma e popullit tim», vëllimet poetike të Kadaresë, Papekës, Gjetjes dhe në këto arritje, ndalemi në mënyrë të veçantë te poema madhore «Nënë Shqipëri», e cila u bë e dashur për lexuesin e gjerë, pikërisht sepse në të u ngrit në art jeta jonë e sotme, me problemet e saj më të rëndësishme.

Më duket se në raport me një dekadë më parë, kur revolucionarizimit të mëtejshëm të jetës, pavarësisht nga nivelet dhe arritjet, iu përgjigj flakë për flakë një letërsi e tërë me temë aktuale, në të gjitha gjinitë, dekada që pasoi nuk gjeti pasqyrim të mjaftueshëm. Megjithatë letërsia pati suksese në tërësinë e saj, veçanërisht romani, në kuptimin e pasqyrimin të zhvillimit të sotëm, edhe ai mbetet borxhli. Prandaj kërkesa që letërsia të ecë me ritmet e kohës, plotësohet kur ajo të pasqyrojë më shpejt, më shumë e më bukur zhvillimin shoqëror aktual, që të frymëzon për vepra të mrekullueshme.

Inisiativat revolucionare që kanë shpërthyer për të vënë në jetë programin madhështor të Kongresit të 7-të të Partisë, realizimi i rendimenteve të vitit '80 që këtë vit, flet për atë lëvizje të fuqishme revolucionare, që kapërcen kohë e vite, gjë që e bën akoma më urgjente dhe më të mprehtë detyrën e pasqyrimin të aktualitetit, i cili, me madhëstinë e tij, krijon tema të denja për vepra letrare.

**NGA NENREFERATET  
DHE DISKUTIMET  
PER ARTET FIGURATIVE**

## PROBLEME TE PARTISHMERISE PROLETARE NE ARTET FIGURATIVE

Partia gjithmonë e ka orientuar artin tonë drejt pasqyrimit të jetës së popullit, të punës dhe të luftës së tij, të realitetit aktual dhe historik të vendit tonë. Pa u hedhur në historinë 30-vjeçare të pikturës dhe skulpturës sonë të re, mjafton të përmendim realizimet e mëdha të këtyre 3-4 vjetëve të fundit në dy ekspozitat kombëtare të arteve figurative, të asaj të 30-vjetorit të çlirimit të atdheut dhe të 35-vjetorit të themelimit të Partisë, në të cilat krijuesit tanë dhanë vepra të frymëzuara në dobi të edukimit komunist të njerëzve tanë. Në to është zbatuar me besnikëri vija dhe orientimet e Partisë dhe ka spikatur me forcë tendencioziteti klasor, partishmëria proletare.

Armiqtë e popullit F. Paçrami e T. Lubonja u orvatën të goditnin partishmërinë proletare dhe me këtë të largonin krijuesit tanë nga vija e Partisë, duke nxitur dhe përhapur rrymat e huaja moderniste, duke luftuar kundër karakterit kombëtar e popullor të artit me qëllim që ta largonin atë nga temat e mëdha problemore dhe ta orientonin në mikrotëma.



Nuk ishin të rastit krijimet e disa artistëve, të cilët, jo vetëm që nuk u mbështetën në parimet dhe vijën e Partisë, por u kapën pas «teorizimeve», pas elementeve formalë dhe, si rrjedhim krijuan punime me përmbajtje të gabuar, të cilat megjithse me ndikime të huaja, u ngritën nga këta «teorisienë» në pedestalin e veprave të «përkryera» e «realiste».

Puna armiqësore dhe ndikimet e huaja borgjeze dhe revizioniste në krijimtari, në letërsi e në art u dërmuan nga Plenumi IV i KQ të PPSH, nga fjalimet e rëndësishme të shokut Enver. Këto mësimë të çmuara u bënë orientim e flamur dhe u përqafuan njëzëri nga artistët tanë, të cilët i vunë në praktikën e tyre krijuese duke pasë si gjithnjë në bazë të metodës së realizmit socialist partishmërinë proletare.

Në këtë mënyrë u ngrit edhe niveli artistik i krijimtarisë sonë, siç e dëshmojnë edhe veprat e kohëve të fundit që trajtojnë tema të rëndësishme si: «Metalurgu», «Drejt lartësive», «Buka e duarve tona», «Atentatori», «Familja kooperativiste», «Gju më gju me popullin», «Vera e begatshme», «Fundi i armikut», «Punëtorët diskutojnë», «Revolta fshatare», «Yje të pashuar», «Trakti i Partisë» etj.

Në këto vepra partizani, punëtori, fshatari zenë një vend të gjerë dhe kjo lidhet me orientimet e Partisë, që në qendër të artit tonë të vendoset njeriu ynë i ri, heronjtë e kohës sonë, duke pasqyruar shumë më gjerë luftën, punën, karakterin heroik dhe revolucionar të tyre. Një aspekt të tillë e shikojmë edhe në vepra të realizuara më parë, p.sh. te «Monumenti i Pavarësisë», «Në një dorë kazmën e në tjetrën pushkën», «Lart frymën revolucionare» dhe «Flamuri i Partisë», te «Partizani Fitimtar», apo te monumenti i realizuar në kujtim të heroinave të Mirditës. Këto arritje janë rezultat i njohjes së jetës, janë rezultat i qëllimit të lartë që artistët i kanë vënë vetes për të na dhënë gjithnjë vepra të partishme. Aspekte të tjera shihen në veprën «Gju më gju me popullin» që pasqyron lidhjet e Partisë me masat. Udhëheqësi i Partisë në mes të malësorëve bisedon, shkëmben mendimet, dëgjon zërin e tyre. Këto aspekte janë vënë në dukje me forcë e tendenciozitet klasor. Me tendencë klasore e partishmëri, shprehet qartë e me realizëm lufta parimore e Partisë sonë në tablonë «Mbledhja e Moskës». Në këtë tablo është pasqyruar vija e qartë e demarkacionit midis marksistë-leninistëve shqiptarë e renegatëve revizionistë modernë, nëpërmjet një zgjidhjeje kompozicionale që forcon idenë

e luftës e të sulmit ndaj armiqve të ideologjisë marksistë-leniniste.

Trajtimi dhe zgjidhja e temave të tilla, të rëndësishme, që pasqyrojnë luftën e Partisë sonë në sferën ndërkombëtare, tregon se krijuesit e arteve figurative mund të trajtojnë tema të tilla dhe mund të arrijnë, pa dyshim, rezultate edhe më të mira.

Me tendencë e partishmëri klasore është realizuar vepra «Vrima e miut 500 grosh». Ajo jep me satirë të fortë figurën negative të komandantit ballist, i cili zbulohet i fshehur në mullarët e barit. Konflikti me armikun e klasës është realizuar e zgjidhur jo vetëm me tendencë të theksuar klasore, me partishmëri, por edhe me mjete të arrira artistike.

Me tendencë klasore proletare janë parë e realizuar punimet: «Gurhedhësi», «Vojo Kushi», «Zëri i masës», «Mic Sokoli» etj. si dhe punime të tjera nëpërmjet të cilave vihen në dukje anë tipike e historike të ngjarjeve siç janë: «Tregim nga Lufta Nacionalçlirimtare», «Tenda e qypit», «Shqiptonjat partizane», «Reforma agrare» etj.

Partishmëria proletare qëndron në zberthimin dhe realizimin e ideve, në realizimin e përmbajtjes, në thellësinë e ngjarjeve, të cilat janë të lidhura ngushtë me pasqyrimin e frymës klasore. «Që të shkruash vepra me vlerë, ... thotë shoku Enver, duhet të lidhesh me njerëzit, me popullin, të futesh, në gjirin e masave, jo vetëm sa për të gjetur subjektin...» Orientimet e Partisë dhe eksperiencia na tregon se gjithnjë e më shumë duhet të hyjmë në thellësinë e ngjarjeve, sidomos për temat e mëdha që ngrenë probleme e ngjarje të karakterit historik, politik e ideologjik. Hyrja në thellësinë e ngjarjeve do të thotë të njohësh mirë të gjitha rrethanat dhe të futesh në analizën e tyre, duke i realizuar ato gjithnjë në prizmin politik e ideologjik, në prizmin e partishmërisë proletare.

Për partishmërinë proletare nuk ka vetëm rëndësi tematika por edhe fakti si trajtohet ajo, si zgjidhet e realizohet ideja e veprës dhe fryma revolucionare e saj, si organizohen mjetet shprehëse.

Peizazhi ynë është pasuruar me temë të re, me përmbajtje të shëndoshë dhe me tendenciozitet. Ai karakterizohet nga një diapazon më i gjerë krijimi, me frymëmarrje të madhe, me kolorit optimist e transparent, me dritë të qartë siç është natyra e bukur shqiptare.

Me gjithë këto arritje një vëmendje më të madhe duhet t'i kushtojmë nivelit artistik në rritje, zgjedhjes së

temave ku të përfshihen më me forcë transformimet e mëdha të vendit, bukuria, epika dhe heroika e Atdheut. Në peizazhin tonë, duhet të vlerësohet edhe më shumë trajtimi i figurës së njeriut në raport me rrethanat ku jeton e punon, sepse, këtu, ka akoma boshllëqe dhe, në disa raste, ai minimizohet, ose vendoset ndërmjet makinave, në plane të dyta apo të treta, gjë, që e zbeh rolin e figurës së njeriut. Zgjidhja e këtyre çështjeve do të ndihmojë që peizazhi ynë t'u përgjigjet edhe më mirë kërkesave që dalin para krijimtarisë sonë aktualisht.

Pllakati, grafika, karikatura kanë luajtur një rol politik e propagandistik gjithnjë në rritje megjithatë ato kanë mundësi që të pasqyrojnë më shumë, më mirë, e flakë për flakë ngjarjet e kohës dhe tu bëjnë atyre jehonë në masat. Edhe kjo krijimtari është udhëhequr nga parimi i partishmërisë duke rrahur temën e Luftës Nacionalçlirimtare, temën aktuale të ndërtimit socialist, temën e luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit dhe luftës së klasave. Karikatura duke u mbështetur më gjerë në një plan politik e ideologjik, ka demaskuar me forcë, imperialistët, revizionistët, politikën e tyre me dy faqe, djallëzore, armiqësore e agresive. Ky aspekt i rëndësishëm e ka bërë karikaturën tonë më luftarake, aktuale dhe një mjet me rëndësi për edukimin e masave. Të tilla janë punimet në botimin e veçantë «Maskat e çjerra», karikatura «Në gjirin e Knerit» si dhe shumë karikatura të tjera, që trajtojnë me mprehtësi luftën kundër fesë, burokratizmit, teknokratizmit, kundër armikut të klasës. Të gjithëve na kujtohet Ekspozita «Satira në skulpturë», ekspozitë që ka lidhje me një temë politike e shoqërore dhe me një përmbajtje që godiste dhe satirizonte regjimin zogolljan, fashizmin dhe nazizmin, imperializmin, kulakun dhe mbeturinat e beshtytnitë në ndërgjegjen e njerëzve. Në krijimet «Satira në skulpturë» lufta e klasave pasqyrohej me forcë, jo vetëm në anën e saj tematike, me një satirë therëse, por edhe në përmbajtjen dhe realizimin e saj artistik.

Në veprën e artit, moszgjidhja e idesë, skematizimi, mostrajtimi i mjeteve shprehëse në përshtatje me përmbajtjen, largimi nga këndi realist i vështrimit, dobësojnë përmbajtjen dhe parimin e partishmërisë. Disa ndikime të tilla u dukën në ndonjë vepër të paeksponuar, nëpërmjet elementeve objektiviste e natyraliste, nëpërmjet zgjidhjes ideore të paarrirë. Në realizimin e perceptimit të temave dhe të ideve të tyre, rol të madh luan këndi i partishëm e realist i vështrimit. Mendimi për një këndvështrim të

ashtuquajtur «poetik», shprehur në ndonjë diskutim, është i gabuar dhe fsheh në vetvete një mendim estetizant. Këndi i vështrimit duhet të jetë revolucionar e realist, e brenda këtij përfshihet edhe poezia e jetës sonë. Sipas këtij këndi interpretohen fenomenet e jetës në zhvillimin e tyre revolucionar. Prandaj të flasësh për «kënd poetik të të parit» në këtë vështrim, do të thotë të harrosh parimin e partishmërisë në interpretimin dhe njohjen e fenomeneve të jetës, të harrosh këndin ideologjik e revolucionar. Kjo gjë shpie në një rrugë të gabuar, siç u duk në ndonjë skulpturë të paeksponuar, në të cilën vlerësohen mjetet e shprehjes të lidhura mbas estetizimit e stilizimit, duke harruar zgjidhjen e idesë, përmbajtjen. Prandaj tek këto lloj veprash nuk ka një zgjidhje të drejtë ideore. Në vend të një optimizmi, të një çasti madhështor e emocional, gëzimi e fitoreje, kemi ftohtësi, deheroizim.

Për artin tonë të realizimit socialist dhe për partishmërinë proletare skematizmi, manierizmi, fryrja dhe pompoziteti janë gjithashtu të huaja, sepse ndikojnë negativisht në veprën, ato zbehin përmbajtjen dhe karakterin e saj realist e militant. Prandaj në zgjidhjen e ideve, qofshin të temës historike, apo aktuale, kërkohet një studim e një interpretim më i thellë politik e ideologjik. Në qoftë se do t'i hedhim një sy grupit skulptural «Sup më sup si malet», do të konstatojmë se, megjithëse kemi të bëjmë me një temë të rëndësishme të ditës, siç është uniteti i popullit tonë, qëllimit të madh të saj nuk i është arritur, sepse autori është nxituar, duke përsëritur skema, duke mos i dhënë rëndësi kompozicionit dhe marrëdhënies së figurave, zbulimit të botës së tyre të brendëshme. Çështje të tilla domosdo dëmtojnë jo vetëm anën artistike të realizimit, por dëmtojnë kryesisht përmbajtjen e veprës. Këto duhet të evitohen nga krijimtaria jonë.

Në vlerësimin e veprave nuk mund të nisesh nga gjykime subjektive, jashtë parimeve, po nga kërkesat e artit tonë, në lidhje me përmbajtjen dhe formën. Këto kërkesa nuk mund t'i quash veprime të ndonjë «kodi të shenjtë rutine». Nuk duhet teorizuar e kërkuar slogane dhe emërtime, siç pretendohet për ekzistencën e ndonjë «kodi të shenjtë rutine», kur kërkohet zbatimi i parimeve të realizimit socialist.

Partishmëria proletare nënkupton edhe shfrytëzimin e elementeve përparimtare të traditës, por ajo duhet parë gjithnjë me sy kritik. Në kompozimin «Brigada e grave», vepër e paeksponuar, të bie në sy stili ikonografik, aspekte

mistike, megjithëse kemi të bëjmë me një temë aktuale. Trajtimi plastik, koloriti, zgjidhja kompozicionale, ana psikologjike e kësaj tabloje të shpien në rrugën e ikonografisë, në rrugën mistike. Rezultate të mira ka arritur autori në tablonë e Lace Backës. Elementët përparimtarë të traditës sonë artistike, dihet, se duhet të studjohen e të lidhen shumë ngushtë dhe organikisht me kërkesat aktuale të krijimtarisë sonë me kërkesat e partishmërisë dhe të shërbejnë për të forcuar përmbajtjen socialiste dhe karakterin kombëtar e popullor të saj.

Momentet kyçe që dalin nga vendimet e Kongresit VII të Partisë janë momente që lidhen me probleme qendrore të zhvillimit të vendit tonë, të ndërtimit të mëtejshëm të socializmit. Pasqyrimi në krijimtarinë e arteve figurative i këtyre problemeve e temave të mëdha lidhet me programin madhështor të ndërtimit të socializmit.

Parimi i mbështetjes në forcat e veta është një parim i madh marksist-leninist. Ky parim ka partishmëri e një përmbajtje të thellë revolucionare dhe duhet kuptuar e realizuar nga ne, në art, si një domosdoshmëri në kushtet e vendit tonë, ku duhet t'u bëjmë ballë me sukses bllokadave imperialisto-revizioniste. Pasqyrimi në artet figurative i këtij aspekti kërkon një njohje të thellë të jetës sonë. Artet figurative nuk mund të mos marrin parasysh aspektin e ri të industrisë sonë të rëndë, të prodhimit të gizës dhe të çelikut shqiptar. Kjo nuk është e rastit, por është rezultat i hovit revolucionar, i teknikës dhe shkencës shqiptare. Zhvillimi i industrisë së rëndë metalurgjike i hap perspektiva të gjera ekonomisë, por, kjo hap gjithashtu perspektiva për trajtimin në artet figurative të temave të mëdha nga industria, metalurgjia, nga klasa punëtore.

Në kushtet e tanishme të krijimtarisë sonë, ne artistët duhet të kthejmë edhe më shumë fytyrën dhe interesimin tonë në drejtim të trajtimit të temës së klasës punëtore, të temave të tjera të mëdha që lidhen me zhvillimin e vendit dhe me transformimet e mëdha që realizohen nga klasa punëtore. Njohja me jetën dhe punën e klasës punëtore, atje ku ajo derdh djersën dhe krijon të mirat materiale, ku punon për ndërtimin e socializmit, do të ndikojë edhe më shumë në realizimin e veprave artistike të partishme, duke e bërë kështu temën e klasës punëtore një temë qendrore të artit tonë figurativ.

Epoka jonë revolucionare kërkon një zhvillim të artit monumental, të pikturës murale, të mozaikut dhe të ar-

teve të aplikuara. Piktura monumentale është në hapat fillestare. Më shumë mund të ishte bërë sepse mundësitë ekzistojnë. Gjithashtu duhet kuptuar se zhvillimi i saj lidhet me kërkesat, me destinacionin e veprave dhe me parashikimin nga projektuesit të veprave të mëdha. Piktura murale monumentale duhet të gjejë vend në fasadat e uzinave, fabrikave, ambienteve social-kulturore etj. Idetë e Partisë, zhvillimi i revolucionit, ndërtimi i socializmit, etapat e ndryshme të historisë mund të pasqyrohen edhe më me forcë në pikturën monumentale. Kështu veprat e kësaj gjinie, jo vetëm që shprehin e propagandojnë në masat punonjëse vijën e Partisë nëpërmjet temave të mëdha, por ato bartin edhe tendenciozitetin e partishëm të krijimtarisë. Zhvillimin e pikturës monumentale duhet ta shikojmë, për vetë karakterin e saj, si një problem të mprehtë të pikturës sonë aktuale.

Kongresi shtroi detyra shumë të mëdha edhe për bujqësinë. Prandaj krijimtarinë tonë figurative ta lidhim më ngushtë pas këtij orientimi të rëndësishëm të Partisë. Detyra jonë është që të njihen dhe të trajtohen aspektet më të rëndësishme të jetës së fshatit tonë kooperativist, duke plotësuar një boshllëk që ndihet akoma lidhur me temën e fshatit.

Nga ana tjetër, vetë roli udhëheqës i Partisë dhe i figurës së komunistit është një fushë e gjerë për veprimtarinë tonë krijuese. Ky aspekt lidhet me trajtimin e temave që burojnë nga Historia e Partisë sonë, nga aktiviteti i saj në luftën ilegale, në Luftën Nacionalçlirimtare, në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit dhe në ndërtimin socialist të vendit. Kompozime të tilla si «Rreth Partisë», «Mbledhja e Moskës», «Themelimi i Partisë», «Traktet e para» etj. portretet e heronjve komunistë «Qemal Stafa», «Manush Alimani» etj. janë vepra me nivel të ngritur e realizim artistik të mirë. Por këto realizime e disa të tjera janë pak. Mbetet që krijuesit t'i kushtojnë një vëmendje më të madhe trajtimit të kësaj teme, sidomos në një pikëpamje më të gjerë. Partishmëria proletare në krijimtarinë e arteve figurative, do të pasqyrohet edhe më mirë, kur krijuesit të futen më thellë në trajtimin e temës së luftës së klasave.

Thellimi i artistëve në njohjen e kontradiktave antagoniste që shfaqen në luftë të ashpër me armiqtë e brendshëm dhe kundër imperializmit e revizionizmit, do ta bëjë krijimtarinë në artet figurative edhe më të partishme,

prandaj del detyrë e veçantë trajtimi i temës së luftës së klasave.

Thellimi i artistëve në njohjen e kontradiktave antagonistike që shfaqen në luftë të ashpër me armiqtë e brëndshëm dhe kundër imperializmit e revizionizmit, do ta bëjë krijimtarinë në artet figurative edhe më të partishme, prandaj del detyrë e veçantë trajtimi i temës së luftës së klasave. Veprat «Partizani fitimtar», «Marta Tarazhi», «Revolta fshatare», «Tenda e Qypit», «Fundi i armikut», «Fundi i sarajeve» etj. në përgjithësi janë realizuar me nivel të mirë artistik, por në ndonjë rast armiku i klasës është paraqitur imagjinar, siç është zgjidhja e kompozimit «Revolta fshatare», ku masat fshatare të revoltuara kanë djegur sarajet e beut dhe janë nisur në sulm për një luftë tjetër e cila mund të imagjinohet. Megjithë këtë dobësi, kjo vepër që trajton një temë të luftës së klasave, të revoltës fshatare për tokë, bukë dhe liri është një përpjekje shumë e mirë e autorit. Mendimet dhe vërejtjet kritike në drejtim të veprës, duke bërë një krahasim denigrues me cfurqet e «djajve» në tablonë e K. Idromenos «Dy rruget», janë të pathemelta, atje nuk kemi të bëjmë me një temë fetare, as edhe me personazhe që t'u përngjajmë djajve, por kemi të bëjmë me figura njerëzore, tipa fshatarësh të revoltuar, që zhvillojnë luftën klasore me armiqtë e klasës e të revolucionit. Pa dyshim, realizimi i veprave me temën e luftës së klasave, me konfliktet antagonistike dhe joantagoniste kërkon nga ne artistët një nivel ideologjik dhe artistik të ngritur, kërkon kulturë të gjerë, punë të ndërgjegjshme dhe tendenciozitet të theksuar klasor proletar. Realizimi i temave që pasqyrojnë luftën e klasave, që trajtojnë në gjerësinë e tyre konfliktin dhe kontradiktat, duke mos u përjashtuar armiku i klasës, do ta bëjnë krijimtarinë në artet figurative akoma më të partishme, do t'i japin asaj karakter kombëtar akoma më të theksuar.

Krijuesit e arteve figurative nuk mund të mos hedhin vështrimin në drejtim të gjendjes aktuale të atdheut tonë në këtë periudhë luftarake dhe revolucionare të masave punonjëse, që nën udhëheqjen e Partisë ka krijuar një epokë të vërtetë heroike dhe revolucionare, një epokë optimiste dhe madhështore, ku masat punonjëse të qytetit e të fshatit ndërtojnë me sukses socializmin në kushtet e rrethimit të egër imperialisto-revizionist. Ky heroizëm masiv, ky mobilizim total i masave, ky unitet rreth Partisë me shokun Enver Hoxha në krye janë karakteristikat re-

volucionare që shprehin me forcë tendencën klasore dhe parimin e partishmërisë proletare. Prandaj të kuptuarit qartë, thellë, politikisht dhe ideologjikisht, të kësaj periudhe heroike merr një rëndësi të veçantë për krijimtarinë dhe për ne krijuesit. Partia jonë orienon që këto cilësi e virtyte që karakterizojnë masat punonjëse në këtë periudhë të zhvillohen gjithnjë e më shumë dhe të trajtohen gjithnjë e më gjerë në krijimtarinë tonë artistike.

Janë pikërisht këto kërkesa esenciale të artit tonë të realizimit socialist, që kanë të bëjnë drejt për së drejti me parimet e partishmërisë proletare, me ideologjinë marksiste-leniniste të Partisë sonë. Këto kërkesa na shtrojnë detyrën, që ne artistët të shumfishojmë përpjekjet tona, për t'i kuptuar dhe për të luftuar për realizimin e tyre; gjithashtu është e domosdoshme që ne, të hyjmë më thellë në jetën e popullit për të ndjerë pulsën e tij, botën e tij shpirtërore, psikologjinë e tij, hovin revolucionar dhe qëndrimin e tij patriotik.

Ne duhet t'i bëjmë një analizë më të thellë krijimtarisë sonë për të njohur edhe më mirë arritjet, dobësitë dhe boshllëqet që kanë punimet tona dhe sidomos në drejtim të partishmërisë, në faktin sa e si është pasqyruar jeta jonë. Punëtorin, fshatarin t'i shohim në zhvillimin e tyre të sotëm sepse nuk janë të dikurshmit. Në jetën e masave punonjëse janë bërë ndryshime të mëdha cilësore, ato kanë fituar aspekte e cilësi të reja në punë e në shoqëri, në jetesën e kulturuar. Të gjitha këto aspekte duhen njohur dhe interpretuar në raport dhe me pozitën që zë njeriu ynë i ri në shoqërinë tonë socialiste.

Duke zbatuar me besnikëri në krijimtarinë e arteve figurative orientimet e Partisë dhe mësimet e shokut Enver, detyrat e Kongresit VII-të duke i përvetësuar ato gjithnjë e më mirë dhe, duke u lidhur gjithnjë e më ngushtë me jetën e popullit, ne krijuesit e arteve figurative do të krijojmë vepra realiste dhe me partishmëri të lartë. Forcimi i vazhdueshëm i kësaj partishmërie mbetet gjithnjë një detyrë bazë për zhvillimin e artit tonë figurativ të realizimit socialist.

## FORCIMI I KARAKTERIT KOMBETAR E POPULLOR NE ARTET FIGURATIVE

Një nga faktorët kryesorë që i japin artit të realizmit socialist frymë kombëtare është përmbajtja sociale revolucionare dhe lidhur me të forma, mjetet e shprehjes së saj.

Shoku Enver në Kongresin e 7-të të Partisë tha: «Përmbajtja socialiste e artit lidhet ngushtë me karakterin kombëtar popullor».

Artistët tanë që jetuan dhe krijuan para çlirimit, mbështetur në patriotizmin dhe dashurinë për Atdheun, në idetë e Rilindjes, duke përvetësuar elemente realiste nga arti klasik botëror kanë shprehur me një formë realiste idetë përparimtare të kohës, ata janë dalluar për krijimin e figurave me tipare shqiptare, për dhënien e ambienteve dhe të natyrës shqiptare, të koloritit karakteristik të vendit, për elementë të modelimit, të formës, të vizatimit etj. të buruara direkt nga arti ynë popullor dhe mbështetur në trashëgiminë e pasur të arteve figurative.

Odhise Paskali ka krijuar figura shqiptare të skalitura jo vetëm nga pikëpamja plastike, por edhe nga bukuria fizike, nga karakteri i fortë e burrëror, nga bota e pasur

shpirtërore. Figurat e patriotëve dhe malësorëve të tij janë tipa të qartë shqiptarësh me forcë të madhe përgjithësuese. Kompozimi «I urituri» është një vepër skulpturale, pasqyrë e vuajtjeve të masave në kushtet e rënda të realitetit shqiptar kur është krijuar. Kështu kujtojmë edhe krijimet më të mira të piktorëve K. Idromeno, V. Mio, S. Zega, A. Kushi, S. Rrota, Z. Kolombi, F. Stamo, N. Zajmi, punime të realizuara Paraçlirimit, që përbëjnë një pasuri të çmuar me vlera të rëndësishme, një traditë të shëndoshë për zhvillimin e mëtejshëm të artit tonë kombëtar të realizmit socialist.

Këto elementë kombëtarë të traditës, të përmbajtjes dhe formës janë zhvilluar më tej nga artistët tanë të realizmit socialist, të cilët në themel të veprës së tyre kanë vënë idealet revolucionare. Kjo brendi e re, e lindur dhe e diktuar nga vetë kushtet historike të epokës sonë pasqyrohet dhe ka gjetur shprehjen e saj në vepra të reja që kanë në themel një frymë të shëndoshë kombëtare, origjinale dhe të papërsëritshme.

Në kushtet aktuale, lufta që bën Partia dhe populli ynë kundër rrethimit imperialisto-rëvizionist, revolucionarizimi i mëtejshëm i jetës së vendit, pasqyrimi me realizëm i elementeve të reja që kanë hyrë në jetën e popullit, i jep artit tonë përmbajtjen kryesore, duke e bërë të dallohet nga arti ynë i mëparshëm dhe ai i kombeve të tjera.

Duke kujtuar shumë punime, edhe nga ato që pamë në Ekspozitën kombëtare të arteve figurative kushtuar 35-vjetorit të themelimit të Partisë, shihet qartë pasurimi dhe zgjerimi i tematikës, pasqyrimi i ngjarjeve dhe fenomeneve të reja, thellimi i përmbajtjes, e bashkë me të, forcimi i karakterit kombëtar. Sigurisht, orientimi i drejtë tematik luan një rol të rëndësishëm, se e shtyn artistin drejt anëve thelbësore të jetës, drejt një përmbajtje të shëndoshë e të rëndësishme. Por tema nuk përbën përmbajtjen e veprës. Sado e rëndësishme të jetë tema e një vepre, po që se ajo do të mbetet e zbehtë dhe nuk do të përshkohet nga ndërgjegja, nga emocionet dhe idealet estetike të krijuesit, nga pozita klasore e artistit të realizmit socialist, po që se materiali jetësor nuk shpreh një ide të rëndësishme atëherë vepra do të dalë e zbetë, pa jetë e pa emocione.

Shumë punime në pikturë, skulpturë apo grafikë të: O. Paskalit, Ll. Nikollës, K. Ramës, Sh. Hadërit, M. Dhramit, Z. Shoshit e F. Haxhiut janë një shembull i mirë në

këtë drejtim. Por, siç vumë re edhe kur u mblodhëm për të diskutuar Ekspozitën e 35-vjetorit të Partisë, pasi vlerësuaam lart arritjen e padiskutueshme të saj dhe evidencuam anët pozitive të punimeve më të mira u ndalëm edhe në mangësitë, veçanërisht në disa dobësi që kishin disa punime që trajtonin tema të rëndësishme, por që nuk zbulonin artistikisht si duhet përmbajtjen e tyre, tablo apo skulptura me temë nga historia apo aktualiteti ynë socialist. Kështu skulptura «Sup më sup si malet» me pikësnyime thellësisht kombëtare siç janë vetë idetë aktuale të mbrojtjes dhe unitetit, ka dobësi në kompozim dhe nuk e zbërthen këtë ide; në të mungon zgjedhja emocionale, mungojnë tipat dhe karakteret e vërtetë dhe jetësorë, pra është një skulpturë pa jetë.

Karakterit kombëtar zbehet gjithashtu në rastet e rrafshimit të kontradiktave, të zbutjes ose herë-herë të eliminimit të tyre siç ndodh në tabllonë «Gjorm-1943» ku forcat armike paraqiten si dordolecë rrëzuar përdhe apo në «Betejën e Mushqetasë» që është zgjidhur disi me kollajllëk, sipas disa skemave dhe mënyrave tashmë të njohura, ku partizanët paraqiten vetëm duke vrapuar. Vërtetësia historike e tablove të këtij realiteti ka një rëndësi të madhe, ajo të bën t'i besosh faktit real, ajo forcon karakterin kombëtar të artit.

Karakterit kombëtar nuk lidhet vetëm me trajtimin e temave historike, që kanë të bëjnë me pasqyrimin e luftës së popullit tonë për çlirim kombëtar. Ai nuk përcaktohet nga tematika e veprës, por ka një kuptim më të gjerë se sa trajtimi i motiveve patriotike në të cilat veçoritë kombëtare mund të jenë më të kapshme, por që nuk përbëjnë gjithë kuptimin e këtij nocioni. Karakter kombëtar ka edhe «Gurëhedhësi», «Mic Sokoli», «Vojo Kushi», «Zëri i masës», ka monumenti i Pavarësisë në Vlorë, skulptura «Lart frymën revolucionare» etj. Rëndësi ka që çdo vepër, me çfarëdo teme qoftë, që i takon së kaluarës apo ditëve tona, të përmbajë vullën e kohës sonë, idealet e socializmit, në to të ndjehet shpirti i shqiptarit, i njeriut tonë të ri.

Realizimi i drejtpërdrejt i formës, larg zbukurimeve dhe ngurtësimeve klasikegjante, është një karakteristikë si për skulpturën, ashtu edhe për pikturën tonë të realizmit socialist. Këtë e shohim në veprat e një radhë autorësh më të vjetër e më të rinj, që pasqyrojnë Luftën Nacionalçlirimtare, apo të kaluarën e lavdishme të popullit tonë, transformimet e mëdha të ndërtimit të shoqërisë

socialiste si: N. Zajmi, Z. Shoshi, F. Haxhiu, S. Shijaku etj. Në skulpturë kjo duket në një radhë bustesh të figurave të shquara të popullit tonë, patriotë, revolucionarë, heronj nga O. Paskali, J. Paço, M. Dhrami, K. Rama etj.

Me formën realiste lidhet edhe parafytyrimi i tipave karakteristikë shqiptarë si në pikturë, ashtu edhe në skulpturë, si pasqyrë e virtyteve më të mira të punëtorit, fshatarit, të komunistit shqiptar: guximi, shpirti luftarak, ndershmëria etj. («Malësori» Ll. Nikolla; «Bajram Curri» — G. Madhi; «Shkurte Pal Vata» M. Dhrami; «Shote Galica» K. Rama etj.). Por duhet vënë në dukje se shpesh nuk ka një thellim në dhënien e tipit, të karakterit, në skalitjen e tij; kjo ndikon edhe në karakteristikat e tij të brendshme, shpirtërore kombëtare edhe në dukjen e tij të jashtme fizike. Ndodh që në një tablo apo relief të punuar me kujdes të ndeshim tipa të përgjithshëm, pa karakteristika të veçanta individuale, me përjashtim të veshjes popullore. Kjo bie në sy sidomos në përfytyrimin e figurës së punëtorit. Veshja popullore është vetëm një element i formës kombëtare, i cili edhe mund të mos jetë fare në shumë raste dhe prapë piktura apo skulptura të ketë frymë kombëtare.

Duke ndjekur traditën e artit tonë, ndonëse të pakët, të periudhës së Rilindjes e të Pavarësisë, kompozimi ynë në pikturë, në skulpturë, në grafikë ka një shtjellim të lirshëm, të zhdërvjellët. Kjo e ka burimin në radhë të parë në vetë jetën, në ngjarjet që pasqyrojnë këto vepra, në historinë plot përpjekje të vazhdueshme, në luftat heroike popullore, në hovet kryengritëse revolucionare, në veprimtarinë e gjallë e të pandërprerë ndërtuese e transformuese të klasës punëtore e të gjithë popullit në socializëm, të cilat kanë lënë gjurmë të thella në psikologjinë e popullit tonë. Në qoftë se në kompozimet vihet re ndonjëherë ngurtësi apo njëfarë naiviteti, kjo rrjedh prej nivelit të pamjaftueshëm profesional, ose për shkak të imitimit të formave të huaja, qoftë edhe klasike, që nuk i përshkatan as karakterit e as jetës sonë socialiste.

Për pikturën dhe skulpturën tonë janë të huaja zgjidhjet e ngurta, të cilat vijnë nga klasicizmi apo neoklasicizmi, sepse kjo nuk i përshtatet shprehjes, psikologjisë sonë të vrullshme, karakterit demokratik të artit tonë, jetës sonë të gjallë revolucionare dhe nuk shërben për të zbuluar realitetin me kontradiktat dhe dramacitetin e tij. Nuk i përshkatan artit tonë, as format e ngrira kompozicionale të marra nga arti i lashtë egjipto-babilonas siç ka ngjarë në ndonjë rast, «Reliefi në Gorë kushtuar formimit të koope-

rativës bujqësore» — H. Beqiraj, e ndonjë tjetër, që nuk i përgjigjen as jetës, as ideve tona socialiste, as frymës sonë kombëtare.

Për pikturën tonë, për karakterin e saj kombëtar janë gjithashtu të huaja shfaqjet e manierizmit, të mënyrës së përsëritur e të konsumuar, që dëmton krijimtarinë, siç është rasti i tablosë «Libri në fshat» realizuar me mjete të konsumuara dhe sipas një mënyre kaligrafike irrealë, pjellë e mosnjohjes së jetës, e kontaktit të pamjaftueshëm me të.

Keqkuptimet për dekorativitetin në veprën e artit, kërkimet e piktorit për të qenë dekorativ në tabllonë «Vjelja e ullinjve», përpunimi i planeve dhe i ngjyrave jashtë realitetit dhe të vërtetës së jetës kanë mpirë figurat e fshatarëve në këtë vepër i kanë kthyer në plane të rrafshëta, të ngathëta e pa gjallëri.

S'kanë të bëjnë me karakterin kombëtar, përkundrazi dobësojnë dhe krijojnë rutinë edhe ato raste kur piktorë, p.sh. të Vlorës, në ndonjë rast në Shkodër, Tiranë, përsërisin njeri tjetrin, imitojnë ndonjë firmë që ka arritur sukses, duke mos bërë përpjekjet e duhura, në kontrast me jetën, për të krijuar sejcili gjuhën e tyre sipas mundësive dhe dhuntive që ka.

Elementet karakteristike kombëtare duhen edhe në dhënien e ambienteve dhe të peisazhit. Relievi i larmi-shëm, siluetet e ndryshme, koloriti i pasur që e sugjeron vetë natyra dhe jeta jonë e gjallë optimiste përbëjnë elementë kombëtarë të shumë peizazheve të F. Stamos, N. Zajmit, I. Lulanit etj. Por në peizazhin tonë të realizmit socialist hyjnë edhe elementë të rinj, ndryshimet, transformimet e mëdha që ka bërë dora e njeriut tonë që gjejnë pasqyrim në forma të dallueshme për karakteristikat kombëtare si vija e zhdërvjellët, ngjyrat e gjalla e optimiste.

Temperamenti i gjallë, vrulli shpirtëror, shpirti luftarak i popullit tonë ka gjetur shprehje edhe në një modelim plastik në forma të dukshme, të thelluara e dinamike në skulpturat «Partizani fitimtar», «Brez pas brezi», «Pas betejës» etj.

Kështu koloriti i gjallë intensiv, vizatimi ritmik e i zhdërvjellët në pikturë pasqyrojnë natyrën e vendit tonë, optimizmin e jetës sonë, karakteristika të psikologjisë së popullit. Pra këto janë gjithashtu elementë estetikë që vijin nga arti popullor.

Njohja dhe studimi i trashëgimisë kulturore të vjetër e të re, të popullit tonë u ka dhënë disa artistëve edhe mjete e forma që u kanë shërbyer me përmbajtjen e tyre

aktuale duke ndihmuar në karakterizimin dhe tipizimin kombëtar të veprës. Autorët e monumentit të 4 heroinave të Mirditës kanë shfrytëzuar në mënyrë krijuese cilësitë më të mira të skulpturës sonë realiste në veprën e O. Paskalit, S. Shijaku me «Mic Sokolin» gjeti frymëzimin e tij në folklorin popullor, në figurat e fuqishme artistike të krijimtarisë popullore.

Arti popullor i jep pikturës, skulpturës, grafikës, arteve të aplikuara dekorativitetin, ritmin e veçantë, gjë që mungon shpesh në disa vepra. Dekorativiteti i artit popullor pasuron artistikisht veprat e artit të kultivuar.

Por nga arti popullor janë marrë edhe elementë të veçantë si koloriti intensiv e i gjallë; ndërtimi kompozicional me pak sipërfaqe ngjyrash, dekorativiteti, vizatimi në konture të trasha e silueta të gjalla, me lëvizje që i gjejmë te B. Sejdini, S. Shijaku, V. Kilica. Në disa raste kjo gjë shfaqet në pasurinë e nuancave të ngjyrave të lehta, të thjeshta, ndërthurje të marra nga qëndisimat popullore ose që të kujtojnë ato si p.sh. te Z. Shoshi, N. Jonuzi etj.

Siç ka theksuar Partia edhe në njohjen e traditave ka rëndësi të parë përmbajtja, e cila në art duhet të shprehet në radhë të parë me vazhdimësinë e ideve shoqërore përparimtare që e kanë përshkruar, pa rënë në formë artistike, pa i kthyer gjinitë figurative në gjini dekorative e ornamentale siç mund të kemi pasur ndonjë rast, duke u munduar t'i vishet përmbajtjes së re një formë e vjetëruar, anakronike. Një formë e gdhendur në shekuj vlen fare mirë edhe për përmbajtjen e re sa kohë që ajo nuk bie në kundërshtim me të, por i shërben dhe e ekspozon qartë, mirë dhe drejt. Por kur ajo nuk i përgjigjet brendisë së re, e dëmton atë dhe idenë e veprës. Një gjë e tillë ndodhi me tablonë «Kur yjet mbushin qiellin», në të cilën përmbajtja me formën s'janë në unitet. Ose me tablonë «Brigada e grave» që nuk u vendos në Ekspozitën e 35-vjetorit të Partisë. Shfrytëzimi i artit popullor s'ka asgjë të përbashkët me primitivizmin, fenomen reaksionar që e shohim shpesh në artin borgjez e revizionist, ku në emër të formave kombëtare popullore kultivohet arti «naiv», krijimet dekorative etnografike.

Nga ana tjetër duhet të kemi gjithnjë parasysh se ndikimet formaliste që u vunë re në artin tonë para Plenumit IV të KQ të PPSH dhe që u dukën edhe në artet figurative, duke marrë hua elementë të formës nga abstraksionizmi, kubizmi e rryma të tjera moderniste, rrezikonin t'i jepnin artit të mirëfilltë dhe të aplikuar një

pamje kozmopolite, sipas modeleve borgjeze e revizioniste.

Madhështia e epika e jetës sonë sot, ndërtimi i socializmit me heroizëm, duke i bërë ballë rrethimit kapitalist e revizionist, veprimtaria aktive e masave kanë sugjeruar forma kompozicionale të gjëra në pikturë, trajtim në plane të gjera e të pastra, ku hyjnë detale karakteristike të njerëzve, të ambienteve, të natyrës shqiptare, ritmi e dekorativiteti i artit popullor dhe trashëgimia e artit tonë të kultivuar. Por gjithë ajo frymë heroizmi epik u ka dhënë monumenteve forma kompozicionale dinamike i ka pasuruar me tipa heroikë. Të gjithë këta elementë të rinj pasurojnë karakteristikat kombëtare të artit tonë të realizmit socialist.

Konceptimi i ri i realitetit, pasqyrimi i përmbajtjes së re të jetës sonë, interpretimi dhe aktualizimi i ngjarjeve të rëndësishme të historisë së popullit tonë nga pozitat revolucionare të ideologjisë sonë marksiste-leniniste, futja e elementëve të rinj në përmbajtje dhe formë siç janë fryma e theksuar luftarake, epika dhe romantizmi revolucionar, optimizmi, solidariteti socialist, uniteti, fryma e internacionalizmit proletar etj.; ambienti dhe tipat tanë, përdorimi i mjeteve shprehëse emocionale me një gjuhë realiste të qartë e të kuptueshme, me plot dinamizëm e kontraste, që përshkohen nga koloriti i gjallë e plastika e ngjeshur, janë shprehje e origjinalitetit dhe e frymës kombëtare, të cilat, në vazhdimësinë e vet, kanë ndihmuar për shfaqjen e dukurive të reja në artin tonë, duke krijuar në këtë mënyrë traditën e re të realizmit socialist.

Në këtë vështrim novatorizmi i arteve tona buron nga përmbajtja që ato kanë sjellë e, njëkohësisht, edhe nga forma me të cilën trajtohen.

Por krahas kësaj, në rrugën e zhvillimit të arteve tona ka patur edhe zigzage, ndonjëherë të meta e gabime deri në shtrembërime që burojnë nga keqkuptimi për novatoren dhe vlerësimin e traditës, apo për raportin midis tyre, që i kanë sjellë dëm krijimtarisë.

Para Plenumit IV nga disa krijues filloi të mohohej tradita dhe të identifikohet ajo me konservatorizmin dhe të shtrohej kërkesa e domosdoshme që pasqyrimi i realitetit tonë të bëhej vetëm nëpërmjet mjeteve të reja shprehëse, sepse ata e kuptonin «novatorizmin» vetëm në formë, të shkëputur nga përmbajtja, nga tradita, duke harruar mësimin e njohur të estetikës sonë marksiste-leniniste se: «edhe mënyra tradicionale mund t'i shërbejë përmbajtjes së re për aq kohë sa ajo nuk bie në kundërshtim me të».

Gjithashtu, duke përdorur me vend e pa vend fjalën «etnografizëm», «arkaizëm», edhe në artet figurative folklori filloi të bëhej «gogol», të indentifikohet me konservatorizmin, se gjoja ai, me format e tij tradicionale, me kostumet dhe qeleshet, po pengonte frymën «novatore». Armiku i Partisë F. Paçrami fyente disa artistë të moshuar të cilët duhet të hiqnin dorë nga arti si «anakronikë» e të «demoduar». Atij nuk i pëlqente monumenti i Skënderbeut dhe «Nëna Shqipëri», ndërsa ndonjë tjetër e quajti ekspozitën kushtuar 500 vjetorit të Skënderbeut si diçka që binte era myk.

Teorizimet e gabuara, që mbështetnin dhe justifikonin ndikimet e huaja në krijimtarinë tonë të arteve figurative, kanë rrjedhur edhe nga ngatërrimi që iu bë para Plenumit IV novatores me modernizimin, duke krijuar shpesh konfuzion ideor në trajtimin e këtij problemi, duke dëmtuar karakterin kombëtar të artit tonë.

Antikombëtare për artet tona figurative kanë qenë edhe mendimet që janë dhënë lidhur me vlerësimet e tablove «Epika e yjeve të mëngjezit», «Mbjellja e pemëve», si asimilim të kulturës botërore duke pranuar mundësinë e përfitimit në teknikë nga disa rryma moderne si kubizmi etj.

Ngushtësia tematike, preokupimi i disa krijuesve që para Plenumit IV ishin nën ndikimin e ideologjisë borgjezo-revizioniste, për temat e vogla intime, për kodrat, malet si motive në vetvete pa ide dhe subjekt, kërkesat e tyre për «temën e lirë», që u kurorëzua me ekspozitën e parë të pranverës në Tiranë, denigrimi që i bëhej tablosë tematike nga disa, si një kërkesë burokratike e hierarqike, kanë qenë gjithashtu në dëm të thellimit të karakterit kombëtar të arteve tona figurative.

Problemet e karakterit kombëtar të arteve figurative duhen parë dhe trajtuar në gjithë gamën e tyre, në gjinitë dhe zhanret e artit të kultivuar, apo aplikativ, në rolin që luajnë piktura dhe skulptura e kavaletit, ato monumentale apo dekorative, grafika e librit apo e aplikuar, pllakati, karikatúra, skenografia, qeramika, tekstili dhe kostumografia, punimet në qelq dhe lloje e tjera nga më të ndryshmet, vlera të shquara të kulturës shpirtërore të një populli, që luajnë që rol jashtëzakonisht të madh në edukimin ideoestetik të masave, në thellimin e karakterit kombëtar të kulturës dhe artit të një populli.

Thellimi i arkitekturës në problemet e karakterit kombëtar është gjithashtu një detyrë e rëndësishme që vuri Kongresi i 7-të i Partisë «Përmbajtja që vihet re në realizi-



*min e frymës e të fizionomisë kombëtare në disa lloje të artit, e sidomos në arkitekturë, kërkon të ndërmerren studime e të bëhet një punë e madhe kërkimore».*

Shkolla jonë e artit, ka detyra të rëndësishme në pregatitjen e talenteve të reja në thellimin e karakterit kombëtar të saj, mbështetur në rezultatet e deritanishme, në shtrirjen e këtij aspekti në gjithë gamën e gjinive të artit figurativ.

Kjo është një detyrë e të gjithë krijuesve të vjetër apo të rinj në moshë.

Në këtë mënyrë, artet tona figurative do të shënojnë arritje të reja, do të forcojnë edhe më shumë fizionominë kombëtare e frymën popullore, do ta rrisin militantizmin e tyre.

## ZHVILLIMI I ARTIT TONË NE LUFTE ME ARTIN DEKADENT BORGJEZO-REVIZIONIST

Ndërtimi i socializmit i kulturës e i artit tek ne, bëhet gjithnjë në luftë me presionin e vazhdueshëm e të gjithanshëm borgjezo-revizionist.

Po mbushet gati një shekull që arti dekadent borgjez përpiqet të nxjerrë në dritë «kryeveprat» e tij. Kjo përpiqje e financuar e propaganduar dhe e lustruar nga borgjezia dhe revizionizmi modern, nuk ka dhënë veçse plagë të pashërueshme.

Lufta jonë kundër artit dekadent borgjezo-revizionist është pjesë përbërëse e gjithë luftës që bën populli i udhëhequr nga Partia për të mbrojtur dhe zhvilluar At-dheun tonë socialist, është pjesë e luftës së klasave në frontin ideologjik. Në luftë me izmat borgjeze është manifestuar forca e artit tonë.

Detyrat që na vuri Kongresi i 7-të i PPSH për të luftuar artin borgjezo-revizionist janë të mëdha e të rëndësishme. Piktorët, skulptorët, artistët e arteve të aplikuara me krijimet e tyre më të mira do të marrin pjesë aktive në këtë luftë.

Sot borgjezia e revizionizmi vazhdojnë të fabrikojnë e të hedhin në luftë kundër artit revolucionar, pje-

llat e tyre të degjeneruara plot vdekje e kalbësira, plot lluks e boshllëk. Në se në këtë kryqëzatë diçka del nga moda apo demaskohet vendin e saj e zë një «izëm» tjetër, më dekadente e më e rafinuar se e para, e cila prapë hiqet nga përdorimi porsa i del boja, e prapë zëvendësohet me fenomene të tjera, që përhapin mikrobin e degjenerimit borgjez.

Në këto situata çdo izëm e artit borgjez është një luftë e ideologjisë borgjeze. Çdo largim nga metoda e realizmit socialist është forcim i influencës së artit dekadent borgjezo-revizionist. Vënë në jetë mësimet e Partisë e sidomos vendimet e Plenumeve të 4-t dhe të mësimëve të fjalimit të 20 Dhjetorit të shokut Enver bëri që artet tona të ecin gjithnjë përpara si arte të partishme në luftë të papajtuashme me izmat dekadente.

Ne luftuam kundër shfaqjeve formaliste e moderniste, që tentonin ta shtynin artin tonë drejt antirealizmit, ta bënin kështu vegël në duart e armiqve për të lizoditur njerëzit. Ne luftuam kundër shfaqjeve të konservatorizmit e natyralizmit, që tentonin të mbanin artin tonë të nanurisë në kanone të vdekura, brenda studjove, në një kohë kur në rrugë thërriste jeta e revolucionit.

Shfaqjet e huaja në artin tonë, të servirura në forma të ndryshme, deri në një platformë të veçantë estetike, me ekspozitat e pranverës, ose me vepra si «Epika e yjeve të mëngjezit», «Pusi i naftës», «Çrrënjosja e ideologjive fetare», skenografia e operas «Traviata», ndonjë ndërtim social kulturor a studim urbanistik etj., përfaqësonin një presion të hapur borgjez, revizionist kundër partishmërisë e tendenciozitetit të artit tonë, kundër frymës së tij kombëtare e popullore. Synimi i tyre ishte të «zgjerohej» nocioni i realizmit socialist e në të të futeshin elemente nga «izmat» perëndimore, që duke harruar natyrën reaksionare të tyre, të shfrytëzoheshin gjoja për të freskuar e rinuar artin tonë. Presioni borgjezo-revizionist vazhdon edhe sot me gjithë goditjet që ka marrë. Në këtë luftë klasore ne kemi metodën tonë të realizmit socialist, që e mbrojmë me veprat tona të partishme, revolucionare dhe me mendimin tonë estetik.

Aktualisht ç'detyra nxjerrim nga Kongresi i 7-të i Partisë për të luftuar kundër artit borgjezo-revizionist?

Partia ka porositur që të kemi një kuptim të drejtë për situatën, për fenomenet e reja artistike që zhvi-

llohen. Të kemi besimin se e nesërmja i takon artit që bart idetë e revolucionit, artit të ideve të Partisë. Brukosja jonë me këtë bindje na bën ne luftëtarë të ndërgegjshëm e të pathyeshëm kundër izmave dekadente. Fryma shoviniste e ekspansionit, ashtu edhe fryma pacifiste e kapitullimit, e pajtimit, e bashkëegzistencës paqësore, e qetësisë falso apo e fatalitetit para situatave është një strategji e tërë borgjezo-revizioniste. Kjo garanton udhëheqjen e Partisë në krijimtarinë tonë, garanton kontrollin e klasës në të, garanton dhe analizën e drejtë në fenomenet e sotme artistike. Sot, siç është e domosdoshme, lufta që bën Partia jonë kundër degjenerimit revizionist në ideologji, në emër të marksizëm-leninizmit, siç është e domosdoshme lufta që bën populli ynë për të ruajtur fitoret e arritura me gjak e sakrifica, për të ruajtur lirinë e pavarësinë e tij, është pra e domosdoshme dhe lufta e arteve tona kundër artit dekadent borgjez e revizionist. Artet tona nuk do bëhen fokuse formaliste linjash, vëllimesh, formash e fakturash; artet tona janë mjete lufte në duart e masave punonjëse. Ato sot japin tonin në jetën shpirtërore të njerëzve duke trupëzuar idetë e mësimet e Partisë. Në raportin e shokut Enver në Kongres u analizua thellë e në mënyrë shkencore natyra e këtyre fenomeneve. «Socializmi, tha shoku Enver, mund ta kufizojë shumë lindjen e fenomeneve negative, që nuk janë të natyrës së tij, por nuk mund t'i mënjanojë krejt». Pranimi i natyrës objektive të fenomeneve negative në shoqërinë socialiste nuk do të thotë në asnjë mënyrë se ato janë një fatalitet. Eksperienca e ish vendeve socialiste ka treguar se në rast se një fenomen negativ pranohet si fatalitet, në rast se ai nuk zbulohet nuk luftohet, atëherë këto fenomene e gryejnë artin socialist.

Plenumi i 4-t i KQ luftoi me forcë shfaqjet e huaja që u dukën në letërsi e arte, gjithashtu mësimet e Kongresit të 7-të na porositin ta mbajmë këtë luftë gjithmonë të gjallë. Armiqtë e kanë halë në sy Partinë tonë, vendin tonë, e artin tonë. Ata na kanë sulmuar dhe do të vazhdojnë të na sulmojnë, por, siç thuhet tek ne: «Ata na kanë në grykë të pushkës ne i kemi ata në grykë të topit». Nga vendet revizioniste lufta kundër artit tonë bëhet me lloj-lloj parrullash. Disa na luftojnë me pseudoartin e tyre, të tjerë me parrullat e «kujdesit» për realizmin socialist shesin në treg modifikimet revizioniste gjoja kundër ngushtësisë tematike, kundër kanonizimeve etj.

Këtyre këmbanave ata do t'u bien vazhdimisht. Detyrë e jona është lufta kundër miopisë ideore e profesionale, rritja e vëzhgimit revolucionar për mbrojtjen e zhvillimit në rrugë të pastër të artit tonë.

Përvoja e luftës sonë kundër artit borgjezo-revizionist tregon se armiku përpqet të mbajë gjallë shpresat për ta kthyer artin prapa, për ta veçuar atë nga populli nga Partia. Në vendet revizioniste ai u mbështet te njerëzit e molepsur rëndë nga ideologjia e vjetra, u mbështet tek krijuesit e çoroditur nga ndikimet e ideologjisë së sotme borgjeze, të cilët ishin të predispozuar të thyheshin para presionit të artit borgjez e revizionist. Artet tona nuk mund të shkojnë përpara jashtë kësaj lufte dhe as mund të presin që të jenë të sulmuara në befasi, por ato bëjnë një luftë të vazhdueshme në mbrojtje të metodës së realizmit socialist. Ashtu si masat revolucionare, kudo në botë, e duan fjalën e Partisë sonë, po ashtu ato kanë nevojë për një art revolucionar si yni. Lufta jonë, kundërvënja tendencioze ndaj artit të shëmtuar e kundërrivolucionar modernist, kërkon që secili nga ne të kuptojë se lufton për të mbrojtur vijën e Partisë, artin tonë të madh e kjo luftë kërkon pjesëmarrjen aktive të artistit, rritjen e vazhdueshme të mjeshtërisë artistike, pjesëmarrjen e tij aktive në luftën klasore, në problemet e kontraktat, në fatet e njerëzve, jo në rolin e soditësit, por në rolin e militantit të vijës së parë. Natyra kundërrivolucionare e artit borgjezo-revizionist nuk ndryshon.

Shoku Enver tha në Kongresin e 7-të të PPSH-së: «*Arti ynë socialist, me idealet e tij revolucionare dhe me synimet për t'i shërbyer socializmit dhe popullit ngrihet përballë artit të çoroditur dekadent borgjez dhe revizionist, i kundërvihet filozofisë reaksionare, pesimiste e kapitulluese*».

Në kushtet e sotme kur dy superfuqitë, të nisur nga qëllimet e tyre hegjemoniste për sundimin dhe për skllavërimin shpirtëror e politik të popujve, përhapin idetë e të ashtuquajturit ndërkombëtarizim të artit dhe të kulturës, ka shumë teorizime e veprimtari krijuese konkrete, që i stimulojnë këto objektiva. Këto dukuri janë njëkohësisht pjellë e qëndrimeve kozmopolite, e humbjes së dinjitetit kombëtar, e nënvleftësimit të vlerave të artit kombëtar. Prandaj në këtë situatë, kur shpallen si të kaluara shkollat kombëtare të artit, kur praktikohen idetë kozmopolite të «ndërkombëtarizimit», të «bashkësisë socialiste» e të «unifikimit të artit» e rrymave artistike,

është detyra jonë të mbështetemi fort në tabanin kombëtar, të evidentojmë e të kultivojmë atë traditë të shkëlqyer të krijuar dje dhe sot. Këto krijime të fuqishme, të realizuara me partishmëri, frymë kombëtare e pathos revolucionar, t'ia kundërvëmë fytyrës dekadente të artit borgjezo-revizionist. Në këtë luftë arti ynë përkrahet nga krijimtaria përparimtare artistike e popujve të tjerë të botës.

Kulti i brendisë boshe, i çlirimit prej arsyes, ose mohimi i njeriut si qenie e ndërgjegjshme, absolutizimi i fenomeneve iracionale në dobi të shprehjes të lirë të impulseve të brendshme të artistit ka krijuar mijëra e mijëra «vepra» pa përmbajtje, (të çliruara, sipas esteteve borgjezë, nga paragjykimet sociale dhe pa angazhime ideologjike). Artistët modernë dekadentë i kanë të fshira tiparet dalluese kombëtare. Një modë e përbashkët kozmopolite i bashkon ata si rendja pas kultit të brendisë boshe, kundërvënja tendencioze ndaj artit realist revolucionar. Në këtë kor bashkohen dhe ato vepra që e trajtojnë botën si ndeshje me vetveten, si pjellë të kontraktave të brendshme, e forcave që e gryejnë, që e çojnë drejt dekompozimit, drejt shpërbërjes e rënies shpirtërore. Kjo ka krijuar një mori veprash ku estetizohet e shëmtuara. Kulti i së shëmtuarës, i patologjikes, i llahtarit, i tmerrit të vdekjes e kalbëzimit ka mbushur sidomos mjaft vepra që trajtojnë temën e luftës. Ky është përdhunimi i botës shpirtërore të lexuesit e spektatorit, duke e ngarkuar atë me lloj-lloj monstruo-zitetesh të kësaj natyre, që është shfaqje evidente e diktaturës borgjeze në art. Sot tema e tmerreve të luftës zë një vend gjithmonë e më të gjerë në artin revizionist. Figura grash të veshura me të zeza dhe qirinj në duar enden në një mori gërmadhash të qyteteve të shkatërruara, midis fushave të lëna djerrë, para hapësirash të frikshme. Asnjë fije jete s'ka për to, çdo gjë ka pushuar së ekzistuari dhe nuk ka asnjë shpresë.

Duke vringëlluar armët në politikë, social-imperialistët, edhe nëpërmjet veprave të artit, përpqen të imponojnë frikën dhe pasigurinë që duhet të shkaktojë çdo rezistencë ndaj politikës së tyre të diktatit. Kjo politikë imperialiste gjen mishërimin e vet me vepra të tilla, që edhe kur bëjnë fjalë për momente historike, gjithmonë aludojnë drejt këtij ankthi, kllapie e pasigurie, që i shkon për shtat logjikës revizioniste.

Krejt e kundërta ndodh në artin tonë. Temat nga Lufta kanë zënë dhe do zënë një vend të rëndësishëm në krijimet tona, po aty ne do të japim akoma më fort se deri tani, bukurinë e heroizmit, idealet e ndritura të heronjve tanë. Tiparet e prepotencës dhe të arrogancës së artit të shtetit të madh manifestohen në arkitekturën e kapitalit prepotent, në arkitekturën e kontrasteve, por manifestohen edhe me ndarjen e sferave të krijimtarisë. Një tipar i ndjenjave rusomadhe duket p.sh. në vetë përmbajtjen dhe programin tematik të artit revizionist. Piktorët rusë p.sh. përpiqen të imponojnë prestigjin e tyre nëpërmjet formatesh e manierash gjigande, ndërsa piktorëve e artistëve të republikave jo ruse, u rezervohet një vend i reduktuar, që përmbledhet në paraqitjen e disa zakoneve e ndërtimit të mejhaneve, lokale tradicionale. Kështu në veprat e piktorëve të republikave aziatike, vihen re gra e burra të ulur këmbëkryq mbi qylyma, të shtrirë në ekstazë pranë dritareve dhe hijeve të pemëve, ose natyra të qeta me enë, rrush e shalqi, pra kryesisht tema ekzotike, njësoj siç vepronin kolonialistët e dikurshëm. Kjo frymë shtrihet dhe në sferat e arteve të aplikuara dhe në trajtimin e interjereve të urbanistikës, të qyteteve, të një arkitekture reklame ku xhami, çeliku e betoni bëjnë ligjin. Edhe në qoftë se në ndonjë qoshe bëhet ndonjë tentativë për të mos mbajtur pozë të tutelës ndaj kombësive, ajo del e qartë prej boshllëkut e cektësisë artistike të saj, prej orientimit të përcaktuar nga klikat revizioniste, që shpallin se internacionalizimi i jetës të njerëzve sovjetikë çon në vdekjen e shpejtë të gjithshkaje që është «arkaike kombëtare», ose që në këtë bashkësi socialiste doemos arti rus shpallet si kanali më i pasur i «bashkësisë internacionaliste». Nëpërmjet formave të «bashkësisë socialiste» të ndarjes së punës, KNERIT etj. revizionistët vendosin një kontroll dhe çfrytëzim të egër mbi vendet satelite. Por në veprat e arteve figurative i thuren lavde këtij bashkëpunimi, kudo ndjehet figura e rusit të madh. Ndjenja e shovinizmit të shtetit të madh, e Ruisë së madhe, ka pushtuar gjithë kasnecët e artit revizionist, që përpiqen të mbajnë gjallë këtë psikozë si në popujt e kombësitë e tjera të Bashkimit Sovjetik ashtu dhe në gubernat e tyre satelite. Detyra jonë është t'i kundërvihemi këtij superarti e kësaj superkulture të fuqive imperialiste, të mbrojmë e të zhvillojmë artin tonë, kulturën tonë kombëtare. Ne duhet të bëjmë

një punë më të thellë shkencore, të luftojmë qëndrimet e cekta në trajtimin e përpunimin e frymës kombëtare të motiveve nga arti popullor, të kuptimeve të ngurta mbi tipizimin e standartizimin, ose të kuptimeve banale për të, si një veshje e jashtme, të luftojmë dhe ndjenjën e inferioritetit e nënvleftësimit të forcave tona krijuese që shfaqen ndonjëherë. Në disa sektorë, si në arkitekturë, Kongresi i 7-të nënvizoi prapambetjen që vihet re dhe detyrat që dalin. Duke u udhëhequr nga mësimet e Partisë, duke u orjentuar nga populli për të krijuar një art që të ketë jetën e tij, fjalën e tij, humorin e tij, psikologjinë dhe shijen e tij, ne do ta forcojmë artin tonë në luftë me kozmopolitizmin borgjez, revizionist dhe me artin e supershteteve.

Një tipar thellësisht reaksionar, i fshehur pas adresimit nga tradita, që ka përfshirë gjithë vendet revizioniste është kthimi i vëmendjes drejt pikturës bizantine, drejt motiveve mistiko-fetare si në përmbajtje ashtu edhe në formën artistike. Në mori veprash përshkohen nga misticizmi, pesimizmi e zymtësia. Motivet e dikurshme biblike, kanë vërshuar gjithandej, shpesh të mveshura vetëm në sipërfaqe nga tituj e emra, që nuk lidhen as me përmbajtjen, as me mjetet e shprehjes e që janë kopjime banale të ikonografisë. Ndjenjat rusemadhe edhe me këtë tipar marrin një karakter konkret. Ato përzihen me nostalgjinë për Rusinë e madhe, ortodokse dhe janë refleksi i asaj politike tradhëtare që ndjek klika revizioniste e Kremlinit.

Nga vetë vërshimi i opiumit fetar, nga botimi e propagandimi i biblës dhe i literaturës fetare vetëkuptohet dhe ai kthim i vëmendjes në artin e pararevolucionit. Lufta jonë kundër këtij arti kërkon nga ne që në veprat tona të nënvizojmë partishmërinë proletare, romantikën revolucionare, heroikën e luftës e të ndeshjeve klasore nga pozitrat e ideologjisë sonë. Dhe në se estetët borgjezë të «antiideologjizmit» bëjnë burimin e së keqes ideologjinë, në se ata proklamojnë se në epokën e revolucionit tekniko-shkencor fillon vdekja e ideologjisë, se ajo zëvendësohet me shkencën, tellallët revizionistë përpiqen të shuajnë luftën ideologjike. Për t'i bërë qejfin propagandës borgjeze, e cila evidencon e propagandon këtë rrugë degradimi të gjenezës moderniste në vendet revizioniste, këta tellallë mohojnë hapur metodën e realizmit socialist, ose e modifikojnë dhe e reformojnë duke i hequr frymën revolucionare. Të tjerë shpallin se arti po

zhvendoset në prehje, se shkenca e teknika formojnë fizionominë e epokës bashkëkohore.

Ekzaltimi i këtyre fenomeneve në fushën e krijimtarisë shpirtërore është së fundi një përpjekje e kamufluar para sloganeve pseudosocialiste e hipokrizisë së borgjezisë së re revizioniste për të spostuar vëmendjen nga problemet e mprehta që ka nxjerrë përpara këtyre popujve rivendosja e kapitalizmit dhe tradhëtia e tyre ndaj çështjes së klasës punëtore dhe lufrave për liri të popujve.

Në këto kushte, të regresionit në vendet borgjezo-revizioniste, në artin tonë duhet të mishërojmë më mirë, më me mjeshtëri përmbajtjen revolucionare. Për t'iu kundërvënë tendencës borgjeze revizioniste në krijimin e veprave, «të çliruara» nga paragjykimet sociale, ne na del si detyrë të thellojmë më tepër përmbajtjen e veprave rona. Ne kemi mjaft shembuj në artin tonë të veprave me përmbajtje të thellë, të cilat qëndrojnë larg çdo izme e plagjiature dhe që kanë vlera të vërteta estetike krejt në kundërshtim me estetët borgjezë që thonë se veprat me angazhim ideor nuk të japin mundësi të krijosh vlera të vërteta estetike. Le të kujtojmë këtu portretin e shokut Enver, Monumentet e Vlorës e 4 heroinat, Nënë e labe, Vallzon Shqipëria, Vojo Kushin, Shotën, U themelua Partia, Denoncimi i traktatit të Varshavës, Vasil Laçin etj. etj. Por në artin tonë, më tepër se deri tani, dhe më me mjeshtëri duhet të futim temat e mëdha, ndeshjet e mëdha klasore, revolucionare. Të futësh këto probleme në art, d.m.th. të trajtosh drejt jetën, të zbulosh në të fenomenet revolucionare dhe regresive, forcat që i zhvillojnë ato, njerëzit dhe qëndrimin e tyre në këto fenomene, do të thotë t'i bësh artet tona më revolucionare, të pasqyrosh në to temat e mëdha.

Krijuesi ynë nuk është fshehur pas frazeologjive se dhe një peizazh, një natyrë e qetë, një portret çfardo, po të punohet sipas kërkesave të metodës së realizmit socialist shërben për edukimin estetik të njerëzve. Kongresi i 7-të na shtroi problemin që ne në mënyrë tendencioze, më tepër duhet të trajtojmë temën e revolucionit. Në artin tonë të pasqyrojmë ndeshjet e mëdha klasore në planin kombëtar e ndërkombëtar. Pozita e artistit tonë revolucionar, nuk është ajo e artistit borgjez e revizionist. Disa nga ata artistë e kanë trajtuar sipas mënyrës së tyre luftën e popujve të Afrikës apo të Vietnamit, por në to mungon heroika revolucionare. Romantika e buku-

ria e përpjekjeve me forcat e errëta në emër të lirisë e Revolucionit është zëvendësuar me deheroizmin e pacifizmin. Klasa punëtore paraqitet nga një kënd vështrimi reaksionar. Punëtori mbetet atje një qenie e zyrtë e trishtuar e fataliste, një robot i mbytur nga makinat gjithë dilema e misticizëm, larg konflikteve sociale. Arti komunikues me masat, është zëvendësuar me novatorizmin e rremë hermetik, me plagjaturat neoavanguardiste. Në këto kushte roli i artit tonë e i artistëve tanë, krahas artistëve revolucionarë në botë, rritet gjithnjë e më shumë.

Temat e mëdha që Partia na porosit për t'i trajtuar kërkojnë nga pikëpamja e mjeshtërisë të kapemi më fort pas gjinisë së kompozimit në artet figurative, kërkojnë zhvillim më të madh të pikturës monumentale, prapambetja e së cilës ka krijuar boshllëk ideor në ndërtesat social kulturore, kërkojnë, që të kapemi pas krijimit të ansambleve, në arkitekturë gjithashtu kërkojnë futjen në vepra më tepër të heronjve, grupeve, të portreteve të masave të gjëra, të dinamikës, larg statizmit të ngurtë. Më gjerë e më mirë duhet kuptuar e trajtuar jeta në të gjitha momentet e saj, pa u futur në kënde të rëndomta e në eksperimentime formaliste, për të cilat u preokupam edhe një herë me dy tri vepra të bëra këtë vit si: «Roja», «Viti 1944», «Artistja». Tani është folur mjaft mbi kuptimin e temave të mëdha, e temave të vogla e të këndeve të jetës. Është folur dhe për qëndrimin ndaj traditës të artit tonë, është folur dhe për novatorizmin e frymën popullore. Kongresi i 7-të i Partisë na ve detyra të rëndësishme për të afirmuar më mirë traditën tonë, artin tonë popullor.

Një problem tjetër i rëndësishëm është demaskimi i koncepteve teorike, krahas demaskimit të krijimtarisë artistike të artit borgjez revizionist. Kritika jonë krahas afirmimit më të denjë që duhet t'u bëjë realizimeve tona duhet të përleshet më tepër me teorizimet borgjeze e sidomos revizioniste, të cilat pranë demagogjisë «pro artit të realizmit socialist» bartin një përmbajtje të thellë reaksionare pajtimi dhe njësimi me ideologjinë borgjeze. Hapja e dyerve ndaj ideologjisë borgjeze tashmë proklamohet në pllakata, në tablo, në komplekse monumentale e arkitekturale, apo urbanistike, në kongrese ndërkombëtare e seminare, apo simpoziume si ato të Vrocllavit, Bukureshtit, Varshavës, Bagdatit etj., ose dhe me ekspozita të përbashkëta në bienale e trinale etj.

Detyrat që na ve Kongresi i 7-të i PPSH-së kanë për qëllim të na bëjnë ne më militantë, të na bëjnë t'i shërbejmë popullit akoma më mirë, që veprat tona artistike të mbushen me jetën e popullit e të Partisë, me emocionet e masave tona revolucionare.

Vënia në jetë e mësimave të Partisë është garanci e sukseseve tona në luftë me artin borgjez revizionist, garanci e fitores së artit tonë kundër dekompozimit e degjenerimit të artit reaksionar. Arti ynë asnjëherë nuk do të vihet në prehje, asnjëherë nuk do të përkundet në ëndërra boshe estetizante, larg jetës e revolucionit. Ai do të jetë gjithnjë mjet luftime kundër çdo lloj izme dekadente të ideologjisë borgjezo-revizioniste.

## ARTET FIGURATIVE DHE KRIJIMTARIA POPULLORE

**M**e një bukuri të rrallë e të mahnitshme krijimtaria figurative e popullit vjen deri në ditët tona si një art i madh që ka shprehur shpirtin e gjenialitetin e tij krijues, karakterin burrëror e luftarak, si një art që ia ka pasuruar jetën shpirtërore.

Ky art përmbledhet në një varg krijimesh në materiale të ndryshme, duke u nisur që nga banesa e thjeshtë popullore. Gdhendjet në dru e gur, punimi i metaleve, endjet dhe kostumet kombëtare, qëndismat, punimet prej leshi dhe argjendaria, kanë përmbushur kërkesat artistike të popullit si dhe ato funksionale. Zhvillimi i këtij arti të madh reflekton kushtet social-historike, mundësitë materiale, prej të cilave lindte. Mbi të gjitha, ne artistët e realizmit socialist, duhet të çmojmë tiparet e rralla e origjinale të këtij arti, që mbron me konsekuencë fizionominë kombëtare, duke mënjeluar çdo tendencë të huaj që përpiqej t'i ngjitej në rrugën e tij të zhvillimit. Ky taban popullor, shqiptar, mbetet për ne sot një burim i madh frymëzimi e studimi të vazhdueshëm; me këtë art jemi rritur që në djepin e gdhendur nga gjyshërit e baballarët tanë, me këngët e tyre jemi përkundur; në mbulesat e lashta e të zbukuruara jemi mësuar të përceptojmë har-

moninë e ngjyrave dhe të linjave, me pjtën dhe luginën prej druri të gdhendur kemi bërë hapat e para drejt jetës.

Shija e popullit, e derdhur në një varg krijimesh, ku çdo gjeneratë ka shtuar diçka, është e rrallë dhe shumë e larmishme. Ornamentika popullore është dëshmi e këtij shpirti krijues dhe na frymëzon edhe sot me format e saj të përkryera, bukurinë e kompozimit, harmoninë e ngjyrave, simetrinë, ritmin dhe linjat e shprehura qartë e me forcë artistike. Ashtu siç ka ndodhur edhe në letërsi, ku krijimtaria popullore ka qënë burim për shkrimtarët patriotë që nga Rilindja e deri më sot, ashtu edhe kjo krijimtari figurative, ka mbetur në qendër të vëmendjes së artistëve tanë të gjinive të ndryshme, si një burim i pashtershëm frymëzimi. Edhe kur artistët e vjetër, për kushte historike të njohura, nuk e kanë patur të ndërgjegjshëm këtë proces, forca e madhe e artit popullor i ka detyruar ata të kthejnë sytë me vëmendje e të zbulojnë në këtë art mësimet të vlefshme. Kjo shpjegon edhe atë fakt që në piktorë të vjetër si Onufri e David Selenicasi ndjehet ndikimi i ngjyrës, linjave dhe harmonisë kompozicionale, që janë aq të dukshme në ngjyrat e tekstileve popullore. Edhe në piktorët e fillimit të shekullit tonë, në vepra të tilla si «Motra Tone», duket qartë ndikimi i artit popullor, që shprehet në harmoninë e përkryer të tërësisë së veprës me detajet e saj, ashtu siç i gjejmë të përkryera në qëndisimat popullore. Ajo harmoni e brendshme e portretit nuk rrjedh thjesht nga kostumi popullor, që doemos, përcakton edhe ai frymën e veprës, por në radhë të parë nga një ndjenjë proporcionesh dhe elegance në linja, në raportet koloristike dhe efektet e dritës e të hijes. Po e njëjta gjë ndodh edhe në skulpturën «Luftëtari kombëtar». Kjo figurë luftëtari, duke mishëruar gjallë shpirtin popullor, të mbërthen jo nga dinamizmi i jashtëm, por nga patosi i brendshëm.

Shoku Enver duke folur në Kongresin e 7-të të Partisë, tha: «Shkrimtarët dhe artistët, të udhëhequr nga mësimet e Partisë, të orientohen drejt jetës së popullit, të krijojnë një art për popullin, të bukur, të qartë e të kuptueshëm nga të gjithë, një art thellësisht popullor». Partia i ka orientuar gjithmonë artet tona të realizmit socialist që krahas njohjes e pasqyrimit realist të jetës të njohin edhe traditat tona përparimtare, artin tonë popullor për t'u in-

spiruar e mësuar vazhdimisht prej tij. Vetë përvoja e zhvillimit të arteve tona figurative dëshmon se këto porosi u vunë në themel të krijimtarisë sonë artistike, duke na dhënë vepra të partishme, me nivel të ngritur artistik, vepra që lozin rol të madh në edukimin e masave punonjëse.

Krijimtaria popullore zuri vendin e merituar, si për vlerat që ka, ashtu edhe për ndikimin mbi artet tona figurative, vetëm në vitet e pushtetit popullor.

Së pari, krijimtaria figurative popullore, ka një vazhdimësi zhvillimi në kushtet dhe horizontet që i hapi asaj jeta e re socialiste. Gjithë gjinitë e saj zhvillohen sot në kushte të reja, me përmbajtje të re dhe nivel artistik të lartë. Bashkëpunimi i pandërprerë i artit tonë të realizmit socialist me atë popullor është një proces i ndërgjegjshëm e me rëndësi jetike për fatet e artit tonë revolucionar, për thellimin e fizionomisë së tij kombëtare.

Çiltërsia e ngjyrave, harmonia dhe thjeshtësia e të shprehurit, optimizmi i dritës i bëjnë peizazhet e Vangjush Mihos shumë të afërta me artin popullor. Piktori edhe në studjon e tij e ndjeu të domosdoshme të krijonte ambient me objekte të artit popullor, prej të cilave ka marrë mësimet për ngjyrën, ritmin, dhe në përgjithësi, atë aromë të bukurisë popullore që reflektohet edhe në krijimtarinë e tij. Është kjo arsyeja që, krahas bukurisë së peizazhit shqiptar, në peizazhet e këtij piktori, njeriu ndjen një ngrohtësi dhe një kolorit të pasur, që të jep një gëzim të veçantë. Po me një forcë të tillë e me ndikim të mirfilltë nga arti popullor ndjehen lidhjet e kësaj krijimtarie me vepra të tilla të krijimtarisë sonë, si: «Barrikada», «Refugjatët», «Nusja nga Divjaka» etj., ku sipas temës, koloriti kombëtar merr hera-herës një karakter dramatik, apo një lirisim të hollë. Kontrasti i madh i dritëhijes shkon paralel me kontrastin koloristik. Vetë lëvizjet e figurave në tablo të tilla rrjedhin nga një studim i vëmendshëm i fizionomisë së shqiptarit, i karakterit të tij burrëror, i veshjes të dhëna të gjitha këto në një atmosferë heroike. Ngjyra ka një forcë vepruese emocionale. Ajo nuk është një stoli në vetëvete, por një mjet shprehës me forcë të veçantë, ashtu siç është edhe në ornamentikën tonë popullore.

Piktura jonë e realizmit socialist, krahas studimit dhe njohjes së thellë të jetës dhe zhvillimit të saj re-

volucionar, ka nxjerrë mësime të vlefshme edhe nga vetë forma e artit popullor. Por procesi i lidhjes me artin dekorativ popullor, për vetë natyrën e tij dekorative, ornamentale, duket ndonjëherë më i pakapshëm se sa në letërsi, bie fjala ku ndikimi i artit popullor, si në brendi, ashtu edhe në mjetet shprehëse, të shumtën e herës, është tepër i dukshëm në poetë e prozatorë me profile të ndryshme. Prandaj duhen vrejtur me kujdes veprat e pikturës dhe të skulpturës sonë, duke mos vënë arbitrarisht një emruer të përbashkët, por duke zbuluar në çmënyrë dhe sa lidhet me tabanin popullor vepra e një artisti apo e një tjetri. Në vepra të tilla si: «Tregime nga Lufta Nacionalçlirimtare», «Nëntor 1944», «Gju më gju me popullin», «Bajram Curri», elementët popullorë në tërësi përqëndrohen në atmosferën e përgjithëshme të tyre, kryesisht në ambientin, veshjet dhe tiparet karakteristike të natyrës shqiptare në raport të drejtë me temën dhe përmbajtjen, ndikimi i ngjyrës, harmonia kompozicionale mbetet më i tërthortë, apo në plan të dytë. Të tjera vlerësime bëjmë në vepra të tilla si: «Vojo Kushi» e «Mic Sokoli», «Çlirimi i Kosovës» e «Shote Galica» etj. Në tablonë «Vojo Kushi», së pari, autori ngre në pedestal një akt heroizmi, që është një vazhdë tipike e heroizmit popullor në shekuj. Me frymë epike tingëllon gjithë kompleksi i mjeteve shprehëse, duke u nisur që nga kompozimi, vizatimi i figurës, efektet e dritës dhe të hijes me po ato konture të ashpra që end mjeshtri popullor. Autori mënjanon çdo detaj të tepërt, duke përqëndruar vëmendjen te figura e heroit. Ndryshe nga kjo, te «Shote Galica», autori e përqëndron vëmendjen si në figurën e heroinës ashtu dhe në tërë atmosferën që e rrethon atë, duke e ndërtuar tablonë me konture të rrepta e dramatike, duke i dhënë përmbajtjes një theks të veçantë heroizmi. Te «Mic Sokoli» të krijohen emocione gati të njëjta si te «Vojo Kushi», pasi tema në të dy veprat ka të bëjë me heroizmin.

Po i njëjti fenomen, që përkon me përfytyrimet tonë për një hero legjendar siç është Skënderbeu, ndodh edhe me monumentin e tij të vendosur në Krujë. Tema e heroizmit popullor është një temë e madhe që ka frymëzuar gjithë krijimtarinë popullore të vjetër e të re.

Gdhendjet në dru dhe gur, që i kanë dhënë artit tonë popullor tipare të përcaktuara kombëtare dhe vlera artistike të holla, kanë qenë burim i mjeshtërisë së

artistit popullor. Banesa popullore më gjithë atë fantazi linjash dhe proporcionesh, me atë harmoni estetiko-funkcionale është krijim i po këtij mjeshtri. Të tilla janë edhe gdhendje mbi dru dhe gur, që i kanë shtuar njeriut shqiptar kulturën e të banuarit e të jetuarit, ndjenjën e fortë të mbrojtjes dhe rezistencës në çdo banesë kala.

Monumenti i Pavarësisë lidhet në mënyrë logjike me frymën popullore. Zgjidhja kompozicionale dinamike të afron me lëvizjen plastike, me siluetat e qarta dhe ekspresive që i gjejmë edhe në gdhendjet popullore në dru ku ndodhen bashkë vibracioni e forca plastike. Në këtë vepër bije menjëherë në sy dashuria dhe sensi për ta përkyer çdo detal, duke mos cënuar ndërtimin arqitektonik, ashtu siç bën populli kur gdhend një furkë apo një tavan. «Në gurrën e pashtershme e jetëdhënëse të popullit, — iu shkruan shoku Enver tre skulptorëve, — ne do të gjejmë atë frymëzim të madh për të realizuar vepra të bukura e madhështore për popullin tonë.

Mirëpo duhet thënë se studimet e mirëfillta shkencore nga institucionet përkatëse në dobi të njohjes së thellë të kulturës popullore janë të pakta e shumë herë të cekta.

Në stadin e tanishëm të zhvillimit të arteve tona figurative, në luftë frontale kundër teorive të «ndërkombëtarizimit» të artit, kozmopolitizmit etj., pra të agresionit ideologjik e kulturor borgjezo-revizionist, mbetet një detyrë e dorës së parë gërshetimi i punës krijuese me njohjen më të thellë e më shumë shkencore të artit tonë popullor.

Detyrat që shtroi Kongresi i 7-të i Partisë dhe raporti i shokut Enver theksojnë këtë domosdoshmëri që do t'i hapë artit tonë horizonte të gjera, do të rrisë e përsosë më tej fizionominë kombëtare dhe frymën popullore të tij.

Mbi këtë bazë piktura dhe skulptura jonë, vitet e fundit, kanë ecur e kanë bërë hapa të rëndësishme përpara. Veprat në skulpturë, që përjetësojnë heronj dhe ngjarje të mëdha të luftës dhe ndërtimit socialist, janë të shumta tek ne. Skulptura jonë monumentale ka marrë shëmbull nga karakteri demokratik i artit popullor. Këtë karakteristikë duhet ta zhvillojmë akoma më shumë sidomos për pikturën monumentale, e cila ka krijuar bosh-



llëqe në trajtimin e temave të mëdha që i kërkon jeta jonë sot.

Skulptura monumentale, përveç zgjidhjes së shumë problemeve si të temës së madhe, partishmërisë proletare, ka thëlluar më tej fizionominë kombëtare, thjeshtësinë dhe karakterin popullor si në veprat «Katër heroinat e Mirditës», «Në udhët e luftës» të Hektor Dules, «Shote Galica» e Kristaq Ramës, «Liri Geros» e M. Dhramit, «Atentatori» i Thoma Thomajt etj.

Populli ynë është lakonik në artin e vet. Në shtrojet e leshta të Hasit p.sh. populli ka përdorur vetëm dy ngjyra, të zezën dhe portokallen, me të cilat ai shpreh pasurinë e madhe koloristike, thjeshtësinë dhe nikoqirllëkun koloristik. Këto tipare i ndeshim edhe tek «Barinjët» e Danish Jukniut, në disa peizazhe të Foto Stamos, te portreti i shokut Enver, punuar nga V. Kilica. etj

Karakterit kombëtar dhe ndikimi i artit popullor në pikturën dhe skulpturën e viteve të fundit ka ardhur duke u thëlluar pikërisht në saje të luftës kundër çdo ndikimi të huaj dhe të përpjekjeve serioze për të nxjerrë mësim sa më të mëdha nga arti popullor, duke ruajtur tiparet e tij më të mira dhe, duke mbajtur vazhdimisht qëndrim klasor e të partishëm. Në krijimtarinë tonë spikat larmia tematike, përmbajtja e shëndoshë dhe forma me nivel të ngritur artistik, që ndjehet si në artistët më me përvojë ashtu në ata me moshë më të re.

Problemet e lidhjes së krijimtarisë artistike të kultivuar me artin popullor janë kuptuar përgjithësisht drejt, në radhë të parë në përmbajtjen e shëndoshë, në temat e mëdha që dikton realiteti ynë socialist, në thjeshtësinë, qartësinë realiste të çdo vepre. Për thellimin e karakterit kombëtar, kthimi i vëmendjes drejt krijimtarisë popullore mbetet një detyrë e përhershme e artistëve tanë. Në këtë luftë piktura dhe skulptura jonë kanë gjithmonë parasysh mësimet e Partisë. Armiqtë e Partisë dhe të pushtetit e shpallnin artin që mbështetej në realitetin tonë dhe në krijimtarinë e popullit të vjetëruar dhe konservator. Duke mohuar vlerat pozitive të artistëve tanë, që në krijimtarinë e tyre reflektonin lidhje të shëndosha me traditën popullore, për të përgjatur veprat më të mira të kësaj krijimtarie, me artin e tyre të ashtuquajtur novator ata donin të krijonin terrenin e një arti dekadent pa ide dhe përmbajtje të rëndësishme.

*«Jo të shpiket një kulturë e re proletare, thotë Lenini, por të zhvillohet nga pikëpamja e botëkuptimit marksist dhe e kushteve të jetës dhe luftës së proletariatit në epokën e diktaturës së tij».*

Natyrisht, duke mohuar çdo lidhje me të kaluarën, armiqtë çfaqnin përcmim edhe për ato tablo apo punime në skulpturë që kishin për subjekt të kaluarën historike të lavdishme të popullit tonë, duke dëmtuar, ose, më mirë duke cunuar kështu zhvillimin në përgjithësi të tablosë tematike dhe të kompozimit në skulpturë. Orientimet e tyre drejt temave intime, largimi nga problematika shoqërore, nga tendencioziteti klasor dhe brendia revolucionare, nënvleftësimi i rolit hegjemon të klasës punëtore, mohimi i heroit pozitiv, kërkonin ta largonin krijuesin nga rruga e revolucionit.

Debati i madh ideologjik që u zhvillua në radhët tonë mbas Plenumit IV sqaroi shumë probleme që lidhen me teorinë e praktikën tonë krijuese, duke dërmuar konceptet e huaja armiçësore, që kishin për qëllim t'u hapnin shtigjet ndikimeve çoroditëse të modernizmit. Piktoret, skulptoret, grafistët dhe artistët aplikativë, të armatosur me mësimet e Partisë dhe porositë e shokut Enver, krahas përpjekjes për të krijuar një art të partishëm, revolucionar e të mbështetur fort në tabanin kombëtar, përpiqen gjithnjë e më shumë që veprat e tyre të shprehin optimizmin dhe gëzimin e popullit, sakrificat dhe dinamikën e jetës sonë socialiste, t'i kushtohen atij, të jenë të kuptueshme prej tij, pra, të kenë frymë popullore.

Ekspozitat e Arteve Figurative, edhe më përpara, por sidomos në periudhën pas Plenumit IV numërojnë një sërë veprash, të cilat shquhen, ndër të tjera, për forcën e tyre të madhe komunikuese, për frymën e tyre popullore në përmbajtje dhe në mjetet e shprehjes si: «Pushka Top» e K. Dilos «Shokë lufte, shokë jete» e V. Halimit, «Çeta e Lace Backës» e H. Nallbanit,

Partia ka vënë në dukje vazhdimisht rëndësinë e madhe të lidhjes së artistit me jetën, me popullin. Shoku Enver në Kongresin e 7-të thekson: «Jeta e popullit, fjalla e mprehtë e tij, psikologjia dhe humori popullor të zënë më shumë vënd në veprat letrare e artistike».

Njohja me jetën e psikologjinë e popullit nuk arrihet menjëherë, ajo nuk do të jetë rezultat i një momenti të vetëm, por është një proces i gjatë që lidhet me të

jetuarit pranë popullit e me të menduarit e të vepruarit si ai.

Forcimi i mëtejshëm i frymës popullore në veprat e artit lidhet ngushtësisht me krijimtarinë tonë popullore, me këtë thesar të madh e të pazëvendësueshëm, me të cilin sa ne me të drejtë krenohemi para çdo kombi tjetër.

Mbështetja në krijimtarinë popullore nuk duhet parë si diçka fikse dhe e ngurtë, por duhet të shfrytëzohet në mënyrë krijuese. Krijimtaria popullore duhet të merret e plotë, me shpirtin e saj, me elementet e përmbajtjes e të formës. Ajo është një model i shkëlqyeshëm i unitetit të përmbajtjes me mjetet e formës.

## TABLOTE E GJERA TE JETES DHE HEROI POZITIV NE ARTET FIGURATIVE

Tema e punës ka ardhur duke u bërë gjithnjë e më e fuqishme, një nga temat qendrore të artit tonë të realizmit socialist. Dhe nuk mund të ndodhë ndryshe sepse tek ne pa rolin pararojë të klasës punëtore as që mund të mendohet socializmi dhe fitoret e tij në të gjitha sferat, ekonomike, politike e shoqërore të jetës së vendit, prandaj dhe në art ky hero, përfaqësues i klasës punëtore po zen gjithnjë e më mirë vendin që i takon. Të tillë p.sh. e sheh dhe e trajton atë piktori S. Shijaku me tablonë «Zëri i masës».

Duke kapur dhe ngritur në art, me guxim, një aspekt të ri të jetës shqiptare, ku klasa punëtore po udhëheq me sukses luftën kundër burokratizmit dhe intelektualizmit mikroborgjez, piktori e fut atë në diskutimin e madh të problemeve të letërsisë dhe artit, jo si sositëse pasive, por, edhe këtu, si drejtuese të mendimit më të përparuar, të partishëm shoqëror.

Aspekti novator i kësaj tabloje nuk qëndron në faktin që autori futi disa njerëz në studio dhe i pikturoi ata bashkë me piktorin. Tingëllimi novator dhe kombë-

tar i kësaj tabloje qëndron në faktin se këtu u futën punëtorët e ndërgjegjshëm, u fut mendimi i tyre, ideologjia e tyre. Njerëzit, ambjenti, fryma dhe psikologjia e përgjithshme janë shqiptare. Aspekti i ri i kësaj tabloje nuk qëndron në ndonjë shpikje të re teknike, apo në ndonjë farë virtuoizimi të të pikturuarit, por në qëndrimin që mban artisti ndaj klasës punëtorë, ndaj realitetit tonë të ri. Krijimi i kësaj dhe i disa tablove të tjera të rëndësishme nuk u bë rastësisht, ato ishin rezultat i moralizimit të artistëve pas mësimëve dritëdhënëse të Ple-numit IV të KQ, për të vënë në jetë orientimet e Partisë dhe të shokut Enver për një art të qartë e të partishëm, që të pasqyrojë drejt dhe me vërtetësi jetën e popullit dhe rolin hegjemon të klasës punëtorë, duke hedhur kështu poshtë teorizimet armiqësore: se kërkesat për tablotë e mëdha tematike janë burokratike e zyrtare dhe se artisti i zoti mund të krijojë edhe brenda në studio pa qënë në kontakt direkt me jetën. Ne sot vërejmë me kënaqësi se janë bërë mjaft vepra serioze, ku janë fiksuar ngjarje të rëndësishme, duke përjetësuar si momente të mëdha historike, ashtu dhe aspekte nga të gjitha sferat e jetës. Tanimë janë bërë të njohura veprat si «Monumenti i Pavarësisë», «Monumenti i Skënderbeut», «4 heroinat», «Heronjt e Vigut», apo statujat «Lart frymën revolucionare», «Përmendorja e Mushqetas», «Metalurgu», «Flladi i Partisë» etj. Tablotë «Shpërndarja e tapive», «Në kantjerin e dritës», «Skroskë 1944», «Shqipëria lulëzon», «Denoncimi i Traktatit të Varshavës», «Diga e Drinit», «U themelua Partia», që bashkë me shumë të tjera, të shpërndara në të katër anët e vendit, kanë lojtur dhe luajnë një rol të rëndësishëm në edukimin ideo-estetik të popullit. Në veprat më të mira, jo vetëm që janë kapur momente të rëndësishme, por në to është shprehur me art edhe tendenca e zhvillimit historik, duke i vendosur në ambjente tipike, me kolorit dhe frymë shqiptare. Në tërësinë e tyre këto vepra, kanë një konceptim të drejtë plastik e kompozicional, emocionet janë shprehur me dritë, ngjyra të qarta e psikologji optimiste, duke u bërë kështu bindëse me vërtetësinë e tyre. Vepra të tilla përkojnë me ndjenjat dhe mendimet e klasës punëtorë.

Megjithatë duhet të pranojmë se po të krahasojmë ato ngjarje dhe dukuri të jetës, në tërë aspektet e saj, me larminë e shfaqjeve e të kontradiktave, me zhvillimin e personalitetit dhe të psikologjisë së njerëzve të thjeshtë

punëtorë e fshatarë, të cilët janë forca vepruese e drejtuese në jetën e vendit, do të vemë re se kemi boshllëqe dhe se kjo jetë nuk është pasqyruar e plotë.

Në Kongresin e 7-të të Partisë shoku Enver shtroi dhe një herë detyrën që: «Pasqyrimi më i mirë i disa temave të mëdha në krijimtarinë artistike, si ajo e rolit hegjemon të klasës punëtorë në shoqëri, e shndërrimeve revolucionare të fshatit tonë, e forcës revolucionarizuese të komunistëve, trajtimi i temave kardinale dhe i momenteve kyçe të historisë së popullit tonë, dhe sidomos të Luftës Nacionalçlirimtare e të revolucionit socialist, janë një kërkesë e domosdoshme për t'i bërë letërsinë dhe artet tona dhe më revolucionare».

Pra tema qëndrore e krijimtarisë mbetet gjithmonë aktualiteti, jeta e gjallë e njerëzve në veprim dhe duhet të kuptojmë drejt e me bindje se çështja e aktualitetit në art nuk është një problem vetëm estetik, por në radhë të parë si një problem shumë i rëndësishëm politik. Duke e kuptuar kështu ne duhet të hidhemi më me guxim e seriozitet në kapjen e temave të mëdha të kohës, sidomos nga klasa punëtorë e fshatarësia kooperativiste, duke mishëruar me figura të fuqishme artistike atë kuptim të thellë që përmbajnë në thelb parullat e Partisë «Me forcat tona», «Të punojmë e të jetojmë si në rrethim», «Bujqësia çështje e të gjithë popullit», dhe «Mbrotjtja e atdheut — detyrë mbi detyrat». Ne do të mund të themi se po përmbushim më mirë misionin tonë si ndihmës të Partisë në edukimin komunist të masave, duke punuar e realizuar problemet aktuale gjithmonë në letërsinë e kërkesave të kohës. Në praktikën artistike ka ndodhur që edhe kur janë kapur tema të rëndësishme të ketë pasur njëfarë cektësie në trajtimin e tyre, nuk është zbrëthyer thellë përmbajtja ideo-emocionale, ka pasur një farë skematizmi dhe kollajllëku në zgjidhjen e figurave. Nganjëherë bile ke përshtypjen se po krijohet një farë shtampe e dëmshme në trajtimin e disa temave të caktuara dhe, ç'është më e keqja, kjo recetë nuk po përdoret në tablotë apo relievet e një autori, por po shfrytëzohet nga disa, siç po ndodh p.sh. me ca tema që trajtojnë sulme partizane. Kjo është një temë e madhe e heroizmit, e karakterit të fortë, e vendosmërisë dhe e fitoreve të popullit tonë, temë përjetësisht e re dhe aktuale, që kërkon pjekuri, dashuri dhe serjozitet e studime në realizimin e saj dhe jo skematizim të skemave kompozicionale. Mirëpo herë pas here ndeshemi me këtë pam-



Në këto vepra sigurisht nuk mund të ketë njohje të dialektikës së fenomeneve, të zhvillimit të jetës, të tendencave përparimtare të këtij zhvillimi e rrjedhimisht nuk ka dhe qëndrim të drejtë të artistit ndaj temës e heronjve që trajton.

Kur Partia thotë se duhet të dalë më mirë roli hegjemon i klasës punëtore në shoqëri, shndërrimet revolucionare të fshatit tonë socialist, apo forca revolucionarizuese e komunistëve, shtron përpara nesh një detyrë të rëndësishme, atë të paraqitjes në art të fenomeneve dhe dukurive më të mprehta dhe të reja në jetën tonë socialiste, sidomos të kuptimit të psikologjisë socialiste të njerëzve të ditëve tona. Punëtori ynë nuk është më ai gjysëm zanatçi i dalë nga lufta, por është drejtues i makinërive moderne dhe i një industrie të përparuar, me shkollë e kulturë, që merr pjesë aktive në revolucionin tekniko-shkencor dhe luan rol vendimtar në shoqëri. A mund të themi ne se e kemi arritur këtë gjë kur kryesisht, punëtorët që paraqesim vërtet i vendosim pranë teknikës së re, me veshjen e punëtorit të industrisë së rëndë moderne, por si tip shoqëror e psikologjik ne shpesh përsërisim atë të 15-20 viteve më parë.

Edhe fshati duhet njohur më mirë e më thellë, pasi në të ka arritje të reja, por këto shndërrime revolucionare erdhën në luftë e kontradikta shpesh dramatike. Kooperativat e tipit të lartë janë shumë larg problemeve që kishin kooperativat e thjeshta në krijimin e tyre. Nuk duhet të konsiderojmë kurrsesi të mjaftueshme paraqitjen e temave nga fshati me aspekte të vajtjes dhe kthimit të kooperativistëve nga puna, (ku ka vetëm buzëqeshje dhe shumë rrallë djersë) apo paraqitjen e tyre duke ngrënë bukë (po me atë buzëqeshje standarte në fushat me grurë e pa grurë). Edhe këto aspekte mund të trajtohen, dhe ndonjë shembull të mirë e kemi, por sidoqoftë kur i sheh kështu mendon se aty është vetëm kopertina e ilustruar e librit. Po ta hapim pak atë libër, ta studjojmë mirë dhe të shohim se në ç'rrugë kaloi bujqësia jonë, në ç'luftë e në çfarë frontesh e bëri atë fshatarësia dhe klasa jonë punëtore gjersa arritëm në fitoren e madhe të sigurimit të bukës në vend?

*«Në qendër të vëmendjes të letërsisë dhe arteve – porosit plenumi i XV i KQ të Partisë – duhet të jenë heronjtë e kohës sonë... nëpërmjet këtij heroit triumfon e reja në jetë, pra do të triumfojë edhe në art, kapër-*

*xehet ose shembet e vjetra në jetë, pra do të kapërxe-  
het, ose shembet edhe në art, krijohet shembulli i gjat-  
llë i punës krijuese, pra do të krijohet edhe në art  
një shembull që do të frymëzojë masat me dashurinë për  
punën me shpirtin e sakrificës e të vetmohimit për çë-  
shtjen e socializmit».*

Në galerinë e madhe të heronjve që kanë krijuar artet figurative, ne gjejmë figura të realizuara me mjeshtëri e nivel artistik dhe që mbeten si shembull i suksesshëm në zhvillimin e arteve tona plastike. Këtë e gjejmë, si në gjininë e portretit ashtu dhe në mjaft kompozime ku personazhet janë në veprim. Të tillë i shohim ata te: «Busti i shokut Enver Hoxha» i O. Paskalit, «Vojo Kushi» i S. Shijakut, «Shkurte Vata» e M. Dhramit. «Vrana Konti në rrethimin e Krujës» e S. Kamberit, «Vasil Laçi» i Th. Thomait, «Bajram Curri», i F. Dushkut, figurat e fshatarëve në tablonë e ndarjes së tapive të G. Madhit, kooperativistët e Z. Shoshit e V. Ballit, «Komandanti partizan» i V. Kiliçës etj.

Por jo rrallë na jepen heronj me një botë të cekët, të njëanshme, deskriptive e pllakateske. Figura e heroit kuptohet si e tillë vetëm sepse është vënë në qendër të kompozimit dhe jo sepse ajo imponohet. Apo ndodh që e bëjmë shpesh heroin me tipare të jashtme «burrërore», me qafë të trashë, me vështrime të rrepta nën vetullat e ngrysura, me kokën e kthyer fort nga e majta ose e djathta, duke krijuar kështu një skematizëm të thatë, gjë për të cilën shpesh herë masa na ka kritikuar, duke pyetur përse skulptorët e piktorët i bëjnë heronjtë të zemëruar?

Këto shabllone na kanë çuar në krijimin e atyre personazheve e busteve që ngjajnë me njëri-tjetrin, jo vetëm fizikisht, por dhe në gjestikulacionin, qëndrimin apo prerjet kompozicionale.

Shablonizimi dhe skematizmi janë armiq të artit të realizmit socialist dhe si të tillë ne duhet t'i luftojmë në tërë praktikën tonë artistike, duke kërkuar dhe gjetur zgjidhje të reja e të përshtatshme për të paraqitur figurën e heroit në momentin e dhënë me intelektin dhe botën e tij të pasur shpirtërore, në lidhje të ngushtë jo vetëm me veprimin momental që kryen, por edhe me procesin e zhvillimit historik të momentit ku ai paraqitet. E vendosur në këtë atmosferë dhe me këto kërkesa ideoestetike, figura e heroit nuk do të mbetet e përciptë, sepse do të kemi karaktere bindëse, jetësore dhe pamjet

e luftës apo të ndërtimit socialist nuk do të mbeten skena të ftohta.

Nga se vjen që ne vazhdojmë të kemi akoma këto dobësi që përmendëm më lart, në pasqyrimin e jetës, sidomos në temat e mëdha? Sepse procesi i njohjes ka qënë i kufizuar si për temën, subjektin, vendin, atmosferën dhe momentin e dhënë historik, ashtu dhe për njohjen e thellë të psikologjisë, karaktereve të personazheve në veprim, të cilët shpesh i krijojmë nga mendja, ose, në rastin më të mirë, nga fotografia. Ç'tablo me vërtetësi jetësore mbi tokën dhe bukën mund të presim nga ai piktor që nuk e njeh fshatin dhe kërkon nga shokët etydet e grurit për t'i përdorur ato në kompozimin që ai ka sajuar për korrjet?! Ç'hero mund të presim nga ai skulptor, i cili rri i shkëputur nga njerëzit e nga jeta dhe heroizmin e kërkon brenda katër mureve të studios?! Këto, sigurisht nuk janë tipike, por, edhe të vetmuara qofshin, ne na shqetësojnë se të punosh e të jetosh si në rrethim do të thotë që edhe në repartin tonë të arteve figurative të mos ketë asnjë pikë të dobët, sado e vogël qoftë ajo. Së dyti, dobësitë vijnë edhe nga egzigjencat e pakta që kemi ndaj vetes në thellimin e përgatitjes sonë ideologjike, profesionale, politike, filozofike e kulturore, si edhe nga fakti që kritika jonë nuk po ecën dot në hap me zhvillimin e arteve figurative e jo më t'u prijë atyre. Me mbarimin e shkollës dhe provimin e marksizmit nuk mbaron formimi i artistit por vetëm etapa e parë. Në jetë ato duhen pasuruar e thelluar vazhdimisht. Shumë djem e vajza mbarojnë shkollat e artit, por nuk janë të paktë ata, të cilëve nuk u pranohen punët në ekspozitë. Njohja e materialit jetësor nga ana e artistit nuk është vetëm vajtja në bazë, por pjesëmarrja intensive e vetë artistit në jetën shoqërore, ekonomike, politike e artistike sepse kështu do të kuptojmë më drejt e më thellë edhe realitetin e do të njohim më mirë kushtet dhe rrethanat ku vepron dhe formohet heroi i ri shqiptar.

## NGJARJET E MËDHA TË JETES NË PIKTURËN TONË

Në traditën tonë të arteve figurative të realizmit socialist, në gjininë e pikturës, ngjarjet e mëdha historike zenë një vend shumë të rëndësishëm, krahas veprave që trajtojnë transformimet e mëdha që po ndodhin në jetën e shoqërisë sonë si rezultat i revolucionit popullor.

Që në veprat e para, krijuesit tanë, duke u orientuar nga mësimet e Partisë kanë patur si pikësynim të vazhdueshëm edhe trajtimin e temës së luftrave për liri e pavarësi, ngjarjet kuptimplote të luftës së lavdishme Nacionalçlirimtare krahas ngjarjeve të mëdha që solli revolucionin ynë popullor. Në këtë mënyrë u krijuan veprat e para me subjekt historik si: «Refugjatët», «Në shpellën e Dragobisë», «Tregim nga Lufta Nacionalçlirimtare», «Agimi i 17 Nëntorit 1944», «Reforma agrare» etj. Tipare dalluese të këtyre veprave të para të realizmit socialist janë karakteri i tyre militant, përmbajtja e shëndoshë ideore dhe trajtimi i qartë e realist. Ato shquhen edhe për karakterin e tyre kombëtar, gjë që ndikoi për forcimin e traditës së realizmit socialist në tablonë historike shqiptare. Në periudhat e mëvonshme, tabloja historike fitoi tipare të reja, që u kushtëzuan nga një kuptim më i thellë dhe më i gjerë i përmbajtjes si edhe nga

një rritje e mëtejshme e mjeshtërisë artistike. Në veprat me temë historike të krijuara më vonë, në shumicën e rasteve trajtohen momente kyçe të historisë së popullit tonë. Duke u bërë jehonë këtyre momenteve kyçe, piktorët tanë kanë pasqyruar, krahas ngjarjeve të mëdha historike, edhe virtytet dhe vlerat shpirtërore më të mira, që populli ynë ka trashëguar nga e kaluara si dhe cilësitë e reja që Partia rrënjosi në shpirtin e popullit tonë, vendosmërinë revolucionare, krenarinë kombëtare, besimin në fitore, urrejtjen ndaj armikut etj. Në këtë drejtim shquhen vepra të tilla me temë historike si «Skroskë 1944», «Në Tendën e Qypit», «Betimi i Vrana Kontit», «Vojo Kushi», «Komunistët», «Ndarja e tapive». Në këto vepra gjejmë një mishërim bindës, heronj pozitivë dhe jetësorë, të dalë nga realiteti ynë dhe të realizuar me mjete të gjetura artistike.

Veprat më të mira të ekspozitës kushtuar 30-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe asaj të 35-vjetorit të themelimit të Partisë shënojnë një hop të madh cilësor përpara si në drejtim të shtjellimit të temës së madhe ashtu edhe në pasurimin e mëtejshëm të traditës sonë artistike të realizmit socialist. Në to trajtohen ngjarje të mëdha historike, të shënuara për popullin dhe vendin tonë siç ishin: «U themelua Partia», «Shpallja e Republikës», «Denoncimi i traktatit të Varshavës», «Mbledhja e Moskës», «29 Nëntor 1944», «Mic Sokoli», «Ju flet Tirana, Nëntor 1944», «Fundi i armikut». Veprat e mësipërme me përmbajtje të shëndoshë ideore dhe me nivel të lartë artistik u krijuan gjithashtu si rezultat i kuptimit të drejtë të orientimeve dhe mësimëve të Plenumit IV historik të Partisë për domosdoshmërinë e trajtimit të temave të mëdha të kohës sonë dhe të historisë sonë, duke i kuptuar ato të lidhura ngushtë me preokupimet dhe kërkesat e shoqërisë sonë për një art militant me partishmëri dhe nivel të lartë artistik, i aftë për të ndikuar në edukimin komunist të masave tona punonjëse.

Në trajtimin e ngjareve historike krijuesit tanë i janë përmbajtur parimit që veprat historike të tingëllojnë aktuale për kohën dhe njerëzit tanë. Kjo gjë është kuptuar si një domosdoshmëri në krijimtarinë tonë artistike. Për këtë një rëndësi të veçantë pati orientimi që dha shoku Enver në Konferencën e 17-të të Partisë për Tiranën në dhjetor 1968, ku ndër të tjera thuhet: «...Është e drejtë kërkesa dhe përpjekja që trajtimi i temave his-

torike të përshkohet nga fryma e kohës, që ngjarjet historike të vlerësohen nga pozitat marksiste-leniniste». Duke u nisur nga ky parim shumë i rëndësishëm marksist-leninist tabloja historike duhet të ketë tingëllim aktual, në të cilin fakti historik të zbërthejë mendimin e kohës sonë. Nga ana tjetër, duke pasqyruar atmosferën e asaj epoke që kërkon të japë, tabloja nuk duhet të jetë as kronikë e thatë historike, as aspekt i parë me sy subjektivist. Vepra, nëpërmjet përmbajtjes së gjërë ideore, duhet të bëjë përgjithësim të rëndësishme. Në këtë drejtim ne kemi shumë shembuj pozitivë nga veprat tona. Në veprën «Ndarja e tapive» momenti i caktuar historik, dhënë nga autori, na transmeton edhe perspektivën, shpreh njëkohësisht edhe atë gëzim me të cilin do të punonte në të ardhmen fshatarësia myzeqare në fshatin e bashkuar kooperativist. Në tablonë «Skroskë 1944» gatishmëria partizane që është dhënë në tablo, përputhet me gatishmërinë me të cilën i përgjigjet populli ynë sot thirrjes së Partisë për të kaluar çdo vështirësi e pengesë, sepse popull e Parti janë të lidhur si mishi me kockën.

Tabloja «Mic Sokoli» me frymën e saj epiko-heroike i kalon caqet e momentit historik, duke i folur bashkëkohësit tonë me gjuhën e kohës, se shqiptarin e karakterizon qëndresa, shpirti i sakrificës dhe i vetmohimit për lirinë. Cilësi të tilla vërehen edhe në vepra të tjera si «U themelua Partia», «Komunistët», «Ju flet Tirana—Nëntor 1944», «Denoncimi i Traktatit të Varshavës», «29 Nëntor 1944» në të cilat jo vetëm ndjejmë tingullin e aktualitetit, por ato janë edhe arritje të mira të pikturës sonë të realizmit socialist, veçanërisht në drejtim të përgjithësimit ideo-artistik.

Fryma e kohës dhe tingulli aktual që, siç thamë më sipër duhet të përshkojnë tablonë historike, nuk përjashtojnë faktin që ajo të përmbajë në vetvete atmosferën e epokës që kërkon të pasqyrojë. Pra njohja e epokës dhe krijimi i koloritit të saj përbëjnë nga ana tjetër, një kërkesë të rëndësishme për realizimin e tablosë historike. Në këtë drejtim vepra si: «Çeta e Lace Backës», «Azem Galica me trimat çan rrethimin», «Lule more trima Drashovicë 1943», «Vitët e para», «Shote Galica» ndjehet epoka, koloriti i saj. Në këto vepra e në të tjera të ekspozitës së 35 vjetorit të Partisë, përveç trajtimit të suksesshëm të përmbajtjes së temës historike janë bërë edhe arritje të rëndësishme artistike të formës, në përputhje me përmbajtjen. Në këto vepra ka gjendje psikologjike,

përpyekje për të zbërthyer idenë në përputhje me botën dhe frymën tonë shqiptare. Ato shquhen edhe për individualitetin artistik të çdo autori.

Ndër çështjet e tjera, që duhet të mishërojë tabloja historike është konflikti klasor. Ky konflikt është pasqyruar në mjaft vepra të piktorëve tanë duke u dhënë në përputhje me subjektin dhe gjetjen kompozicionale. Në veprën «Mbledhja e Moskës» autori, duke i kundërvënë përballë njëri-tjetrit dy forcat kundërshtare në debatin e madh politik, vë në dukje largpamjen dhe vendosmërinë e Partisë sonë dhe të udhëheqësit të saj shokut Enver për të ecur me konsekuencë drejt komunizmit. Në tablonë «Në Tendën e Qypit» apo në vepra të tjera të ekspozitës së fundit si «Mic Sokoli», «Fundi i armikut» gjejmë të mishëruar heronj dhe personazhë pozitivë që ndeshen me forcat e errëta armike dhe që fitojnë mbi to. Kjo sigurisht është arritur nëpërmjet zgjidhjeve të mprehta kompozicionale, në skalitjen e heronjve dhe në mjetet shprehës artistikë të tonit dhe të ngjyrës. Megjithatë, duke u nisur nga ndonjë rast si në tablonë «Gjorm—Janar 1943» në ndeshjen e forcave të kundërta, mendojmë se, duhet t'u ruhemi skemave ku armiku paraqitet i shpartalluar para kohe, ose tepër i minimizuar. Vërtet që armiku është i destinuar të shkatërrohet, por kjo vjen si rezultat i një lufte të përgjakshme për jetë a vdekje, nga e cila del edhe triumfi i personazheve dhe heronjve pozitivë. Me një fjalë skenat masive të betejave kërkojnë një punë serioze dhe më të thelluar për t'i dhënë vërtetësinë e duhur dhe për të zgjuar emocione të fuqishme te masat, te spektatori.

Arritje të suksesshme ka edhe në skalitjen e heronjve pozitivë në veprat tona historike. Kjo është arritur si rezultat i thellimit në psikologjinë e tyre, i kërkimit të karaktereve, i përdorimit të mjeteve shprehëse të goditura të ngjyrës dhe të detajeve. Këta heronj i vemë re të skalitur bukur në vepra si «Çeta e Lace Backës», «Trakti», «29 Nëntor 1944», «Ju flet Tirana — Nëntor 1944», «U themelua Partia», «Denoncimi i traktatit të Varshavës» dhe në vepra të tjera të krijuara më parë. Megjithatë duhet pohuar se ka akoma shumë për të bërë që në veprat tona historike të ketë heronj më të skalitur dhe më të gjallë, të marrë nga realiteti. Prandaj njohja më e thellë dhe më komplekse e jetës, e realitetit dhe e fizionomisë së kombit tonë përbën një detyrë të vazhdueshme për ne krijuesit.

Thellim të pakët në personazhet dhe heronjtë ndeshim edhe në vepra të rëndësishme të ekspozitës së 30-vjetorit të Çlirimit si p.sh. në tablonë «Lule more trima — Drashovicë 1943», «Revolta fshatare», «Çastet e para» e ndonjë tjetër.

Kjo vjen, mendoj nga që krijuesit shpesh herë kënaqen me përshtypje të sipërfaqshme, të varfëra dhe mbi këtë bazë ngrenë tablonë. Nga ana tjetër edhe tabloja ka nevojë të mbahet një kohë më të gjatë në duar për t'u pjekur dhe thelluar më tepër nga krijuesi.

Për trajtimin e ngjarjeve të rëndësishme historike të periudhës së ndërtimit socialist, duhet të plotësohet një farë boshllëku që vihet re akoma në ekspozitat tona, ndonëse nuk kanë munguar shembuj të mirë të kësaj natyre, sidomos në ekspozitën e 30 vjetorit të çlirimit si: «Shpallja e Republikës», «Denoncimi i Traktatit të Varshavës», «Mbledhja e Moskës», «Vitet e para» dhe «Askujt nuk i dorëzohemi». Ngjarje të tilla historike si kolektivizimi i bujqësisë, apo ngjarje të tjera të revolucionit tonë socialist duhet të gjejnë pasqyrim më të madh në ekspozitat tona të ardhshme.

Për të gjithë ne krijuesit do të jetë një detyrë e vazhdueshme trajtimi i ngjarjeve të mëdha të jetës, historike. Suksesi në realizimin e këtyre temave të mëdha dhe kyçe të historisë sonë ka të bëjë me shkallën dhe aftësitë krijuese të artistit militant, për t'i shprehur me mjeshtëri idetë e mëdha të kohës sonë, nëpërmjet një ambienti dhe atmosfere historike të caktuar.

Për këtë arsye një kërkesë e vazhdueshme mbetet për ne rritja e aftësive krijuese, krahas ngritjes së nivelit tonë ideologjik, duke u thelluar dhe njohur edhe prirjet e revolucionit tonë, krahas njohjes së gjithanshme të jetës dhe të fizionomisë së popullit tonë dhe sot për ndërtimin e socializmit.

Duke pasur për bazë arritjet e deritanishme në pikaturë, që përbëjnë një traditë të mirë, ne padyshim do të realizojmë vepra me një nivel akoma më të lartë ideologjik-artistik, në të cilat të pasqyrohet denjësisht e kaluara e lavdishme dhe e tashmja heroike e popullit tonë.



## ZHVILLIMI HARMONIK I TE GJITHA GJINIVE

**M**e kushtet e krijuara nga shoqëria socialiste dhe nën udhëheqjen e Partisë, kanë marrë zhvillim shumë gjini të arteve figurative, të cilat janë rritur në mënyrë të gjithanëshme. Janë krijuar vepra me përmbajtje socialiste e revolucionare, militante e popullore e me fytyrë kombëtare. Kudo që janë ngritur, vendosur apo riprodhuar, ato janë një ushqim shpirtëror për klasën punëtore, masat e gjëra të popullit, për formimin e tyre komunist.

Një zhvillim të madh ka marrë, sidomos në disa etapa të ndërtimit të shoqërisë socialiste, skulptura monumentale; janë ngritur disa vepra madhore që kanë zënë vend mirë në qytetet tona si dhe bustet me ngritjen e tyre në qytete e fshatra. Në pikturë zhvillim të madh ka marrë, veçanërisht këtë dhjetëvjeçarin e fundit, kompozimi tematik. Shkaku i këtij zhvillimi është, ndërmjet të tjerave mundësia që ka kompozimi për të dhënë tablo më të gjëra të jetës, pasqyrimin e masave të popullit. Gjithashtu, sidomos kohët e fundit është zhvilluar peizazhi. Ne shohim se grafika, si e lirë ashtu edhe e aplikuar, gjithnjë e më shumë po ecën përpara; është përhapur shumë karikatura, ilustrimi. Ka dhënë një radhë krijimesh të bukura skenografia. Botohen edhe shumë pllakate.

Më pak janë trajtuar, ose me rezultate të pamjaftueshme artistike, relievi dhe skulptura e kavaletit, portreti në pikturë dhe fare pak natyra e qetë. Piktura e madhe monumentale dekorative ka mbetur vetëm me dy a tre pano apo ndonjë mozaik. Një gamë shumë të gjerë gjinish përbëjnë artet dekorative dhe të aplikuara si qeramika, trajtimi i tyre në nivelin e duhur artistik që t'i përgjigjet shoqërisë sonë, ende nuk ka marrë rrugën e duhur.

Natyrisht, për arsye objektive disa gjini nuk kanë më atë rëndësi që kanë patur dikur ose humbasin fare sepse edhe funksioni i tyre në shoqëri është pakësuar apo ka rënë. Megjithatë gjinitë e ndryshme të artit duhet të zhvillohen në masën që kërkon funksioni i secilës prej tyre në shoqërinë socialiste.

Zhvillimi harmonik i sa më shumë gjinive do të thotë një pasqyrim më i gjithanshëm i realitetit, i aspekteve historike, shoqërore dhe intime e lirike të tij, të cilat nuk mund të thellohen e të trajtohen si duhet vetëm me disa gjini. Këtë e kërkon plotësimi i rolit njohës të artit, i rolit të tij për afirmimin e ndërgjegjes shoqërore, i rolit të tij militant, i rolit të tij më të plotë për edukimin komunist të njeriut, të masës në shoqërinë socialiste.

Zhvillimi harmonik i sa më shumë gjinive është një kërkesë që arti t'i përgjigjet siç duhet ritmit të zhvillimit të sotëm të shoqërisë sonë detyrë e rëndësishme që shtrun para tij Kongresi i 7-të i PPSH. Kjo do të thotë në të njëjtën kohë që arti ynë i realizmit socialist të përhapet kudo në të gjitha format dhe momentet më të ndryshme të jetës së popullit: në Pallatin e kulturës, në Komitetin Ekzekutiv, në shkollë, në teatër, në rrugë, në shtëpi, në punë, në dëfrim e kudo në jetë, duke kontribuar për të rrënjosur ideologjinë marksiste-leniniste të Partisë sonë në atë drejtim që mund ta bëjë vetëm arti. Kjo do të thotë që ai t'i përgjigjet përmirësimit të mëtejshëm të mirëqënies së popullit. «*Mirëqënia shprehet dhe gjen pasqyrimin e saj në të gjitha aspektet e jetës së popullit, — tha shoku Enver Hoxha në Kongresin e 7-të të Partisë, — ajo është një mirëqënie materiale e shpirtërore, për të gjithë*».

Shkaku i prapambetjes së disa gjinive, të cilat edhe janë praktikuar por me dobësi dhe të meta, janë disa faktorë subjektivë. Numuri i kufizuar i portreteve me vlera artistike në pikturë vjen nga thellimi i pamjaftueshmërisë së tyre.

shëm në botën e njeriut tonë, në tipat e në karakteret, dobësi që është pasqyruar dhe në kompozim. Mungesa e natyrës së qetë është thjeshtë një nënçmim. Karikatura është një gjini komunikuese që ka lojtur dhe lot një rol të rëndësishëm duke agjituar e milituar për politikën e Partisë, sidomos me subjektet dhe zgjidhjet e saj të mprehta. Por ndikimi i saj do të ishte më i thellë sikur të ishte më e arrirë artistikisht. Një numër i madh pllakatësh janë shumë herë të përsëritur, skematikë dhe të cekët sa që nuk tërheqin fare vëmendjen dmth nuk lozin rolin e tyre agjitues për çështjet e ditës. Fotografia jonë ka arritur një nivel të mirë teknik por ajo ende nuk është në nivelin e duhur që të jetë me të vërtetë artistike. Ne kemi arritur suksese në ilustrimin e librit por paraqitja e tij grafike, kompozimi, faqosja etj. është ende shumë prapa. Të gjitha këto vijnë për shkak të përgatitjes së pamjaftueshme estetike, nga mos njohja e vizatimit dhe e artit, nga mungesa e njohjes së specialitetit, nga niveli i pamjaftueshëm kultural i shumë autorëve të tyre aq më tepër se në disa nga këto gjini ne nuk kemi patur asnjë traditë.

Për zhvillimin e skulpturës monumentale, të monumenteve skulpturale, që janë ngritur në qytete e pika të rëndësishme historike, ka ndikuar porosia e përvjetorëve apo ngjarjeve të tjera. Por porosia shtetërore dhe shoqërore ende është e pamjaftueshme për shumë gjini të tjera të artit.

...Ndërhyrja që është bërë vitet e fundit për të hequr nga lokalet publike punime sentimentale, mikroborgjeze, pa vlera artistike apo me ndikime të huaja, është një veprim pozitiv. Por po ngjet diçka tjetër e pa pëlqyer. Tashti muret e shumë lokaleve publike kanë mbetur fare bosh ose kanë vepra të dobëta artistike siç kemi një shembull me një pano që pretendon të jetë monumentale dekorative në restorantin «Drini».

Gama e arteve të aplikuara është shumë e gjerë dhe rritja e prodhimit dhe industrializimi i vazhdueshëm kanë nevojë edhe për paraqitjen e bukur, artistike të prodhimit dhe të ambalazheve të tij. Kohët e fundit diçka është bërë që artet e aplikuara dhe monumentale të ngrihen në nivel më të mirë profesional.

Arti mund të përhapet dhe të zhvillohen gjinitë e tij të ndryshme, në radhë të parë, duke i dhënë popullit

vepra e krijime me vlera të vërteta estetike si edhe duke ushqyer e brumosur shijen e tij.

Nga njëra anë vepra e artit duhet të tërheqë vetë spektatorin me forcën e saj siç bëjnë shumë vepra letrare e filma tanë të kohëve të fundit, siç bëjnë disa monumente apo tablo. Që t'ia arrijë këtij qëllimi, vepra e artit duhet t'i përgjigjet sa më qartë ndjenjave, mendimeve, aspiratave të popullit në të gjithë gamën e tyre dhe të jetë shprehëse artistikisht.

Por arti do bërë edhe i njohur. Për këtë është e nevojshme të tërhiqet vëmendja e njerëzve që në shkollë. Ashtu sikundër një libër po ta kapërcësh fletë pas flete e të mos i lexosh fjalët që janë shkruar, nuk e kupton, ashtu edhe veprën e artit po s'e mësove t'a lexosh, nuk e kupton dot. Por a ia vlen të bëhet ky mësim? Ja vlen sepse punëtorit, fshatarit, çdo njeriu të popullit në këtë mënyrë do t'i hapet horizonti, do të pasurohet jeta e tij me gëzime estetike, do të rritet shpirtërisht e mendërisht, do të fitojë më shumë vetëdije shoqërore duke edukuar edhe me anë të artit virtute të larta, shpirt revolucionar, ideale komuniste. Së bashku me njohjen e letërsisë në shkollat e të gjitha shkallëve, mund të bëhet edhe njohja me artin kombëtar e botëror.

Përveç përpjekjeve që duhet të bëjnë dhe mund të bëjnë vetë piktorët e skulptorët, që të punojnë në gjini të ndryshme duke hequr dorë nga kufizimet kategorike të specialiteteve të tyre, — koncepte që na kanë hyrë prej disa shkollave të huaja, mund të merren edhe masa shtetërore e organizative që të nxisin e ndihmojnë zhvillimin harmonik të gjinive të ndryshme të arteve figurative, në përshtatje me kushtet materiale në rritje të vendit tonë.

Më parë kanë pas qenë hapur ekspozita për gjini të veçanta të arteve p.sh. për portretin, për ilustrimin e librit etj. Përse të mos hapen prapë të tilla ekspozita? Natyrisht ato nuk janë të vetmit mjete për zgjidhjen e problemit, por janë një mjet i fuqishëm për të njohur gjendjen dhe për të nxitur krijuesit në këtë drejtim.

Zhvillimi i të gjitha gjinive të artit, që nga skulptura e piktura monumentale e deri te artet dekorative dhe paraqitja e librit është një nga faktorët e rëndësishëm për të krijuar pamjen e denjë të kohës sonë. Por ky qëllim do të arrihet më mirë kur të gjitha gjinitë e artit të frymëzohen më shumë nga idealet komuniste,

të konceptohen duke u mbështetur në estetikën marksiste-leniniste, të jenë popullore, demokratike dhe të kenë karakter kombëtar.

Duhet bërë përpjekje që edhe të gjitha gjinitë e arteve të aplikuar të forcojnë frymën kombëtare.

Por në zhvillimin dhe rritjen artistike, harmonike të të gjitha gjinive të arteve të aplikuar një rol i rëndësishëm i bie të lozë arkitekturës e cila krijon kushtet për ta dhe bën edhe sintezë të arteve. Përpara saj shtrohet problemi i formimit të frymës dhe fytyrës kombëtare. Diskutimi që është bërë mbi këtë çështje nuk ka dhënë shumë rezultate. Por që të mund të vihet në një rrugë reale e konsekuente arkitektura jonë për të krijuar fytyrën e saj kombëtare, në radhë të parë duhet kuptuar domosdoshmëria e brendëshme e kësaj kërkesë. Duhet kuptuar se në ç'drejtime është e domosdoshme të forcohet fizionomia dhe karakteristikat kombëtare të arkitekturës sonë të re, që ajo të mundë të ecë përpara e të zhvillohet. Në radhë të parë duhet kuptuar se si një arkitekturë socialiste ajo mund të zhvillohet vetëm si arkitekturë demokratike. Kjo do të thotë se ajo nuk do të jetë e bukur dhe me karakteristika kombëtare vetëm në ndërtesat e rëndësishme publike, përfaqësuese e kulture, por kudo, në shtëpitë e banimit, në ndërtesat e shërbimeve të ndryshme etj. Por realizimi i kësaj detyre mund të ndeshet në shumë probleme ekonomike, teknike dhe organizative të ndërtimit. Pra këtë domosdoshmëri nuk mjafton ta kuptojnë vetëm arkitektët por të gjithë ata që lidhen me realizimin konkret të ndërtimeve. Pa një kuptim të tillë karakteri kombëtar do të mbetej vetëm një zbukurim i jashëm i pa nevojshëm.

Ndërmjet arsyeve që e bëjnë të domosdoshme një arkitekturë me fytyrë kombëtare është në radhë të parë mënyra e jetesës dhe psikologjia e popullit tonë sot, shija e tij e shëndoshë. Faktorë të tjerë janë akordimi i ndërtimeve të reja me arkitekturën e vjetër me vlerë popullore e kombëtare në qytete të tilla si Berati, Kruja, Gjirokastra, Shkodra e gjetiu si dhe në fshat: në rradhë të parë në linjën e tyre të përbashkët plastike; akordimi me natyrën e vendit tonë, me nevojat dhe jetën ekonomike.

Një faktor tjetër që ndikon në disa gjini të arteve si pllakati, karikatúra, ilustrimi etj. është edhe shtypi,

arti i të cilit nuk është zbatuar duke u mbështetur mbi baza të vërteta shkencore.

Zhvillimi harmonik i gjinive të ndryshme të arteve figurative është pjesë përbërëse e kulturës masive e cila, siç u theksua në Kongresin e 7-të të Partisë, duhet të ngrihet në një nivel më të lartë. «Për këtë, — tha shoku Enver Hoxha, — është e nevojshme të formohet një koncept më i gjërë për kulturën, duke e parë atë në të gjitha aspektet e ndryshme të jetës, dhe për njeriun e kulturuar». Në këtë kuptim të kulturës duhet parë vendi i të gjitha gjinive të arteve figurative që të rritet edhe roli i tyre militant, aktiv për idetë e Partisë dhe idealit e komunizmit.

## MONUMENTALITETI I JETES SONE DHE PASQYRIMI I TIJ NE SKULPTURE

Historia e popullit tonë, që nga e kaluara e lashtë dhe deri te e sotmja socialiste, është e mbushur me shembuj të shumtë heroizmi të rrallë. Ky heroizëm shkëlqor është transmetuar nga brezi në brez, është bërë tipar dallues i kombit tonë. Me të është ushqyer gjithënjë populli e sidomos rinia jonë, e cila ka ecur kurdoherë me krenari në rrugën e lavdishme të baballarëve trima. Një rol të madh për pasqyrimin e këtij heroizmi ka luajtur e luan arti, dhe në kuadrin e tij, skulptura, së cilës, në dritën e mësimave të Kongresit të 7-të të Partisë i dalin detyra të rëndësishme.

Megjithë sukseset e shumta që ka arritur skulptura jonë, i mbetet shumë për të bërë që të pasqyrojë sidomos monumentalitetin e jetës sonë socialiste. Madhështore janë fitoret e vendit tonë të arritura në të gjitha fushat në epokën e Partisë si gjigandët e dritës e të çelikut që po ngrihen në Fierzë, Elbasan, Ballsh, linjat hekurudhore e të tensionit të lartë, lindja e qyteve të rinj, transformimi i thellë socialist i fshatit dhe duke arritur deri tek vepra më e madhe e kohës sonë, njeriu i ri. Ky realitet i mrekullueshëm i ka frymëzuar

dhe do t'i frymëzojë si të gjithë krijuesit tanë, edhe skulptorët për vepra monumentale, si është vetë jeta.

Nga koha e paraçlirimit kemi trashëguar pak vepra të skulpturës monumentale. Në sheshet para tyre, në vitet e Luftës, u organizuan mitingje, greva e demonstrata. Mbas Çlirimit, pranë tyre ngriheshin tribuna manifestimesh përkujtimore ngjarjesh të rëndësishme.

Por lulëzim të vërtetë skulptura jonë jetoi pas Çlirimit. Po mbushen 30 vjet nga vendosja e njerës prej skulpturave të para, ajo e Partizanit po mbas saj, zbulohet sheshet edhe shumë të tjera si bustet e Qemal Stafës, të Vasil Shantos, të Vojo Kushit, të Misto Mames, të Mustafa Matohitit, të Margarita Tutulanit, të Zonja Çurres, të Bules e Persefonit etj., të cilat janë futur thellë në jetën tonë dhe luajnë rol në edukimin patriotik e estetik të masave e kryesisht të brezit të ri.

Vepra skulpturale me vlera të shquara janë varrezat e dëshmorëve të ngritura me kujdes në gjithë vendin të cilat shprehin respektin e Partisë e të popullit për ata që i falën jetën lirisë së Atdheut. Në këto vepra është derdhur dhe talenti i skulptorëve tanë.

Vlerat e skulpturës sonë të realizmit socialist janë të shumta, të bukura e të larmishme. Në mes tyre kujtojmë veprat monumentale të Skënderbeut, të Pavarësisë, të Katër Heroinave, të Nënës Shqipëri, të Mushqetasë, të Partizanit fitimtar, Përmendoren e 1920-ës etj.

Por me gjithë këto suksese që ka arritur skulptura jonë e re ajo përsëri është ende larg dhënies së monumentalitetit të jetës sonë socialiste duke pasqyruar në vepra të fuqishme vendosmërinë e popullit tonë nën udhëheqjen e Partisë me shokun Enver në krye, për të ecur në rrugën socialiste, duke sfiduar me guxim bllokadën e egër imperialisto-revizioniste. Madhështia e kësaj qëndrese në rrethim dhe ndërtimi me sukses i shoqërisë socialiste, duhet të frymëzojë edhe në të ardhmen skulptorët tanë për vepra të bukura e të fuqishme. Si në të gjitha sferat e jetës sonë politike, ekonomike e ushtarake, edhe këtu faktor vendimtar për arritjen e fitores mbi armiqtë është njeriu i ri, për të cilin me të drejtë thuhet se është vepra më e madhe e kohës sonë. Mirëpo skulpturës sonë i mbetet shumë për të bërë në mënyrë që ta japë me gjithë madhështinë e vet këtë hero të kohës sonë.

Kusht vendimtar për të zbuluar e pasqyruar drejt madhështinë e kohës sonë, krahas talentit dhe zotërimit

të ligjeve të artit, është njohja e thellë e jetës. Skulptori duhet të bëjë një jetë ideologjike intensive në gjirin e masave, të provojë thellë bashkë me to gëzimet e shqetësimet që lindin në punën e përditshme për ndërtimin e socializmit, si kusht për të arritur pastaj në kuptimin dhe pasqyrimin e drejtë të dukurive të jetës shoqërore në vepra me vlera të shquara ideoartistike. Natyrisht, njohja e jetës nuk duhet kuptuar si një gjë e thjeshtë që arrihet vetëm «duke vajtur në bazë» si i thonë. Ajo është një proces i ndërlikuar dhe i vështirë që presupozon një përgatitje të gjithanëshme të artistit. Përveç aftësive profesionale, njohja e jetës kërkon një formim të shëndoshë botëkuptimor marksist-leninist të skulptorit, në mënyrë që dukuritë e jetës ai t'i kuptojë e interpretojë drejt, që të hetojë menjëherë tendencat e ndryshme që përfaqësojnë ato. Prandaj në dritën e mësimeve të Kongresit të 7-të të Partisë, të përpigemi më shumë për të njohur e pasqyruar drejt kohën tonë të madhërishtme në vepra të tilla me vlera të larta ideoartistike si Portreti i shokut Enver, «Lart frymën revolucionare», «Në një dorë kazmën e në tjetrën pushkën» etj.

Pra, për të krijuar vepra që të pasqyrojnë denjësisht madhësitë e kohës sonë, është e domosdoshme të përvetësojmë thellë marksizëm-leninizmin, mësime të Partisë e të shokut Enver, të cilat na shërbejnë si busull për t'u orientuar drejt që në zgjedhjen e temës. Gjithashtu është e domosdoshme një punë këmbëngulëse me kërkesa të larta ndaj vetes, punë pa të cilën talenti e fantazia sado të ndezura të jenë, nuk japin dot vepra arti me vlera të mëdha. Vlerat, artisti i vërtetë, i zbulon në shpirtin e popullit dhe pastaj me talentin dhe frymëzimin e tij u jep jetë në figura të gjalla, me tipare të qarta kombëtare.

## MBI THELLIMIN E PSIKOLOGJISË SË PORTRETIT NE PIKTURE

Artet figurative, duke qenë të lidhura kurdoherë me realitetin konkret revolucionar, duke ndjekur me besnikëri orientimet e direktivat e Partisë kanë fituar përherë e më shumë cilësi të reja ideoartistike në të gjitha gjinitë. Në qoftë se disa vjet më parë p.sh. në portretin në pikturë, në raport me gjinitë e tjera, vihej re një prapambetje e dukshme, tani mund të themi se ai është vënë në rrugë më të mirë, çdo ekspozitë sjell vepra të frymëzuara edhe në këtë gjini. Lidhjet e piktorëve me jetën, pjesëmarrja aktive në veprimtarinë politiko-shoqërore, ngritja ideologjike, politike e profesionale, veçanërisht pas Plenumit IV të KQ të Partisë, kanë rritur në nivel më të lartë mendimin e shprehjen artistike edhe në gjininë e portretit. Kjo është e lidhur edhe me luftën që bënë artistët kundër pikëpamjeve armiqësore, antikombëtare të F. Paçramit e T. Lubonjës, kundër shfaqjeve të formalizmit, «dekorativizmit», skematizimit, pompozitetit, që u dukën në disa raste edhe në portret.

Materialet e Kongresit të 7-të të Partisë, veçanërisht raporti që mbajti shoku Enver, si për të gjitha fushat edhe për artet figurative, janë një tjetër forcë e madhe shtytëse për të forcuar akoma më shumë partishmërinë

proletare, përmbajtjen socialiste e karakterin kombëtar të tyre.

Portreti në pikturë, për vetë specifikën e tij i jep dorë piktorit të zbulojë më mirë e në mënyrë më të plotë tiparet sociale të njeriut, botën e mendimeve e ndjenjave të tij. Për këtë arsye interesi i krijesve ndaj njeriut të përparuar të shoqërisë sonë, zë një vend të dukshëm në artin tonë figurativ. Në disa vepra, karakteri i heroit në portret zbulohet duke e vendosur atë në atmosferën e veprimtarisë së përditshme të tij, në mjedisin e uzinës, fshatit, në aktivitete politike e shoqërore etj. Në disa të tjera vëmendja e piktorit është përqëndruar krejtësisht në gjendjen psikologjike, në botën e brendshme të tij. Sigurisht, si më të shquar qëndrojnë portretet, në të cilët, krahas atmosferës së përgjithshme, janë zbuluar më mirë tiparet individuale e shoqërore të njeriut tonë. Në «Portretin e shokut Enver Hoxha» Z. Shoshi ka ditur të vizatojë e të pasqyrojë bukur e me dashuri jo vetëm tiparet individuale, por edhe mendimet largpamëse të udhëheqësit të Partisë e të popullit tonë si dhe botën e madhe të ndjenjave. Kurse «Partizani» i F. Stamos, i kompozuar lirshëm, me qëndrim të natyrshëm e pushkën mbi supe, në tërësinë e tij, veçanërisht me psikologjinë e fytyrës shpreh vendosmëri e optimizëm, që i jep figurës një notë lirike e monumentale njëkohësisht. Po kështu në veprën «Diga e Drinit» N. Zajmi nëpërmjet vendosjes në një ambjent epik të një grupi punëtorësh, është përqëndruar në radhë të parë në psikologjinë e në botën shpirtërore të punëtorëve pararojë, prandaj ata duken optimistë, të vendosur e revolucionarë të ndërgjegjshëm. Një kënd të tillë vështrimi shohim edhe në portretet e tjera me vlera ideoartistike, si «Nëna» e R. Shabanit, «Q. Stafa» i B. Sejdit, «Partizani» i D. Jukniut, «Shyqyri Kanapari» i M. Qarrit, «Tekstilistja» e H. Nallbanit, «Partizani me ditar» i N. Jonuzit e në mjaft portrete të tjera të realizuar.

Këto dhe arritje të shquara në këtë gjini na japin shkas e të drejtë për të kërkuar më shumë, për të hyrë edhe më thellë në problemet e zgjidhjes ideore e emocionale të portretit. Portreti krijon mundësi shumë të mëdha për t'u thelluar jo vetëm në individualitetin e heroit, nëpërmjet zbulimit të tipit, karakterit, por edhe në botën e brendshme e psikologjike, në mendimet dhe idetë e tij. Në portret duhet të ndjehet medoemos koha,

realiteti i sotëm me epikën e tij revolucionare, si dhe qëndrimi ideoemocional e këndi i vështrimit të piktorit, i cili krijon në këtë situatë revolucionare që jeton vendi ynë.

Këtë gjë nuk e gjejmë kurdoherë plotësisht të realizuar në portretet tona. «Mjelsja» e S. Capos p.sh. ndonëse e vizatuar me përpikmëri dhe e vendosur në ambient pune, ndonëse edhe me një tip pak a shumë të përcaktuar fshatareje, nuk e shpreh plotësisht kooperativisten e kohës, të gjallë e dinamike, që lufton me zgjuarsari e vetëdije ideopolitike për të ecur përpara, nuk arrin sa duhet të krijojë një gjendje emocionale, që ta bëjë vizitorin të jetojë me mendimet më të përparuara të mjelses. «Tornitorja» e Z. Shoshit ka një vendosje të bukur, me vizatim të gjetur, në një ambient uzine, me atmosferë artistike, por në të njëjtën kohë autori nuk ka mundur të zgjedhë një tip punëtorëje të përshtatshme, të vërtetë, që t'i jepte dorë atij të krijonte një portret të gjallë, dinamik, me psikologjinë e punëtore revolucionare, pararojë të kohës sonë.

Duke parë me vëmendje disa portrete të Ekspozitës Kombëtare të vitit të kaluar, të bien në sy figura që kanë ngjashmëri me modelet që kanë pozuar, të cilët janë tipa, karaktere në vetvete, kurse nga pikëpamja e shprehjes psikologjike në tërësinë e tyre nuk janë të përcaktuar në mënyrë tërësore, d.m.th. nuk janë parë, aq sa do të dëshironim edhe në raport me psikologjinë e përgjithshme të shoqërisë sonë të sotme. Portretet «Veterania nga Orenja» si dhe «Veterania Kade Beqiri» të F. Stamos në këtë ekspozitë janë të lavdërueshme për ngjashmërinë, për tipat që pasqyrojnë, të cilat janë tipa të vërtetë shqiptarë, të individualizuar për motivet tematike që e kanë shtyrë piktorin në krijimin e portreteve të tyre. Të gjitha këto janë mjaft pozitive sepse nuk i gjejmë kurdoherë në portretet tona. Por, nga ana tjetër, bota e brendshme psikologjike, shprehja e fytyrës, sfondi i jashtëm neutral, kompozimi dhe vendosja e zakonshme e portreteve, nuk e ndihmojnë autorin të zbërthejë aq sa duhet në to gjendjen emocionale e mendimet e sotme që do të karakterizonin këto figura të Luftës. Një qëndrim më kërkues i autorit edhe në këtë aspekt do t'i bënte këto portrete jo vetëm më të bukur artistikisht, por, më kryesorja, do të kishte mundur t'i vendoste ato më në kohë, në gjendjen emocionale të njeriut të epokës sonë.

Kontakti i gjallë i piktorit S. Shijaku me jetën e fshatit tonë socialist e ka ndihmuar atë të gjejë emociione të freskëta, të pasurojë galerinë e tipave, të pejzazheve, e të subjekteve nga jeta në fshatin tonë të ri e të gjallërojë paletën kromatike. Dy portretet e tij që u ekspozuan në Ekspozitën e vitit të kaluar «Nusja nga Divjaka» dhe «Pleqëri e bardhë», janë portrete të shpejtë, pa kërkesa të mëdha përgjithësuese nga autori, janë si të thuash, më shumë përshtypje, etyde, sidomos ky i fundit. Portreti «Nusja nga Divjaka», në thjeshtësinë e vet, ka një vendosje të bukur, kolorit të gjetur e harmonik, me dritë. Nën shaminë e vajzës spikat një tip i vërtetë myzeqareje. Portreti është pikturuar me kulturë profesionale. Por, krahas këtyre vlerave, do të dëshironim që në portret të shihnim, në radhë të parë, më shumë një myzeqare të emancipuar, revolucionare, me sy të gjallë e të zgjuar, e kryesorja me psikologjinë e përparuar të fshatares së Myzeqesë socialiste, nga e cila kanë dalë sot sa e sa gra revolucionare, pararojë, që punojnë e drejtojnë që nga brigada deri në vende me përgjegjësi në shtet e në Parti. Autori, krahas kërkesave artistike, mendojmë se duhej të synonte për t'u thelluar më shumë në zgjidhjen psikologjike të portretit, e cila do të dilte jo vetëm nëpërmjet shprehjes së fytyrës, por edhe nëpërmjet gjithë komponentëve të tjetër artistikë të portretit. Portreti tjetër i këtij autori «Pleqëri e bardhë», i zgjidhur më shumë me mjetet grafike të pikturës, pasqyron një tip karakteristik të plakut myzeqar. Piktori ka ditur me aftësi të kapë tiparet karakteristike të fshatarit pensionist myzeqar. Megjithatë, që të zgjidhej më mirë kjo përmbajtje, mendojmë se portreti duhej parë nga këndi i psikologjisë së pensionistit fshatar, zgjidhjes së të cilit do t'i shërbenin jo vetëm vështrimi i syve, psikologjia e përgjithshme e fytyrës, por e gjithë gjendja emocionale e portretit. Kjo do të bënte që në këtë portret të përgjithësohej më mirë optimizmi, gëzimi i jetës, krenaria e pensionistit kooperativist, lufta, puna e djersa e të cilit nuk shkuan kot.

Këta shembuj të pakët që mora për ilustrim, jo pa qëllim i zgjedha nga krijimtaria e piktorëve tanë më të mirë. Këtë e bëra se nëpërmjet tyre mund të dalin më mirë në pah problemet më të mprehta aktuale të interpretimit ideoartistik të portretit në pikturën tonë.

*«Arti i vërtetë — theksoi shoku Enver në Kongresin e 7-të, — forcon tiparet e veta novatore dhe fiton një nivel të lartë artistik, kur mishëron një përmbajtje revolucionare dhe kur udhëhiqet nga idealet komuniste».* Këtu nxjerrim mësimin shumë të çmueshëm se në çdo portret të pikturuar, duhet të synojmë që të shihet jo vetëm pasqyrimi i një individi të caktuar, por prapa tij të ndjejmë e të shohim figurën artistike që bart në vetvete idetë e kohës, idealet komuniste të shoqërisë sonë.

Portreti është një gjini e vështirë e arteve figurative, elementet figurative janë shumë të kursyer e të koncentruar brenda kornizës së telajos, prandaj kërkon pikësnyime të qarta e sa më të plota ideo-artistike, qëndrim estetik e mjeshtëri artistike. Kërkon, në radhë të parë, përgatitje politike e ideologjike, njohje të thellë të jetës e të proceseve të saj revolucionare. Kërkon gjithashtu njohje të afërt e të thellë të njeriut që portretohet. Është meritë e veçantë për piktorin tonë në qoftë se arrin që në kohën e seancave të punës me portretin, njeriu që pozon para tij të dijë të jetojë me problemet, mendimet, emocionet e tij individuale dhe jo me pozën që duhet të marrë para piktorit si para fotografit. Kështu mund të realizohet më mirë në telajo një portret që përmban në tërësinë e tij psikologjike shoqërore të heroit të portretuar, një portret i natyrshëm me frymëmarrje, pa sforcim, pa pozë.

Epoka jonë, epoka e Partisë kërkon që portreti ynë të krijojë figura poetike, të cilat duhet të flasim me një stil epik, madhor, figura ku të vlojë gjaku i zjarrtë, madhështia e karakterit, mendimi i shqiptarit të kohës të mburjtur me idealet komuniste të Partisë sonë.

## PIKTURA MONUMENTALE

Nga viti në vit artet tona figurative të realizmit socialist, duke zbatuar me konsekuencë orientimet e Partisë, mësimet dhe porositë e shokut Enver, krahas pasqyrimit me vërtetësi e realizëm të jetës, kanë zgjeruar rrezen e veprimtarisë edhe në fusha që vite më parë lëvroheshin më pak, siç janë, grafika, ilustrimi i librit, pllakati, skenografia e teatrit dhe e filmit, disa teknika të arteve të aplikuara, piktura monumentale etj.

Ekspozitat e viteve të fundit, sidomos pas Plenumit të 4-t të KQ të PPSH, shënuan suksese të rëndësishme. Në qoftë se bëjmë një krahasim ndërmjet pikturës dhe skulpturës, kjo e fundit i ka plotësuar më shpejt fushat e veprimtarisë së saj, dhe në këtë rrugë zhvillimi ndjehet se paraprind skulptura monumentale si një art me ndikim masiv të drejtpërdrejtë e të gjerë. Ajo u ka bërë jehonë e ka fiksuar në gur, çimento e ngjarje të mëdha historike dhe aktuale, momente kyçe të revolucionit dhe ndërtimit socialist të vendit, figura të shquara të historisë dhe traditave luftarake të popullit. Duke patur veçorinë e të komunikuarit me ambiente të hapura, skulptura monumentale shtrihet në të katër anët e Atdheut me një numër veprash shpesh me nivel të lartë ideoartistik, me përmbajtje të shëndoshë klasore, me karakter kombëtar e thjeshtësi që i afrohen përherë e më shumë asaj të popullit.

Piktura monumentale, piktura që me teknikat e saj murale lidhet kryesisht me arkitekturën, mbetet aktualisht për artet tona figurative një ndër fushat që kërkon vëmendje më të madhe, si nga pikëpamja e përqëndrimit të forcave (krahas lëvrimin të gjinive të tjera), ashtu edhe nga ana organizative, për të krijuar ato kushte që lidhin ngushtësisht punën e arkitektit me zgjidhjet figurative të shumë objekteve të rëndësishme arkitektonike. Zgjidhja e një detyre të tillë vite më parë ka patur edhe vështirësi objektive. I pakët ka qenë numri i arkitektëve dhe po ashtu i piktorëve të specifikuar për të përballuar të tilla detyra.

Kongresi i 7-të i PPSH përcaktoi përpara arkitekturës sonë detyrën e thellimit të mëtejshëm të fizionomisë kombëtare, të studimit dhe të aplikimit të traditës sonë të pasur e tepër të larmishme edhe në këtë fushë. Bashkërenditja e arteve tona figurative në këto përpjekje do të ndikojë në zgjidhjen e këtyre kërkesave. dhe piktura e skulptura monumentale me teknikat përkatëse do ta pasurojnë organikisht vlerën e çdo objekti arkitektonik të rëndësishëm.

Trajtimi i temave të mëdha të kohës nuk është privilegj i gjinive të veçanta. Artet tona figurative, si gjithë kultura jonë socialiste, duke i trajtuar ato, do të rrisin vetë përmbajtjen, nivelin ideoestetik dhe fizionominë kombëtare të tyre. Gjini si piktura monumentale, janë të prirura të bëjnë gjithmonë përgjithësime të mëdha të realitetit, ta trajtojnë temën e madhe njësoj si e trajton me sukses skulptura monumentale. Shumë institucione social-kulturore, ndërtesa shtetërore, etj. në të katër anët e Atdheut, janë dëshmi e veprës monumentale të epokës së Partisë, tablo e gjerësisë së zhvillimit kulturor të njerëzve tanë në qytet e fshat. Përgjithësisht fasadat dhe brenditë e këtyre institucioneve nuk janë pasuruar me vepra të pikturës murale, me teknikat e mirëfillta të saj të lidhura tradicionalisht me arkitekturën si pjesë përbërëse dhe e përndarë e saj. Plotësimi i një kërkesë të tillë do t'ua shtonte bukurinë, forcën komunikuese dhe edukuese, pasi në ambjente të tilla, jashtë e brenda, zien jeta kolektive. Shëmbujt e pakët të realizuar deri më sot, si ai i mozaikut në fasadën ballore të varrezave të dëshmorëve në Durrës e ndonjë tjetër, si edhe përpjekjet e shkëputura për punë dekorative me karakter monumental, të paraqitura nëpër ekspozitat tona, janë raste të pakta në krahasim me gjithë mundësitë e pashfrytëzuara deri më sot.



Nga ana tjetër piktura jonë e ka ndjerë nevojën e shprehjes dhe konceptimit monumental. Vetë përmbajtja e shëndoshë, trajtimi epik i temës së heroizmit popullor në shumë tablo të fundit të arteve tona, ka ndikuar në zgjidhje figurative, të cilat mund të zbërtheheshin rishtas me destinacion të caktuar në teknikat e pikturës murale, duke fituar vlera të reja dhe një ndikim e popullaritet më të gjerë. Vepra të tilla si «Refugjatët», «Çlirimi i Tiranës», «Ndarja e Tapive», «Vojo Kushi» e «Mic Sokoli», «Rrethimi i Krujës», «Barinjte» e shumë të tjera mund të dilnin nga muret e galerisë në një shesh me mundësira të reja komunikimi.

Vepra, si ato që përmendëm, sqarojnë pjesërisht edhe një problem që ndeshet në ekspozitat tona. Disa përpjekje për t'u shprehur në mënyrë monumentale lidhen me disa punë dekorative të zgjidhura pa një temë dhe subjekt të përqëndruar.

Në raste të tilla këto punime janë një bashkim eklektik i shumë aspekteve pa lidhje të ndërmjetme, janë më tepër grupime figurash e momentesh të ndryshme, duke krijuar shpesh një mbingarkesë në pastërtinë ideore të përmbajtjes që, në ndonjë rast të veçantë, zbehin edhe vetë dëshirën e mirë të autorit, duke krijuar edhe keqkuptime. Nuk është i përjashtuar rasti kur logjikisht një zgjidhje e tillë përshkohet nga një ide qëndrore e qartë dhe e shprehur po ashtu me mjete të thjeshta e të qarta, pa simbolizma e metafora. Por edhe piktura monumentale, si çdo gjini tjetër, duhet të verë në qendër të vëmendjes zgjidhjen e temës me subjekt të qartë, me pasqyrimin e fenomeneve tipike të jetës në rrethana konkrete, të konceptuara në mënyrë monumentale në tërësinë e marrëdhënieve kompozicionale të veprës, larg pozave, qëndrimeve të ftohta dhe efektive të jashtme. Është me rëndësi të sqarohen këto probleme që në përgatitjen shkollore të piktoreve të rinj monumentalistë. Si gjithë arti ynë, piktura monumentale do të mbështetet doemos në traditën e arteve tona figurative dhe në traditën popullore, në ato shembuj që mbeten një mësim i madh i bukurisë dhe thjeshtësisë së shprehjes figurative dhe jo vetëm figurative. Vëndi ynë ka një pasuri të tillë nuancash në gurët e shtratit të lumenjve, të maleve dhe të bregdetit, që zor se zëvendësohen nga prodhimet industriale prej zmalti. Fineza e kësaj bukurie na ka lënë, që nga lashtësia, mozaikë të bukur të një teknike të përsosur.

Duke zbatuar orientimet e Kongresit të 7-të të PPSH dhe mësimet e shokut Enver artet tona figurative do të rrisin akoma më shumë forcën komunikuese dhe edukuese ndër masat, nëpërmjet zhvillimit harmonik të të gjitha gjinive, duke përfshirë edhe pikturën monumentale si pjesë përbërëse e artit dhe kulturës sonë socialiste, në luftë për rritjen e forcimin e karakterit kombëtar të krijimtarisë artistike, kundër çdo ndikimi të huaj borgjezo-revizionist, për të pasqyruar me realizëm heroizmin dhe jetën e popullit tonë.

## PER NJE ZHVILLIM TE METEJSHEM TE PLLAKATIT

Pllakati ynë i realizmit socialist me përmbajtjen e tij socialiste, ka qenë e është përherë militant. Ai ka folur me gjuhë të pastër e koncize, me një vizatim të thjeshtë e ngjyra të qarta. Le të kujtojmë pllakatet e krijuara sidomos këto vitet e fundit si: «Partia», «Ja vdekje ja liri» të F. Ashikut; «Malet me blerim mbuluar» i N. Prizrenit, «1 Maji» i V. Priftit, «10 Korriku» i P. Meles, pllakatet kushtuar festës 1 Majit 1976, pllakatet e Spiro Kristos, Z. Shoshit, I. Çezmës, B. Dizdarit, Z. Matit, S. Pranikut etj. dhe do të vërejmë se pllakati ynë ka arritje të mira e të suksesshme, duke qenë mobilizues e luftarak e, duke agjituar e propaganduar me forcë problemet më të rëndësishme që shtron Partia.

Por megjithë sukseset dhe rezultatet e mira që kemi, nuk mund të pretendojmë se kemi patur përherë gjetje origjinale dhe të goditura. Kemi patur edhe raste të përsëritjes së mjeteve shprehëse dhe ngarkesa me figura e elemente të tepërt, gjë që ka sjellë komplikime në leximin e mirë dhe në fuqinë komunikuese të pllakatit, fjala vjen pllakati i B. Dizdarit kushtuar 30-vjetorit të klubit sportiv Partizani e ndonjë tjetër. Pllakati duhet të luftojë si britmat pompoze, ashtu edhe statizmin apo qetësinë që vjen si rezultat i moskërkimit të vazhdueshëm, apo dhe i ndonjë përsëritjeje gjë që e gjejmë p.sh. te pllakati i Z. Matit kushtuar zgjedhjeve të 3 Prillit.

Pllakatistët tanë i kanë dhënë rëndësi pllakatit për-

kujtimor dhe në këtë drejtim janë krijuar punime të bukura dhe militante, sidomos për festat në ditët e shënua-ra, p.sh. pllakatet kushtuar Kongresit të 7-të të Partisë, festës së 1 Majit 1976, apo ai kushtuar 8 Marsit të këtij viti që janë pasqyrë e një realizimi me nivel të mirë ideo-artistik. Megjithatë në ndonjë rast kemi patur problemet që kanë dalë në vetë rrugën e zhvillimit të tij si, përsëritje figurash nga një pllakat tek tjetri gjë që ka krijuar shablone; po ashtu edhe përdorimi me vend e pa vend i gërmave, të cilat kanë peshën e tyre në pllakat kur përdoren në raport të drejtë me figurën por shpesh ato janë vënë në rolin e dorës së dytë. Ka raste kur autorët kanë punuar me nxitim dhe kjo ka shpër në ndonjë pllakat me dobësi të theksuara ideore dhe artistike. Vërtet pllakati duhet t'i përgjigjet flakë për flakë realitetit por kjo nuk do të thotë që në kërkesat artistike piktori duhet të tolerojë edhe atëherë kur pllakati duhet të dalë sa më shpejt në shtyp.

Lufta kundër shfaqjeve liberale dhe burokratike nuk është pasqyruar sa duhet nëpërmjet pllakatit. Gjithashtu nuk patëm pllakate aq të fuqishëm për diskutimin e gjerë të Projektkushtetutës, që t'i përgjigjeshin denjësisht trajtimit të këtij problemi mjaft të rëndësishëm. Më i arrituri ndër ta ishte ai i piktorit Z. Shoshi.

Për ecjen dhe zhvillimin e pllakatit ka rëndësi të madhe dhe përkrahja e të rinjve pllakatistë. Dhe në këtë drejtim ka filluar të çahet; themi kështu se akoma mbi-zotërojnë më shumë autorë e firma të njohura dhe të rinjtë më pak merren me këtë gjini të rëndësishme. Më shumë në të ardhmen duhet të debutojnë të rinjtë e sidomos ata që dalin nga Instituti i lartë i arteve e që kanë përgatitjen e nevojshme në këtë gjini, sepse pak autorë kemi, në një kohë kur shtypi ynë e kërkon gjithmonë pllakatit. Përveç angazhimit të shokëve të rinj, edhe piktorët e ka-valetit dhe skulptorët mund të bëjnë pllakate.

Probleme nxjerr edhe pllakati i filmit, i cili me gjithë përparimet në të kaluarën, përsëri, në ndonjë rast, nuk qëndron në lartësinë e vetë filmit, mbasi shpesh herë ato nuk zbërthejnë si duhet përmbajtjen e tij p.sh. në filmat «Zonja nga qyteti», «Në fillim të verës», apo «Pylli i lirisë» mungon konçiziteti në dhënien e vetë subjektit të filmit si dhe mënyra dekorative dhe e qartë e paraqitjes së tyre. Ose ka raste që pllakatet vihen në vende të papër-shtatshme, prandaj dhe nuk ngjallin emocione. Pllakati nuk duhet të mbushë boshllëqe por të lozë rolin e tij të madh.

Mendoj se në ngritjen e nivelit artistik të pllakatit influencon edhe formati, i cili nuk duhet të imponohet, por të lëvizë në mvarhtësi të zgjidhjes kompozicionale dhe të idesë. Gjithashtu janë të gjitha mundësitë për ta shtuar tirazhin e tij, lidhur kjo edhe me kërkesat e kohës. Njëkohësisht edhe shtypshkronjat tona duhet të rrisin kërkesat për një botim sa më të pastër dhe sa më afër origjinalit, mbasi në shumë raste pllakati humbet shumë nga riprodhimi i dobët dhe i pakujdesshëm.

Edhe reparti i dekorit të qytetit, duhet t'i vërë rëndësi zmadhimit me rigorozitet të pllakatit, sepse ka raste që bëhen deformime nga origjinali. Gjithashtu një vëmendje e veçantë i takon figurës së njeriut në pllakatet, gjithnjë në raport të drejtë me gërmat se kështu rriten vlerat e tij. Mendoj se ka ardhur koha që të organizohet një bërthamë e redaksive për pllakatin pranë Ndërmarrjes Botuese, lidhur kjo me organizimin më të mirë të krijimtarisë së pllakatistëve, redaksi e cila do të bëjë të mundur përballimin jo vetëm në sasi për pllakatet e kërkuara, por edhe në cilësi. Gjithashtu pllakati duhet të gjejë më tepër vend në revistat tona dhe, sidomos, është e nevojshme të militojë më tepër në ekspozitat tona e në galeritë e arteve.

Perspektivat e pllakatit janë të mëdha, ashtu si në tërë gjinitë e tjera.

Partia shtron para pllakatistëve gjithmonë detyra të reja, të cilave duhet t'u përgjigjemi në kohë e denjësisht. Ne duhet ta luftojmë konceptin për të patur pllakate të mira vetëm në ekspozita apo në dy-tri festa në vit. Pllakatisti kurdoherë e në çdo moment duhet të jetë i gatshëm e t'i kryejë detyrat me nivel të lartë ideor e artistik, sepse ngjarje të mëdha e me rëndësi në jetojmë çdo ditë.

Përpara pllakatistëve tanë aq më tepër në fazën e tanishme dalin detyra të reja dhe të mëdha nën dritën e orientimeve të Kongresit të 7-të të Partisë e të mësimëve të shokut Enver Hoxha.

Për ta zhvilluar me sukses luftën në frontin ideologjik duhet t'i kushtojmë kujdes të madh edukimit të pllakatistëve për t'u armatosur përditë me ideologjinë e Partisë sonë, me mësimet e shokut Enver, me botëkuptimin marksist-leninist.

Kjo ka të bëjë me një kuptim të thellë teorik e praktik të problemit, me luftën që duhet t'i bëjmë njëanshmërisë në kapjen e trajtimit të temave të ndryshme, me faktin se duhet të krijojmë pllakate me një pikësynim të caktuar.

## PERDORIMI I MATERIALEVE TE FORTA NE SKULPTURE

Artet tona figurative tashmë kanë marrë zhvillim të madh dhe në aktivitetin krijues po debutojnë një numër i konsiderueshëm piktorësh, skulptorësh, grafistësh me përvojë dhe të rinj, të cilët i ekspozojnë veprat e tyre në ekspozita të ndryshme që çelen herë mbas here qofshin këto me karakter tematik, apo jubilar.

Tek ne ka bërë një përparim të dukshëm skulptura monumentale nëpërmjet kompozimeve, portreteve, relieveve etj., e cila për vetë natyrën e saj po lidhet më ngushtë me njerëzit, nëpërmjet tematikës e problemeve që pasqyrojnë, duke ngritur në piedestal ngjarje e data të rëndësishme nga historia e popullit tonë. Veprat e saj realizohen në materiale të ndryshme, me nivel të lartë ideartistik, tërheqin masat artdashëse për bukuritë dhe emocionet që u zgjojnë. Dukja në ekspozitat tona, në sheshe e vende historike e skulpturave të gdhendura në material, nuk është një element i jashtëm për skulpturën, por me vetë natyrën që ka materiali, me mundësitë dhe frymëzimin që ka derdhur krijuesi, në përdorimin me mjeshtëri të mjeteve

shprehëse në shërbim të idesë, krijon terren për ta fuqizuar veprën dhe për ta nxjerrë më evidente përmbajtjen e saj.

Nga viti në vit, në saje të studimeve e kërkimeve po dalin në dritë vlera të mëdha të kulturës materiale të popullit. Kjo krijimtari, që ruhet me kujdes, e realizuar nga mjeshtrat tanë popullorë me shumë dashuri, në mermer, gur, dru, qeramikë etj. flet për realizime të bukura e të qëndrueshme, të cilat kalojnë nga një brez në brezin tjetër duke i rezistuar thellësisë së viteve.

Populli ka shprehur gjithë këto vlera shpirtërore të kulturës materiale duke gdhendur gurin me ornamentin e bukur dhe e ka vendosur në harkun e portës, ka realizuar rozetën në dru dhe e ka vendosur në qendër të dhomës, e sa e sa krijime të tjera në material të fortë duke zotëruar me mjeshtëri cilësitë e materialit, për të shprehur në të mendimin, botën shpirtërore. Këto krijime përshkohen nga një virtuozeitet i rrallë, pavarësisht nga koha e gjatë në realizimin e tyre, ato ruajnë gjallërinë, ngrohtësinë, shprehin dinamizmin e jetës së shqiptarit.

Zhvillimit të shoqërisë sonë i është përgjigjur edhe skulptura si një gjini që gjithmonë ka nxjerrë vepra të cilat marrin pjesë aktivisht në jetën sociale, në edukimin ideoestetik të masave. Përpyekjet e artistëve janë të vazhdueshme për krijime të reja, duke formuar grupe pune për realizimin e monumenteve që do të vendosen në përkujtim të ngjarjeve të rëndësishme dhe që kërkojnë t'i përjetësojnë ato në pedestal. Në drejtim të kërkimit, zërthimit të idesë së veprave natyrisht po punohet me ngulm, por duhet thënë që për realizimin duhet menduar edhe rreth materialit që mund të përdoret, pra krahas zgjidhjes kompozicionale, zërthimit të ideve, është mirë që të shfrytëzohet dhe materialet e vendit tonë. Vepra mund të konceptohet për t'u realizuar dhe në bronx, por më mirë duhet menduar që të lidhet bronxi me gurin ose mund të realizohet vetëm në gur. Duhet të përqijemi që krijimet tona t'i realizojmë me zgjidhje sa më origjinale e të bukura. Se ma merr mendja se edhe realizimi i skulpturave, fjala vjen, vetëm në bronx nuk do ta lozë rolin e duhur. Ne kemi shumë drejtime që duhet të aplikojmë krahas metalit p.sh. në skulpturën e parkut edhe gurin; në krijimet për ambientet e brendshme mund të përdoret druri, guri e metali. Sidoqoftë, për përdorimin e materialeve në destinacionin e duhur duhet menduar mirë. Sot kemi realizime që flasin

për përpjekjet e krijuesve në këtë drejtim. Ne e kemi përdorur çimenton për realizimin e veprave por shikojmë se ky material dëmtohet në atë shkallë që ia humbet veprës cilësitë artistike.

Përdorimi i materialeve të forta në krijimtari kërkon punë kërkimore me qëllim që ato të vendosen në unitetin e duhur dhe t'i shërbejnë mendimit që shpreh artistin.

Ndër ekspozitat që janë organizuar, krahas krijimeve në allçi janë ekspozuar edhe vepra të realizuara në gur, dru, etj. si p.sh. vepra të skulptorit Ll. Nikolla, i cili e ka punuar me pasion gurin gjatë krijimtarisë së tij dhe na ka dhënë një sasi veprash me vlerë që pasurojnë fondin e krijimtarisë sonë. Në përdorimin e materialit na kanë dhënë krijimet e tyre A. Mano, K. Rama, Sh. Hadëri, Dhe më vonë dollën më të rinjtë Nelo Lukaçi, Skënder Kraja, Ilia Xhano, Hashim Kruja, Sami Turku, Stefan Papamihali, Piro Dollaku, Dhimitër Veriga, Hamza Halili etj. që po mërrren gjerësisht, duke na dhënë jo vetëm portrete, por edhe figura të kompozuara, krijime dekorative etj. Tani ka një kuptim më të gjerë si në shkollën e mesme artistike «J. Misja» ashtu dhe në Institutin e Lartë të Arteve, për të ngjallur tek krijuesit e rinj dëshirën për të punuar në material. Kjo është e lidhur me atë punë që bëhet për të kuptuar e përvetësuar vlerat që përmban krijimtaria popullore dhe e kultivuar. Në këtë mënyrë, duke mos e parë materialin si qëllim në vetvete, po si një element që artisti ta verë në shërbim të realizimit të veprës me vlera artistike, sigurisht kërkohet njohja e krijimtarisë popullore, kërkohet thellim në mënyrë sistematike për të gjykuar e vlerësuar se si janë përdorur elementët për të shprehur përmbajtjen, pa prishur cilësinë e materialit, të cilat i përdor në funksion të përmbajtjes, si në krijimet dekorative dhe në ato raste që përmbajnë aspekte nga vetë jeta e përditshme.

Shohim vlerat etnografike, diku shikon oxhak të gdhendur në gur, apo kanatet e dollapeve, dyert etj. dhe të bëjnë për vete bukuria që kanë këto krijime, dekorativiteti harmonioz, pastërtia me të cilën janë realizuar. Kështu, në një krijim në hekur realizuar nga mjeshtëri popullor që në vështrimin e parë të bie në sy se sa fantazi e zgjuarsishtë është derdhur atje. Në dukje mund të jetë një fushë e kufizuar krijimi, kurse në fakt gjejmë një larmi të atillë sa të zgjon kureshtje e interes me aftësinë krijuese, me mënyrën e përdorimit të materialit, me plastikën që përfshihet

het në të duke konkretizuar ornamentin, duke ruajtur gjithmonë natyrën e materialit.

Sigurisht vlerat që trashëgojmë janë shembuj dhe frymëzim për artin e kultivuar dhe për të vlerësuar ato duhet një punë e vazhdueshme e këmbëngulëse me qëllim njohjeje dhe asimilimi.

Përmbajtjen e re duhet të dimë ta pasqyrojmë me mjete të atilla që të jenë sa më shprehëse e të larmishme, me qëllim që të komunikojmë sa më mirë me masat tona artdashëse.

NGA  
NENREFERATET  
PER MUZIKEN

## KRIJIMTARIA MUZIKORE TE LIDHET ME NGUSHTE ME JETEN E POPULLIT

Krijimtaria jonë muzikore është e lidhur ngushtë me jetën e popullit dhe me gjithë problemet që ngrihen para shoqërisë. Objekt frymëzimi i kësaj krijimtarie është puna dhe lufta e popullit tonë për ndërtimin e socializmit nën udhëheqjen e Partisë e të shokut Enver. Kongresi i 7-të, programi dhe orientimet e Partisë, i hapën edhe muzikës sonë perspektiva të ndritura. Ajo duke ndjekur zhvillimin e socializmit në bazë të programit madhështor të Partisë, do të njohë me siguri arritje të tjera më të shquara, sepse si çdo gjini dhe lloj i artit tonë, është pasqyruese e transformimeve që ndodhin në jetën, në botën shpirtërore dhe në psikologjinë e popullit. Duke ndjekur ritmet e përparimit të vëndit, me një tendencë të theksuar klasore dhe me partishmëri të lartë proletare, gjithë gjinitë e muzikës sonë kanë fituar vazhdimisht cilësi të reja dhe janë bërë të afërta dhe të dashura për njerëzit tanë.

Arti ynë muzikor e filloi rrugën e tij pas çlirimit, në frymën e këngëve partizane dhe duke u mbështetur mirë

në krijimtarinë muzikore të popullit. Gjatë këtyre viteve të një jete intensive dhe plot frymëzim, kompozitorët tanë krijuan një fond veprash me vlerë mbi të cilat mund të mbështetem për ta çuar artin tonë muzikor akoma më përpara. Pa përmend këtu Rapsoditë e Konos, përpunimet e Trakos, operën «Mrika» dhe «Skënderbeu» të Jakovës, simfoninë dhe koncertin për piano të Zadejës, balletin «Halili e Hajrija» dhe veprat instrumentale të Daisë, koncertin për piano dhe operën «Zgjimi» të Harapit, simfoninë dhe vallet e Gjonit, simfoninë dhe pjesët për piano të Larës, rapsoditë dhe koncertin për piano të Ibrahimit, simfoninë dhe pjesët instrumentale të Dizdarit, rapsoditë e Larës, poemat simfonike të Kushtës, pjesët instrumentale të Peçit, Gacit, Dedës, si dhe shumë këngë të bukura të Prodanit, Mulës, Krajkës, Hoshafit, Grimcit, Çangut, Mingës, Zaharianit, Gjinit, Kodrës, Xhungës, Osmanit, Bulos, Lalos, Dokos etj. Në këto vepra mund të gjejmë karakteristika dhe shprehje artistike individuale nga të cilat formohet fizionomia e përgjithshme kombëtare e artit tonë muzikor. Në vitet e fundit në muzikën tonë fizionomia kombëtare ka ardhur duke u forcuar. Kompozitorët sjellin gjithmonë shprehje të reja artistike jetësore, drejtohen drejt temave dhe figurave të reja. Kërkohet në drejtim të formës, të gjuhës, të mjeteve shprehëse të këtij arti; ritmi, modi, intonacioni. Fusha e tyre është rritur e zhvilluar. Krahas kësaj është rritur dhe kuptuar rëndësia e kërkimit krijues. Megjithëse këto kërkime nuk kanë qenë gjithmonë të suksesshme, aktivizimi i gjithanshëm i mendimit krijues, është një punë e frytshme. Ku kanë synuar kërkimet e kompozitorëve tanë në veprat e tyre të viteve të fundit? Po përmend disa prej tyre. Kompozitorët, me guxim dhe të mbështetur në krijimtarinë folklorike të popullit tonë, kanë ndërtuar meloditë e tyre, të thjeshta, të freskëta dhe të fuqishme, ata janë përpjekur të organizojnë harmonishëm tonalitetin e veprës simbas karakteristikës së modit, duke kombinuar drejt lidhjen e harmonisë tonale me atë modale duke i dhënë prioritet sistemit tradicional mazhor-minor. Është përpunuar dhe zhvilluar ritmika në veprat muzikore ku ndjehet më fuqishëm ritmi dhe pulsi i jetës sonë. Në krijimtarinë muzikore, mjetet teknike përdoren me kritere të caktuara në dobi të përmbajtjes, e cila është kryesore dhe kurrsesi nuk duhen vënë mbi idenë e veprës. Sado që të jetë e rëndësishme teknika në art, ajo gjithmonë i nënshtrohet idesë, mendimit, detyrës artistike që qëndron në bazë

të krijimit sepse edhe ajo më virtuoza qoftë, nuk i jep jetën veprës. Roli i teknikës është të ndihmojë artistin të materializojë me bindje idenë e tij.

Partishmëria proletare nuk është një parim abstrakt por tendencë klasore, realizimi konkret në art i ideologjisë marksiste-leniniste, shprehje e vetë jetës që zhvillohet në mënyrë revolucionare, e ndërtimit të socializmit dhe luftës së klasave në frontin e brendshëm e të jashtëm për ruajtjen e fitoreve të arritura dhe për sigurimin e perspektivave të revolucionit e të ndërtimit të socializmit e komunizmit, për edukimin komunist të njerëzve tanë. Temat dhe figurat që lindin nga ngjarjet e jetës së përditshme, lidhen gjithmonë me tema të atilla të mëdha që janë dhe do të mbeten aktuale, Atdheu dhe revolucioni, Partia dhe lufta e popullit për çlirimin e vendit, heronjtë e punës në ndërtimin socialist, dhe më në fund tema e luftës kundër imperializmit e revizionizmit.

Çështja e partishmërisë dhe e temës aktuale nuk duhet kuptuar në mënyrë të sipërfaqshme duke kërkuar medemos subjektin apo faktin duke e kaluar atë direkt nga jeta në materialin artistik. Ne nuk duhet të kënaqemi me kaq. Muzika fuqizohet nga ideja, nga koncepti filozofik dhe asgjë nuk mund të plotësojë mungesën e tyre. Nga artisti i vërtetë kërkohet njohja e thellë e jetës, pjesëmarrja aktive në të, duke jetuar intensivisht me masat dhe duke njohur thellë rrugën e zhvillimit historik revolucionar të popullit e të kulturës së tij. «Artin revolucionar e bëjnë artistët revolucionarë, zemra e të cilëve rreh me zemrën e popullit», thotë shoku Enver.

Tema e madhe e kohës nuk pranon muzikë të shkruar pa përgjegjësi. Vepra do ta meritojë plotësisht të drejtën për ta trajtuar këtë temë dhe për t'u ngritur në nivelin e kohës, vetëm atëherë kur muzika di t'i përgjigjet denjësisht asaj dhe do të përshkohet nga fryma e thellë popullore. Partishmëria proletare dhe lufta e klasave në specifikën muzikore, duhen parë në gjetjen e temave të rëndësishme, pa pompozitet të shtirur, sa më njerëzore, siç është vetë Partia, siç janë komunistët, siç janë punëtorët e fshatarët tanë, në kërkimin e figurave artistike me plasticitet dhe me kulminacione të qarta që të tregojnë perspektivën, tema të thella ku të ndjehen lufta dhe përpjekjet e përditshme të popullit për socializëm. Pasqyrimi i konflikteve antagonistë e joantagonistë në planin origjinal të dramaturgjisë muzikore, ku temat të kontrastojnë ndërmjet sferave antagonistë, shtjellimi i idesë me kthjelltësi,

optimizëm, plot forcë emocionale, e bëjnë veprën muzikore të partishme dhe të afërt për masat punonjëse.

Gjinia e operës dhe baletit për mundësitë specifike, trajton në përmasa të gjëra e të thella idetë e mëdha të kohës. Megjithë vështirësitë e mëdha që paraqesin këto gjini në kërkimin e rrugëve që të shprehin denjësisht temën e ditës, të momenteve kyçe të historisë së popullit tonë, me aspekte sa më kryesore të ecjes sonë përpara, nëpërmjet kontradiktave e konflikteve tipike të kohës, — kompozitorët tanë, me një punë këmbëngulëse, kanë shkruar vepra operistike e balete si «Mrika», «Halili e Hajria», «Skënderbeu», «Zgjimi» etj. Në to gjen shprehje trajtimi epik i temës aktuale, pasqyrimi i luftës së klasave dhe tendencioziteti klasor, problem i cili është shtruar në shumë dokumente të Partisë.

Opera jonë e fundit «Zgjimi» trajton faqe të shquara të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, të ditëve të stuhishme të heroizmit popullor, kur nën udhëheqjen e Partisë, populli u ngrit më këmbë për të çliruar vendin dhe për të shembur rendin e vjetër. Në këtë operë zënë një vend të rëndësishëm skenat masive të popullit dhe të partizanëve. Gjatë momenteve kryesore të veprës populli me komunistët në ballë është i pranishëm, pjesëmarrës aktiv e vendimtar i kësaj lufte të zjarrtë.

Një traditë e mirë është krijuar në operat tona me vënien e këngës në qendër të dramaturgjisë së veprës, qysh me veprën e parë të kësaj gjinie, «Mrikën». Kjo e bën gjininë e operës më popullore e më komunikuese. Në operat tona gjithashtu është bërë traditë citimi i këngëve popullore në momente e situata të përshtatshme, duke krijuar kështu një kontrast të bukur me skenat ekspresive dhe dramatike. Edhe citimi i këngëve partizane ze një vend të rëndësishëm në veprat e fundit me temë nga lufta, p.sh. kënga «Partizani në luftë po shkonte» në tablonë e operës «Zgjimi», motivi i cili zhvillohet bukur edhe në vazhdim të veprimit dramaturgjik. Në këto vepra, forcat ndërluftuese vihen përballë njëra-tjetrës në dy linja, duke i dhënë mundësi kompozitorit të shtjellojë situata të guximshme dramaturgjike për të shprehur botën e brendshme shpirtërore të heronjve.

Heronjtë kryesorë në operat tona janë komunistët luftëtarë të paepur, frymëzuesit dhe organizuesit e palodhur që përçojnë vijën e Partisë.

Megjithatë, si rrjedhim i mungesës së traditës dhe përvojës nga formimi i pamjaftueshëm, nga kuadrot relativisht

të pakta (siç dihet tek ne janë shkruar pak opera dhe balette), veprat tona të gjinisë skenike vuajnë nga mungesa e organizimit të mirë të materialit muzikor në veprimtarinë dramaturgjike, nga mungesa e karakterit në gjetjen e figurës muzikore të forcave kundërshtare të dramës, nga moszhvillimi logjik i personazheve dhe mosarritjet e kulminacioneve të nevojshme. Ne vazhdojmë të shkruajmë simbas skemës tradicionale të operës, apo baletit, duke shënuar aty këtu ndonjë moment origjinal (veçanërisht në skenat masive). Mungon kërkimi aktiv i rrugëve të reja në paraqitjen e subjekteve aktuale nga jeta jonë. Duhet bashkuar me sukses tradita klasike me situatat tona dramaturgjike, duke vënë në qendër figura të skalitura sipas botës së personazheve tanë, me karakter psikologjik dhe natyrë shqiptare, nëpërmjet një gjuhe muzikore sa më origjinale. Me një fjalë, sipas mendimit tonë, duket akoma shumëpunë kërkimore për të arritur që veprat skenike të paraqesin të skalitur jetën e popullit, fjalën e mprehetë të tij, psikologjinë dhe humorin popullor. Për këtë është e nevojshme të bëjmë më shumë punë për njohjen e folklorit, zakoneve e festave popullore, jo vetëm këngët e vallet, por edhe krijimet gojore, poemat, baladat, legjendat si dhe kostumet, pra të gjithë kulturën e popullit tonë. E gjithë kjo u shërben kërkimeve të vazhdueshme të rrugëve origjinale për paraqitjen e temës aktuale në teatrin muzikor, në fushën e dramaturgjisë së operës dhe të baletit, për thjeshtimin maksimal të gjuhës dhe të formës (në kuptimin e mirë të fjalës), të krijimit të situatave dramatike me mjete sa më të thjeshta, por gjithmonë të fuqishme dhe emocionuese, jo të thjeshtësuara, por të denja për të mbajtur mbi vete peshën e figurës që përfaqësojnë. T'i afrojmë masat tona me teatrin e operas dhe baletit duke u dhënë vepra sa më të kuptueshme.

Për krijimin e veprave skenike me një fizionomi sa më kombëtare, do të japin ndihmën e tyre edhe punonjësit e tjerë të teatrit muzikor, dirigjentët, regjisorët, baletmaestrët, artistët, të cilët lozin një rol të rëndësishëm për formimin e teatrit muzikor kombëtar, për forcimin e parimeve ideoestetike dhe muzikore-dramaturgjike të operës dhe baletit tonë.

Në praktikën tonë shumëvjeçare të muzikës së kultivuar, kemi krijuar një traditë të mirë përsa i përket gjinisë vokalo-simfonike, e cila i ka të gjitha mundësitë për të paraqitur denjësisht temat e rëndësishme, si rolin hegjemon të klasës punëtore në shoqëri, forcën revolucionari-



zuese të komunistëve etj, pra në trajtimin e temave kardinale dhe të momenteve kyçe të historisë së popullit tonë, të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e të revolucionit socialist. Por, me ndonjë përjashtim, vitet e fundit në këto gjini kompozitorët tanë nuk janë drejtuar fare. Duhet gjetur shkaqet dhe duhet krijuar mundësitë e krijimit dhe ekzekutimit të kantatave, oratorëve, poemave, baladave e shumë gjinive të tjera të muzikës vokalo-simfonike. Është për t'u vënë në dukje se për këto gjini kemi një fond krijimtarie me vlera të mëdha ideoartistike, të cilin na e kanë vënë në dispozicion poetët tanë, poema të panumërta me tema e subjekte nga më të ndryshmet, nga më të rëndësishmet, poezi të bukura, të përshtatshme për muzikë. Mbetet vetëm t'i kërkojmë ato dhe t'i vëmë në shërbim të artit tonë muzikor.

Lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të gjinive vokalo-simfonike duhet luftuar një tendencë jo e drejtë që, duke u nisur nga dëshira për të kërkuar vepra muzikore sa më të kuptueshme për masat, heqim dorë nga veprat shumëkohëshe si «gjinia të gjata, të komplikuar, të vështira për t'u perceptuar». Mendoj se rreziku për paqartësinë e një vepre nuk qëndron në gjatësinë e saj, por duhet parë në se vepra është e konceptuar drejt dhe me një gjuhë të qartë e me forcë emocionale.

Ekzekutimi i parë i një vepre, jo vetëm duhet bërë i plotë, por duhet të kthehet në një festë për krijuesin dhe ekzekutuesit. Mendoj që për këtë problem të interesohet Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve për të organizuar në klubin e saj ekzekutimet e veprave për herë të parë, dhe në të njëjtën kohë, për të bërë diskutimin masiv të tyre.

Muzika jonë instrumentale ka bërë hapa përpara me gjithë vështirësitë që paraqiten në tipizimin dhe në zhvillimin e tyre dramaturgjik nëpërmjet temave ku figurat muzikore transmetojnë idetë e realitetit tonë. Kjo është shprehje e partishmërisë proletare dhe këtu kemi realizuar një fond të konsiderueshëm veprash duke krijuar edhe tiparet e saj dramaturgjike të përputhura me idetë tona, me realitetin tonë. Konceptimi epik i realitetit në muzikën tonë ka ardhur duke u forcuar e kristalizuar gjithnjë e më shumë, duke pasqyruar gjithnjë e më qartë e më me tendencë brendinë e jetës, idetë e shoqërisë sonë (sinfonia e Zadejës). Dramatika është zhvilluar me intensitetin e emocioneve të jetës, si një forcë që shpreh shpirtin e gjallë të popullit, e që u kundërvihet forcave të kundërta, si shprehje e një atmosfere të vrullshme, aktive e dinamike të jetës,

(poema simfonike e Gaqit) etj. Një tipar tjetër i dramatikës që përftohet nga karakteristika e vrullit, energjisë është ai i ndeshjes dhe i fitores mbi vështirësitë, që të shpjen drejt finalit optimist, (poema simfonike e Harapit, koncerti Nr. 2 për piano i Ibrahimit etj.). Në mënyrë të drejtëpërdrejtë e të mirfilltë heroikën e dëgjojmë të fuqishme në poemën simfonike «Alarme të përgjakura» të Shpëtim Kushtës, ku shprehet heroizmi popullor gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Tiparet lirike, zakonisht shprehën në kohët e dyta të cikleve veçanërisht lirika e lidhur me epikën dhe lirika epiko-elegjiake (sinfonia e Limos Dizdarit, koha e dytë); lirikën ëndërruese e ekzaltuese, të lidhura me romantikën tonë revolucionare i gjejmë të koncertet për piano të Harapit e Zadesë, kurse lirika optimiste festive, të vallet simfonike të Simon Gjonit etj. Të gjitha këto flasin për gjerësinë, larminë tematike dhe forcën ideo-emocionale të muzikës sonë.

Një rëndësi të madhe në zhvillimin e mëtejshëm të muzikës sonë instrumentale ka lëvrimi më i madh i muzikës instrumentale me program që lot rol në edukimin e masave. Për ta çuar këtë gjini të muzikës tek dëgjuesi më i thjeshtë, kompozitorët tanë duhet të nisen nga një përmbajtje e caktuar. Është tashmë e njohur dashuria e popullit tonë për veprat muzikore që paraqesin figura nga historia, heronj të njohur nga literatura. Ngjarjet epike të historisë së popullit tonë duhet medoemos të gjejnë shprehje në veprat muzikore. Skemat e zakonshme pengojnë zhvillimin dramaturgjik të veprës instrumentale me program, prandaj duhet të përpiqemi të gjejmë atë formë origjinale që mund të shprehë një program të caktuar. Dramaturgjia e veprave simfonike me program kërkon forma të reja, kërkime të guximshme në përshtatje të idesë, duke vënë në shërbim të saj të gjithë mjetet shprehëse, duke zgjeruar gamën e tematikës ku të spikasë forca e idealeve të Partisë roli hegjemon i klasës punëtore, tema e fshatit, lidhja e qytetit me fshatin, jeta dhe puna e rinisë, e fëmijëve etj.

Shumë pak jemi preokupuar për gjininë e romancës vokale. Edhe në ato raste kur kompozitorët tanë janë drejtuar nga kjo gjini, në përgjithësi kanë dhënë vepra të një tingllimi jo plotësisht bindës për natyrën e intonacioneve dhe ritmeve të fuqishme që kërkohen për të shprehur me vërtetësi ngjarje nga jeta e ditëve tona. Dëgjuesit tanë duan të gjejnë në tingëllimin e kësaj gjinie figura të jetës sonë, heronjtë e ditës, prandaj, karshi kësaj kërkese të

masave, ne nuk duhet të qëndrojmë indiferentë. Në të vërtetë gjinia e romancës për kompozitorët ka qenë gjithnjë një punë laboratorike e muzikës vokale, për të kërkuar intonacione të reja, tipike dhe për të kaluar pastaj në gjininë e operës. Edhe në këtë gjini është e nevojshme t'i drejtohemi krijimtarisë sonë të pasur poetike nga mund të gjënden poezi të përshtatshme për të krijuar romanca, cikle vokale, poema balada e gjini të tjera me tematikë shumë të larmishme nga Lufta Nacionalçlirimtare si dhe nga lufta dhe jeta e njerëzve tanë në ndërtimin socialist.

Gjinia e këngës na ka preokupuar dhe duhet të na preokupojë gjithnjë e më tepër. Fakti është se kemi shumë arritje në këtë gjini. Krahas kompozitorëve të afirmuar, kanë dalë dhe dalin vazhdimisht krijues të rinj, të cilët debutojnë me sukses të madh. Kompozitorët tanë, në veprimtarinë e tyre krijuese janë udhëhequr gjithmonë nga mësimet e Partisë e të shokut Enver, nga metoda e realizmit socialist, nga tendencioziteti klasor, nga partishmëria proletare dhe prirja për harmonizimin e frymës popullore e kombëtare me traditën e shëndoshë realiste. Duke e parë zhvillimin e artit tonë në luftë me ndikimet e huaja ideologjike të vjetra e të reja, konservatore e moderniste, sidomos me ato borgjezo-revizioniste, rëndësi të madhe në këtë luftë kanë patur për krijimtarinë tonë orientimet e Plenumit të 15-të të vitit 1965 të KQ dhe vendimet historike të Plenumit të 4-të të KQ ku Partia gjithashtu vuri theksin me forcë te nevoja e një lufte frontale kundër ndikimeve të rrezikshme të ideologjisë së sotme borgjeze e revizioniste, e cila ushtron pandërprerje presionin e saj mbi ne. Materialet e Kongresit të 7-të të Partisë, të cilat po i zbërthejmë në këtë plenum dhe që janë busull orientimi për veprimtarinë tonë, vënë përsëri theksin në rrezikun e ideologjisë së sotme borgjeze e revizioniste dhe në rëndësinë që merr në kohën tonë mbrojtja e kulturës kombëtare. Duke përsosur përherë e më tepër tiparin e saj themelor, partishmërinë proletare, kënga jonë ka milituar në çështjen e Partisë, u ka bërë jehonë e ka pasqyruar ngjarjet e fenomenet e jetës e të shoqërisë sonë.

Forcimi i partishmërisë në këngët tona, lidhet ngushtë me forcimin e frymës popullore, për t'i bërë ato sa më të përshtatshme për masat, sa më të thjeshta, të kapshme e të depërtueshme, duke thelluar në të njëjtën kohë fizionominë kombëtare.

Në të gjitha këto drejtime duhet të marrim shembull

nga krijimtaria e popullit. Këngët popullore janë të thjeshta, shumë koncize, shumë të fuqishme dhe emocionuese. Në këngën tonë, përveç temave që kemi trajtuar deri tani, duhet të mësojmë nga populli lidhur me trajtimin e temave të mprehta të luftës klasore, nga mënyra e konceptimit. Duket sikur kënga nuk i mban dot këto tema me peshë dhe me konfliktet e tyre klasore antagoniste dhe jo-antagoniste, por kur dëgjojmë këngën popullore që denoncon traktatin e Varshavës etj. (këngë të kësaj natyre populli krijon vazhdimisht), bindemi për mundësitë që ka kjo gjini.

Edhe folklori ynë tradicional ka kapur tema të mprehta me konflikte të fuqishme klasore. Në periudhën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare populli dhe partizanët krijuan këngë të tilla që demaskonin armikun e brendshëm apo të jashtëm.

Sigurisht në këto raste kanë shumë rëndësi mjetet artistike me të cilat do të arrihet kjo këngë që, për mendimin tonë, do të jenë të ndryshme nga mjetet melo-ritmike me të cilat do të thurim një këngë hymnizuese. Edhe mënyrën e trajtimit të temave me fabul humoristike, me motive ku goditet armiku, ose flitet për të meta në gjirin e shoqërisë sonë, ta mësojmë në këngët që ka krijuar edhe vazhdon të krijojë populli. Në këto tipe këngësh ne nuk kemi bërë pothuajse asnjë përpjekje, ndaj ndjehet një mungesë e madhe në fushën e këngës së kultivuar. Sukseset më të mëdha të këngës sonë janë arritur në gjininë e këngës me përmbajtje heroiko-patriotike. Ky është një fakt pozitiv që tregon për karakterin e partishëm të këngëve tona më të arritura, gjë që nuk pengon zhvillimin e gjinive të tjera të këngës, siç përmenda edhe më lart, duke patur gjithmonë në qendër të vëmendjes dhe duke mos harruar për asnjë çast ato ndikime, të meta e gabime që patën zënë vend në këngën tonë të muzikës së lehtë, e që u kritikuan nga Plenumi IV që, po të lireshin në heshtje, do të bëheshin qendra të rrezikshme infeksioni. Ndonjë nuancë e tillë ngre krye ndonjëherë në krijimtari apo në interpretim, prandaj ne duhet të jemi vigjilentë dhe të gatshëm për t'u prerë rrugën që në embrion.

Kompozitorët tanë pothuaj pa përjashtim që merren me vepra të gjinive të mëdha muzikore, shkruajnë në të njëjtën kohë edhe këngë. Do të ishte gabim ndarja në krijues të këngës dhe në krijues veprash simfonike. Çdo kompozitor duhet të jetë i aftë të kompozojë edhe këngë edhe simfoni apo opera, mbasi ato ndihmojnë njëra-tjetrën.

Duke pasur për bazë zhvillimin e madh që ka marrë tek ne veprimtaria muzikore profesioniste dhe sidomos ajo amatore, siç thotë Partia «është ngjitur në skenë masa, njeriu i punës, punëtori e kooperativisti, gratë e të rinjtë, pleqtë e fëmijët», është e nevojshme t'i kushtohet këtij zhvillimi një vëmendje më e madhe e të bëhen studime e diskutime rreth problemeve të krijimtarisë.

Perspektivat madhështore që na hap Kongresi i 7-të i Partisë në zhvillimin e gjithë jetës sonë, edhe për krijimtarinë muzikore janë objekt frymëzimi të përhershëm. Vendimet historike të Kongresit të 7-të do të vazhdojmë t'i zbërthejmë me imtësi për të kuptuar drejt e thellësisht dhe për të reflektuar në veprat tona të ardhme, të cilat t'i diskutojmë me njëri tjetrin me një frymë kolegjiale dhe të shëndoshë në dobi të krijimtarisë. Këtë duhet ta bëjmë edhe nëpërmjet lidhjeve individuale me njëri tjetrin, por kjo gjë duhet organizuar nëpërmjet Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve për ta bërë këtë siç mëson Partia, «një qendër ku të inkurajohet krijimtaria dhe të rrihen gjerësisht problemet filozofike, etike e estetike të saj nga pozita e partishmërisë proletare».

## MBI FORCIMIN E FRYMËS E TË FIZIONOMISË KOMBËTARE POPULLORE TË MUZIKËS E KOREOGRAFISË SONE

**K**arakterit kombëtar dhe fryma popullore realizohen duke pasqyruar me vërtetësi realitetin, nga pozita e ideologjisë marksiste-leniniste, duke asimiluar në mënyrë kritike dhe nga pozita klasore gjithë përvojën e kulturës sonë, traditën e vjetër përparimtare dhe të renë revolucionare, duke u mbështetur fort në krijimtarinë e popullit», — tha shoku Enver në raportin e Kongresit të 7-të të Partisë.

Duke e parë karakterin kombëtar në dialektikën e zhvillimit, muzika dhe koreografia jonë e kanë pasqyruar me të gjitha tiparet e reja të fuqishme të tij, mbështetur fort në traditën tonë më të mirë e përparimtare. Kështu, çështja e forcimit të fizionomisë kombëtare popullore të muzikës e koreografisë sonë, nuk është trajtuar si çështje «zbukurimi nacional», por si domosdoshmëri jetike e lidhur ngushtë me pasqyrimin, transmetimin sa më realist të përmbajtjes jetësore dhe botës shpirtërore të kombit, të bashkëkohësve tanë.

Çështja e karakterit kombëtar dhe frymës popullore

në muzikën e koreografinë tonë, ndërthuret me shumë faktorë të rëndësishëm, që lidhen drejtpërdrejt me përmbajtjen e formën, me kuptimin e drejtë të raportit mes traditës dhe novatores, në mbështetjen në trashëgiminë folklorike të popullit dhe në traditën e realizmit socialist si dhe me luftën kundër çoroditjeve e ndikimeve të huaja e teorizimeve të dëmshme. Muzikës e koreografisë sonë të realizmit socialist, në radhë të parë, ajo që i jep frymën kombëtare popullore është përmbajtja socialiste dhe, lidhur dialektikisht me të, edhe forma, gjuha muzikore koreografike, mjetet shprehëse.

Karakterin kombëtar e dallojmë në krijimet artistike që mishërojnë emocionet reale të buruara nga vërtetësia e një përmbajtjeje të fuqishme revolucionare, në veprat që fiksuan momente vendimtare të jetës sonë, sintetizuan patriotizmin socialist, vendosmërinë, bashkësinë e mendimit e veprimit të popullit të udhëhequr nga Partia, duke u bërë lajtmotive të ditëve tona, p.sh. «Në një dorë kazmën, në tjetrën pushkën» të P. Jakovës, e cila të krijon përfytyrimin e një mase monolite, të pasur me virtyte të reja e ndërgjegje të lartë që marshon me besim të patundur në të ardhmen. Gjithashtu në këngën «Revolucioni marshon» të T. Hoshafit pasqyrohet gruaja jonë si luftëtare e së resë që hyn me vendosmëri në radhët e ngjeshura të revolucionarëve, mëshiruar në muzikë me atë energjikën e tingëllimit gati si të thirrjes së fanfarave. Tingëllim të fortë kombëtar gjejmë në këngën «Për ty At dhe» të P. Gacit, «Marshime partizane» të A. Mulës e krijime të tjera të Konos, Trakos, Grimcit, Prodanit, Daisë, Laros etj.

Karakterin kombëtar nuk spikat vetëm në veprat që trajtojnë të shkuarën historike, që lidhet me luftrat e popullit për liri e pavarësi, me doket e zakonet e tij, por dhe në pasqyrimin e temës së Luftës Nacionalçlirimtare si dhe të luftës që bën Partia e populli ynë për të ndërtuar socializmin, në luftë kundër imperializmit e revizionizmit, në dhënien me besnikëri të atyre tipareve dhe elementeve të reja, që, të lidhura fort me traditën më të mirë, kanë hyrë në jetën e popullit duke u bërë karakteristika kombëtare. Këto i kanë dhënë krijimtarisë sonë përmbajtjen kryesore që ruan veçoritë origjinale nga ajo e mëparshme dhe e dallojnë nga kombet e tjerë. Fizionominë kombëtare popullore e ka opera me temë historike «Skënderbeu» (Jakova – Siliqi), ashtu si edhe opera «Mrika» (krijimtari e të njëjtëve autorë) me temë nga epoka socialiste, opera «Zgjimi» (Harapi-Marko) me temën e Luftës Nacionalçlirimtare,

ashtu si baleti «Cuca e maleve» (Zoraqi-Aliaj) me temë të luftës klasore nga periudha e pasçlirimit të vendit. Në muzikë dhe koreografi trajtimi i kohës sonë dhe i historisë është realizuar nga pozitat marksiste-leniniste, nga idealet e socializmit. Në këto vepra tek heronjtë janë përgjithësuar vetitë më të mira e më tipike të popullit tonë, është shprehur me forcë ideoemocionale psikologjia shqiptare (kujtojmë p.sh. arien e Mrikës nga akti i III. të, në operën «Mrika» duetin e Cucës me Fizin dhe të Cucës me priftin nga baleti «Cuca e maleve» monologun e Hajrijes nga «Halili e Hajria») etj.

Bota e madhe e ndjenjave dhe emocioneve shqiptare të së kaluarës heroike e të sotmes së lavdishme, është trajtuar nga një kënd vështrimi dialektik duke i bartur e ripërtërirë me një theksim aktual aktiv: figurat, tablotë, nuancat më tipike kombëtare si ato të trimërisë, besës, dashurisë për punën, tokën, lirinë, optimizmin, besimit në forcat e veta, temperamentit etj. («Vallja e shqipeve», «Komitet», «Festë të madhe ka sot Shqipëria», «Barinjtë e Korabit», «Vallja e gështenjave» etj.) në veprat e koreografëve P. Kanaçi, A. Aliaj, G. Kaceli, E. Tërshana, F. Shaqiri.

Përgjithësimi emocional e dramaturgjik i jetës e historisë sonë, duke u bërë pasqyruer i drejtpërdrejtë i realitetit fitoi cilësi të reja përmes frymës kombëtare e popullore, si thellim në psikologjinë e popullit dhe shprehjen progresive të ideve të socializmit. Kështu koncepti kombëtar popullor përfshin në sferën e vet një interpretim të ri ku elementët intonativë popullorë marrin proporcione të gjëra, duke pasqyruar botëkuptimin e masave të epokës socialiste, p.sh. Simfonia Nr. 1 e Zadesë apo vepra të tjera të kompozitorëve Daija, Zoraqi, Lara, Dizdari, Ibrahim, Gaqi, Kushta, Laro, Peçi etj. si dhe koreografëve Kanaçi, Aliaj, Kaceli, Shaqiri, Tërshana etj.

Në luftrat e gjata për çlirim, shqiptari bëri shumë sakrifica. Notat tragjike e elegjiake lanë gjurmët e tyre në folklorin e popullit tonë të vogël që në emër të lirisë hidhej në zjarrin e luftës. Por domosdoshmëria e qëndrës, besimi dhe optimizmi karakteristik i popullit për ditë më të mira, kushtëzuan gërshetimin e ngushtë të tingëllimit elegjiak me atë heroik. Në mënyrë konçize e burrërore ky fenomen është shprehur në sentencën popullore «trimi-trimin nuk e qan». Ky trashëgim që gjeti pasqyrim edhe në folklor, u asimilua në mënyrë krijuese dhe u ngrit në një shkallë të re nga kënga jonë («Komisari i kuq» i Daisë – «Mësuesit hero» i Dizdarit, «Ilia Kici Dashi» i Laros),

tek veprat operistike («Mrika») e simfonike («Alarme të përgjakura» të Kushtës; «Borova» të Gaqit, «Baballarët» të Laros), ku krahas shprehjes së dhimbjes dhe respektit të lartë për heronjtë, theksi kryesor nuk vihet mbi humbjen, por në besimin se ideali, në emër të të cilit u bë sakrifica, do të fitojë, sepse «një bie, mijra ngrihen». Duke u mbështetur thellësisht e gjerësisht në epikën e popullit, lirika jonë dallohet për karakteristika dhe origjinalitet të theksuar kombëtar («Kujtimet e ndjenjat e rapsodit», — koha II e simfonisë së Zadejës, «Koncerti për piano e orkestër» i T. Harapit). Këtë e ndjejmë në «Koncertin për violinë e orkestër» të Zoraqit kushtuar heronjve të Luftës Nacionalçlirimtare, në karakterin lirik e epiko-elegjiak që me një përgjithësim tingëllimi, duke u mbështetur në këngën popullore për Qemal Stafën ngrihet lart akti sublim i heroit (Koha II); e ndjejmë në atë notë elegjiake ku shkrihet tragjizmi me heroikën që depërton thellë në psikologjinë e mendimin popullor (materiali muzikor është marrë nga folklori i jugut) në simfoninë e Dizdarit (Koha II).

Lirizmi ynë në muzikë, i lidhur me idealin e jetës e me të bukurën, buruar nga romantika revolucionare me perspektivën optimiste, përshkohet nga atmosfera e gjallë, plot humor e temperament popullor, tipare këto që të gërshetuara mes tyre japin atë larmi të madhe nuancash tipike të dinamikës së pasur e të gjerë të vrullit të jetës sonë, të ndjenjave të pastra e temperamentit të njerëzve tanë. Këto duke u mishëruar në veprat tona me trajta e nuanca të ndryshme, herë si meditim ëndërrues që me një transformim të figurave lirike arrin në kulmet të fitojë një ndjenjë të fortë burrërie, ose duke shfrytëzuar gjërësisht motivet e ritmet burimore të folklorit dallohen për frymën popullore («Koncertet për piano e orkestër» të Zadejës dhe Larës, — «Uvertura festive» e Zoraqit, «Rapsoditë» e Ibrahimit, Harapit e Laros, «Vallet shqiptare» të Gacit; «Suitat me tema popullore për orkestër frymore» të Grimcit, Çangut, Dungut, si dhe të mjaft finaleve të veprave simfonike).

Meqenëse në epokat e mëparshme elementët më të shëndoshë kombëtarë kanë gjetur vend në radhë të parë në kulturën dhe në artin popullor, çështja e folklorit pati rëndësi vendimtare në kushtet e fillimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të krijimtarisë sonë muzikore e koreografike. E theksojmë këtë sepse kryesore është edhe mbi çfarë baze mbështetet krijimtaria kulte, që të jetë mishërim i karakterit kombëtar.

Kompozitorët dhe koreografët tanë, të brumosur me atë sintezë të madhe të kombëtares, me historinë e kombit, me natyrën e vendit, jetën e njerëzve në të, me raportet e tyre në shoqërinë tonë, me faktorët gjeopolitikë, me gjuhën amtare dhe veçoritë e melodikës së saj, me folklorin muzikor e koreografik të popullit etj. si pjestarë aktivë të jetës së këtij kombi, kanë dhënë atë krijimtari që e shquan nga popujt e tjerë, ku dallohet origjinaliteti kombëtar. Mbi këto baza është formuar dhe individualiteti i secilit prej tyre, që duke ruajtur anën e përbashkët kombëtare, kanë dhe stilin e tiparet individuale.

Në këtë krijimtari mishërohet prirja e melosit dhe leksikut tonë koreografik në mënyrën më dialektike. Për këtë ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë tradita e artit popullor, praktika jetësore, si dhe përvoja e zhvillimit muzikor e koreografik, që po lulëzon në vendin tonë. Përforcimi i tipareve kombëtare është lidhur jo vetëm me kristalizimin e tyre si gjini, në mjaft raste të pa kultivuara më parë, por me vetë formimin e një tradite të re, si rrjedhë organike e lidhur me trashëgiminë tonë më të mirë dhe me arritjet më me vlerë të krijimtarisë së epokës socialiste.

Trajtimi i gjërë i këngës e melodisë folklorike, këngës patriotike e partizane, apo valles popullore, në krijimtarinë e kultivuar, nuk është marrë nga krijuesit tanë si veshje e jashtme e formës, si elementë të veçuar të saj, po si tërësi e karakterit kombëtar që përmbledh përmbajtjen dhe kompleksitetin e formës, kushtëzuar nga ligjet objektive, historike të shoqërisë, që i ve vulën e fizionomisë së kombit, të vendit dhe të kohës. Në këtë mënyrë muzika e koreografia jonë në arritjet më të mira ruajnë tiparet e një tingëllimi realist dhe kombëtar. E theksojmë këtë çështje sepse ka raste kur autorë të huaj kanë marrë melodi të folklorit tonë e i kanë përdorur në veprat e tyre. Po kurrë këto krijime nuk kanë tingëlluar shqiptare, sepse nuk kanë mishëruar karakterin e kombit, tiparet, vetitë dalluese e botën shpirtërore të popullit tonë, por karakterin e atij kombi ku janë krijuar.

Vërshimi në krijimtarinë muzikore e koreografike (me një trajtim krijues që thellohet e përsoset gjithnjë më shumë), i këngëve, melodive e valleve popullore, i atyre patriotike, partizane e qytetare, prirjet drejt ngjyrimit instrumental popullor, drejt ritmeve popullore etj. ndikuan fuqishëm në skalitjen e mëtejshme të fizionomisë kombëtare popullore, p.sh. këngët popullore e partizane në operën

«Zgjimi» e «Komisari», këngët patriotike në operan «Lulja e kujtimit», kënga e gjyshit Ndue me çifteli dhe kënga masive e hidrocentralit në operan «Mrika», vallet masive popullore në baletin «Halili dhe Hajrija» e në baletin «Cuca e maleve», temat popullore tek «Simfonia Nr. 1» e Zajdejës e në «Koncertin për piano» të Harapit, — Uvertura me tema partizane e Zoraqit etj. Prandaj duke dëgjuar të karakterizuar muzikalisht heronjtë, masën, popullin, personazhet, figurat, ambientet etj, ndjejmë vërtetësinë e botës shqiptare të ditëve tona, i ndjejmë ata luftëtarë të idealeve të kohës e të së ardhmes, bashkëveprues me ne, që shprehin aspiratat e popullit, luftën, përpjekjet dhe heroizmin e tij.

Përpjekja e kompozitorëve tanë që në veprat e formave të mëdha, të kristalizojnë materialin tematik-muzikor afër këngës, qoftë në formën e citimit ose të krijimit mbi këto parime (larg temave muzikore; «instrumentale», disa herë subjektive e me paqartësi emocionale), nuk ka ardhur si refleksi i jashtëm historik, por si nevojë e domosdoshmëri me bazë ideore e psikologjike kombëtare. Në mënyrë të veçantë në këngë, janë mishëruar e kanë spikatur vetitë e alluese të popullit tonë gjatë historisë së tij si dhe të aktualitetit të sotëm si në brendi ashtu dhe në formë dhe në stadin e zhvillimit të muzikës sonë, është pikërisht kjo që përgjithëson lajtmotivin vital e novator të krijimtarisë sonë kombëtare, si një veçori dalluese e saj. Forma e këngës u muar nga tradita e popullit tonë dhe u përdor me tendenciozitet në krijimtarinë e kultivuar për të materializuar mendime, ide, ndjenja e ngjarje tek të cilat zotëron karakteri e psikologjia kombëtare, sepse kjo vetë është shprehje e kësaj psikologjie dhe këtij karakteri.

«Karakterit kombëtar popullor shprehet jo vetëm në krijimtari, por dhe në ekzekutimin e interpretimin e saj», thotë shoku Enver. Tek bartësit më të shquar të krijimtarisë popullore dallojmë qartë veçoritë kombëtare në interpretimin e ekzekutimin e saj, ashtu siç i kemi të kristalizuara tek artistët tanë të njohur: T. T. Koço, M. Kraja, K. Antoniu, dhe këto tipare kombëtare i gjejmë të fuqizuara në një plan të ri në epokën socialiste tek M. Xhemali, G. Çako, A. Mula, R. Kovaçi, V. Zela e shumë të tjerë, njëlloj si tek këngëtarët e rapsodët popullorë: B. Ndoja, F. Rexha, Xh. Avdalli, N. Shyti, L. Bariu, te grupet folklorike të Pilurit, ansambllit «Çiftelia» të Lezhës, valltarëve të Devollit, instrumentistëve tanë më të mirë etj. Ndodh kështu sepse këta artistë si pjesëtarë aktivë të këtij kombi, emocionet që

shprehin i kanë të përfituara nga tabani ynë, bota e tyre shpirtërore është njësh me bashkëkohësit e vet, ndjeshmëria e tyre, reagimi emocional ruan ato tipare e veçori karakteristike të kombit tonë, të psikologjisë, të veçorive të perceptimit emocional të jetës sonë.

«Kultura jonë socialiste asnjëherë nuk është mbyllur në guaskën nacionale. Ajo ka përfituar nga arritjet më të mira të kulturës përparimtare botërore dhe nga ana tjetër, duke qënë bartëse e idealeve të popullit tonë për liri, pavarsësi e socializëm, ka qënë dhe është e afërt edhe për popujt e tjerë» — thotë shoku Enver në Kongresin e 7-të të PPSH. Populli ynë ka dhënë e ka marrë reciprokisht në procesin e gjatë historik të zhvillimit. Ka marrë në atë masë dhe atë që e ka ndjerë të domosdoshme, që i ka shërbyer atij duke e trajtuar e përpunuar nëpërmjet shijes estetike popullore, sa i ka vënë vulën e fizionomisë së vet kombëtare. Në fillimet tona dhe në zhvillimin e mëtejshëm të muzikës e koreografisë sonë të realizimit socialist, ne përfituam nga përvoja realiste, përparimtare e huaj në shërbim të kombëtares, por gjatë gjithë këtij procesi, edhe aq më tepër në stadin e tanishëm, gjithnjë shikojmë qartë prirjen e një qëndrimi e trajtimi krijues kundrejt kësaj përvoje, ndjejmë tendencën e krijuesve tanë drejt ruajtjes e përforcimit të tipareve tona kombëtare, origjinalitetit kombëtar.

Në kuadrin e karakterit kombëtar të krijimtarisë sonë është trajtuar dhe çështja e formave muzikore e koreografike. Ne nuk mohojmë domethënien internacionaliste të formave të mëdha strukturore-kompozicionale, sepse ato shprehin mundësitë objektive të vetë muzikës si lloj i artit, por këto iu nënshtruan veçorive kombëtare në përmbajtje e në mishërimin artistik dhe është meritë e krijuesve tanë që kanë mundur ti trajtojnë në mënyrë origjinale, në përshtatje me idetë e aktualitetit tonë, me traditën e kulturës e psikologjisë kombëtare. Në veprat tona skenike-muzikore p.sh., sferës së blloqeve masive, në përgjithësi rituale e ceremoniale (që janë karakteristika në veprat e traditës së zhanrit), iu kundërvunë ato të betejave («Halili e Hajrija», «Komisari» — «Zgjimi»), skenat e punës masive ndërtimtare (opera «Mrika», «Përtej mjegullës»), festat e gëzimit popullor (Reforma agrare në baletin «Cuca e maleve»), skenat masive të luftëtarëve të lirisë (opera «Skënderbeu», «Lulja e Kujtimit»). Gjithashtu u eliminuan melodramatizmit i operave e baletëve si dhe mjaft konvencionalizma të njohura të kësaj gjimie.

Trajtimi në veprat tona skenike-muzikore i skenave

masive është një tipar dallues dhe traditë përgjithësuere e cila, ndryshe nga ajo e përvojës botërore, bën që masa të mos mbetet si sfond dekorativ, po të marrë pjesë aktive, të frymëzojë heronjtë pozitiv në luftën për triumfin e idealeve të Partisë e të popullit, Hovi i masave është ajo forcë aktive, e cila përcakton idealet e Mrikës e u jep zgjidhje edhe linjave lirike të saj (opera «Mrika»). Frymën e thellë të kohës, të aspiratave të masave, frymën e revolucionit popullor e ndjemë tek baleti «Cuca e maleve»; ndër-  
sa te operat «Skënderbeu» e «Komisari» etj. populli masa paraqitet aq e rëndësishme sa pothuaj dhe vetë heroi kryesor. Këto veçori i gjejmë të përgjithësuara dhe në muzikën vokale të formave të mëdha si poema vokale, kantata dhe oratorio, në veprat simfonike-instrumentale. Në vetë thurjen dramaturgjike të këtyre veprave, forca e heroizmi popullor triumfon kurdoherë mbas një konflikti të ashpër, si rrjedhim i luftës së tij shumëvjeçare për liri e të drejta sociale, përmes shprehjeve emocionale kombëtare duke nënvizuar ato ndjenja që janë më të qënësishme të cilat janë trashëguar dhe zhvillohen në kushte e rrethana të caktuara historike. Edhe vetë trajtimi i formës, e ciklit oratoral, i ka dhënë kantatës apo oratorit tonë tipare që i dallojnë nga veprat e tjera të literaturës botërore. Në to mbizotëron gjerësia e madhe e aspekteve që përfshijnë si dhe karakteri përgjithësues historik i tyre (oratori «Partia» i K. Trakos), dhe këtë karakteristikë epopeje e kanë në përgjithësi shumica e veprave të kësaj gjinie.

Por si rrjedhim i presionit ideologjik borgjezo-revizionist dhe veprimtarisë armiqësore të F. Paçramit e T. Lubonjës, para Plenumit të IV të KQ, pati shmangie nga partishmëria proletare e tendencioziteti klasor si dhe deformime të fizionomisë kombëtare e frymës popullore edhe në krijimtarinë tonë muzikore.

Edhe në lëmin e koreografisë, krahas sukseseve të mëdha të saj, të meta e dobësi kemi patur edhe më përpara duke filluar që nga ndonjë balet i yni, apo ndikime të huaja në numura koncertal të veçantë, e në ndonjë valle, për të cilat janë bërë vërejtje dhe kritika. Por më shumë të meta e dobësi u dukën në Koncertet e Majit të vitit 1976. Kjo ka ardhur në radhë të parë sepse jo gjithnjë përmbajtja është trajtuar në unitet me formën (p.sh. «Vallja e Këmishtajt»). Gjithashtu nga mosnjohja e thellë e folklorit, koreografët i thjeshtëzojnë motivet popullore, ose bëjnë një shfrytëzim jo racional të plastikës koreografike të trevës së caktuar, ka dhe raste kur nga përzierja pa kriter e ma-

terialit burimor popullor kalohet në pështjellim zonash, mjetesh, në çnatyrim kostumesh, apo në lidhje eklektike siç u vrejten në valen me motive labe. Me trajtimin e valleve masive u kaluan në ekstrem sepse u lanë pas dorë vallet dyshë aq të shumta e shprehëse në krijimtarinë popullore.

Karakterin kombëtar në koreografi e cënuan ato ndikime të një farë ornamentike orientale (lëvizje të tepruara të kokës, duarve, të trupit), hedhje e përdredhje jashtë natyrës së valles sonë etj.) e deri në një konceptim të huaj, goftë të tërthortë të vetë valles sonë, apo lëvizjeve të huajtura që u panë në përpunimin e valles së Peshkopisë. Nga plastika e guas që më përpara pothuaj njësohej me të burrit, u kalua drejt një zbutjeje e poetizimi të tepruar, gjithashtu të dëmshëm (p.sh. vallja «Përsëndetje nga zemra e Partisë» apo ajo e Këmishtajt) ku vajzat nuk përfaqësojnë më tipin social, por kthehen në qenie përrallore. Pozat e çoroditura të krekosjes e kapadaillëkut, janë karakteristika të shtresave të larta, dhe s'kanë të bëjnë me tiparet e burrisë e krenarisë së popullit tonë. Praktika e zbatuar e përgatitjes së valles jashtë emocioneve të muzikës (vallja labe u përgatit vetëm nën tingullin e daulles), ka sjellë si rrjedhim kontradiktën mes tyre, çoroditjen edhe të vetë interpretimit. Kërkimi i dinamikës së jetës në absolutizimin e elementit ritmik, ka shkaktuar disa dukuri negative: prirjen për spekulim artificial, injorimin e pasurisë të valles së jugut e krahinave të tjera dhe mënjanimin e valles sonë lirike, humoristike, satirike etj. Në vallet me temë të punës e mbrojtjes, nga mosmbështetja në materialin popullor, është kaluar në imitime lëvizjesh natyrale, duke i hequr koreografisë veçorinë si art përgjithësues e jo thjesht imitues. Edhe fëmijët më tepër imitojnë vallet e të rriturve, gjë që nuk përputhet shumëherë me moshën dhe psikologjinë e tyre. Nga mungesa e konceptimit të qartë artistik të fabulës, e aspektit konkret që ofrohet për specifikën e trajtimit në koreografi, tema bashkëkohore është përgjithësuar në atmosferë festive, gëzimi e hareja, duke sjellë shumë herë njëllojshmërinë e valleve.

Kostumet kombëtare, këto vlera të mëdha historike-artistike të lidhura organikisht me komponentët e tjerë të artit popullor, u cënuan rëndë, duke u përlijtur me teorizime të gabuara, si «nevoja të skenës», «përgjithësim», «evolim» etj. Si rrjedhim u vu dorë në to, në forma, në prekje, në ornamente vend e pa vend, u përziën e u pështjelluan jashtë burimit e strukturës të kostumit krahinor apo

ndërkrahinor, gjer në zëvendësimin e kostumit të një valleje të një krahine me atë të një krahine tjetër. Trajtimi i shkëputur i formës nga përmbajtja e tyre, ka çuar në shndërrim të ngjyrave, ngarkesë me shkëlqime e zbukurime të huaja për ta. Duke mos mbajtur qëndrim të qartë klasor nuk u bë dallimi edhe me kostumet, por u evidentuan ato të shtresave të larta, jashtë qëllimit kryesor që ka arti ynë, në edukimin e drejtë të shijeve estetike të masave nëpërmjet asaj që paraqesim në skenë.

Për të zbatuar vendimet e Kongresit të 7-të të Partisë para koreografisë, muzikës dhe ekzekutimit e interpretimit dalin detyra të mëdha për thellimin e fizionomisë kombëtare popullore.

Edhe kënga jonë, është e nevojshme të forcojë më shumë tingëllimin shqipëtar, sepse akoma kemi raste të një intonacioni të përgjithshëm. Nga ana tjetër ajo nuk po depërton siç duhet në masat, sepse e stërhollojmë, kufizojmë kuptimin e saj ashtu dhe mundësinë e të kënduarit. Një lloj «zbutje e papërcaktim intonativ», që vërehen në disa raste sidomos në këngët për heronjtë, dëshmorët, apo të tipit himnizues etj., qoftë edhe në ekzekutimin e orkestrave të muzikës së lehtë ritmike (p.sh. Estrada e Ushtarit), çnatyrojnë karakteristikat dhe tiparet kryesore të këngëve të këtij lloji. Më shumë mund të trajtohet tema internacionaliste, apo kënga e vogël familjare, e dashurisë për shokun, kënga e afërt me tematikën e problemet e rinisë si pjesë e pandarë e popullit tonë, kënga lirike, humoristike etj. sepse këto janë aspekte të jetës sonë të gjerë e të bukur.

Në muzikën simfonike, besnikëra e qartësia e lidhjes me temat muzikore e me materialin burimor gjatë zhvillimit, është e domosdoshme sepse ka raste largimi aq të madh sa nuk njihet më ajo që u muar si bazë në zanafillë. Gjithashtu më tepër duhet të synojmë drejt harmonisë, polifonisë, strukturës, ritmeve popullore etj. që këto të bëhen pjesë organike e indit të gjallë të veprës. Në muzikën me program, qartësia ideoemocionale është kusht i demokratizimit të saj. Nuk mund të kënaqemi më me emërtimin klasik të formave, por duhet titulli i saktë, që të mos arrihet deri atje sa ti vemë një titull për të qenë brenda, e që në fakt edhe kur ndërrohet ky nuk i prish gjë veprës. Nga ana tjetër kjo gjini e muzikës duhet të kapërcejë një lloj kufizimi kur mbetet vetëm brenda tipit tregimtar.

Në veprat tona skenike-muzikore, vërehet një farë skematizimi dhe spostimi i situatave kryesore, prandaj du-

het të thellohet vërtetësia e konfliktit dramaturgjik si një element bazë i krijimit, ndeshja e forcave të kundërta në mënyrë bindëse dhe kësaj t'i përgjigjet më mirë dramaturgjia muzikore, duke dalë nga ai plan ilustrues, të cilin e vemë re mjaft dhe në muzikën e filmave tanë. Demokratizimin e operas, nuk e sjell çpërpjestimi mes asaj që këndohet dhe ngarkesës orkestrale, siç mund të shihet në ndonjë vepër tonën; opera kryesisht është krijim që këndohet nga njerëzit dhe errësimi i kësaj veçorie, dëmton kapjen e saj nga masat. Një nga problemet e operës mbetet edhe diksioni, sepse kur fjala e kënduar nuk kuptohet, duam a s'duam kalohet në formalizëm. Si gjini më të afërta për masat e gjëra, më shumë duhet të kultivojmë operetën, komedinë muzikore, operat e baletet me një akt, operat komike etj. Por dhe për vetë strukturën e operas sonë mund të mendojmë më seriozisht, në vështrimin se si përmbajtja e re duhet të influencojë edhe më tepër në demokratizimin më të madh të saj. Në rast se me vallet masive në baletet tona, jemi më mirë, mbetet gjithnjë problem realizimi i monologut, dialogut, që mjaft herë mbetet disi jashtë stilit të baletit kombëtar. Tema e klasës punëtore, e fshatit të ri socialist, janë trajtuar vetëm në gjininë e këngës. Këto tema të rëndësishme duhet të trajtohen denjësisht në vepra skenike dhe në vepra të formave të mëdha simfonike e vokale.

Më shumë ka nevojë për trajtim muzika pedagogjike (ku jemi tepër deficitarë), muzika e dhomës, përpunimi i këngës popullore etj. Jeta koncertale si në qendër, ashtu edhe në rrethe akoma nuk po i përgjigjet kërkesave të masave. Veprat tona ekzekutohen njëherë dhe me kaq e mbyllin jetën e tyre, pra nuk mbeten më në kontakt të drejtë-përdrejt me dëgjuesin, gjë që sjell shumë mangësi si për publikun ashtu dhe për krijuesit.

Edhe tek interpretuesit tanë në disa raste ndeshemi në efekte të jashtëme, një lloj nervozizmi e dramatizmi të huaj. Këto shenja më shumë i hasim në interpretimin e këngës sonë. E keqja është se këto po ua kalojmë edhe interpretuesve të vegjël, siç vërejmë në mjaft festivale. Të marrim shembull tek singëriteti i këngëtarit popullor, ashtu si dhe tek artistët tanë më të mirë, që pa grimase na emocionojnë me botën dhe shpirtin e tyre të madh që na transmetojnë.

Kritika me përpjekjet e saj ka dhënë mjaft kontribut në çështje të ndryshme të muzikës kohët e fundit dhe të koreografisë e shumë pak në atë të intepretimit dhe ek-



zekutimit. Krahas gjallërimit më të madh të saj, ne kemi gjithashtu nevojë për studime të ndryshme në këto fusha, si dhe përgjithësime të përvojës më të mirë të realizuar në krijimtarinë tonë.

Ngritja jonë ideologjike, thellimi në materialet e Partisë e në mësimet e shokut Enver, do të bëjnë që ne të kryejmë më mirë detyrat e mëdha që shtroi Kongresi i 7-të i Partisë në lëmin e krijimtarisë, interpretimit dhe ekzekutimit në shërbim të popullit e Partisë.

## MUZIKA JONË NË LUFTE KUNDER ARTIT BORGJEZ – REVIZIONIST

Muzika jonë e realizmit socialist që në fillimet e saj u zhvillua mbi bazën e traditave më të mira popullore, të këngëve patriotike dhe të këngëve partizane me një përmbajtje revolucionare, duke iu kundërvënë kështu ndikimeve fetare, mistike, temave intime me karakter sentimental, që gjenin shprehje si rezultat i sistemit feudo-borgjez të së kaluarës dhe shtypjes së huaj.

Në themel të këtij zhvillimi u vu parimi i karakterit klasor të artit që lidhet me forcimin gjithnjë e më shumë të partishmërisë proletare, të përmbajtjes socialiste dhe të karakterit kombëtar popullor.

Arti ynë i realizmit socialist është zhvilluar në kushtet e një rrethimi dhe të një ekspansioni të egër ideologjik të rrymave të ndryshme të artit borgjez e revizionist, dhe në luftë të papajtueshme me to. Edhe kompozitorët tanë, duke u udhëhequr nga mësimet e Partisë e të shokut Enver, nga ideologjia marksiste-leniniste i kanë bërë ballë këtij presioni, dhe kanë dhënë vepra me nivel të lartë ideoartistik me një përmbajtje të theksuar revolucionare të mbështetur fort në truallin kombëtar, për të realizuar rolin që

u ka ngarkuar Partia si ndihmës së saj në edukimin komunist të masave.

Tendencat kryesore që vihen re sot në zhvillimin e muzikës në vendet borgjeze e revizioniste, ashtu si edhe në gjithë artet e tjera, lidhen me heqjen dorë plotësisht nga idetë dhe përmbajtja e shëndoshë. Përmbajtja shihet nga jashtë si një element që nuk ka të bëjë fare me artin muzikor. Për kritikën borgjeze objekt studi është vetëm forma me elementet e saj. Kështu kur analizohet një vepër evidentohet ana strukturale, duke paraqitur aplikimin e rregullave të cilat ia ka imponuar vetes autori dhe asgjë më shumë.

Kjo lidhet me konceptet ideo-estetike të këtyre kompozitorëve, të cilët në raste të veçanta e shprehin haptazi ashtu siç bën Stravinski, që e quan veten jo një kompozitor por një shpikës të muzikës. Në një mënyrë tjetër (por që shpreh të njëjtën gjë), e perceptojnë muzikën përfaqësues të tjerë të muzikës dekadente, të cilët në vepër nuk shohin asnjë mundësi për të pasqyruar realitetin jetësor. Por ndërkohë që borgjezia trumbeton me bujë të madhe se muzika nuk mund të shprehë një përmbajtje konkrete ka një vërshim të madh të muzikës me përmbajtje dekadente reaksionare duke filluar që nga kënga e deri tek veprat me karakter fetare.

Kompozitorët tanë duke zbatuar mësimet e Partisë e të shokut Enver janë preokupuar vazhdimisht që muzika jonë ta transmetojë përmbajtjen e saj të shëndoshë me një gjuhë të thjeshtë, të bukur e të kuptueshme për masat e gjëra. Është luftuar koncepti intelektualist i artit për art duke i kundërvënë tendencën për një art demokratik e revolucionar. Theksi gjithnjë është vënë në përmbajtjen ideore të veprave, gjë e cila ka rritur rolin edukues e mobilizues të muzikës sonë dhe e ka shpënë atë afër masave. Muzika jonë, përmes krijimeve që nga gjinia e këngës së autorëve Kono, Trako, Dungu, Grimci, Prodani, Gaci etj dhe deri tek muzika skenike e simfonike e kompozitorëve Zadeja, Zoraqi, Daija, Harapi, Dizdari, Gaqi, Lara, Kushta etj. ka pasqyruar aktualitetin, luftën heroike të Partisë e popullit tonë për ndërtimin e socializmit nëpërmjet transmetimit të emocioneve epike, heroike dhe optimiste, karakteristika këto të jetës sonë. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka luajtur fakti që kompozitorët tanë kanë trajtuar edhe temat e mëdha që preokupojnë shoqërinë tonë duke u vënë përballë tendencave që vihen re sot në muzikën borgjezo-revizioniste për të trajtuar temat e vo-

gla intime, që kultivojnë ndjenjën e individualizmit borgjez. Në këtë rrymë është përfshirë sidomos muzika e lehtë e këtyre vendeve. Duke spekuluar në veçorinë e këngës e cila nga natyra e saj, depërton më me lehtësi te masat, borgjezia bën ç'është e mundur që, nëpërmjet kësaj gjinie, të helmojë ndërgjegjen e njerëzve, sidomos të të rinjve, për t'i larguar nga problemet e mëdha politike e shoqërore. Temat intime, temat e vogla të para nga një kënd vështrimi borgjez kanë pushtuar këngën dhe muzikën e lehtë perëndimore. Këto vitet e fundit po bëhet shumë zhurmë për «muzikën pop» e «folk — muzikën», të cilat nuk kanë të bëjnë aspak me muzikën e vërtetë popullore, por që spekulojnë në emër të saj për të trullësuar ndërgjegjen e masave.

Kënga jonë është kristalizuar si tip i ri i këngës politike e shoqërore. Ajo e ka afirmuar veten si këngë e revolucionit, ka pasqyruar aktualitetin tonë në çdo moment me ngjyra të forta epike e optimiste, duke ngjallur tek njerëzit tanë gëzimin e mobilizimin për të tashmen e të ardhmen e lumtur. Ajo është mbështetur fort në traditat më përparimtare të këngëve tona popullore, patriotike e partizane.

Në rrugët e saj të zhvillimit, kënga si dhe muzika jonë në përgjithësi është ndeshur edhe me vështirësi që kanë të bëjnë sidomos me gjithë atë presion që ushtron arti borgjez-revizionist mbi ne. Shprehje e këtij presioni qenë ndikimet e huaja liberale që u shfaqën në muzikën tonë dhe që u kritikuan nga Plenumi IV i KQ. Këto ndikime që shpinin në largimin nga partishmëria proletare dhe karakteri kombëtar e popullor i artit, lidheshin me nënvleftësimin e folklorit tonë, duke e quajtur arkaizëm mbështetjen në këtë truall, dhe ky «folklorizëm» u pa si pengesë kryesore për zhvillimin e muzikës sonë të kultivuar. Teorizimet u shtrinë dhe në fushën e melodisë dhe u quajt shfaqje konservatorizmi mbizotërimi i melodisë në veprat muzikore. Mbi zotërimi i muzikës «dinamike e ritmike» që «u përgjigjej kërkesave të rinisë» çuan në festivalin e 11-të të Radiotelevizionit me një tematikë anësore, me deformime të gjuhës muzikore e me largime nga trualli kombëtar. Partia në Plenumin IV i kritikoi ashpër këto tendenca, si shfaqje të huaja liberale borgjezo-revizioniste dhe tregoi rrugët e zhvillimit të artit tonë. Edhe një herë në Kongresin e 7-të të Partisë, shoku Enver na porositi për ruajtjen e pastërtisë së arteve tona nëpërmjet forcimit të vazhdueshëm të partishmërisë proletare dhe mbështetjes fort në tabanin

tonë kombëtar. Kjo detyrë e madhe lidhet edhe me luftën kundër artit borgjez e revizionist si dhe ndikimeve të tyre.

Kristalizimi i pikpamjeve formaliste e dekadente në muzikë nisi në fillim të shekullit tonë me lindjen e zhvillimin e impresionizmit dhe më vonë të dodekafonizmit. Sot «izmat» janë shumëfishuar dhe në kërkimet formaliste të «së resë» këto rryma kanë shkëputur çdo lidhje me kulturën kombëtare të popujve dhe me traditat më përparimtare që ka krijuar njerëzimi në shekuj. Vetë muzika dodekafonike, konkrete, apo elektronike përbën një mohim absolut të muzikës tonale dhe të melodisë, e cila është bartësja e mendimit muzikor. Mohimi i melodisë dhe rolit të saj në muzikë përveç të tjerave, ka shpënë edhe në unifikimin e zhdukjen e karakteristikave individuale kombëtare të këtyre kompozitorëve. Kështu nuk dallon asnjë karakteristikë kombëtare të një dodekafonisti austriak nga ai italian, apo të një elektronisti gjerman nga ai polak. Unifikimi dhe zhdukja e karakteristikave kombëtare ka shpënë plotësisht në zhdukjen e shkollave nacionale. Zhvillimi i artit tonë në bazë të mësimëve dhe orientimeve të Partisë përbën një antitezë të pseudo-teorive borgjeze që trumbetojnë me bujë zhdukjen e shkollave nacionale. Arti ynë duke qënë në radhë të parë art kombëtar i Shqipërisë socialiste ka vlera ndërkombëtare, jep kontribut në thesarin e kulturës botërore. Kësaj teze marksiste-leniniste i janë përmbajtur edhe kompozitorët tanë, të cilët janë mbështetur fort në truallin tonë kombëtar, për të shkruar një muzikë që të tingëllojë në tërësinë e saj shqiptare, të shprehë botën e pasur shpirtërore të popullit tonë dhe të pasqyrojë aktualitetin e ditëve tona. Këtij qëllimi i ka shërbyer dhe shfrytëzimi në krijimtarinë muzikore i folklorit tonë popullor, i cili u jep veprave tona një frymë të theksuar nacionale. Në muzikën dekadente ndërkohë që është hequr dorë plotësisht nga folklori i popujve, ka një rëndje pas primitivitetit, që shprehet në shfrytëzimin e modeve të vjetër të Indisë, Greqisë së lashtë, në përgjithësi të Lindjes. Një gjë të tillë e bëjnë kompozitorët e muzikës së ashtuquajtur «modale». Ka rëndësi të kuptohet thelbi reaksionar i kësaj muzike sepse spekulohet mbi një element bazë të muzikës realiste, siç është modi. Ashtu si edhe në muzikën dodekafonike edhe këtu i jepet prioritet absolut teknikës dhe kryesisht atyre mjeteve që transformojnë më shumë figurën muzikore, në qoftë se këtu mund të bëhet fjalë për një gjë të tillë.

Mbi një bazë të kundërt estetike është muzika jonë popullore modale, e cila mbështet kryesisht në pasqyrimin emocional të mendimit melodisë së qartë e të këndueshme. Kjo pasuri përbën një bazë të shëndoshë ku duhet të mbështeten fort kompozitorët tanë për krijimtarinë e tyre. Dhe në praktikën tonë krijuese, vihet re tendenca pozitive për të shfrytëzuar në tërësi këto karakteristika modale të folklorit tonë. Por nga ana tjetër ka edhe raste të veçanta kur nuk njihen në thellësi këto vlera, dhe kjo ka shpënë në shfrytëzimin e pjesshëm të tyre. Përpyekjet e kompozitorëve tanë këtu duhet të jenë të dyanshme: në njohjen në mënyrë shkencore të karakteristikave modale të këngëve tona popullore dhe, nga ana tjetër, për të luftuar tendencat formaliste që mund të shfaqen në këtë drejtim si rezultat jo vetëm i mosnjohjes në thellësi të problemeve por edhe i ndikimeve të huaja të muzikës dekadente. Është një fat i madh që populli na ka lënë në dorë një trashëgimi të tillë me vlerë të madhe, e cila po pasurohet përditë e më shumë duke iu kundërvënë tezave borgjezo-revizioniste të zhdukjes së folklorit.

*«Në se me shekuj populli ynë ruajti e zhvilloi më tej këtë kulturë, atëherë neve, brezave të shoqërisë socialiste, — thotë shoku Enver në plenumin e 4-t të KQ të Partisë, — na bie barra të luftojmë me pasionin e militantit komunist, për ta ruajtur të pastër atë dhe për ta zhvilluar më tej».*

Me një vrap të papërmbajtshëm vërshuan «Teknikat moderne» në vendet revizioniste pas vitit 1956. Në Moskë nxënësi i Verbernit, Filip Herkoviçi së bashku me kompozitorë të tillë si Andrea Vollkonskij, Edison Denisov e shumë të tjerë, u bënë propagandistë të flaktë të Shënbergut e shkollës së tij. Festivalët muzikore që bëhen tani në B.S. janë bërë teatri i diskutimeve të zjarrta për «muzikën moderne», ku jo rrallë dëgjohe thirrje si ajo e një farë estonezi Jan Raetz, që thotë se «dodekafonia nuk ka as më shumë e as më pak lidhje me ideologjinë borgjeze se sa kontrabasi». Karakteristikë për muzikën e vendeve revizioniste është largimi nga metoda e realizmit socialist dhe heqja dorë nga përmbajtja politiko-shoqërore e veprave muzikore. Ashtu si dhe në krijimtarinë e kompozitorëve të vendeve perëndimore edhe këtu mbizotërojnë temat e vogla, temat intime nën një kënd vështrimi borgjez, Gjithnjë e më shumë po përhapet muzika religjioze, misticizmi i së cilës, së bashku me frymën e deheroizmit, të pasigurisë, të frikës e të panikut ka pushtuar të gjitha sferat e krijimtarisë muzikore.

Nga ana tjetër tendenca e superfuqisë ndjehet në të gjitha aktivitetet muzikore që bëhen herë pas here në B.S. duke filluar nga koncertet e thjeshta e deri tek festivalet e muzikës bullgare, çeke, polake e kështu me radhë të të gjitha shteteve «të bashkësisë socialiste». Edhe në fushën e koreografisë është i njëjti kuadër: — revizionistët janë në garë për t'ua kaluar rrymave më formaliste të perëndimit. Në këto vende janë rivënë në skenë shumë vepra që kanë qënë kritikuar prej kohësh për përmbajtjen e tyre të gabuar.

Në vendet borgjezo-revizioniste koreografia ka degjeneruar në dekadentizëm, shfaqje të së cilës janë dhe veprat me përmbajtje ekzotike, mbushur me sensualizëm si për nga lëvizjet ashtu dhe nga kostumet që me ekstravaganca karakteristike të tyre evidentojnë pjesët e zhveshura të trupit. Plastika koreografike është zëvendësuar nga lëvizjet gjimnastikore. Çdo ditë e më shumë në këtë fushë të artit po thellohet tendenca e largimit nga intonacioni dhe gjuha koreografike popullore e përparimtare botërore, nëpërmjet temave intime mbështjellë me një petk fetar të cilat trajtohen në mënyrë abstrakte duke i dhënë rëndësi formës dhe mjeteve shprehëse me efekte të jashtme.

Rruga e zhvillimit të koreografisë sonë përbën një shebull të kundërt. Ajo është rritur e zhvilluar mbi bazën e mësimave të Partisë e të shokut Enver, mbështetur fort në vallet tona popullore e në traditat përparimtare botërore. Një nga piksynimet kryesore në fushën e koreografisë ka qënë, në radhë të parë, forcimi i përmbajtjes socialiste të veprave. Praktika krijuese e koreografisë sonë ka pasuruar traditën kombëtare me vepra që shquhen për vlerat ideore dhe nivel të lartë artistik si: baletet «Cuca e maleve», «Halili e Hajria», numërat koreografikë «Festë të madhe ka sot Shqipëria», «Vallëzimi i shqipeve», «Komiteti», «Barinjët e Korabit», «Valle e Dardhës» etj. vepra të koreografëve P. Kanaçi, A. Aliaj, G. Kaceli, E. Tërshana, F. Shaqiri, etj. Në rrugën e zhvillimit të saj edhe koreografia jonë është ndeshur me vështirësi të ndryshme që lidhen si me gjetjen e rrugëve për forcimin e pasurimin e traditave tona, ashtu edhe me ndikimet e artit borgjezo-revizionist. Edhe këtu pati shfaqje të shpëputjes nga vallja popullore duke kërkuar përdorimin e elementeve formalistë. Probleme të tjera që kanë lindur në koreografinë tonë, lidhen me thjeshtëzimin e motiveve popullore si rezultat edhe i mosnjohjes së mirë të folklorit tonë koreografik. Një aspekt tjetër i ndikimeve të huaja është absolutizimi, në ndo-

një rast, i elementit ritmik për të arritur efekte të jashtme, stilizimi i kostumeve kombëtare jo mbi baza shkencore si dhe ndonjë shfaqje e luksomanisë karakteristike kjo e shtresave të pasura.

Arti ynë është vënë tërësisht në shërbim të idealeve të revolucionit dhe ka luftuar vazhdimisht kundër artit borgjezo-revizionist. Presioni ideologjik që ushtrohet nga armiqtë tanë, nga «izmat» e artit dekadent nuk e kanë lëkundur aspak artin tonë të realizmit socialist, përkundrazi ai është pastruar e forcuar më shumë nën dritën e mësimave të Partisë e të shokut Enver.

Kongresi i 7-të i Partisë theksoi edhe njëherë me forcë të madhe domosdoshmërinë e ruajtjes së pastërtisë së arteve tona nëpërmjet forcimit të luftës kundër presionit të artit borgjezo-revizionist. Në kushtet e rrethimit borgjezo-revizionist vigjilenca ndaj ndikimeve të huaja duhet mbajtur lart sepse rreziku është i vazhdueshëm dhe nuk duhet ushqyer asnjë iluzion mbi dobësimin e këtij.

Terren i luftës për të ruajtur pastërtinë e artit tonë ashtu siç na porositi edhe Kongresi i 7-të i Partisë është forcimi i vazhdueshëm i partishmërisë proletare, lidhur me luftën për forcimin e përmbajtjes socialiste të artit tonë. Forcimi i partishmërisë lidhet edhe me atë trajtimin më të gjerë e më të thellë të temave të mëdha që preokupojnë shoqërinë tonë. Kjo kërkon që këto tema të njihen e të kapen në terrenin konkret të luftës që bën populli ynë e klasa punëtore për ndërtimin e socializmit.

Forcimi i karakterit kombëtar, ashtu siç u theksua edhe njëherë me forcë në Kongresin e 7-të të Partisë, është një detyrë shumë e rëndësishme që shtrun para artistëve nevojën e njohjes më të thellë të jetës e pasqyrimin e saj me vërtetësi, njohjen e traditave tona të vjetra e të reja, dhe shfrytëzimin më të gjerë të tyre. Forcimi i tipareve kombëtare të artit tonë përbën në të njëjtën kohë edhe një mburojë të fuqishme ndaj agresionit të tërbuar të artit dekadent, sepse edhe tehu i luftës kundër artit tonë nga ana e armikut, është drejtuar pikërisht në dobësimin e partishmërisë proletare dhe të karakterit kombëtar të arteve tona.

Një problem me rëndësi është çështja e propagandimit të mirë të vlerave të krijimtarisë sonë muzikore, që ka të bëjë me atë se si ia kundërvëmë muzikën tonë muzikës së çoroditur dekadente. Krahas sukseseve, mendoj, se këtu kemi edhe të meta, që duhet të preokupojnë organizatën tonë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Te

ne çdo vit kompozohen me dhjetra vepra që i bëjnë jehonë aktualitetit tonë. Por numërohen me gisht ato vepra që gjatë vitit, pas premierës që zakonisht është në koncertet e majit, të luhen dy a tri herë. Në mospropagandimin e mirë të jetës koncertale ndikojnë inçizimet e dobëta me të cilët transmetohen shumë nga veprat tona.

Edhe në propagandimin e vlerave tona jashtë kufijve të atdheut, krahas përhapjes së artit popullor, të përfaqësohemi denjësisht edhe me arritjet tona më të mira të muzikës sonë të kultivuar, në mënyrë që të zbatojmë dhe ato detyra të rëndësishme që shtroi shoku Enver në fjalën e 20 dhjetorit 1974.

Krijimtaria jonë, në luftë kundër artit dekadent borjezo-revizionist, do të militojë gjithnjë më fuqishëm për edukimin komunist të masave.

## FOLKLORI DHE KRIJIMTARIA MUZIKORE E KOREOGRAFIKE

Krijimtaria jonë muzikore e koreografike me përmbajtje të re revolucionare në frymëzimet dhe realizimet e saj gjeti burime të fuqishme të pashterura në artin e popullit. Pasqyrimi me vërtetësi i realitetit të vendit tonë në krijimtarinë muzikore e koreografike, u ka dhënë atyre përmbajtjen socialiste, e cila kërkon formën e vet kombëtare. Mbështetja në truallin amtar, e ka bërë këtë krijimtari të afërt për masat e gjera punonjëse, shprehëse të aspiratave dhe vrullit revolucionar të tyre. Vetëm duke pasur piksynime të qarta ideologjike nga pozitat e Partisë, të frymëzuar në jetën tonë të gjallë, në melosin dhe leksikun koreografik popullor, në përvojën estetike të folklorit, u bë e mundur të krijoheshin vepra të tilla të shquara si operat «Mrika», «Zgjimi» dhe «Komisari», baletet «Halili dhe Hajria», «Cuca e maleve», kantatat «Me ty Parti, me ty Enver», «Parti e Punës, Parti e trimave», «Nënë Shqipëri», «Vullnetarët» etj. këngët «Për ty Atdhe», «Në një dorë kazmën, në tjetrën pushkën», «Revolucioni marshon», «Këngë për Republikën», «Marshime partizane» etj., vallet «Festë të madhe ka sot Shqipëria», «Vallëzimi i shqipeve», «Vallja Dardhare», «Barinjtë e Korabit», «Vallja e Librazhdit etj. Po ashtu motivet popullore përshkojnë shumë vepra të kompozitorëve tanë, duke filluar që nga gjimitë më të vogla e deri në gjinitë e mëdha. E ndeshim atë në sonatat dhe poemat e Ç. Zadejës e T. Daisë, në veprat pianistike: rapsodi e koncert të T. Harapit, F. Ibrahimit, në koncert e tokatë të Ç. Zadejës, koncert e baladë të K. Larës, në veprat për vio-

linë: koncertet N. 1, 2, 3 të N. Zoraqit, P. Gacit; në poemat «Atdheu» të Sh. Kushtës dhe «Baballarët» të K. Laros; në koncertin dhe poemën e Th. Gaqit; në oratorin «Partia» të Trakos, në rapsoditë dhe suitat për bandë të P. Dungut, dhe A. Grimcit, e deri të simfonitë e L. Dizdarit e S. Gjonit, etj.

Format e muzikës polifonike popullore kanë ndikuar në muzikën e kultivuar. Tek ajo gjejmë shumë elementë me një potencial të madh për trajtimin jo vetëm të gjinive të vogla, por edhe të atyre simfonike e koncertale deri edhe të operës. Në këtë polifoni gjejmë të zhvilluar recitativin melodik dhe atë të thjeshtë; gjejmë pentatonin shumëformësh, këtë strukturë tingëlluese sa të vjetër dhe origjinale aq edhe bashkëkohore; gjejmë imitacione nga më të ndryshmet, pedalet e shumëlojshme, ritmet dhe fakturat ritmike aq të pasura dhe, veçanërisht kontrapuntin dhe harmoninë modale. Tek bashkëtingëllimet disonante që gjinden pa përjashtim tek shumica e këngëve polifonike të jugut, sidomos atyre labe, nuk kemi një fërkim disonant të thjeshtë por një sistem funksional modal të organizuar që krijon vazhdimisht një tingëllim epiko-lirik. Pikërisht këtë ndeshje bashkëtingëlluese midis dy sferave të kundërta modale, që të duket se të shpie edhe tek maxhori edhe tek minori, raport që haset edhe në shumë këngë popullore të krahinave të tjera, e gjejmë të realizuar herë pas here në veprat e kompozitorëve tanë. Po ashtu paralelizmat e sekondës apo të kuartës, kaq të dendura si në muzikën polifonike të jugut, dhe në muzikën rapsodike instrumentale të veriut, kanë gjetur shprehje në krijimet tona, duke filluar që nga kënga e deri në veprat e formave të mëdha, sidomos në ato me karakter vallëzues. Kështu p.sh. i ndeshim ato në «Këngën për Kongresin e 5-të» të T. Daisë, «Festë në fshatin socialist» të Ç. Zadejës, tek vallet simfonike të F. Ibrahimit e P. Gacit dhe në disa koncerte.

Po ashtu karakteri i imitacionit, kjo formë kaq origjinale e polifonisë sonë popullore, ka gjetur shprehje në trajta më të zhvilluara e më të organizuara në disa nga veprat e krijuesve tanë. Duhet theksuar se sa herë kompozitorët dhe koreografët tanë u janë drejtuar burimeve popullore, u kanë dhënë një kuptim dhe përmbajtje të re bazave të harmonisë, melodisë, pentatonit, ritmit ornamentikës, polifonisë popullore, figurave, lëvizjeve e plastikës së valleve popullore dhe në përputhje me përmbajtjen e re dhe aftësitë individuale krijuese, i kanë pasuruar ato me forcë tingëlluese optimiste.

Në shqyrtimin e ndikimit të folklorit në muzikën e ko-

reografinë e kultivuar vend, të rëndësishëm zë raporti midis traditës dhe novatorizmit. «Raporti midis traditës dhe novatorizmit, — thotë shoku Enver, — duhet kuptuar drejt, në mënyrë dialektike. Kjo para së gjithash, është çështje e përmbajtjes së artit dhe letërsisë, prandaj nuk duhet shkëputur asnjëherë nga lufta për t'u thelluar në njohjen e realitetit...» Njohja e realitetit në procesin e krijimit mbi bazën popullore, ka të bëjë me atë që është tipike e përparimtare e mendimit dhe botëkuptimit popullor, e formimit të tij psikologjik në përmbajtje e në formë, pikërisht e atij origjinaliteti që e ka dalluar shqiptarin nga çdo popull tjetër që qëndron në zakonet dhe folklorin e popullit tonë përmjet të cilit ai i ka rezistuar asimilimit të pushtonjësve të huaj në të gjitha kohët.

Krijimtaria jonë muzikore e koreografike e krijuar në epokën e Partisë ka zgjuar interesin e masave me përmbajtjen e vet revolucionare, me tingëllimin kombëtar e popullor, ka ecur përmes luftës së vazhdueshme për të gjetur rrugën e drejtë të zhvillimit në kushtet e realitetit tonë socialist. Në praktikën tonë krijuese është bërë gjithnjë një luftë e vendosur kundër adaptimit mekanik, imitimit të jashtëm dhe formal të modeleve të ndryshme. Këtë e kemi bërë e do ta bëjmë duke vënë gjithmonë në plan të parë përmbajtjen tonë revolucionare, origjinalitetin e jetës sonë socialiste. Megjithatë është për tu theksuar se nevojitet të njohim mirë ndërtimin e këngës, të baladave, të rapsodive të kreshnikëve, meloditë instrumentale dhe të vallëzimit popullor të gjinive të ndryshme. Duke i studiuar dhe analizuar thellë si përmbajtjen ashtu dhe formën popullore, do të fitojmë shumë për t'u dhënë akoma më tepër veprave tona një fizionomi origjinale kombëtare.

Armiqtë e Partisë e të kombit F. Paçrami e T. Lubonja etj. kërkonin të shkëpusnin artin e kultivuar nga arti popullor, duke i hapur rrugën agresionit të huaj kulturor. Intonacioni i një periudhe historike të së kaluarës, thuhej nga këta armiqtë, nuk ka forcë për të shprehur brendinë revolucionare të epokës sonë socialiste, se muzika e vjetër popullore nuk i ofron kompozitorit një fjalor të mjaftueshëm për të shprehur kohën tonë, se ka vepra që kanë rënë në folklorizëm etj.

Mendime të tilla kërkonin t'i hiqnin folklorit mundësinë për të qëndruar si bazë e drejtpërdrejtë e krijimtarisë muzikore e koreografike kombëtare, e një harmonizimi funksional dhe të zhvillimit të gjerë simfonik, mohonin traditën në mënyrë metafizike, pengonin shprehjen e një

përmbajtjeje të re socialiste përmjet gjuhës muzikore kombëtare.

Në këto mendime duket qartë koncepti denigrues për folklorin, duke e konsideruar atë si prodhim që i përket një zhvillimi të ulët shoqëror, duket konsiderata ndaj tij si «i ngurtë», i pa aftë që të zhvillohet bashkë me ecjen përpara të shoqërisë. Në folkloristikën borgjeze e revizioniste folklori tradicional paraqitet si një eksponat muzikor, si një kujtim i përmortshëm, që «jeton» në ndërgjegjen e popullit pikërisht me cilësinë e diçkaje të kaluar.

Në Plenumin IV, Partia dhe shoku Enver duke kritikuar rëndë këto teorizime që përçmonin krijimtarinë popullore, shtruan me forcë se e vetmja rrugë e drejtë për zhvillimin e artit dhe letërsisë sonë, është mbështetja vazhdimisht në tabanin tonë kombëtar, në luftë me të gjitha rrymat dhe shfaqjet e huaja dekadente borgjeze dhe revizioniste.

Në evoluicionin e folklorit jetojnë pranë krijimeve të reja edhe krijime që pas një epoke lulëzimi ua lënë vendin të tjerave. Kështu p.sh. në qoftë se kemi parasysh këngët legjendare, baladat, këngët e nizamit, të kurbetit apo një sërë këngësh rituale dhe një pjesë të këngëve të ceremonialit të dasmës, zhvillimi i të cilave u përkent rëndëve të mëparëshme shoqërore, sot nuk mund të bëhet fjalë për një zhvillim të tyre. Këtu është fjala më tepër për përdorimin e sotëm të këtyre këngëve. Përsa i takon përmbajtjes së tyre, ato ruajnë vlerën e kohës kur kanë lindur dhe shprehin atë botëkuptim, ato ndjenja shpirtërore. Nga pikëpamja e formës muzikore e koreografike nuk ndodh e njëjta gjë; forma muzikore e koreografike nuk mohohet tërësisht, ajo, në funksion të një përmbajtjeje të re, transformohet përmjet një trajtimi të ri të elementëve karakteristikë. Kështu p.sh. një pjesë e melodive të këngëve për kurbetin, nizamin apo një sërë melodish që u këndoheshin heronjve të së kaluarës, apo vajtimet epiko-dramatike të grave të Labërisë, u bënë bazë mbështetëse për këngët e heronjve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare duke i ngritur ato në një patos të ri, kushtëzuar nga përmbajtja revolucionare që mishëruan. Po ashtu mjaft valle të karakterit ritual e ceremonial që trashëguam nga e kaluara nuk humbën. Shumë elemente të karakterit, të plastikës, figuracionit dhe lëvizjeve që ruhen në ndërgjegjen e bartësve, integrohen gradualisht në valle të tjera, duke marrë një funksion të ri në përshtatje me realitetin e kohës. Kështu populli në çdo epokë merr nga thesari tradicional fol-

klorik në mënyrë kritike ato krijime, të cilat pasqyrojnë mendimin dhe kërkesat e tij, duke i transformuar, sa që ato bëhen me të vërtetë shprehje e ndërgjegjes së tij shoqërore të kohës. Është kjo arsyeja që në këngën dhe vallen popullore të periudhave të ndryshme, epizmi apo lirizmi, shqiptohen e tingëllojnë në mënyrë të qartë dhe dinjitoze nga pikpamja artistike. Është detyra jonë si krijues që, në larminë e mjeteve artistike që përdor populli, të hetojmë e të zgjedhim ato më të përshtatshmet, të cilat, duke i përvetësuar në mënyrë krijuese e racionale, do të na shërbejnë për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e aktualitetit tonë socialist, ashtu siç na mëson shoku Enver: «Nga folklori ne duhet të ruajmë atë që është e mirë, atë që është e popullit, atë që shpreh ndjenjat e pastra të popullit, dhe të spastrojmë ato pjesë, qoftë në formë e në përmbajtje, në të cilat kanë depërtuar ideologjia dhe frymëzimi i klasave sunduese, i lumpen-mikroborgjezisë etj.»

Mbështetja në krijimtarinë popullore nuk vjen, siç është konceptuar shpesh, vetëm nëpërmjet një përgjithësimi të intonacionit popullor gjithkrahinor, por edhe nëpërmjet përgjithësimit të intonacionit krahinor, apo të përfaqësimit krijues të disa elementeve më tipike krahinore apo të disa krahinave të marra së bashku me një sistem të njëjtë tonal e koreografik. Procesi i krijimit vetëm nëpërmjet përgjithësimit të intonacionit popullor gjithkrahinor me anën e të cilit kërkojmë të shprehim idenë në kuptimin kombëtar, ka anët e tij pozitive, por mendoj se s'mund të jetë e vetmja rrugë. Krijimi përmjet intonacioneve të veçanta krahinore, është një rrugë që të shpie në të përgjithmen, se edhe kjo është në gjendje të shprehë plotësisht idenë në kuptimin kombëtar, sepse jo vetëm që intonacioni krahinor është pjesë përbërëse e atij ndërkrahinor, por edhe sepse ngjarjet historike apo aktuale të krahinave të ndryshme nuk janë të veçanta, por janë pjesë përbërëse e marrëdhënieve të përgjithshme shoqërore, politike dhe ekonomike kombëtare. Në qoftë se nuk do të kuptonim origjinalitetin krahinor, të veçantën krahinore në muzikë e koreografi, nuk do të arrinim të krijonim as të përgjithshmen kombëtare. Nëpërmjet këtyre dy rrugëve kemi edhe individualitete në krijimtarinë tonë muzikore e koreografike.

Në rrugën e kristalizimit gjithnjë e më të plotë të ti-

pareve kombëtare në muzikën dhe koreografinë tonë të re socialiste, ndeshemi edhe me simplizmin në vështrimin e traditës. Tendencat që vihen re ndonjëherë në mënyrën e citimit, të riprodhimit naiv të një elementi të pjesshëm të melodisë apo valles popullore apo «aty këtu» me «një akord apo motiv në trashëgiminë kombëtare», duhet të jenë të huaja për kulturën tonë. Ato nuk mund të fshihin varfërinë e ideve, paqartësinë ideoartistike dhe mungesën e mjeshtrisë. Prandaj, është e domosdoshme të bëjmë përpjekje të parreshtura dhe të zhvillojmë në krijimet tona gjithë potencialin e muzikës dhe valles popullore, të vlerave ideo-estetike të saj në përmbajtje si dhe në kompleksitetin e formës me bazë atë popullore.

Partia e shoku Enver vazhdimisht e kanë theksuar çështjen e gjallërimit të lëvizjes amatore, të ngritjes së saj në një nivel më të lartë ideoartistik. Lëvizja artistike amatore si pjesë përbërëse e kulturës sonë revolucionare është bërë një shkollë e madhe me karakter masiv që ndihmon në formimin e shijeve ideoartistike të masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit. Afrimi i fshatarësisë sonë kooperativiste, me format e kulturës profesioniste, ku hyn edhe përvetësimi i sistemit tonal të temperuar që qëndron në bazën e kësaj muzike, sidomos në brezin e ri, nuk ndodh vetëm për shkak të ngritjes së nivelit ideologjik, ekonomik e kulturor të fshatarësisë sonë kooperativiste, por edhe se vetë krijimtaria amatore dhe ajo profesioniste ushqehen vazhdimisht nga krijimtaria popullore folklorike. Në këtë proces dhënie e marrje, ruajtja e raporteve midis veprimtarisë folklorike, nga njëra anë, dhe lëvizjes amatore, nga ana tjetër, ka një rëndësi të dorës së parë.

Kështu, mendojmë se ka një keqkuptim kur thuhet që sistemi i temperimit semitonal duhet të veprojë edhe në veglat popullore, në orkestrinat popullore të fshatrave dhe krahinave të ndryshme. Orkestrinat popullore, sidomos ato të Shqipërisë së Veriut, janë organizuar në bazën e ndërtimit dhe akordimit të veglave të ndryshme, në shembullin e një modeli, i cili, në këtë rast, zgjidhet si stereotipi i instrumentit me mundësi përgjithësuese të strukturës intonative të krahinës dhe përbën në vetvete «temperimin» modal tradicional. Kjo përbën bazën teknike të organizimit të këtyre orkestrinave dhe pikërisht këtu qëndron edhe një nga pikat më nevralgjike të novatorizmit të tyre. Imponimi i sistemit semitonal të temperimit në këto orkestrina do të ishte një lloj sikur të donim të shoqëronim këngët apo rapsoditë e Veriut apo të ekzekutonim

meloditë instrumentale të polifonisë vokale të jugut me kitarë e fizarmonikë. Ekzistenca e pedaleve të përherëshme në veglat kordafone të Veriut të ngjashme me ison në polifoninë vokale dhe instrumentale të Jugut, janë faktorë që përcaktojnë formimin e sistemit modal, faktorë që bien në kundërshtim me harmonizimin funksional të sistemit të temperuar.

Procesi i temperimit të veglave popullore, duke ndjekur rrugën e evoluimit, ndofta do të kryhet nga masat, por vetëm atëherë kur ai të jetë bërë domosdoshmëri. Vetëm përmjet një rruge të tillë ky fenomen do të konsiderohet i natyrshëm dhe i vendosur.

Për sa u përket ansambleve orkestrale të shtëpive të kulturës, apo Ansambllit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore është e natyrshme që krahas veglave tashmë të njohura që janë bërë popullore si klarineta, violina etj. të futen edhe vegla të tjera popullore të krahinave duke iu nënshtruar procesit të temperimit. Kjo është plotësisht e justifikueshme bile e domosdoshme sepse lidhet me kriteret artistike të krijimit dhe përpunimit të folklorit nga forcat profesioniste dhe amatore.

Në stadin e tanishëm të zhvillimit të krijimtarisë sonë në muzikore është e nevojshme të krijohet orkestra kombëtare me instrumente popullore të temperuar, pranë Ansambllit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve, e cila do të nxirte në pah, në mënyrë më të plotë, vlerat intonative dhe timbrike të krijimeve me frymë popullore.

Padyshim që folklori në lëvizjen amatore zë një vend të rëndësishëm, sidomos në vatrat dhe shtëpitë e kulturës së fshatrave dhe qendrave industriale. Shpesh në këtë lëvizje, për shkak të disa koncepteve që kanë disa drejtues të saj (si muzikantë, koreografë, regjisorë, etj.), folklori paraqitet i modifikuar.

Folklori do të përpunohet dhe do të stilizohet vazhdimisht nga forcat krijuese amatore e profesioniste. Por në qoftë se është fjala për një stilizim, krijim apo përpunim i një pjese folklorike, atëherë duhet përmendur emri i përpunuesit apo krijuesit dhe jo të paraqitet si folklor autentik, se krijojnë keqkuptim në opinionin shoqëror, artistik e shkencor dhe në mënyrë të veçantë në vetë folklorin. Shpesh shohim në programet e televizionit tonë të transmetohen këngë e sidomos valle popullore nga krahina e rrethe të ndryshme të vendit ku duket nga fillimi e në fund dora e përpunuesit e megjithatë ato paraqiten si këngë e valle origjinale popullore.



Në trajtimin e folklorit apo të elementeve të tij në skenë megjithë sukseset e ndjeshme të arritura, shpeshherë mungon koncepti themelor i nisjes, përpunimit dhe destinacioni i paraqitjes. Vihen re edhe tendenca spektakulare të krijimeve e përpunimeve koreografike. Çdo fenomen folklorik këngë, valle, melodi instrumentale etj., ka fizionominë dhe origjinalitetin e vet të kristalizuar nëpër shekuj. Ky origjinalitet në asnjë mënyrë nuk duhet të çenohet në thelbin e tij, pavarësisht nga format e ndryshme të krijimit artistik koreografik, qoftë edhe me përmbajtje të caktuar tematike, etj. Mosrespektimi i një parimi të tillë të çon në zhveshjen dhe rrafshimin e stileve krahinore, në krijimin e një uniformiteti të mërziqshëm, në shtrembërime nga më të ndryshmet deri në përzierjen e lëvizjeve të valleve të grave me ato të burrave. Fenomene të tilla që ishin vënë re më parë, u dukën më të theksuara, sidomos në Koncertet e Majit të vitit të kaluar. Të prirur për efekte spektakulare të jashtëme, u përzien në mënyrë të panatyrshme brenda një krijimi, motive të krahinave të ndryshme, u ngarkuan me figura dhe lëvizje artificiale, të shrrëgullta, spostime formacionesh në drejtime të ndryshme, lëvizje në dy vija paralele, në diagonale, etj., elemente këto që nuk përputhen në asnjë mënyrë me natyrën e përmbajtur, lëvizjet dhe figurat harmonike, rrjedhshmërinë logjike dhe unitetin që karakterizon krijimin artistik popullor. Të gjitha këto të pengojnë të perceptosh qartë linjat artistike dhe ideore të asaj njësie krijuese që demonstron në skenë. Këtu e marrin piknisjen edhe shartimet e lëvizjeve dhe të figuracionit të qartë popullor me huazime jo vetëm në kuadrin e brendshëm krahinor kombëtar, por edhe me ndikime reminishencash të formimit kulturor apo impresionesh të huaja. Të tilla praktika që u vunë re edhe në koncertet e ndonjë grupi amator, si rezultat i ndikimit të lëvizjes profesioniste, përmjet zgjerimit gradual të depërtimit të tyre, të çojnë në humbjen e tipareve karakteristike kombëtare të kulturës sonë popullore, në hapjen e rrugëve të shfaqjeve të huaja.

Ka raste që një frymë spektakulare përshkon edhe këngën, këtë gjini sa të thjeshtë aq edhe të dashur për popullin. Kënga në këto raste jo vetëm, s'është afër intonacioneve popullore, por edhe kur u afrohet atyre, ajo komplikohet mjaft deri në atë shkallë sa s'arrin të këndohet nga masat dhe mbetet kështu vetëm për një grup njerëzish të skenës. Ne kemi shumë këngë të bukura revolucionare që kur i dëgjon të krijojnë me të vërtetë kënaqësi estetike,

por në shumë raste mungon ajo thjeshtësi që e bën këngën të afërt dhe të këndueshme në kolektiv, në gëzimet shoqërore e familjare.

Këngët popullore me një thurje të thjeshtë por të bukur melodike, ashtu si dhe lodrat e vallet e moshës së njomë nuk shlyhen lehtë nga kujtesa. Ato, si një laimotiv, e ndjekin njeriun gjatë gjithë jetës. Ja përse është e rëndësishme dhe e domosdoshme që brezin femëror duhet ta ushqejmë me këngën dhe vallen e bukur popullore dhe me stilizime e krijime në frymë popullore. Ky edukim padyshim duhet të njohë një punë të diferencuar simbas grup-moshave si në kopësht ashtu në shkollë. Kjo praktikë do të rrënojë tek fëmijët tanë që në mituri muzikën dhe këngën e popullit, intonacionin dhe frymën kombëtare popullore.

Komunikimi i madh folklorik që kryhet nga të gjitha mjetet e propagandës masive të radios, televizionit, koncerteve, festivaleve, botimeve etj., janë faktorë të rëndësishëm që shërbejnë për njohjen e veçantive të folklorit në shumë aspekte të tij, por qëndrimi gju më gju me popullin ka gjithmonë një kuptim të thellë për procesin e njohjes dhe krijimit.

Kompozitorët, koreografët ashtu si dhe kritikët, këtë njohje dhe përvojë, është e domosdoshme ta konkretizojnë në përveç se në praktikën krijuese edhe në studime. Kështu janë një sërë problemesh që duhet të bëhen objekt studimi si fjala vjen: çështje të zhvillimit të melodikës popullore, ritmikës, modeve, kadencave, harmonisë, tipologjisë së polifonisë, tipologjisë së valleve, plastikës, lëvizjes e figuracionit të valleve, çështje të raporteve midis lokaleve e kombëtares, autentikes e jo autentikes, traditës e novatores, probleme të gjenezës dhe evolucionit historik të folklorit muzikor e koreografik, etj. Këto janë probleme shkencore që kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë e të përhershëm të institucioneve të interesuara, të Institutit të Folklorit, Institutit të Lartë të Arteve, Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Teatrit të Operës dhe Baletit dhe një angazhim të të gjithë studjuesve dhe krijuesve të muzikës e koreografisë.

Studimi dhe evidencimi i këtyre problemeve do të ndihmonte shumë në ngritjen e nivelit ideo-profesional të krijuesve, në përdorimin shkencor të materialit folklorik në krijimtarinë tonë si dhe në zhvillimin e udhëheqjen e drejt të lëvizjes amatore e folklorike.

## PAMJET E GJERA TE JETES DHE HEROI POZITIV NE KRIJIMTARINE MUZIKORE

Në goftë se do të kujtojmë veprat tona muzikore e koreografike më të arritura që janë krijuar në vitet e lulëzimit të artit tonë të realizmit socialist, duke filluar që nga këngët e vallet plot jetë e deri tek veprat skenike, do të bindemi se forca ideoemocionale e tyre qëndron në transmetimin e ideve të mëdha të kohës, si dhe në dhënien e heronjve pozitivë.

Prandaj, thelbin realist të muzikës e koreografisë sonë ta kërkojmë, në radhë të parë, në përmbajtje, në prirjen themelore të saj ku zbulohen veçoritë më tipike të kombit në epokën e madhe të Partisë.

Shembuj për këtë mund të gjejmë tek këngët tona, ku ndjenja e epokës, tablotë e gjera të jetës, janë të sintetizuara me nuanca të fuqishme, me poetizëm të ndierë, si koncentrim emocional i realitetit tonë. Mund të përmendim këtu këngë të tilla si «Për ty atdhe», «Në njerën dorë kaz-

mën, në tjetrën pushkën», e shumë e shumë të tjera, të cilat mbeten gjithnjë të freskëta e aktuale për arsye se ato, si shumë të tjera, kanë pasqyruar me besnikëri të vërtetën jetësore të shoqërisë tonë.

Krahas shumë cilësive të tjera edhe përmbajtja lirike e këngës sonë në shumë raste është shkrirë me përmbajtjen patriotike, posaçërisht në këngët që trajtojnë tema nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare siç është p.sh. kënga «Ylli partizan» apo kënga e festivalit të fundit në Radiotelevizion «Nënë moj, do pres gërshetin».

Pa dashur të hyj në analizë të hollësishme, mund të shtoj se këngët më të mira mbeten gjithnjë figura të krijimtarisë së lartë. Në to shpirti heroik i epokës së socializmit është skalitur me një forcë jo më të vogël, por ngandongjherë edhe më të madhe artistike se sa në veprat e gjinive të tjera. Këtë të vërtetë me shumë frymëzim e bindje e shpreh kënga popullore, e ka përforcuar kënga e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe e pohon edhe kënga e re e Shqipërisë socialiste.

Në mënyrë më të gjërë, për vetë mundësitë e specifikkës, kantata e oratori ynë, kanë trajtuar tema kardinale të epokës. Veçoritë stilistike të tyre, forca emocionale, qëndron pikërisht në përgjithësimet e mëdha të heroizmit popullor, në temën kushtuar Partisë, Atdheut, Luftës Nacionalçlirimtare, komisarit hero etj. Figurat artistike në këto vepra janë skalitur me tiparet e veta më emocionale. Shembull mund të marrim oratorin «Kënga e maleve» e T. Harapit me poezi të Ll. Siliqit. Kontrastet midis kohëve, si vazhdimësi ideoemocionale, krijojnë koncepte të qarta e të shpien drejt kapjes së idesë. Por, nga ana tjetër, duhet të pranojmë se në disa vepra të tjera vokale-sinfonike, paraqitja e tablove të mëdha të jetës nuk gjen pasqyrim bindës. Arsyet duhen kërkuar tek një farë karakteri deklamativ që i përshkon këto vepra, te mungesa e kontrasteve të qarta, ku jeta, historia, humbet jehonën e saj. Këto të meta, simbas mendimit tonë, gjejnë vend për arsye se shpesh harrojmë që krijimtaria e oratorit apo kantatës, është e afërt me dramaturgjinë e operas për nga figurat, karakteret, ndjenjat. Si rrjedhim mungon procesi i njohjes së jetës me tërë thellësinë e vet.

Ka raste kur oratorin nuk e dallojmë nga suita, së cilës i mungon strumbullari. Kështu, tërësia emocionale nuk arrin të japë figurën e Partisë me tërë larminë e vet, figurën e heroit etj. Në ndonjë rast është kaluar në poemën

vokale tregimtare, me muzikë përshkruese, ilustruese, ndryshe nga konceptimi aktiv i tekstit poetik.

Kjo ndjehet herë pas here edhe në vepra të tilla të arritura në përgjithësi, p.sh. të «Nëna Shqipëri» (A. Mula — D. Agolli) ku me gjithë episodet e goditura forca emocionale mbetet më shumë tek teksti ose tek vargëzimi i motiveve të bukura por që kalojnë pa interpretuar muzikalisht esencën ideoartistike të kësaj poeme madhore të letërsisë sonë.

Kjo gjini, që ka fuqi të mëdha për të përgjithësuar tablo të gjëra të jetës, të skalitë figura të heroizmit popullor, të japë figurën e heroit pozitiv, fatkeqësisht ka mbetur mbrapa dhe nuk ka gjetur kultivimin e duhur.

Me të drejtë, sidomos kohët e fundit, përherë e më tepër vëmendja kryesore përqëndrohet mbi problemin e muzikës skenike. Të gjitha këto shqetësime nuk janë të rastit. Kërkesat e mëdha të masave të gjera për të parë në skenë heroikën masive dhe luftën e madhe që bëjnë ato nën udhëheqjen e Partisë për ndërtimin e socializmit, botën e pasur shpirtërore me idealet dhe emocionet e tyre, mbeten plotësisht të drejta, me që asnjë gjini muzikore nuk ka qas mundësi për të shprehur konfliktet jetësore se sa muzika skenike, opera, baleti apo edhe opereta.

Prandaj edhe zhvillimi relativisht i shpejtë i kësaj gjinie në procesin e thellimit të vazhdueshëm të revolucionit popullor, vjen si kërkesë e domosdoshme për të pasqyruar realitetin objektiv, ndryshimet e mëdha shoqërore e politike të jetës së popullit. Idealet e mëdha të revolucionit frymëzuan autorët e operës «Mrika», heronjtë e së cilës janë ndërtuesit e socializmit me virtytet më të larta morale e politike, Këto ideale frymëzuan të gjitha veprat tona të skenës. Dhe ky frymëzim që gjeti shprehje tek pasqyrimi i aktualitetit tonë revolucionar, ashtu siç e theksuam më parë, shkurtoi distancat e eksperimenteve të epokave të tëra, për formimin e operas apo baletit. Kjo prirje e bën operën tonë të besueshme, e bën baletin tonë bindës; mbi këtë bazë u krijua tradita novatore e muzikës sonë skenike.

Në operan «Mrika» të Jakovës e Siliqit tablotë e gjëra të jetës jepen me nuanca të qarta: Mrika, përfaqësuese e së resë, në marrëdhënie me shoqërinë që e lindi, i kundërvihet zakoneve prapanike: ajo ka bindje për veprimet e saj. Paraqitja e kësaj gjendjeje në aktin e parë të emo-

cionon e të përgatit rrjedhën e ngjarjeve, të bind për tendencën e zhvillimit të heronjve të veprës. Ndiashmëria intonative, poetike dhe e thellë, e qartë dhe dramatike, ka gjetur shprehje posaçërisht në ekspozicion. Por në vazhdim, heroina mbetet më shumë në kujtesën e aktit të parë, ajo nuk është më aq aktiviste, humbet veprimin, i cili kalon tek tragjedia e Gjinit dhe nënë Marës.

Në operën «Komisari» për vetë ndërthurjen e ngjarjeve, karakteri heroik i veprës shtjellohet në mënyrë bindëse. Këtë e ndjehmë që tek demonstrata, e cila është në thellësi një prolog i fuqishëm i forcës së popullit në luftën shekullore për liri e për pavarësinë kombëtare e shoqërore. Është e besueshme kjo skenë për faktin se është një përgjithësim, një tablo e madhe jetësore ku me ngjyra të spikatura del në pah heroizmi masiv. Vetë ndërtimet melodike-ritmike, impulsiteti i tyre, intonacionet e qarta dhe të afërta me ato të tipit patriotik, e kanë bërë këtë skenë origjinale dhe të fuqishme.

Edhe në baletet tona gjejmë një pasqyrim tipik të realitetit tonë historik dhe aktual. Nga vetë forca, logjika e ndërtimeve e të endjes dramaturgjike të libreteve, në baletin «Halili e Hajria», pasqyrohet me besnikëri lufta e madhe popullore kundër pushtuesve të huaj. Vitaliteti i masave tingëllon fuqishëm sidomos në vallet e skenat masive. Po kështu mund të flasim për zhvillimin logjik të heroinës. Kjo tendencë arrin një kulm të ri sidomos në baletin «Cuca e maleve», i cili është vazhdim i heroizmit popullor në një etapë të caktuar të zhvillimit të shoqërisë sonë.

Pa pretenduar për të hyrë në analiza të hollësishme të veprave, na duket e nevojshme të flasim për disa probleme që i përkasin zhvillimit të kësaj gjinie në mënyrë që ta blotë e gjëra të jetës të jenë akoma më të besueshme muzikalisht, për të ndierë akoma më me thellësi evoluimin e heronjve pozitivë që prijnë me virtutet e larta moralopolitike.

Në zhvillimin intonativ të veprave tona skenike një rol pozitiv ka luajtur kënga, në të cilën mishërohen gjithë ato tendenca progresive të melosit tonë që zhvillohet në tërë kompleksitetin e vet në marrëdhënie me folklorin. Nuk mund ta shkëpusim melodikën e këngës së Jakovës nga opera e tij, të Daisë apo të Zoraqit nga individualiteti i tyre krijues etj. Këtu kemi një vazhdimësi logjike në kristalizimin e tipareve dhe të origjinalitetit krijues jo ve-

tëm të kompozitorëve, por edhe fuqizimin e tipareve origjinale novatore të artit tonë të realizmit socialist. Në përgjithësi këto cilësi i kanë dhënë operës e baletit tonë tingëllim demokratik. Nëpërmjet këngës kanë depërtuar nga ana tjetër edhe idetë e mëdha në tregime intonative, si materializim i sintetizuar i tipareve të shoqërisë sonë. Nuk është e rastit që gjuha e zgjedhur, stili përgjithësues dhe roli i këngës, si bazë fillestare, kanë influencuar në porcione të dukshme në veprat skenike.

Sa më tendencioz të tregohet kompozitori për realizimin e këtyre kërkesave, sidomos në qartësinë e dhënies së mendimit, aq më e kuptueshme bëhet vepra. Si shembull mund të marrim edhe episode të ndryshme brenda një krijimi. Në skenën e pushkatimit, në operën «Komisari», drama është e ndieshme për arsye se vazhdimësia melodike origjinale mbetet bazë si për heroin ashtu edhe për masën, e cila shpërthen në një revoltë të fuqishme, (aria e Ademit — koralja «U mbush lemi»). Pra këtu origjinaliteti është i lidhur me intonacionin kombëtar, i cili ka influencuar qoftë drejtpërdrejt në trajtimin e idesë tek koralja që është një këngë popullore, ashtu edhe tek kënga monolog i Ademit. Ndryshe nga kjo ndodh në episodin tjetër, tek shtëpia e doktorit, ku dialogu i Almës me komisarin, mbeten si ide e nuk perceptohen dhe marrin karakter tipik instrumental, pikërisht se kompozitori largohet nga konceptimi i qartë melodik, si veçori thelbësore e karakterit kombëtar.

Në vazhdimësi të këtij problemi mund të shtojmë se edhe në gjuhën koreografike ndiejmë një ndarje midis skenave masive dhe dialogjeve, ose më mirë të marrëdhënjëve midis heronjve, heronjve e masës. Aty ku influenca e kulturës popullore ka qenë më e qartë si p.sh. tek vallet apo skenat masive, ngjarjet janë të besueshme, sepse ato materializohen me melodi të qarta, të kuptueshme, bindëse, kurse kur kemi të bëjmë me gjuhën e heronjve, ndiejmë më tepër ndikimin e shkollave, të traditës së epokave, të mëparëshme në dëm të përmbajtjes, për arsye se kemi një trajtim më subjektiv të formës mbi përmbajtjen. Me këtë çështje lidhet edhe problemi i konfliktit, me që ekspresiviteti melodik përfaqëson, ose më mirë në mënyrë më direkte konkretizon heroin pozitiv apo masën, pa të cilat nuk mund të ketë dramaturgji operistike apo koreografike.

Mungesa konsequente e zhvillimit të intonacionit muzikor, si mishërim i idesë, ka zbehur në shumë raste ve-

çoritë e heronjve pozitivë në dramaturgjinë tonë skenike. Kjo ka bërë si rrjedhim që muzikalisht, në këto raste, heroi mbetet jashtë dramës skenike, qoftë edhe nga ana plastike në baletet tona.

Në krijimet ku konflikti është më i dukshëm në bazë të veprës, si tek baletet «Halili e Hajria» e «Cuca e maleve» tek operat «Skënderbeu», «Komisari» apo «Zgjimi», forcat antagoniste të dy kampeve përcaktojnë qartë karakterin e konfliktit. Por kjo nuk është e mjaftueshme në qoftë se nuk ndodh kështu dhe me tingëllimin muzikor apo koreografik, dhe si rrjedhim në sferat intonative gjatë konfliktit, apo plastikës koreografike. Tek opera «Zgjimi» p.sh. këto sfera, si tendencë, janë më të realizuara sipas mendimit tonë. Përcaktimi i ndryshimeve cilësore midis dy forcave ndërluftuese, që mbështetet tek pikëpamjet klasore dhe grupet antagoniste vepruese duhet të zbulohen jo vetëm si «dëshirë» e libretit por duhet të gjejnë zgjidhje edhe muzikalisht apo koreografikisht. Në muzikën e baletteve tona ky problem është zgjidhur më me sukses, gjë që lidhet me tipizimin individual të çdo personazhi dhe shpërthimin e një konflikti intonativ, pa të cilat nuk mund të bëhen të besueshme tipizimi i tablove të gjëra të jetës dhe roli i heroit pozitiv në situata tipike. Mosrealizimi me sukses në ndonjë vepër i kësaj kërkesë, e ka bërë atë jo deri në fund bindës. Sidomos për dramaturgjinë epiko-lirike ky fenomen është shumë i ndieshëm. Sa më mirë kompozitori apo koreografi ka mundur të mishërojë me mjete individuale tipike, me intonacion e në plastikë, një figurë të personifikuar duke zbuluar karakterin e çdo personazhi, në veçantitë tipike kombëtare individuale dhe lidhjen midis tyre, — aq më tepër vepra e ka thënë fjalën e vet, aq më tepër bëhen bindëse dhe zhvillohen tablotë e gjëra të jetës, përcaktohet qartë tendenca pozitive e heroit. Ka raste kur kalohet në thjeshtësimin e sferës intonative të personazheve, si rrjedhim ndeshim moskonsequencën e zhvillimit intonativ të tyre, pra kompozitori e ka shtjelluar dramën muzikore mbi episode të veçanta, duke i kaluar kërkesat më tepër në ilustrim. Si rrjedhim, drama muzikalisht është e shkëputur nga e vërteta skenike dhe muzika nuk kryen deri në fund funksionin e saj me specifikën tingëlluese. Kjo nuk i përgjigjet as realitetit konkret. Heroi i ditëve tona, masat e gjëra, me të gjitha ato veçori individuale, veprojnë në rrethana e kondita të caktuara historike. Si të tilla ato duhet patjetër të personifikohen jo vetëm me laitmotivin bazë të qartë, por me të

gjitha ato ndryshime që pëson heroi apo masa në endjen dramaturgjike. Ndryshe do të kemi «shpersonifikim» muzikor dhe në këtë rast krijohet një farë monotonie në shtjellimin dramaturgjik. Kjo vlen edhe për gjuhën e baletit, ku personazhet duhet të kenë lajtintonacionin plastik. Mosrealizimi konsequent i këtyre kërkesave në koreografi ka errësuar dramën muzikore, ashtu edhe koreografike dhe vepra është «besuar» nga njohja e saj e mëparëshme prej veprës konkrete letrare, kur është marrë nga romani, drama, pra nga përmbajtja letrare.

Nga mungesa e zhvillimit të portretizimit të heronjve apo të masës, ka ndodhur edhe një farë nivelimi i forcave ndërlytuuese për arsye se në dramë, «pozita» intonative e personazheve në situata të ndryshme është zëvendësuar me episode pa rrjedhë konkrete. Në praktikën e krijimtarisë skenike, përcaktimi i temave të personazheve pozitive, në shumicën e rasteve, është gjetur drejt (të kujtojmë temën e Cucës tek baleti «Cuca e maleve», e Palit tek ajo «Zgjimi» etj. etj.); më pak janë goditur ato të heronjve negativë, bile shpesh këto të fundit janë përcaktuar me intonacione mjaft ilustruese, gjë që ka penguar veprën në zhvillim, në ndonjë rast edhe në dëm të intonacioneve përcaktuese të heronjve kryesorë.

Lufta e të kundërtave në veprën dramaturgjike muzikore, karakteri klasic i saj, fillon që në karakterizimin intonativ të heronjve. Si rrjedhim roli i heroit pozitiv ose i pasqyrimin të tablove jetësore, kryhet brenda specifikës së vetë muzikës. Ndryshe drama skenike zhvillohet jashtë dramës intonative, gjë që është sigurisht artificiale për një vepër muzikore realiste. Konflikti i intonacionit është ekivalent me konfliktin e personazheve dhe ai duhet të reflektohet jo vetëm në monologje etj., por edhe në një formë të tillë të rëndësishme siç është recitativi ose pontamima në balet. Për operat apo baletet tona, muzikalisht apo koreografikisht kjo mbetet pika më nevralgjike. Kështu pra, çështja e unitetit, ose po ta themi në mënyrë figurative, çështja e sinkronizimit të zhvillimit skenik e muzikor të figurës së heroit pozitiv, mbetet një çështje me rëndësi parimore për dramaturgjinë tonë në përgjithësi.

Për të qartësuar këtë problem duhet rikthyer edhe një herë tek kënga. Do të ishte gabim të trajtohet ky problem në mënyrë të ngurtë. Kur heroi ose masa karakterizohen në një plan më të gjerë dhe lëvizës, nuk mund të simbolizohet vetëm në një këngë statike, ose më mirë, me

një këngë të pazhvilluar në funksion të dramaturgjisë, këngë e cila është e pamjaftueshme për zbulimin e botës së brendëshme të masave. Shumë këngë-laitmotiv, me gjithë forcën e tyre fillestare të fuqishme, në ecurinë e dramës, mbeten të izoluar nga veprimi dramatik.

Gjithashtu për t'u zgjidhur nga dramaturgjia skenike, muzikore dhe koreografike mbetet çështja e recitativit apo e pantomimës. Në këto forma më shpejt dhe në mënyrë më të dukshme se sa tek të tjerat, ndodh përtëritja në gjuhë apo plastikë nga pikëpamja e intonacionit. Prandaj para kompozitorëve, koreografëve tanë del detyrë e rëndësishme njohja jo vetëm me jetën, por edhe me krijimtarinë letrare edhe artistike në përgjithësi. Krijuesi i veprës duhet të përpiqet të njohë në thelb psikologjinë e popullit, si mendon, e si flet ai, të jetojë ashtu si na porosit shoku Enver, gju më gju me të, dhe vetëm atëhere do ta pasqyrojë atë në muzikë apo koreografi. E nënvizuar këtë moment meqë problemi i recitativit apo i pantomimës ka të bëjë me rishikimin e shumë problemeve të skenës tradicionale të operas apo të baletit tonë. Recitativi influencon direkt në ripërtëritjen e veprimit të dramaturgjisë sonë meqë pikërisht që këtu hidhen themelet e vërteta të novatorizimit të operas apo baletit shqiptar, pa të cilat nuk është e mundur të krijohet një vepër e këtyre gjinive mbi temat e kohës. Krijimtaria e popullit në evoluimin dialektik të gjuhës e veprimit, (si pasqyrim i materializuar i mendimit, i psikologjisë së masave), na jep shembuj të shkëlqyer në këtë drejtim: vetë karakteri recitativ i muzikës popullore polifonike nga njera anë dhe i muzikës omofonike në gojën e rapsodëve, nga ana tjetër, vërtetojnë karakterin novator edhe të formës artistike të artit tonë popullor që mbetet bazë për krijimtarinë profesioniste. Nuk është e rastit p.sh. se pikërisht kur i jemi referuar krijimtarisë popullore, folklorit kemi arritur suksese të ndieshme.

Në mjaft raste mundohemi të «legalizojmë» çdo huazim të mjeteve, të stileve e shkollave të ndryshme që në kontekste të caktuara shprehin një mendim, një botë të pakapshme për realitetin tonë socialist. Nuk ka asnjë logjikë p.sh. që në baletin tonë të sjellim ngritjet ekzaltuese akrobatike si shprehje e një shpërthimi emocional kulminant, atëhere kur fjala është për një bashkëbisedim heroik midis partizanëve e komisarit. Për të shprehur forcën e punëtorit komunist të pararojës në një aksion tipik kombëtar, nuk ka pse të përdorim «arabeskën» si element ti-

pik shprehës, sikurse nuk mund të besojmë p.sh. bartjen e «pa dë-dë-së» klasike, që transmeton ekzaltim emocionesh subjektive, për të paraqitur marrëdhënjet tipike të të rinjve tanë, atëherë kur ndryshimet rrënjësore të revolucionit i kanë dhënë emancipim të plotë gruas në shoqërinë tonë socialiste. Këtu, e në shumë raste të tjera, kemi të bëjmë me probleme etike e estetike për të cilat çdo krijues duhet të mbajë qëndrim të qartë ideologjik. Këto kërkesa që i sjell vetë koha, vetë revolucioni, nuk duhen reduktuar në një konceptim të ngurtë. Fjala këtu nuk është të shkëputemi nga çdo gjë pozitive që ka krijuar gjenia e popujve dhe që i shërben aktualitetit revolucionar. Në përgjithësi në muzikën instrumentale prirja drejt tematikës së qartë, drejt programatikës bashkëkohore, ka qenë dhe mbetet një detyrë e ngutëshme për krijuesit tanë. Nuk është e rastit zhvillimi i opemës simfonike si sintezë e një tregimi realist aktual.

Karakteristike gjithashtu është se edhe atëhere kur nuk kemi patur një detajim programatik, vetë influenca e realitetit tonë socialist i ka bërë ato të frymëzuara dhe mjaft të qarta emocionalisht. Mund të marrim si shembull rapsodinë Nr. 2 të F. Ibrahimit ku, në njerën anë evokohet heroika popullore shekullore, duke e dhënë jehonën e vet herë herë në plan tragjik, herë me zberthime heroiko-dramatike, kurse, nga ana tjetër, ndiejmë gëzimin, harrenë popullore të kohës (si kontrast i mendimit të pjesës së parë). Në veprat simfonike të Dizdarit, Kushtës, Laros, Gaqit e shumë kompozitorëve të tjerë, ndiejmë një koment realist të episodeve të rëndësishme të historisë së popullit.

Por gjithnjë programatika e qartë duhet të mbetet prirje themelore për zhvillimin, progresin e muzikës instrumentale, qysh nga format e vogla. Këtu kemi të bëjmë me përcaktimin konkret emocional të kompozitorit, me pozitën dhe vlerësimin e tij ndaj realitetit, me kontradiktat përkatëse klasore, si forcë shtytëse të revolucionit. Nuk është e rastit që kur dëgjojmë poemën «Borova» të Th. Gaqit, jetojmë luftën heroike të popullit tonë.

Por fjala këtu nuk është vetëm për të analizuar apo komentuar sukseset tona në këtë drejtim, që pa dyshim janë të mëdha. Mendoj se duhet të ndalemi në disa probleme që mbeten mjaft të ngutshme për zhvillimin e muzikës instrumentale, ku për vetë karakterin e saj stërho-

llimet intelektualiste zënë vend më tepër duke filluar që nga influenca e formës mbi përmbajtjen, etj.

Largimi nga tema e qartë ideo-emocionale, sjell si rezultat formalizmin e tematikës jashtë së vërtetës reale, jashtë atmosferës jetësore. Prandaj pasqyrimi i tablove të mëdha të jetës dhe rolit të heroit pozitiv, kanë të bëjnë me probleme thelbësore të metodës së realizmit socialist.

Konceptimi i drejtë i këtyre detyrave nga ana jonë, pa tjetër do të na çojë edhe në gjetjen e rrugëve të reja në përputhje me vetë kërkesat e masave të gjera që duan të shohin dhe ta ndiejnë heroin e epokës së Partisë është siç është, me ato virtyte të larta morale e revolucionare.